

Bordi Editorial

PROF. DR. TONIN GJURAJ, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

FATOS TARIFA PH.D., *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR. ERLETA MATO, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

STEPHANIE SCHWANDNER-SIEVERS, *University of Roehampton, Britani e Madhe*

PROF. ASOC. ÇAPAJEV GJOKUTAJ, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

Kryeredaktore

ODETA BARBULLUSHI, PH.D.

Redaktorë shkencorë

PROF. DR. PËRPARIM FUGA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR. ALEKSANDËR DHIMA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

VALBONA NATHANAILI, DREJTORE UET PRESS

Redaktorë

DOKT. ANJEZA XHAFERAJ

DOKT. DORINA NDOJ

Arti grafik

DRITAN LLESHI

përmbajtja

<i>Qeverisja e mirë: "Imazh përfaqësimi" për shoqërinë civile në Shqipëri.</i> Marcela MELE, Ph.D, Erion CUKU, MA.....	5
<i>Te aven saste sare oroma: Aspekte të zhvillimit njerëzor të romëve të Shqipërisë.</i> Dr. Ilir GËDESHI, Prof. Dr. Kosta BARJABA.....	19
<i>Ligji i hekurt i oligarkisë. Vështrim mbi demokracinë e brendshme të partive shqiptare.</i> Ina K. ZHUPA.....	39
<i>Instrumentet e Diplomacisë parlamentare: Rasti i Italisë.</i> Ervis ILJAZAJ, PhD.....	53
<i>A e zvogëlon Traktati i Lisbonës rolin e Shtetit për një Politikë të Jashtme të përbashkët?</i> Dokt. Eglantina GOLEMI, Erjona CANAJ, PhD.....	65
<i>Amerikanizimi i fushatës elektorale në Shqipëri</i> Rrezart LAHI.....	81
<i>Transformimet gjuhësore morfologjike dhe sintaksore, një domosdoshmëri në komunikimin mes dy identiteteve të ndryshëm</i> Holta HEBA.....	91
<i>Roli i të tretit ndërmjetësues në zgjidhjen e konflikteve jashtëgjyqësore</i> Erjona CANAJ, Ph.D, MSc. Emiliano ALIU.....	99
<i>Ndikimi i zhvillimit të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore tek veshjet qytetare</i> Alfred NINI.....	113
<i>Marrëdhëniet politike mes Shqipërisë dhe Kinës në vitet '70</i> Alba KREKA.....	127
<i>Shoqëria Botërore: Kushtëzimi nëpërmjet "Qeverisjes së Mirë"</i> Dorina NDOJ.....	141
<i>Abstracts.....</i>	153

Botime të kolanës "REVISTA SHKENCORE".

© 2014 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar "Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Punimet e paraqitura shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të autorëve.
Redaksia nuk mban përgjegjësi për sa autorët kanë shprehur në shkrimet e tyre.

Universiteti European i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare "UET Press"

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

odeta.barbullushi@uet.edu.al

www.uet.edu.al/uetpress

Revista është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit European të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare

"UET Press" është pjesë e

Universitetit European të Tiranës.

Tiranë, vjeshtë 2014.

Qeverisja e mirë: “Imazh përfaqësimi” për shoqërinë civile në Shqipëri.

Marcela MELE, Ph.D

Erion CUKU, MA

Abstrakt: *Shoqëruar nga një lëvizje e përgjithshme në botën industriale, qeverisja ka qenë fokusi kryesor në debatin e zhvillimit në fillim të viteve '90-te, jo vetëm në lidhje me nevojën e ristrukturimit të organizimit të qeverisjes globale, por gjithashtu dhe në lidhje me ri-strukturimin e shtetit dhe lidhjeve shtet-shoqëri brenda këtyre vendeve si një kusht bazë për zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë artikull paraqitet evoluar mendimi i disa politologëve për shtetin dhe mënyrën e qeverisjes, rolin e shoqërisë civile dhe veçanërisht rëndësinë e qeverisjes ‘së mirë’ për një zhvillim të qëndrueshëm. Koncepti i ‘qeverisjes së mirë’, ideuar nga Deklarata e Rio-s dhe Banka Botërore në vitin 1992 dhe përshtatur nën përjasjen e zhvillimit neoliberal, nëpërmjet mekanizmeve të saj strategjike, kontribuon në angazhimin afatgjatë të kohëncës politike përmes një procesi të hapur, transparent, gjithëpërfshirës me palët e interesuara për të sjellë strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm më afër komunitetit dhe shoqërisë civile. Në këtë kontekst propozohet si metodologji analiza e përmbajtjes tematike, se si një ‘qeverisje e mirë’, reflekton në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm. Studimi thekson se mekanizmat strategjike janë të nevojshme për të shpërndarë praktika të mira dhe për t’i sjellë strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm më afër njerëzve, në format që ato i kuptojnë dhe përdorin për të ndryshuar sjelljen e tyre në një më të qëndrueshme. Ky studim hap rrugë për studime të ardhshme në reflektimin e qeverisjes së mirë në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm, në bazë të qasjeve dhe metodologjive të ndryshme.*

Fjalët kyçe: *Qeverisja e mirë, strategji e zhvillimit të qëndrueshëm, shoqëri civile, analiza e përmbajtjes tematike, Shqipëria.*

Hyrje

Qeverisja e mirë është një mjet i rëndësishëm për avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konsiderohet një element i rëndësishëm që duhet të përfshihet në strategjitë e zhvillimit. “Qeverisja e mirë promovon llogaridhënie, transparencë, efikasitet dhe sundim të ligjit në të gjitha nivelet dhe lejon menaxhim të burimeve natyrore, njerëzore, ekonomike dhe financiare të barabartë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke garantuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes” (Frey, 2008: 40). Qeverisja e mirë dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë dy koncepte të lidhura ngushtë. Megjithëse qeverisja e mirë nuk garanton zhvillim të qëndrueshëm, mungesa e saj e kufizon mungesa e saj e kufizon këtë zhvillim.

Në këtë artikull ne përpiqemi të ofrojmë një fazë për diskutim, duke eksploruar disa nga mënyrat sesi përdoret qeverisja në lidhje me strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë diskutim lind pyetja se si dhe në çfarë mase qeverisja e mirë mund të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm dhe si pasqyrohen strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm në rastin shqiptar. Fillimisht prezantohen disa konsiderata të përgjithshme teorike në lidhje me qeverisjen, shoqërinë civile para dhe pas viteve '90-te dhe lidhjen e tyre me zhvillimin e qëndrueshëm në rajon. Pjesa e dytë ofron një reflektim të qeverisjes në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm në vendet në zhvillim, duke përdorur si metodologji analizën tematike të përmbajtjes. Punimi përfundon me një pjesë të konkluzioneve në lidhje me studimin, dhe disa implikime për hulumtime të mëtejshme për modele si vendi ynë.

Një vështrim i përgjithshëm

Përdorimi i termave ‘qeverisje’, ‘qeverisje e mirë’ dhe ‘qeverisje për zhvillim të qëndrueshëm’ është rritur ndjeshëm kohët e fundit. Megjithatë, përveç pranimit të rëndësishëm të tij, mbizotërojnë dallime në lidhje me formulimet teorike, recetat e politikave dhe të konceptimit mbi përkufizimin përfundimtar të vetë termit ‘qeverisje’. Sipas programit të zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP, 1997) termi “qeverisje” nënkupton ushtrimin e autoritetit ekonomik, politik dhe administrativ për të menaxhuar punët e një shteti në të gjitha nivelet, nëpërmjet të cilit qytetarët dhe grupet artikulojnë interesat e tyre, ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore. Koncepti i qeverisjes interpretohet edhe në lidhje me politikëbërjen e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal (Berger, 2003) ose në lidhje me sundimin e ligjit (Sachiko dhe Durwood, 2005). Bashkimi Europian (2001) përcakton parimet e qeverisjes së mirë duke deklaruar se elementet kryesore për një kuptim të plotë të qeverisjes janë: sinqeriteti, pjesëmarrja, llogaridhënia, efikasiteti dhe koherenca.

Pa marrë parasysh se qasjen dhe interpretimin i saj, ekziston një konsensus

ndërkombëtar për të promovuar qeverisjen si një bazë për zhvillim. Sfidat që përballen të gjitha shoqëritë, është forcimin e institucioneve, proceseve dhe mekanizmat që mundësojnë pjesëmarrjen e plotë të qytetarëve në vendosjen e një programi për zhvillimin e qëndrueshëm. Diversiteti mund të manifestohet nëpërmjet mekanizmave të demokracisë, duke lejuar të dëgjohet zëri i njerëzve dhe konflikt-interesat të zgjidhen në mënyrë paqësore (Wijkman, 1998). Qeverisja e mirë bazohet në bindjen se një sistem duke vendosur sovranitetin në duart e njerëzve ka më shumë gjasa për të investuar në njerëz, duke kanalizuar burimet publike në bazë arsimit, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet sociale.

Metodologjia

Në këtë diskutim kërkojmë të testojmë nëse qeverisja ‘e mirë’ parimisht mund të konsiderohet ‘një imazh përfaqësimi’ në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm në vendet në tranzicion, përfshirë dhe Shqipërinë në këtë grupim. Të paraprirë nga analiza tematike e literaturës paraqitur në pjesën e parë dhe të dytë të artikullit, objektivat konkretisht synojnë të përcaktohet nëse strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm ose SDS (Strategy of Sustainable Development) i referohen ndonjë angazhimi afat-gjatë dhe objektivave strategjike; të identifikohen mënyrat për promovimin e transparencës dhe angazhim publik; të vlerësohen nëse qasjet dhe strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm janë sjellë në nivelin e komuniteteve lokale dhe shoqërisë civile në përgjithësi. Për sa i përket aspektit metodologjik, hulumtimi është cilësor, kryesisht përshkruar, pasi studimi përshkruan se si është pasqyruar qeverisja e mirë në SDS. Ky hulumtim ka për qëllim të ofrojë një kuptim më të mirë se si është përdorur qeverisja e mirë në lidhje me shoqërinë civile. Si njësi e analizës, ne kemi parasysh literaturën referuar qeverisjes ‘së mirë’ dhe konceptet e lidhura me të; shoqëria civile dhe ri-përkufizim i saj pas viteve '90-të.

Qeverisja si koncept analitik

Qeverisja synon kuptimin e lidhjeve të brendshme ndryshuese midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe shoqërisë civile. Nisur nga një këndvështrim i shkencave politike, menaxhimit të zhvillimit dhe ekonomisë institucionale, koncepti i qeverisjes së mirë është ekuivaluar me ‘qeverinë’, duke qeverisjen ‘me një përkushtim të një qeverie eficiente dhe besueshme’ dhe roli kryesor i shtetit, si një agjensi menaxhuese, ‘si mënyrë ku pushteti ushtrohet me menaxhimin e resurseve ekonomike dhe sociale për zhvillim’ (Frey, 2008: 42). Praktika dhe nevoja e balancave politike të interesave dhe koncepteve të ndryshme dhe shpesh herë antagonistike ka influencuar në shfaqjen e qeverisjes së mirë. Mungesa e qeverisjes së mirë identifikohet si mungese progresi në zhvillim, pavarësisht transfertës së ndihmës. Pra, theksohet efekti anti-motivues

mbi njerëzit të përjasjes lart-poshtë, që konsiston më shumë në të kopjuarit sesa të adoptuarit e modeleve perëndimore.

Sipas një raporti të OECD-së (1995), me qeverisje të mirë kuptohet 'menaxhim efikas', në gjendje për të luftuar korrupsionin, për të ulur shpenzimet ushtarake dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke zbuluar perceptimin teokratik të pjesëmarrjes. Qeverisja e mirë dhe zhvillim i qëndrueshëm janë pjesë e agjendes së zhvillimit si strategji dhe domosdoshmëri për të mbështetur reformat neo-liberale të përshtatjes strukturore, megjithëse jo me synimin e sjelljes së emancipimit politik dhe social. Kjo strategji e dyfishtë e agjendës neo-liberale u shoqërua me strategji stimuluese të zvogëlimit të varfërisë, sikurse e thekson dhe Kjær (2004:15) si një përpjekje për të balancuar interesat e ndryshme dhe besueshmëritë me të cilat duhet të merren aktoret ndërkombëtarë, nëpërmjet agjencive financiare dhe zhvillimit multinacional. Nga ana tjetër për të siguruar legjitimitetin dhe një ambicie favorizuese të pranimit dhe kooperimit, duhet marre parasysh atë që Kjær e quan 'interesat globale' që janë interesat e komunitetit global të shteteve dhe shfaqja e shoqërisë civile globale. Këto aktorë më parë mbronin disa degë të industrisë, disa rregulla shtetërore dhe madje disa rregulla të tregut kapital dhe financiar, por gjithashtu dhe marrjen në konsideratë të çështjeve sociale dhe mjedisore.

Kontradiktat dhe konfliktet kryesisht rreth orientimit dhe efikasë administrative nga njëra anë, dhe uljes së varfërisë dhe forcimit demokratik nga ana tjetër shpesh çon në kundërshtim të grupeve të ndryshme. Megjithëse, ekziston një tendence, për të qenë më 'global', në praktike ekziston me shumë tendenca në ecjen sipas ideve neoliberalë. Megjithatë ajo që është e rëndësishme për shtetin është se, pavarësisht neutralitetit politik të aktorëve ndërkombëtarë, konceptet dhe diskutet zhvillimore janë të kontestuara në natyrën e çështjeve. Kjo kontraditë shfaqet në konceptin e qeverisjes së mirë, pavarësisht përkufizimit neutral të qeverisjes, ajo synon në ndikimin e proceseve vendim-marrëse politike dhe administrative, dhe aktin qeveritar duke ndikuar në marrëdhëniet ekzistuese të pushtetit brenda vetë shtetit.

Qeverisja e mirë përbëhet nga katër zona veprimi: menaxhim efikas i sektorit publik; besueshmëria e shtetit dhe aktit administrativ; transparenca dhe shpërndarja e aksionit, dhe të paktën një kuadër ligjor. Këto bazohen me tepër si mekanizma teknike që synojnë të përmirësojnë kushtet e zhvillimit ekonomik. Sipas Nanda (2006: 246) është pikërisht historia dhe kultura e çdo vendi që aktoret ndërkombëtarë nuk marrin parasysh, duke filluar me supozimin 'se ato janë përgjegjëse për ndryshim, shteti *pritës* vepron me "zgjedhje racionale". Janë pikërisht këto kushte politike dhe kulturore të çdo vendi dhe implementimet e tyre për procesin politik që gjeneron rezistencë dhe pengon implementimin e suksesshëm të reformave të qeverisjes së mirë. Sipas Nanda (2006: 275) dimensionin politik i qeverisjes së mirë bëhet evidente nëse shohim lloje të ndryshme të përdorimit

bazuar në konceptin e politikës zhvillimore: (1) si një kriter për fillimin e ndihmës financiare, për prishjen apo ndryshimin e saj; (2) si një objektivi për fuqizimin e organizatave shtetërore, praktikave demokratike ose përfshirja në organizatat e shoqërisë civile; dhe (3) si një instrument për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe uljen e varfërisë.

Kjo do të thotë nga njëra ana qeverisja e mirë, po bëhet një kriter shtesë në kushtëzimin për ndihmën zhvillimore dhe nga ana tjetër po bëhet një qëllim zhvillimi dhe fusha e aksionit të vetë ndihmës zhvillimore. Në të njëjtën kontekst, fuqizimi i demokracisë dhe pjesëmarrja hyn në diskursin e qeverise së mirë, ku jepet lidhja esenciale e qeverisjes së mirë, me zhvillimin e qëndrueshëm dhe shoqërinë civile globale. Në mbështesim idenë se qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar janë esenciale për një rritje ekonomike të qëndrueshme, zhvillimin e qëndrueshëm dhe uljen e varfërisë. Prandaj, Hoebink në supozimin e tij, me të drejtë thekson se "një kujdes i veçantë duhet lidhur me konceptin e qeverisjes së mirë, kriter për fillimin, ndryshimin apo prishjen e ndihmës financiare ndaj komuniteteve" (Hoebink, 2006: 156), ndërsa nuk ka evidencë të qarta empirike mbi lidhjen e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit ekonomik ose përdorimin efektiv të asistencës zhvillimore.

Qeverisja e mirë brenda konceptit neoliberal të zhvillimit dhe reformave territoriale

Në politikën ekonomike, qeverisja 'e mirë' konsiderohet si një kompliment esencial. Lindja e konceptit dhe praktikës moderne të 'qeverisjes' sipas Foucault (1978:12) ndihmon për një analizë kritike të raporteve që thuren midis politikës dhe neoliberalizmit ekonomik në botën e sotme. Në analizat e tij, Foucault përpiqet të nxjerr në pah veçantinë dhe risinë e 'artit të qeverisjes' që u formësua në fillimet e modernitetit dhe vë në pah ndikimin që ushtroi praktika pastorale të ky art i qeverisjes. Duke marrë parasysh domosdoshmëritë e realitetit modern, "shteti shihej edhe si objektivi që duhej të arrihej në sajë të veprimit të artit të qeverisjes. Të menduarit politik, si teori, lidhet me realitetin dhe praktikën politike". Këtë lidhje Foucault e vë në dukje kur trajton raportin midis arsyes së shtetit dhe shtetit modern kundrejt praktikave apo "teknologjisë politike".

Në një vështrim analog, Fukujama (2008:98), në analizën që i bën ndërtimit të shtetit, vë në dukje faktin se "shtetet mbeten ende të rëndësishme dhe se shumë prej problemeve të sotme – nga lufta kundër SIDA-s deri tek terrorizmi – i atribuohen dështimit në ndërtimin e shtetit dhe 'qeverisjes së paefektshme'". Kjo përbën një shmangie nga nocioni tepër i thjeshtësuar i 'shteteve minimale' që dominoi debatin rreth zhvillimit deri në mes të viteve '90-të. Prandaj, qëllimi i vendeve të dobëta duhet të jetë gjetja e mënyrës optimale të ndërtimit të shtetit dhe përhapja ndër

to e qeverisjes efikase. Kjo shërben si pikënisje për studimin tonë përqendruar në rastin shqiptar, një vend tranzitor, që përqafoi idetë neoliberale jo më shumë se dy dekada më parë.

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm ka pasur një ndikim të rëndësishëm në axhendën ndërkombëtarë. Megjithatë të gjitha konceptet që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, më e përcaktuara mbeten konceptet në kërkim të zbatimit dhe, ashtu sikurse thekson Strandeneas (2011:97) sistemet e qeverisjes janë të nevojshme në të gjitha nivelet për të udhëhequr të tilla zbatime. Sikurse u tha dhe në seksionin e mësipërm, qeverisja përcaktohet dhe përdoret në shumë mënyra dhe në kontekste të ndryshme. Pavarësisht nga sugjerimet e ofruara, ende, nuk ka marrëveshje të përbashkët si të përkufizohet qeverisja për zhvillimin e qëndrueshëm. Sfida kryesore është që formësimi i llojit të qeverisjes, si një parakusht, dhe ndoshta një produkt i hapave drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Për të adresuar çështjet gjithnjë e më komplekse të zhvillimit të qëndrueshëm, është e nevojshme *një qasje strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm ose SDS* (Sustainable Development Strategies) nëpërmjet diskutimit, pjesëmarrjes dhe procesi i diskutimeve për arritjen e objektivave ekonomike, mjedisore dhe sociale në mënyrë të balancuar dhe të integruar në nivel kombëtar dhe lokal. SDS mund të konsiderohet si një mjet për të informuar vendim-marrjet që ofron një kornizë për të menduarit sistematik në të gjithë sektorët dhe territorin, duke ndihmuar për të institucionalizuar proceset për konsultime, negociata, ndërmjetësim dhe ndërtimit të konsensusit për çështjet prioritare të shoqërisë ku interesat ndryshojnë.

Kështu, SDS-të lëvizin nga zhvillimi dhe zbatimi i një plani të caktuar, në drejtim të një sistemi adaptiv që përmirësohet vazhdimisht. Siç përmendet dhe nga Kemp, Parto dhe Gibson (2005:23), sfida më e rëndësishme është të sigurohet se regjimet e qeverisjes mishërojnë kapacitete për qëndrueshmëri me koordinim të orientuar, drejtim dhe ri-drejtim dhe të sigurojë një koherencë të arsyeshme të vizionit dhe angazhimit. Qëndrueshmëria kërkon integrimin e politikave, së bashku me ndërveprimin midis institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare dhe krijimin e një pikëpamjeje afat-gjatë në qeverisje. Përpjekjet për integrimin e politikës janë të nevojshme, sepse zhvillimi i qëndrueshëm përfaqëson shumë më tepër se një plan menaxhimi mjedisor dhe politikat sektoriale. Në këtë drejtim, është e nevojshme matja e decentralizimit nëpërmjet integritit të objektivave dhe zbatimeve si 'vertikalisht' (përmes niveleve ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale të qeverise) dhe 'horizontalisht' (përmes entiteteve të një shkalle/niveli, të qeverise). Lafferty (2002) ofron disa sugjerime për integrimin vertikal dhe horizontal të politikave brenda një territori. Për integrimin vertikal ai rekomandon specifikimin e politikave dhe aktivitetëve administrative-territoriale, krijimin i një sistemi dialogu dhe konsultimi, plane veprimi, dhe programe monitorimi. Për integrimin horizontal, ai propozon përdorimin e strategjive afatgjata të qëndrueshmërisë organe të veçanta qeverisë, me një koordinim e përgjithshëm të procesit të integritit, programet e

komunikimit dhe planet e veprimit kombëtar.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i qeverisjes se mirë është sigurimi i transparencës dhe angazhimi publik aktiv në procesin e vendimmarrjes. Parimi 10 i Deklaratës së Rios (1992) prezanton përgjegjshmëri, transparencë dhe fuqizimin demokratik në vendimmarrje për çështje sociale dhe politike. Në një studim të Institutit të Bankës Botërore (2005), thuhet se me anë *qasje në informacione* në lidhje me ndikimet politike, qytetarët janë në gjendje të sfidojnë qeveritë dhe të marrin vendime që reduktojnë fuqinë e pushtetit qendror. Nëpërmjet pjesëmarrjes, qytetarët (shoqëria civile) angazhohen në mënyrë aktive duke bërë konsultime dhe dialog, dhe propozime konstruktive në mënyrë që planifikimi dhe legjislati të pasqyrojë më mirë nevojat e tyre. Përmes *qasjes në drejtësi*, qytetarët synojnë të mbrojnë aksesin e tyre në informacion dhe pjesëmarrje, dhe të kundërshtojnë vendimet që nuk marrin parasysh nevojat e tyre. Zhvillimi i qëndrueshëm është i një rëndësie kritike për të gjithë qytetarët, si ajo angazhohet zgjedhje prekin aspekte thelbësore të jetesës tonë. Në këtë kontekst, arritja e zhvillimit të qëndrueshëm varet se çfarë lloj roli luan shoqëria për të arritur një konsensus lidhur vizion të qëndrueshëm të zhvillimit, qëllimet dhe objektivat, pavarësisht nga interesat ekonomike, mjedisore dhe sociale. Përpjekja për të angazhuar të gjithë qytetarëve në mënyrë efektive arrihet në trinomin *Qeveri-Sektor i biznesit-Shoqëria civile*. Makineria formale e artit të qeverisjes shpesh ka treguar kufizimet e saj dhe shpesh here mungojnë procedura vendimmarrje të qarta në nivelin e autoriteteve publike dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset e vendim-marrjes (Morita & Zaelke, 2002). Zgjerimi i pjesëmarrjes së shoqërisë në përgjithësi është një çështje kyçe, ndërsa, suksesi i strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm varet nga njerëzit, sesi ata përgjigjen dhe të reagojnë në të.

Kuptimi i Shoqërisë civile në lidhje me "zhvillimin e qëndrueshëm"

Termi "shoqëria civile" është një koncept modern edhe pse, si të gjithë idetë politike, ajo mund të jetë shfaqur që në periudhën e Aristotelit. Për mendimtarët e hershme moderne, nuk kishte asnjë dallim midis shoqërisë civile dhe shtetit. Shoqëria civile, është një shoqëri e qeverisur nga ligjet, e bazuar në parimin e barazisë para ligji, në të cilin të gjithë janë subjekt të ligjit, me fjalë të tjera, një kontratë shoqërore midis anëtarëve individualë të shoqërisë. Ishte Hegeli, i cili përkufizoi shoqërinë civile si fushë e ndërmjetme mes familjes dhe shtetit, ku individit bëhet person publik dhe, nëpërmjet anëtarësimin në institucione të ndryshme, ishte në gjendje për të zgjidhur situata të veçantë dhe universale (Comaroff, 1999: 03).

Përkufizimi mbi 'shoqërinë civile' u ngushtua përsëri në shek XX, kur shoqëria civile nuk ishte një marrëdhënie vetëm midis shtetit dhe familjes, por filloi të zërë hapësirë në fushën e kulturës, ideologjisë dhe debatet politike. Politologu Gramsci ngriti shqetësimin e tij me pyetjen se pse ishte shumë më e lehtë të ketë një revolucion

komunist në Rusi se sa në Itali. Përgjigja e tij ishte pikërisht *shoqëria civile*. Në Itali, theksoi ai, “nuk kishte një lidhje e duhur mes shtetit dhe shoqëri, dhe kur shteti u drodh, një strukturë e guximshëm nga shoqërisë civile ishte shpallur menjëher ë.” (Ehrenberg, 1999: 209). Ndryshimi i përkufizimit të shoqërisë civile shprehën në mënyra të ndryshme si: pëlqimi i saj përgjithësuar në periudha të ndryshme, si dhe çështje të ndryshme që ishin të rëndësishme në kohë të ndryshme. Me fjalë të tjera, shoqëria civile, është procesi në të cilën individët negociojnë, argumentojnë, luftojnë kundër ose bien dakord me njëri-tjetrin me pjesën qendrore të pushtetit politik dhe ekonomik. Nëpërmjet shoqatave vullnetare, lëvizjet, partitë, sindikatat, individi është në gjendje për të vepruar publikisht. Kështu, në periudhën e hershme moderne, shqetësimi kryesor ishin të drejtat civile, liria dhe frika. Prandaj në këtë kohë shoqëria civile ishte një shoqëri ku ligjet zëvendësohej me shtërngime fizike dhe arrestime arbitrare, etj. Në shek XIX, çështja ishin të drejtat politike, dhe aktorë të shoqërisë civile përfaqësoheshin nga borgjezia.

Në shek XX, lëvizja e punëtorëve sfidoi shtetin, dhe çështjet ekonomike dhe emancipimi social e ngushtuan më tej termin. Të gjitha këto përkufizime e konceptuan shoqërisë civile të lidhur ngushtë me shtetin territorial. Gjithashtu dhe me shoqëritë para moderne, të cilat nuk kishin një shtet dhe nuk kishin konceptin e individualizmit. Shumë teoricienë të shoqërisë civile besonin që shoqëria civile në ‘shtëpi’ ishte e lidhur për luftë edhe jashtë vendit. Ajo kishte aftësia për t’u bashkuar kundër një armiku të jashtëm dhe që e bëri shoqërinë civile të ekzistojë. Kështu, sipas pikëpamjes së Ferguson, mendimtar iluminist skocez në libri i tij “Ese mbi historinë e shoqëri civile”, shoqëria civile, krahas shtetit dhe tregut ekonomik është elementi i tretë përbërës i shoqërisë. Ai ishte thellësisht i shqetësuar për individualizmin modern, dhe donte për të zhvilluar një qasje shkencore për studimin e fenomene sociale dhe kjo realizohej nëpërmjet studimit empirik të shoqërive të tjera (Kaldor, 2003: 585).

Për të kuptuar evolucionin e shoqërisë, ai ndërmoi raste studimore në malet e Skocisë dhe tek Indianët e Amerikës së veriut dhe u bind që shoqëria moderne e kishte humbur shpirtin e komunitetit, ndjeshmërinë natyrore dhe dashurinë mes qenieve njerëzore. Ai besonte, duke marrë shembullin e Spartës, se, rrënjosja e patriotizmit dhe shpirti luftarak ishte një mënyrë për të kapërcyer rreziqet e individualizmit. Një mbështetës i këtij argumenti ishte dhe Hegeli. Sigurisht, jo të gjithë teoricienët e shoqërisë civile morën këtë pikëpamje, Kant ishte përjashtimi më i rëndësishëm, duke besuar se kushtetuta e përsosur e shtetit do të mund të arrihet vetëm në kontekstin e një shoqërisë civile universale.

Sipas, Putnam (1993: 132), akti themelor i qytetarisë në një demokraci pluraliste është formimi i një shoqate që ka për detyrë mbajtjen dhe ripërcaktimin e kufijve mes shoqëria civile dhe shtetit përmes proceseve ndërvepruese të zgjerimit të barazisë dhe lirisë sociale, dhe ristrukturimi dhe demokratizimi i institucioneve shtetërore. Kjo shpjegon rëndësinë e shoqërisë civile në demokraci që mbështetet

jo vetëm nga teoria sociale dhe politike, por dhe me evidenca empirike. Në një shoqëri demokratike, qytetaret kanë njohuri për këto ide sikurse shfaqen përditë në diskutimet politike, në debatet rreth domethënie dhe bazave të të drejtave e lirive kushtetuese. Ato ide që përdoren për të organizuar dhe strukturuar në tërësi drejtësinë si paanshmëri i konsiderojmë ide themelore. Ideja më themelore në këtë koncept të drejtësisë është ajo e shoqërisë si sistem i paanshëm kooperimi social në rrjedhë të kohës nga një brez në tjetrin. Ajo shërben si ide organizuese qendrore teksa orvatemi të shtjellojmë një koncept të drejtësisë për shoqërinë demokratike. Kjo ide qendrore përpunohet me dy ide themelore që janë: ideja e qytetareve (e atyre që hyjnë në kooperim) si persona të lirë e të barabartë, dhe ideja e një shoqërie me rendin e duhur e një shoqërie efektivisht e rregulluar nëpërmjet një koncepti publik të drejtësisë. Këto ide intuitive themelore konsiderohen si të njohura në kulturën politike publike të një shoqërie demokratike. Po si ka evoluar dhe është ri-përkufizuar termi ‘shoqëri civile’ para dhe pas viteve ’90-të, me ndryshimin e sistemeve politike dhe përqafimin e ideve neo-liberale perëndimore?

Shoqëria civile para viteve ’90

Ideja dhe rikonceptimi i idesë së shoqërisë civile në vitet 1970-’80 lindi në të njëjtën kohë në Amerikën Latine dhe Evropën Lindore. Në të dy rastet, koncepti ‘shoqëri civile’ provoi një dobishmëri në kundërshtim të regjimeve të militarizuara. Amerikanët latine ishin kundër diktaturat ushtarake dhe Evropianët lindorë iu kundërvënë totalitarizmit. Të dy erdhën në konkluzionin e rrëzimit të regjimeve të tyre ‘nga lart’. Përpjekjet për të sjellë ndryshimin nga lart, si në rastin e Hungarisë në 1956 apo Çekosllovakisë në 1968 kishin dështuar, dhe se e vetmja strategji e mundshme ishte ndryshimi nga poshtë, duke ndryshuar marrëdhëniet mes shtetit dhe shoqërisë (Michnik, 1985: 75). Ajo që nënkuptohej me shoqërinë civile ishte autonomia dhe vetë-organizimi, por dhe një tërheqje nga shteti.

Si rezultat i zgjerimit të komunikimit, teknologjisë, shoqëria civile mori një kuptim global, bazuar në mbështetjen e grupeve të të drejtave të njeriut duke i suportuar financiarisht dhe duke publikuar rastet e tyre dhe duke vendosur presion mbi qeveritë dhe institucionet. Me fjalë të tjera, nëpërmjet lidhjeve ndërkombëtare dhe apelit për autoritet ndërkombëtar, këto grupe krijuan hapësirë politike. Sipas Havel-it, (1985: 90) në një demokraci, njerëzit duhet gëzojnë liri dhe siguri që nuk janë të panjohura për ne, por janë të paafte për të mbrojtur shqetësimet e tyre në lidhje me identitetin e tyre. Sipas Kalderit (2003: 291) mendohet se shoqëria civile merr *një përfaqësim të ri*, si një lëvizje drejt rregullave dhe institucioneve globale. Megjithatë, disa mendojnë se revolucionet e 1989-se nuk sollën ide të reja, dhe ata që përqafuan këtë lëvizje donin vetëm të imitonin perëndimin, kjo lëvizje pati jehone në aspektin global.

Me ndryshimin e sistemeve politike pas vitit 1989, koncepti shoqëri civile globale ndryshoi kuptimin e saj dhe kuptohet në mënyra të ndryshme. Fjala *global* është huazuar nga të ashtuquajturat 'lëvizje të reja sociale' që u zhvilluan pas '68-s dhe që u përqendruan në çështje të reja, si paqja, gratë, të drejtat e njeriut, mjedisi, dhe forma të reja të protestës. Kohët e fundit është krijuar një sistem në të cilin shtetet rrethohen nga një grup marrëveshjesh, dhe rregullash me karakter ndërkombëtar. Gjithnjë e më shumë, këto rregulla nuk janë të bazuara vetëm në marrëveshje midis shteteve, por në mbështetje publike, të krijuara përmes shoqërisë civile globale. Me fjalë të tjera, shoqëria civile globale është një platformë nga aktivistët, OJQ-të dhe neoliberalistët, si dhe të grupe kombëtare dhe fetare, ku ata argumentojnë rreth fushatës për (ose kundër), negociojnë në lidhje me, ose llojnë për marrëveshje që i japin formë zhvillimeve globale. Nga njëra anë, kjo është arsyeja për krizën në institucionet shumëpalëshe. Në anën tjetër, një ndjeshmëri e re për të drejtat e shoqërisë civile duhet të ofroje mundësinë e një sistemi të institucioneve që të veprojnë mbi bazën e reflektimit, në vend se, si në të kaluarën, pëlqim për hegjemoninë amerikane. Ideja e shoqërisë civile globale është një ide emancipuese, i cila lejon çdo individ të angazhohet në këtë debat.

Reflektim i qeverisjes së mirë në strategjitë e shoqërisë civile: Rasti shqiptar.

Pranimi i mirëqeverisjes nga komuniteti ndërkombëtar ofron zgjidhje me alternativa, fleksibilitet dhe mundësi për inovacion, mbështetje të pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe shmangien e përjasjes 'përshtatje 100%' duke gjetur shprehje në rastin shqiptar. Megjithatë, format e qeverisjes 'së mirë' në shumë aspekte hasin vështirësi. Siç është ilustruar nga Dodds (2007), sistemi është me shumë i fragmentuar sesa dinamik, me shumë llojshmëri organizatash të hartimit të politikave, mekanizma financimi dhe projekte të zbatimit përpjekjet e të cilëve nuk kanë komunikim, janë shpesh të koordinuar dobët dhe ndonjëherë mbivendosi, duke gjeneruar sfida të rëndësishme në lidhje me kapacitetet administrative dhe potencialin e zbatimit. Megjithatë, duhet përpjekje për të imponuar uniformitetin politik dhe social në një botë aq të ndryshme si kjo e jona. Shoqëritë duhet të jenë të lira për të kërkuar zgjidhje që janë unike për rrethanat e tyre. Është e vërtetë se përpjekjet e zhvillimit të pakoordinuara në nivelin lokal nuk do të jenë të qëndrueshme, dhe efektive me kalimin e kohës. Qeverisja lokale në mënyrë aktive përfshin një gamë të gjerë të aktorëve të sektorit publik, privat dhe vullnetar në zbatimin e politikave në terren. Studimet e fundit, theksojnë rolin e pushtetit lokal në marrjen e udhëheqjes për zbatimin e iniciativave të reja në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm, si

institucionet në nivel lokal janë ngjarje, të cilat reflektojnë nevojat dhe aspiratat e njerëzve dhe mbështeten gjithashtu nga pjesëmarrja publike. Në dhjetëvjeçarin e fundit ka një përfshirje të gjerë publike në procesin e hartimit dhe zbatimit të SDS-ve, nën formën e konferencave, seminareve, forumeve, konsultimeve on-line, ku marrin pjesë aktorë nga institucionet shtetërore, të biznesit dhe industrisë, OJQ-të dhe komunitete të ndryshme. Ne konsiderojmë se këto aktivitete të përhapen dhe të shkëmbejnë praktika të mira në këtë drejtim. Një çështje tjetër që tregon dobësi në zbatimin strategjik në qasjet e qeverisjes së mirë referohet faktit se preferohet një qasje nga lart-poshtë, në vend të një një poshtë-lartë, në zbatimin e SDS dhe më shpesh komunitetet lokale nuk kanë SDS e tyre ose nuk e sinkronizuar e tyre strategjive me NSDS.

Në kushtet e koherencës politike, mekanizmat e koordinimit horizontale, me qëllim për të përfshirë çështjet ekonomike, mjedisore dhe sociale në preokupimet strategjike të sektorëve të ndryshëm, duhet të jetë funksionimi më i mirë se sa mekanizmat e koordinimit vertikal, ku vetëm disa nga vendet e BE-se kanë zhvilluar trupat formale në krye të koordinimit në nivelet kombëtare dhe nën-kombëtare në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm, ndërsa të tjerët përfshijnë nivelet nën-kombëtare në procesin e konsultimit në mënyra më pak formale. Prandaj, ne sugjerojmë se për suksesin e strategjive do të jetë e nevojshme disa rregullore për të rritur mekanizmat vertikale koordinues.

Qeverisja e mirë - "imazh përfaqësimi" për shoqërinë civile në zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri

Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon hartimin e të gjitha vendimeve të politikës në mënyrë që të arrihet një bilancë e duhur midis pasojave sociale, ekonomike dhe mjedisore afat-gjatë. Në kushtet e koherencës politike, analizuar dy dimensionet e tij: integrimin vertikal dhe horizontal. Integrimi vertikal është pengesë, ku të gjithë llojet e ndryshme të situatave në lidhje me ekzistencën dhe funksionimi i mekanizmave formale strategjike kanë për qëllim për të koordinuar lidhje midis niveleve kombëtare dhe rajonale në zbatimin e SDS-ve. Në përgjithësi, mund të krijohen dy lloje situatash. Njëri, është ai i vendeve që kanë mekanizmat strategjike dhe tjetri janë organet formale përgjegjës për koordinimin në nivelet kombëtare dhe rajonal në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm, si në rastet e Letonisë, Suedisë dhe Britanisë së Madhe. Konkretisht, mund të përmendim se në Letoni ka një këshill kombëtar zhvillimi, të ngritur për koordinimin e zhvillimit të shtetit me qëndrueshmërinë vënë në thelbin e vet, me anëtarë nga ministrat, por edhe nga autoritetet rajonale, komunat lokale shoqatat dhe institucionet kryesore publike. Në Suedi ekziston një komision për zhvillim të qëndrueshëm, një autoritet formal përgjegjës për organizimin e seminareve dhe duke ofruar një mundësi e

bashkëpunimit midis niveleve të ndryshme politike.

Në Shqipëri ende nuk ka organe formale koordinimi mes niveleve kombëtare dhe rajonale, ku nivelet rajonale të përfshihen në procesin e konsultimit. Mund të marrim rastin analog, Danimarkën, ku nivelet rajonale përfshihen në procesin e konsultimit dhe bashkëpunimit kanë SDS e tyre, por nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë midis këtyre strategjive dhe grupet e interesit janë të përfshirë në tryeza të rrumbullakëta, një forum on-line për të dhënë mendime, sugjerime. Analiza tregon se ka një koherencë më të mirë në aspektin e koordinimit horizontal, ku objektivat zbatohen duke përfshirë çështjet mjedisore, ekonomike dhe sociale në strategjitë e ndryshme sektorët ekonomikë dhe rajonale. Ne kemi identifikuar disa mekanizma koordinuese për integrimin horizontal: njësia e Koordinimit për Zhvillim të Qëndrueshëm në bashkëpunim me grupet e punës ndër-dikasteriale përfshijnë të gjitha ministrinë, si në rastin e Suedisë. Procesi i pjesëmarrjes së hapur, transparenca publike, ndërsa zhvillimi dhe zbatimi e SDS është një tjetër formë në të cilat qeverisja mund të provojë efektivitetin e saj. Në rastin shqiptar mund të jenë forma të ndryshme: një Komision këshillues për zhvillimin e qëndrueshëm, me përfaqësues të ministrive kombëtare, të sektorit të biznesit, OJQ-ve dhe komunitetit kërkimor, si një forum për diskutime, analiza dhe dialogu me qëllim të stimulimit diskutim më të gjerë në shoqëri në zhvillimin e qëndrueshëm dhe strategjive të veprimit ndër-sektoriale (Suedi); shumë forume rajonale dhe një forum kombëtar përfshirë më shumë se 1000 njerëz, duke diskutuar prioritetet specifike për zhvillim të qëndrueshëm dhe të çon në një përmirësimin e draftit final të strategjisë (Letoni), organizimi dhe dialogje të drejtpërdrejta me grupet e të rinjve, autoritetet rajonale, biznesi dhe industria, procesi i konsultimit on-line me profesionistë dhe ekspertë. Grupe interesi janë dhe organizatat shoqërore, përfaqësues të ekonomisë, sferat lokale qeveritare dhe civile, këshilli kombëtar i zhvillimit të qëndrueshëm, i përbërë nga përfaqësues që vijnë nga sektori shtetëror, sektori ekonomik, OJQ-sociale të komunitetit dhe sektorit akademik, si një forum për konsultime dhe dialogu në çështjet lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm. Me rendësi është pjesëmarrja në zhvillimin e programeve të qëndrueshme të politikave të zhvillimit dhe suksesi i një SDS-je varet sesa u afrohet dhe u shërben njerëzve në komunitetet lokale.

Në vend të konkluzionit

Ky studim kontribuon në pasqyrimin e qeverisjes së mirë në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo ese hap rrugë për studime të ardhshme në reflektimin e qeverisjes 'së mirë' në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm, në bazë të qasjeve dhe metodologjive të ndryshme. Njëpërmjet aplikimit të konceptit "zhvillim i qëndrueshëm" synohet ngritja e mirëqënies së qytetarëve dhe me një impakt të

drejtpërdrejtë në nivelin e qeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve urbane. Për të arritur qëllimet e saj, në të gjitha nivelet, nga globale në atë lokale, strategjitë e zhvillimit duhet të jenë të qëndrueshëm, me objektiva të qarta dhe plane veprimi. Roli i qeverisjes së mirë në lidhje me strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm është krijimi i një kuadër të nevojshëm angazhimi strategjik afatgjatë, konkretizuar në objektivat strategjike, mekanizma integruese të politikës në drejtim të vertikal dhe horizontal koordinimi, konsultimi publik dhe proceset e pjesëmarrjes dhe angazhimit për të bërë SDS të arritshme në komunitetet lokale. Qeverisja e mirë duhet të promovojë llogaridhënie, transparencë, efikasitet dhe sundim të ligjit në të gjitha nivelet dhe lejon menaxhim të burimeve natyrore, njerëzore, ekonomike dhe financiare të barabartë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke garantuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes. Studimi mbi reflektimin e qeverisjes së mirë në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm të rastit shqiptar zbulon që në përgjithësi, organizimi administrativ dhe legjislativ duhet të angazhohen dhe punojnë në mënyrë me efikasitet për një zhvillim të qëndrueshëm afat-gjatë.

Në një demokraci, mënyra me e mirë për një qeverisje të mirë është forcimi i një shoqërie civile, përmes zgjerimit të proceseve të barazisë dhe lirisë sociale. Sundimi i ligjit sjell siguri dhe parashikim për çështjet socio-ekonomike dhe politike si një gur themeli i qeverisjes së mirë, si dhe llogaridhënie në punët publike, përpjekjet për të nxitur transparencën, decentralizimin dhe një rol në rritje për shoqërinë civile. Ky ri-strukturim dhe demokratizim i institucioneve shtetërore, sjell një zhvillim të qëndrueshëm, jo vetëm nga teoria sociale dhe politike, si dhe me evidenca empirike. Ajo që realisht duhet të theksohet është fakti se si shoqëria civile mund të bindë shtetin për të miratuar një alternativë për çështje që prekin drejtpërdrejt komunitetin. Rasti i protestave kundër ardhjes së armeve kimike në Shqipëri, shpjegon, se transparenca e qeverisjes nuk u sjell afër me shoqërinë civile, të cilët janë praktikisht përgjegjës për ndryshimin e sjelljes së tyre në një më të qëndrueshme. Sipas analizave tona, kjo është një temë e ndjeshme dhe kërkon shumë vëmendje.

Bibliografia

- Berger, G. (2003). "Reflections on Governance: Power Relations and Policy Making in Regional Sustainable Development", *Journal of Environmental Policy & Planning*, 5 (3) 349-365.
- Comaroffa, L. J. (1999). *Civil Society and the Political Imagination in Africa: Critical Perspectives*. Chicago and London: University of Chicago Press.
- Ehrenberg, J. (1999). *Civil Society the Critical History of an Idea*, New York and London: New York University Press.
- Havel, V. (1985) 'The Power of the Powerless', in: Keane, J. (ed.) *The Power of*

- the Powerless: Citizens against the State in Central-Eastern Europe*, London: Hutchinson.
- Foucault, M. (2007). *Security, Territory, Population: Lectures at the Collège de France, 1977-78*, (ed) Michel Senellart. Translated by Graham Burchell, London: Palgrave Macmillan.
- Fukujama, F. (2008) *Ndërtimi i shtetit: Qeverisja dhe Rendi Botëror në Shek. XXI*. Tiranë: AIIS.
- Kaldor, M. (2003). "The Idea of Global Civil Society", *International Affairs* 79 (3), pp. 583-593.
- Kjær, A. M. (2008) *Governance*. Cambridge: Polity Press.
- Kemp, R., Parto, S., & Gibson, R.B. (2005). *Governance for Sustainable Development: Moving from Theory to Practice*. *International Journal of Sustainable Development*, 8 (1) 12-37.
- Lafferty, W. M. (2002). Adapting Government Practice to the Goals of Sustainable Development. *Expert Report for OECD seminar Improving Governance for Sustainable Development*, held 22-23 November 2001.
- Michnik, A. (1985). 'The New Evolutionism', in *Letters from prison and other essays*, Berkeley: University of California Press.
- Nanda, V. P. (2006) "The Good Governance, Concept Revisited", *ANNALS*.
- Sachiko, M. & Durwood, Z. (2005). Rule of Law, Good Governance and Sustainable Development, *Seventh International Conference on Environmental Compliance and Enforcement*.
- Strandeneas, J.G. (2011). *Sustainable Development Governance towards Rio+20: Framing the Debate*. SDG.
- UNDP (1997). *Governance for Sustainable Human Development*. UNDP Policy Paper. Marrë nga: UNDP Management Development and Governance Division: <http://magnet.undp.org/>
- Wijkman, A. (1998). Does Sustainable Development Require Good Governance? *UN Chronicle*, Spring.
- World Bank/The International Bank for Reconstruction and Development (1992). *Governance and Development*, Report no. 10650, Washington: *World Bank Publication*, ISBN – 0-8213-2094-7. Marrë nga: <http://documents.worldbank.org/curated/en/1992/04/440582/governance-development>

Te aven saste sare oroma¹: Aspekte të zhvillimit njerëzor të romëve të Shqipërisë.

_____ **Dr. Ilir GËDESHF** _____

_____ **Prof. Dr. Kosta BARJABA** _____

Abstrakt. Ky artikull trajton disa aspekte të zhvillimit njerëzor të popullsisë rome të Shqipërisë dhe bazohet, përveç burimeve bibliografike, në rezultatet e kërkimit shkencor në kuadrin e projektit *Roma Mapping të UNICEF-it (2011)*. Ky kërkim u shtri në të gjitha vendbanimet rome në Shqipëri. Në kuadër të tij u realizuan 3.139 anketa me familjet rome, 120 intervista dhe 9 diskutime në grup me përfaqësues të këtij komuniteti. Krahas tyre u realizuan edhe 60 intervista me përfaqësues të qeverisë lokale dhe qendrore, drejtues dhe mësues shkollash, mjekë dhe infermierë të qendrave shëndetësore, punonjës të ndihmës ekonomike etj. Disa nga të dhënat sasiore të projektit krahasohen edhe me rezultatet e *Censusit (2011)*. Artikulli përbëhet nga tri pjesë. Në pjesën e parë flitet për popullsinë rome, për diversitetin dhe shpërndarjen e saj gjeografike në territorin e Shqipërisë. Në pjesën e dytë jepen disa nga tiparet e saj demografike duke i krahasuar ato me popullsinë e vendit. Në pjesën e tretë jepen disa tipare të zhvillimit njerëzor, duke u fokusuar te shëndeti dhe arsimimi, të shoqëruara me disa rekomandime për ndryshimin e politikave ndaj popullsisë rome.

¹ Në gjuhën Rome: 'Të jenë shëndoshë e mirë të gjithë Romët'.

² Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale.

Romët në popullsinë e Shqipërisë

Sipas të dhënave më të fundit, popullsia Rome në Shqipëri, është më e vogël sesa pretendohet nga shoqatat përfaqësuese të komunitetit Rom. Të dhënat e ndryshme të burimeve të ndryshme shtrojnë nevojën e saktësimit të statistikave mbi Romët e Shqipërisë. Romët janë një popullsi diverse, të organizuar mbi baza fisnore, dhe kjo mënyrë jetese ndikon në mobilitetin, profesionet, veprimtaritë punuese, marrëdhëniet me komunitetet e tjera, tiparet e zhvillimit njerëzor dhe cilësinë e tyre të jetës. Komuniteti Rom është më i ri në moshë se popullsia e përgjithshme e Shqipërisë. Mosha e re, niveli i ulët arsimor, shëndeti problematik dhe varfëria e lartë shtrojnë nevojën e hartimit të politikave të zhvillimit, specifike për këtë komunitet. Mungesa e kualifikimit dhe hendeku arsimor i Romëve me popullsinë në shumicë do të vazhdojë të rritet. Kjo diferencë rrit papunësinë e pasigurinë dhe nuk i lejon Romët të dalin nga niveli i varfërisë. Nga ana tjetër, ajo përbën një barrë për sistemin e mirëqënies. Këto kontradikta mund të zgjidhen nëpërmjet arsimimit dhe kualifikimit të të rinjve Romë. Treguesit e gjendjes shëndetësore të Romëve janë më të përkeqësuar se treguesit e shëndetit të popullsisë së Shqipërisë dhe këta tregues vijnë duke u përkeqësuar. Këto tendenca shtrojnë nevojën e intensifikimit të politikave e programeve parandaluese në shërbim të zhvillimit njerëzor të komunitetit Rom të Shqipërisë

Romët janë një grup i veçantë etnik, të cilët migruan me valë të njëpasnjëshme nga pjesa veriore e Indisë në drejtim të Europës, duke filluar ndoshta nga shekulli IX e.s. (Silverman, 1995) deri në shekullin XIV. Dokumentet historike tregojnë se familjet e para rome duhet të kenë ardhur në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet Greqisë, rreth gjysmës së dytë të shekullit XIV (Kolstij, 1991) dhe janë vendosur në territorin shqiptar rreth shekullit XIV-XV (Koinova, 2000).

Krahas romëve, në Shqipëri jetojnë edhe *egjiptianët*. Historianët dhe antropologët socialë, që studiojnë çështjet e romëve, ngulmojnë se romët dhe egjiptianët kanë migruar nga India Veriperëndimore dhe kanë të njëjtën trashëgimi etnike. Pavarësisht nga origjina (ose jo) e përbashkët, të dyja grupet dallojnë aktualisht shumë nga njëri-tjetri (ECRI, 2002) me identitete krejtësisht të ndryshme. Egjiptianët nuk e flasin gjuhën romani, njihen si sedentarë dhe janë më të integruar në shoqërinë shqiptare. Veshjet e grave, traditat gojore, organizimi social dhe mënyra e jetesës janë krejtësisht të ndryshme mes romëve dhe egjiptianëve. Ndërkaq, shoqatat që pasqyrojnë interesat e egjiptianëve pretendojnë se kanë origjinë kopte dhe kanë ardhur nga Egjipti i Lashtë rreth shekujve IV-V p.e.s. (ECRI, 2002).

Romët e Shqipërisë

Dilemat e statistikave

Përgjithësisht, deri në prag të tranzicionit passocialist, pavarësisht nga emërtime vendore³, ata që ne quajmë sot *romë* dhe *egjiptianë*, identifikoheshin nga studiuesit e huaj si *gypsy* (në anglisht) ose *ciganë* (në frëngjisht). Të dhënat e para për këtë popullsi datojnë që në vitin 1522-1523, ku në regjistrin e taksave të Perandorisë Osmane vlerësohej se në territorin e Shqipërisë së sotme banonin 374 familje rome ose rreth 1800 persona (Marushiakova & Popov, 2001). Pas kësaj periudhe vlerësimet për popullsinë rome, qoftë nga dokumentet zyrtare ose nga përshkrimet e udhëtarëve të huaj, që vizitonin herë pas here trojet shqiptare, kanë qenë të pjesshme.

Në fund të viteve '30 të shekullit të kaluar, Margaret Hasluck dallonte qartë dy grupe, ata "që jetojnë në çadra dhe flasin romani si gjuhë të tyre, si dhe sedentarët që jetojnë në shtëpi ose në kasolle dhe e kanë harruar gjuhën romani". Ajo vlerësonte se në Shqipëri-popullsia e së cilës vlerësohej në rreth 1 milion-të dyja grupet përbëheshin prej "rreth 20.000 vetash", nga të cilët "vetëm 2.000 ishin ende nomadë" (Hasluck, 1938).

Gjatë periudhës socialiste (1945-1990), romët dhe egjiptianët nuk konsideroheshin minoritet dhe rrjedhimisht ata nuk janë përfshirë si grup i veçantë etnik në regjistrimet e popullsisë. Megjithatë, në vlerësimet zyrtare pranohej se romët dhe egjiptianët kishin të njëjtën origjinë etnike. Ndërkaq, kur filloi tranzicioni post-socialist, shoqatat rome që u krijuan, të inkurajuar nga vakumi statistikor, publikuan shifra të ndryshme të popullsisë rome që varionin nga 120.000 deri 150.000 persona. Ndërsa shoqatat egjiptiane flasin për 300.000 deri 400.000 egjiptianë në Shqipëri (De Soto et al, 2005). Shifra të tilla, që nuk bazohen në vlerësime reale, burojnë nga dëshira për rritjen numerike të grupeve të tyre etnike, çka do të rriste peshën e tyre dhe do të tërhiqte vëmendjen e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare.

Ndërkaq, nevoja për të dhëna demografike dhe socio-ekonomike të sakta, të besueshme dhe të përditësuara për romët në Shqipëri lidhet me hartimin e politikave specifike dhe me ndërmarrjen e masave praktike nga qeveria në nivel qendror e lokal, nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile. Këto të dhëna mund t'u shërbejnë për nevoja praktike ose për të programuar shërbimet edhe institucioneve lokale. Veç kësaj, këto të dhëna mund të evidentojnë

³ Romët në Shqipëri njihen me emra të ndryshëm. Në veri të vendit, ata njihen me emrin *gabelë*, në jug si *arixhinj* dhe në Juglindje (Korçë, etj.) si *kurbatë*. Ndërsa egjiptianët njihen edhe me emrin *magjypë* në Shkodër, *evgjitë* në Korçë dhe Berat, si dhe *jevgy* në Elbasan. Këta emra konsiderohen si fyes për komunitetet në fjalë dhe përdorimi i tyre duhet shmangur.

edhe progresin (ose regresin) real në fusha të caktuara (arsimi, shëndeti, kushtet e banimit, mbrojtja sociale, regjistrimi civil, etj.), shkallën e përfshirjes sociale të romëve dhe nevojat për ndërhyrje.

Në tetor 2011 në Shqipëri u realizua Censusi i popullsisë dhe banesave, i cili për herë të parë përfshiu pyetje lidhur me etninë. Të dhënat e Censurit 2011 tregojnë se popullsia rome në Shqipëri ishte 8.301 persona ose 0.3 për qind e popullsisë së përgjithshme (INSTAT, 2012). Këto të dhëna janë kundërshtuar nga shoqatat rome dhe nga disa ekspertë si jo të besueshme. Ndërkaq, një projekt i UNICEF-it (Roma Mapping), i realizuar thuajse në të njëjtën kohë me Censusin, tregoi se popullsia rome në Shqipëri ishte 14.564 persona (0,5 për qind e popullsisë së përgjithshme) e shpërndarë në 3.139 familje në 108 vendbanime të ndryshme (Gëdeshi & Jorgoni, 2012) (shih tabela 1). Autorët e Roma Mapping theksonin se ndoshta 15 për qind e popullsisë rome nuk ishte regjistruar për shkak të refuzimit dhe migrimit sezonal të brendshëm dhe të jashtëm. Aktualisht Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” është duke përfunduar një vërtetim për strehimin e komunitetit rom, ku padyshim ka edhe të dhëna për popullsinë⁴.

Tabela 1. Popullsia rome në 2011 sipas qarqeve

Nr	Qarku	Popullsia rome sipas “Roma Mapping” 2011	Popullsia rome sipas Censurit 2011	Diferenca midis dy burimeve
1	Berat	958	202	756
2	Dibër	99	92	7
3	Durrës	1703	940	763
4	Elbasan	1265	1064	201
5	Fier	2969	1640	1329
6	Gjirokastrë	397	91	306
7	Korçë	2199	1005	1194
8	Kukës	64	45	19
9	Lezhë	338	187	151
10	Shkodër	443	382	61
11	Tiranë	3270	2371	899
12	Vlorë	859	282	577
	Totali	14.564	8.301	6.263

Burimi: UNICEF, Mapping Roma Children in Albania, 2012. INSTAT, Albania, Population and Housing Census 2011, Main Results, 2013.

⁴ Shih: Censusi i banesave të komunitetit rom në Shqipëri 2013-2014.

Dy burimet e mësipërme bazohen në popullsinë banuese në Shqipëri dhe nuk marrin parasysh migrimin ndërkombëtar të romëve. Pavarësisht se nuk ka të dhëna të sakta për migrimin e romëve, do të vlerësonim se gjatë periudhës së tranzicionit passocialist deri 1/3 e popullsisë rome, kryesisht për shkaqe ekonomike, ka emigruar në Greqi dhe Itali. Kjo hipotezë, krahas faktorëve shtytës e tërheqës, bazohet edhe në kapitalet humane, sociale dhe financiare të komunitetit rom. Kështu, një studim i realizuar në 2012-ën tregoi se fenomeni i migrimit ndërkombëtar afatgjatë është shumë i përhapur në disa vendbanime rome të Shqipërisë Jugore dhe Qendrore, si në Xarë, Delvinë, Zinxhiraj të Gjirokastrës, Moravë, Levan, Grabian, Baltëz, Llakatund, Novoselë etj., ku 30 deri 60 për qind e familjeve kanë migruar (Gëdeshi & Miluka, 2012; Sokoli, 2014). Në vjeshtë të vitit 2011, në Zinxhiraj të Gjirokastrës, për shembull, banonin rreth 56 familje rome (Gëdeshi & Jorgoni, 2012), ndërsa rreth 82 familje të tjera, të migruara nga kjo zonë, banonin në disa kampingje në periferi të qytetit të Janinës në Greqi (Gëdeshi & Miluka, 2012). Afërsia gjeografike me Greqinë dhe lehtësia për të kaluar kufirin, riaktivizimi i lidhjeve familjare me romët në Greqi, kapitali më i pasur human (arsimimi e profesionet sidomos të meçkarët) dhe financiar i kanë nxitur romët e Shqipërisë Jugore dhe Qendrore të migrojnë me intensitet më të lartë. Ndërkaq, romët në komunitetet e varfra dhe shumë të varfra, si në Fushë-Krujë, në Shkodër, etj nuk i dispononin këto kapitale dhe rrjedhimisht intensiteti i migrimit të tyre ishte i ulët (De Soto at al, 2005). Rikthimi i pjesshëm i migrantëve romë, si pasojë e papunësisë nga kriza financiare dhe ekonomike në Greqi, do të rriste numrin e tyre në Shqipëri.

Ndërkaq, një botim i fundit i UNDP (2012), i cili bazohet në të dhënat që ofron shoqata rome “Amaro Drom”, pohon se në Shqipëri jetojnë 40.478 romë (Ivanov at al, 2012). Shifra e këtij vlerësimi ndryshon dukshëm nga dy të parat, por njëkohësisht është shumë më e vogël se vlerësimet e mëparshme të shoqatave rome, çka tregon se ai informacion është i ekzagjeruar.

Romët, një komunitet divers

Romët janë të organizuar në grupe ose *fise* që mund të dallohen nga njëri-tjetri nga koha dhe rruga e ardhjes së tyre në Shqipëri, nga profesionet socio-ekonomike, nga mënyra e jetesës dhe zakonet, nga dialektet gjuhësore, etj. Ato janë: *meçkarët, karbuxhinjtë, cergarët (rupane dhe skodrara), bamillët dhe kurtofët* (Courthiade & Duka, 2002; De Soto & Gëdeshi, 2002; Barjaba, 1995) (tabela 2), të cilët formojnë, sipas shprehjes së Liegeois-it, *një mozaik grupesh të diversifikuara* (Liegeois, 1983).

Tabela 2. Struktura e popullsisë rome sipas fiseve

Nr	Struktura e popullsisë rome	Popullsia	Në përqindje
1	Karbuxh	7353	50.49
2	Meçkar	4693	32.22
3	Cergare	1310	9
4	Bamill	156	1.07
5	Nuk shprehen/Nuk e di	1019	7
6	Jo romë	33	0.22
Totali		14564	100

Burimi: Mapping Roma Children in Albania, UNICEF, 2012.

Meçkarët janë vendosur prej shekujsh në Shqipëri (Courthiade & Duka, 2002). Ata janë më të integruar dhe kanë nivel më të lartë arsimor në krahasim me fiset e tjera rome. Ata përfaqësojnë rreth 32 për qind të romëve dhe ishin vendosur kryesisht në fshatrat dhe qytetet e rretheve Fier (Patos, Roskovec, Baltëz, Levan, Drizë, Seman, Hoxharë, Mbrostar Ura, Ferma Çlirimi), Lushnjë (Grabian, Savër, Plug, Zham, Shënepremtë, Sulzotaj, Gramsh, Çermë), Vlorë (Novoselë, Akërnë dhe Llakatund), Berat (Moravë, Orizaj, Lapardha, Pashalli, Ura e Kuçit), Durrës (Xhafzotaj, Fllakë, Rrushkull) si edhe në qytetin e Tiranës. Meçkarët janë marrë tradicionalisht me bujqësi e blegtori (Barjaba, 1995; Milaj, 1943), një profesion që ndeshet rrallë te romët në Ballkan. Courthiade dhe Duka vërejnë se në gjuhën e tyre ka huazime të shumta të fjalëve dhe dialekteve të ndryshme të gjuhës shqipe, çka tregon se ata janë endur për një kohë të gjatë nëpër Shqipëri, para se të nguliteshin në vendbanimet aktuale (Courthiade & Duka, 2002).

Karbuxhinjtë (të vetëquajtur erli⁵) janë fisi më i madh dhe përfaqësojnë rreth 51 për qind të romëve. Ata migruan nga Turqia dhe Greqia (Follorina dhe Kosturi) në Shqipëri gjatë shkëmbimit të popullsisë pas Traktatit të Lozanës në vitet '20 të shekullit të kaluar midis Turqisë dhe Greqisë (Hasluck, 1938). Courthiade dhe Duka vërejnë se gjuha e tyre është arkaike dhe ka më shumë huazime të turqishtes sesa të shqipes. Ndërsa Mann thekson se dialekti i tyre është i afërt me atë të romëve të Follorinës dhe Selanikut (Mann, 1933). Ata janë vendosur kryesisht në qytetet dhe fshatrat e rretheve Korçë (Maliq, Pojan, Plasë, Rrëmbec, Sovjan, Zvezdë, Terrovë, Progër, Vloçisht, Vashtmie, Libonik), Bilisht (Bitinckë, Tren), Pogradec (Cërravë), Elbasan (Cërrik, Peqin), Tiranë, Durrës (NISH Tulla)

⁵ Fjala "Erli" vjen nga turqishtja dhe do të thotë "banor vendas" ose "jonomad".

dhe Fushë-Krujë. Profesionet e tyre tradicionale kanë qenë shitblerja e kuajve, punimet e artizanatit dhe kryesisht punimet e thuprës. Ata përfaqësonin një grup tregtarësh të vegjël. Courthiade dhe Duka theksojnë se nëngrupe të *karbuxhinjve* janë edhe romët e quajtur *stravali* të Rrapishtës dhe romët *vakërde* të Gjirokastrës dhe Beratit. *Meçkarët* dhe *karbuxhinjtë* ishin edhe muzikantë popullorë që merrnin pjesë në dasma dhe në ceremoni të tjera.

Cergarët migruan nga Mali i Zi dhe nga Serbia dhe u vendosën në Shkodër gjatë viteve '20 për t'u shpëtuar sulmeve të jugosllavëve (Kolsti, 1991). Burrat merreshin kryesisht me shitblerjen e kuajve, kurse gratë me hedhje falli (Taho, 1943). Aktualisht ata gjenden në Tiranë dhe në Durrës. Ndërsa cergarët e Shqipërisë së Mesme migruan në Shqipëri në fillim të shekullit XX nga Turqia përmes Maqedonisë. Ata merreshin me shitjen e kuajve, me prodhime artistike dhe me artikuj prej bakri (kazanë rakië, kusi, gjyma, shosha, qebapë, etj), që i shisnin nëpër fshatra.

Bamillët janë një grup i vogël romësh, të cilët erdhën nga fshati Voshtinë në afërsi të Janinës (Greqi) gjatë shkëmbimit të popullsisë pas Traktatit të Lozanës (Matras, 2004). Disa familje të tjera rome erdhën në Shqipëri në vitet 1945-1946, bashkë me refugjatët çamë. Ata janë vendosur kryesisht në Zinxhiraj të Gjirokastrës dhe në Levan e në lagjen Azotik të Fierit. Ata ishin teneqepunues dhe bënë qebapë, kusi dhe kazanë rakië, profesion që e kanë ruajtur deri në ditët tona.

Ndërsa *kurtofet* erdhën në vitet '30 të shekullit të kaluar nga Manastiri i Maqedonisë dhe u vendosën në rrethin e Fierit. Disa prej tyre vazhduan të ishin gjysmënomadë edhe gjatë periudhës socialiste. Profesionet e tyre ishin tregtia e vogël dhe artizanati. Courthiade dhe Duka vlerësojnë se shumica e tyre kanë migruar në Greqi në vitet e para të tranzicionit (Courthiade & Duka, 2002).

Shpërndarja gjeografike

Sipas Roma Mapping të UNICEF-it (idem) dhe Censurit të vitit 2011 (INSTAT, 2012) romët janë vendosur kryesisht në zonën urbane dhe peri-urbane (65 për qind) të vendit, si Tirana, Durrësi, Elbasani, Shkodra dhe Korça. Një pjesë më e vogël banojnë në qytete të mëdha (Berati, Pogradeci, Kavaja, Gjirokastra, Fushë-Kruja, Lezha, Kukësi, Peshkopia, Peqini, Cërriku, Bilishti, Delvina) dhe në qytete të vogla (Mamurras, Milot, Maliq, Kuçovë, Roskovec, etj).

Ndërsa 35 për qind e romëve banojnë në komunitete në zonën rurale, kryesisht në fushën e Myzeqesë (fshatrat Cermë, Gramsh, Zham, Sulzotaj, Shënepremte, Plug, Savër dhe Grabjan të Lushnjës; në fshatrat Baltëz, Levan, Seman, Hoxharë, Mbrostar Ura dhe ferma Çlirimi të Fierit; dhe në fshatrat Moravë, Orizaj, Lapardha, Ura e Kuçit dhe Pashalli e Beratit), në pllajën e Korçës (fshatrat Pojan,

Tërnovë, Zvezdë, Progër, Sovjan, Plasë, Rrëmbec, Libonik, Vashtmi, Vloçisht dhe Bitinckë e Tren të Devollit), në disa fshatra të Vlorës (Novoselë, Akëri, Llakatund), të Durrësit (Fllakë, Rrushkull, Xhafzotaj, Kthesa e Ariut dhe fshati Rinia), të Sarandës (Cukë, Xarë, Shkallë) dhe të Pogradecit (Cërravë). Familje të veçuara romësh banojnë edhe në fshatra të tjera.

Romët karakterizohen nga një mobilitet shumë i lartë. Një studim i UNDP-së tregon se në vitet e para të tranzicionit pasocialist, thuajse 17 për qind e romëve, nën ndikimin e faktorëve ekonomikë dhe socialë ose nën *shtytjen* e popullsisë në shumicë, ndryshuan vendbanimin. Kështu, romët nga fshati Halil migruan në Fushë-Krujë; nga qyteti i Beratit shkuan në Rrapishtë të Elbasanit; nga qytetet e tjera në Tiranë, etj. Ky migrim ka vazhduar me intensitet të lartë edhe gjatë 10 viteve të fundit. Sipas studimit, thuajse 30 për qind e romëve kanë migruar në Tiranë, Shkodër, Milot, Kukës, Peshkopi, Kavajë, Sarandë, Gjirokastër, Përmet, Himarë etj (Gëdeshi & Miluka, 2012). Të tjerë lëvizin brenda rrethit, nga fshati në qytet ose nga fshati në fshat. Rrjedhimisht, romët po shtrihen në të gjithë Shqipërinë dhe harta e vendndodhjeve të tyre ka ndryshuar.

Faktori kryesor i mobilitetit të lartë të popullsisë rome është papunësia dhe varfëria. Thuajse gjysma e romëve janë të papunë dhe kjo papunësi është afatgjatë (idem). Në mungesë të punës në sektorin formal, ata punojnë në sektorin informal, ku grumbullimi i hekurishteve dhe kanoçeve është kthyer në burimin kryesor të të ardhurave familjare. Aktualisht 42 për qind e romëve merren me grumbullimin e tyre (Gëdeshi, 2013). Ndërkaq, rritja e numrit të romëve që përfshihen në grumbullimin e hekurishteve dhe të kanoçeve rrit konkurrencën midis tyre dhe, në kushtet e burimeve të kufizuara, zvogëlon të ardhurat e familjeve. Në këto kushte, shumë romë zgjedhin migrimin në qytete të tjera, ku konkurrenca është më e vogël. Në mungesë të mundësive të punësimit në sektorin formal kjo tendencë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ky mobilitet në rritje po shoqërohet gjatë dekadës së fundit edhe me krijimin e kampingjeve, ku familjet rome banojnë në kasolle ose çadra. Në këto kampingje shpesh mungon infrastruktura e nevojshme, si uji i pijshëm, kanalizimet e ujërave të zeza, rrugët, etj. Kjo vërehet sidomos në Shkodër, Kukës, Peshkopi, Tiranë (Shkozë, Ura e Farkës, Babrru, Bregu i Lumit, etj), Durrës, Gjirokastër (tregu i shumicës), Sarandë (fusha e Vrionit), etj. Në disa vende të tjera romët banojnë në zona periferike krejtësisht të segreguara, si në Fushë-Krujë, në Durrës (NISH Tulla dhe Ura e Dajlanit), në Gjirokastër (Zinxhiraj), në Elbasan (Rrapishtë), në Fier (Azotiku), etj. Rrjedhimisht po rritet një brez i ri që nuk njih realitete të tjera sociale e kulturore veç atyre të kampingjeve ose zonave të segreguara. Pasojat sociale të këtij fenomeni sigurisht që do të ndihen më vonë.

Roma Mapping tregon se karbuxhinjtë dhe cergarët janë fiset rome me mobilitet më të lartë. Kështu, për shembull, më shumë se 98 për qind e romëve që jetojnë në kampingje në Shkodër, Kukës, Peshkopi, Tiranë (Shkozë, Ura e Farkës)


dhe Gjirokastër (tregu i shumicës) janë karbuxhinj dhe cergarë. Rrjedhimisht kemi një rikthim në traditat e jetës gjysmë nomade, e cila ka pasoja, veç të tjerash, edhe në arsimimin e brezit të ri.

Disa tipare demografike të romëve të Shqipërisë

Popullsia e re në moshë

Si pasojë e ritmeve më të larta të lindjes, komuniteti rom është dukshëm më i ri në moshë sesa popullsia e përgjithshme në Shqipëri. Mosha mesatare e komunitetit rom është 25,6 vjeç, nga 35.3 vjeç që është për popullsinë e përgjithshme. Për vitin 2011, të dhënat e Roma Mapping tregojnë se 36.2 për qind e popullsisë rome ishte 15 vjeç e poshtë (indeksi i zëvendësimit), kurse për popullsinë e përgjithshme në Shqipëri, sipas Censurit të vitit 2011, kjo ishte 21 për qind. Nga ana tjetër, indeksi i moshës së vjetër (popullsia 65 vjeç e sipër ndaj popullsisë gjithsej) është 4,2 për qind për romët, kurse për popullsinë e përgjithshme kjo është 11 për qind (INSTAT, 2002). Mosha e re e popullsisë rome vërehet edhe në piramidën e moshës, ku shumica e popullsisë është përqendruar në bazën e saj (figura 1).

Figura 1. Piramida e popullsisë rome



Burimi: Anketa me familjet rome, 2011

Popullsia e re në moshë nuk është thjesht një tipar i rëndësishëm demografik i popullsisë rome apo nuk ka vetëm një interes akademik. Ajo tregon, siç do të shohim më poshtë, se në vitet e ardhshme prurje të reja, të rëndësishme, do t'u shtohen forcave ekzistuese të punës të këtij komuniteti. Pyetjet që shtrohen janë të shumtadhedisa prej tyre janë: Cili është niveli arsimor i kësaj mase të rinjsh që do të hyjë së shpejti në tregun e punës? A do të dinamizojnë ato forcat ekzistuese të punës apo do t'i shtohen papunësisë strukturore ekzistuese të këtij komuniteti? Dhe së fundi, çfarë rekomandime duhet të bëjmë për politikën?

Struktura e balancuar gjinore dhe martesat endogame

Popullsia rome, ashtu si dhe popullsia në shumicë, paraqitet e ekuilibruar nga pikëpamja gjinore. Sipas Roma Mapping femrat përfaqësojnë 49.3 për qind të popullsisë dhe meshkujt 50.7 për qind, ndërsa për popullsinë e përgjithshme ky raport është 50.2 për qind femra dhe 49.8 për qind meshkuj (INSTAT, 2011). Raporti gjinor është pak më i diferencuar për grupmoshat deri 15 vjeç (48.3 për qind femra dhe 51.7 për qind meshkuj) ku dominojnë meshkujt dhe për grupmoshat mbi 65 vjeç (52.6 për qind femra dhe 47.4 për qind meshkuj) ku dominojnë femrat.

Të dhënat e Roma Mapping tregojnë se 12 për qind e popullsisë rome 18 vjeç e sipër është beqare, 79 për qind e martuar, 5 për qind e divorcuar dhe 4 për qind të ve. Martesat bëhen brenda grupit të etnisë rome dhe janë të rralla ato me egjiptianë dhe shumë të rralla martesat me partnerë të etnisë shqiptare. Përgjithësisht romët preferojnë të martohen brenda të njëjtit fis. Kështu Roma Mapping tregon se në më shumë se 95 për qind të rasteve martesat ndodhin midis partnerëve të të njëjtit fis. Shumë prej këtyre martesave realizohen me ndërmjetësi. Megjithatë, si rezultat i lëvizjeve të popullsisë kjo traditë nuk respektohet shumë dhe gjithnjë e më shpesh ndodhin martesat midis pjesëtarëve të fiseve të ndryshme rome.

Ndërkaq, në disa komunitete rome të izoluara, si në Levan dhe Azotik të Fierit, në Zinxhiraj të Gjirokastrës, në Delvinë, në Fushë-Krujë etj., vërehen edhe martesat midis kushërinjve të parë dhe të dytë. Kjo formë e endogamisë shpjegohet me mundësitë e pakta për të gjetur partnerë për martesë jashtë komunitetit të tyre. Shpesh kjo dukuri justifikohet edhe me shprehje të tilla si: "Kali i mirë duhet të shitet në fshat" ose "Pse ta hajë mollën e mirë tjetri?" (De Soto et al, 2005).

Lindshmëria e lartë dhe popullsi pjellore

Historikisht, romët në Shqipëri kanë pasur një rritje më të madhe të popullsisë në krahasim me grupet e tjera etnike. Në vitet '30, Hasluck shkruante se gratë rome "lindin më shumë se një herë në tre vjet" (Hasluck, 1938). Kjo shpjegohet me varfërinë, nivelin e ulët arsimor dhe me faktorë kulturorë. Përgjithësisht në Shqipëri popullsia e varfër riprodhohet dhe rritet më shpejt se popullsia jo e varfër (Barjaba, 2013). Në kulturën rome vajzat duhet të martohen shpejt dhe të kenë shumë fëmijë. Roma Mapping tregon se numri i fëmijëve për një nënë rome është më i lartë se për nënat e popullsisë në shumicë. Roma Mapping tregon gjithashtu se ka një lidhje të ngushtë midis numrit të madh të fëmijëve dhe nivelit të ulët arsimor të prindërve. Përgjithësisht prindërit me nivel më të ulët arsimor dhe socio-ekonomik kanë më shumë fëmijë.

Martesat e hershme


Martesat në moshë të hershme janë një nga faktorët kryesorë që kontribuojnë në rritjen e shpejtë demografike. Vajzat rome martohen në një moshë shumë më të re dhe bëhen nëna më shpejt se grupet e tjera etnike.⁶ Shumë prindër romë mendojnë se mundësia për martesë e vajzës ulet me rritjen e moshës. Krahas kësaj kjo lidhet edhe me disa norma kulturore, si prirja për të ruajtur virgjërinë para martesës, çka i nxit shumë prindër romë t'i largojnë vajzat e tyre nga shkolla dhe t'i izolojnë ato nga jeta sociale, për t'i martuar në moshë shumë të re.⁷

Roma Mapping tregon se thuhet se 70 për qind e vajzave të grup-moshës 18 deri 21 vjeç janë të martuara. Ndërkaq, studimet tregojnë se mosha mesatare e martesës së vajzave, për shkaqe ekonomike (varfëria) dhe të sigurisë (rëmbimi për qëllime trafikimi), është ulur gjatë tranzicionit pasocialist. Një studim i Bankës Botërore, i realizuar në vitin 2002-2003, tregoi se mosha mesatare e martesës për vajzat ishte 15,5 vjeç, ndërsa mosha mesatare kur ato kishin fëmijën e parë ishte 16,9 vjeç. Kjo moshë, thekson studimi, është ulur me rreth 2 vjet në krahasim me periudhën para tranzicionit (De Soto et al, 2005) dhe të kujton normat që ekzistonin thuhet se 50 vjet më parë (Courthiade & Duka, 2002).

⁶ Në Shqipëri mosha minimale ligjore e martesës është 18 vjeç për vajzat dhe 18 vjeç për djemtë.

⁷ Disa prindër të tjerë i largojnë vajzat nga shkolla kur ato arrijnë moshën 12-13 vjeç, në mënyrë që të mos shoqërohen me djem. Krahas pasojave negative në shëndetin fizik dhe psikologjik, martesat në moshë të hershme i pengojnë vajzat në arsimim e kualifikim dhe zvogëlojnë mundësitë e tyre të punësimit. Martesat në moshë të hershme godasin jo vetëm fëmijët e sotëm, por edhe të nesërm. Është e njohur se shumë nëna të reja janë vetë fëmijë dhe atyre u mungojnë njohuritë për mirërritjen e fëmijëve.

Figura 2. Numri i vajzave rome sipas gjendjes civile dhe moshës (grup-mosha 13 deri 17 vjeç



Burimi: Anketat me familjet rome, 2011

Ndërkohë, moshë mesatare e martesës për femrat në nivel kombëtar në vitin 2007 ishte 22.4 vjeç (Barjaba, 2012). Roma Mapping tregon se në vitin 2011, 31 për qind e femrave të grup-moshës 13 deri 17 vjeç ishin të martuara (figura 1). Ky fenomen është më i përhapur te *tecergarët* dhe *karbuxhinjtë*, sidomos në komunitete të varfra dhe të izoluar si në Shkodër, Fushë-Krujë, Kthesa e Ariut, Rrapishtë, etj.

Kultura e ulët e planifikimit familjar

Numri më i madh i fëmijëve në krahasim me popullsinë në shumicë shpjegohet edhe me mungesën e kulturës së planifikimit familjar. Një studim i UNDP tregoi se vetëm 23 për qind e romëve përdorin mjetet kontraceptive, ndërsa 44 për qind e tyre njohin një metodë kontrolli. Përdorimi i pakët i tyre, krahas mosbesimit dhe refuzimit nga ana e burrave, është rezultat edhe i mungesës së informacionit që kanë romët për këto metoda kontrolli. Rrjedhimisht, shumë gra rome vazhdojnë të përdorin abortin për shtatzënitë e padëshiruara si një mjet kontraktiv. Studimi tregoi se thuhet se 53 për qind e grave kanë kryer një abort dhe 75 për qind e tyre dy e më shumë gjatë periudhës së tyre riprodhuese (Gëdeshi & Miluka, 2012). Numri mesatar i aborteve për grua, për ato që kanë kryer abort, është 4.8 për romët. Në fund të viteve '90 Claire Auzias, në librin e saj, tregon se gratë rome kanë kryer mesatarisht 10-15 aborte dhe në disa raste deri në 30 aborte në jetën e tyre riprodhuese (Auzias, 1998). Ndonëse aktualisht shumica e aborteve kryhen në spital dhe në prani të mjekut ose mamisë, 3.2 për qind e grave rome shprehen se i kryejnë vetë ato, në kushtet e shtëpisë (Gëdeshi & Miluka, 2012).

Megjithatë përdorimi i mjeteve kontraceptive duket se është rritur, krahasuar

me një dekadë më parë, çka shpjegon edhe uljen e fertilitetit të grave rome. Kështu në vitin 2003, vetëm 10 për qind e romëve përdornin kontraktivët (De Soto et al, 2005), nga më shumë se dyfishi në vitin 2011. Intervistat e realizuara tregojnë se gratë rome janë më të interesuara sesa burrat për përdorimin e kontraktivëve si metodë kontrolli. Ermira, një punonjëse e planifikimit familjar në Gosë të Kavajës, tregon: “Ka shumë gra që i marrin kontraktivët në formën e injeksionit me depoprovera. Efekti i tij zgjat 3 muaj dhe pastaj duhet përsëritur. Shumë prej tyre e bëjnë këtë veprim pa dijeninë e bashkëshortëve, të cilët vijnë në shtëpi shpeshherë të dehur”.

Fëmijë “të harruar”

Grup -moshat 0 deri 18 vjeç përfaqësojnë 43,3 për qind të popullsisë rome. Por një pjesë e tyre nuk janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile dhe rrjedhimisht janë “fëmijë të harruar” dhe të përjashtuar nga disa shërbime sociale (UNICEF, 2007). Roma Mapping tregon se në vitin 2011, rreth 359 fëmijë ose 5.7 për qind e fëmijëve të grup-moshës 0 deri 18 vjeç, nuk ishin të regjistruar. Ky fenomen, i shfaqur gjatë tranzicionit pasocialist, për shkak të martesave në moshë të re (e joligjore), divorceve, varfërisë dhe nivelit të ulët arsimor, migrimit të brendshëm dhe të jashtëm, është më i përhapur te *karbuxhinjtë* dhe *tecergarët*. Ky fenomen është më i theksuar në Tiranë, Fushë-Krujë, Fier (fshati Rrom, Levan, etj), Shkodër, Berat (Uznovë, Moravë), Elbasan (Rrapishtë) dhe Korçë.

Madhësia e familjes rome

Sipas Roma Mapping, madhësia mesatare e familjes rome është 4,6 anëtarë, çka tregon se është ulur dukshëm në krahasim me disa vite më parë. Në vitin 2003, studimi i Bankës Botërore vlerësonte se madhësia mesatare e familjes ishte 6.4 anëtarë (De Soto et al, 2005). Krahas uljes së fertilitetit, këtu kanë ndikuar edhe migrimi i brendshëm dhe i jashtëm. Shumë të rinj që kanë migruar me familjen brenda dhe jashtë vendit kanë lënë prindërit në vendlindje.

Roma Mapping tregoi se rreth 4.5 për qind e familjeve përbëhet nga 1 ose 2 persona të moshuar (60 vjeç e sipër), një pjesë e të cilëve janë prindër të lënë pas nga migrantët. Shumë prej tyre jetojnë në kushtet e një varfërie të thellë materiale dhe stresi të vazhdueshëm emocional. Roma Mapping tregoi se vetëm 54 për qind e këtyre familjeve përfitojnë pension pleqërie (Gëdeshi & Jorgoni, 2012). Ndërkaq, thuhet se 35 për qind e këtyre të moshuarve janë të ve dhe jetojnë vetëm. Ndihma financiare nga fëmijët e tyre migrantë është shumë e vogël. Kështu, një studim i Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” tregoi se përqindja e familjeve rome migrante që dërgojnë remitanca për prindërit në vendlindje dhe

madhësia e këtyre të fundit është shumë më e vogël në krahasim me popullsinë në shumicë (Gëdeshi & Miluka, 2012). Këto fakte nxjerrin në dukje edhe një çështje të mprehtë sociale, atë të përkujdesjes ndaj të moshuarve romë.

Një faktor tjetër që ndikon në zvogëlimin e madhësisë së familjes është edhe përfitimi i “Ndihmës Ekonomike”, e cila ndahet për familje. Vëzhgimet në fushë tregojnë se kjo tipologji shpërndarjeje i detyron familjet rome të ndajnë më vete fëmijët me qëllim që të përfitojnë nga programi i “Ndihmës Ekonomike”.

Megjithatë, madhësia mesatare e familjes rome vazhdon të mbetet më e lartë se ajo e popullsisë së përgjithshme, e cila sipas Censurit 2011 ishte 3.8 (INSTAT, 2011). Krahas numrit më të madh të fëmijëve për një çift, në madhësinë mesatare të familjes rome ndikon edhe numri relativisht më i lartë i kurorave. Një studim i UNDP-së tregoi se një e treta e familjeve rome përbëhen nga më shumë se një kurorë (Gëdeshi & Miluka, 2012). Madhësia mesatare e familjes rome varion sipas zonave. Sipas Roma Mapping romët në zonën peri-urbane kanë një madhësi më të madhe të familjes (4.76 persona) në krahasim me zonën rurale (4.6) dhe urbane (4.5 persona).

Disa tipare të zhvillimit njerëzor

Zhvillimi njerëzor i Romëve është i lidhur ngushtë me shkallën e integritimit të tyre në shoqëri, me aftësinë për të përballuar sfidat e zhvillimit shoqëror si edhe me kontributin dhe përfitimet e tyre prej sistemit të mirëqenies shoqërore.

Rikthimi i analfabetizmit

Historikisht, në Shqipëri, ashtu si dhe në vendet e tjera të Europës, romët kanë pasur nivel shumë të ulët arsimor. Traditat gjysmë-nomade dhe mënyra e veçantë e jetesës, varfëria dhe diskriminimi janë disa nga faktorët kryesorë që shpjegojnë këtë gjendje. Në vitet '30 të shekullit të kaluar, duke përshkruar nomadizmin e romëve, Hasluck (1938) vërente se ata nganjëherë “vendoseshin në një qytet për disa muaj”, por pastaj i riktheheshin përsëri “jetës së çadrës”. Kjo mënyrë jetese gjysmë-nomade i pengonte fëmijët romë të ndiqnin shkollën.

Niveli arsimor i romëve u përmirësua dukshëm gjatë periudhës socialiste (1945-1990), si pasojë e politikave arsimore dhe masave që u morën për t'i integruar ata në shoqëri. Vendosija e romëve në vendbanime të qëndrueshme gjatë viteve '60, punësimi i plotë dhe i garantuar, strehimi dhe përmirësimi i standardeve të jetesës u pasqyruan edhe në rritjen e nivelit arsimor të tyre (De Soto et al, 2005). Roma Mapping tregoi se niveli i analfabetizmit për individët romë, që kishin moshën 35-45 vjeç, domethënë që u futën në institucionet arsimore gjatë viteve 1973-

1983, u ul në 30.6 për qind. Kurse vitet mesatare të shkollimit, për ata që vazhduan shkollën, ishin 6,6 vjet.

Gjatë tranzicionit passocialist, niveli arsimor i romëve, ashtu si në vendet e tjera të Europës Lindore e Qendrore (Ringold et al, 2003), u përkeqësua. Papunësia e lartë dhe varfëria, diskriminimi dhe përjashtimi social u pasqyruan në uljen e nivelit arsimor. Në vitin 2011, sipas të dhënave të Roma Mapping, 40.4 për qind e romëve 10 vjeç e lart ishin analfabetë (35.8 për qind meshkujt dhe 45 për qind femrat). Ndërsa sipas rezultateve të Censurit niveli i analfabetizmit për popullsinë e përgjithshme ishte 2.8 për qind (3.7 për qind femrat dhe 1.7 për qind meshkujt). Në rast se në popullsinë e përgjithshme thuajse gjysma e analfabetëve i përket grup-moshës mbi 75 vjeç (INSTAT, 2012) në popullsinë rome 58 për qind e analfabetëve i përket grup-moshës 15 deri 35 vjeç ose forcave më aktive të punës.

Popullsia karakterizohet nga analfabetizmi (40.3 për qind), arsimi fillor i përfunduar (25,9 për qind) dhe i papërfunduar (14,9 për qind), ndërsa shumë pak kanë përfunduar arsimin 8-vjeçar (16,1 për qind) dhe të mesëm (2,1 për qind) me popullsinë e përgjithshme në të gjithë treguesit e arsimit tregon se hendeku është shumë i madh (tabela 3) dhe vazhdon të thellohet.

Tabela 3. Niveli arsimor i romëve

Nr.		Popullsia rome (10 vjeç e sipër)	Popullsia e Shqipërisë (2011)*
1	Analfabetë*	40,3	2.8
2	Arsim 4 -vjeçar i pa përfunduar	14.9	n.a
3	Arsim 4 -vjeçar i përfunduar	25.9	14.9
4	Arsim 8/9 -vjeçar i përfunduar	16,1	40.9
5	Arsim i mesëm	2,1	28.4
6	Arsim universitar	0,3	10.7
7	Vitet mesatare të shkollimit (meshkuj)	5.6	10
8	Vitet mesatare të shkollimit (femra)	5.3	10

*Burimi: Anketa me familjet rome, 2011; *INSTAT., Popullsia e Shqipërisë, 2001*

Shënim: * Persona që nuk dinë as shkrim as këndim, sepse nuk kanë bërë asnjë vit shkollë.

Sipas Roma Mapping vitet mesatare të përfunduara të arsimit për popullsinë rome 15 vjeç e lart janë 3.4 vite ose 3.78 për meshkujt dhe 3.02 për femrat. Në rast se në këtë tregues do të përfshijmë vetëm ata që kanë ndjekur shkollën atëherë vitet mesatare të përfunduara të arsimit janë 5.9 ose 6.06 vite për meshkujt dhe 5.71 për femrat. Ndërsa sipas Censurit, ky tregues për popullsinë e përgjithshme është mesatarisht 10 vite, kurse diferenca midis meshkujve dhe femrave është e

paperfillshme (idem).

Pavarësisht se ka një përmirësim të nivelit arsimor të romëve gjatë dekadës së dytë të tranzicionit, në krahasim me dekadën e parë të tij, analfabetizmi vazhdon të mbetet shumë i lartë. Në disa vendbanime ku romët jetojnë në kampingje, si në Shkodër, Beltojë, Peshkopi, Kukës, Fushë-Alie, Shupenzë, Milot, Shkozë, Farkë, Kavajë, Qafë e Vishës, Gjirokastrë (tregu i shumicës) dhe Vrion (Sarandë), niveli i analfabetizmit për grup-moshën 10 deri 18 vjeç arrin në 68.3 për qind, ndërsa 91.3 për qind e fëmijëve të grup-moshës 8-15 vjeç nuk e ndjekin shkollën. Ky nivel i lartë analfabetizmi do të vazhdojë të riprodhojë varfëri edhe në të ardhmen. Në mungesë të arsimit, popullsia rome e ka të vështirë të integrohet në tregun e punës dhe aftësia e saj, në krahasim me popullsinë mazhoritare, do të vijë duke u ulur.

Sëmundshmëria e romëve në kontekstin e sëmundshmërisë në vend

Ndonëse në Shqipëri, ashtu si në shumë vende të tjera të Europës Qendrore dhe Lindore, ka mungesë statistikash dhe analizash në lidhje me gjendjen shëndetësore të romëve, mund të hipotezohet se treguesit e gjendjes shëndetësore të romëve po përkeqësohen krahasuar me treguesit e shëndetit të popullsisë së përgjithshme të vendit. (Foldes & Covaci, 2011; Hajioff & McKee, 2000). Në shumë vende vlerësohet se romët përgjithësisht jetojnë rreth 10 vjet më pak se popullsia në shumicë (Ringold at al, 2003; Braham, 1993). Për shkak të varfërisë, kushteve të vështira, mënyrës së jetesës, nivelit të ulët arsimor, aksesit të pakët në shërbimet shëndetësore, diskriminimit etj., romët kanë një incidencë më të lartë sëmundshmërie dhe janë më të prekshëm sidomos ndaj sëmundjeve të transmetueshme.

Tipologjia e sëmundshmërisë së romëve po ndryshon, duke ndjekur pak a shumë dinamikën e sëmundshmërisë së popullsisë së vendit. Aktualisht po ndodh zëvendësimi i sëmundjeve tradicionale infektive e parazitare me sëmundjet e hipertensionit, neurozat, anomalitë optike, kariat dentare, traumat dhe aksidentet, diabeti, sëmundjet e stomakut (Barjaba, 2012). Këto ndryshime janë të ngjashme me evoluimin e sëmundshmërisë, sidomos përhapjen e sëmundjeve psikomotorrike e nervore, streseve e çrregullimeve emocionale, të shkaktuara nga arsye të ndryshme si papunësia në rritje, mungesa e banesës, varfëria, përhapja e gjerë e dhunës, krimit, emigrimi masiv etj. Megjithatë, zbulueshmëria, diagnostikimi dhe kurimi i këtyre sëmundjeve për popullsinë rome është në një shkallë dukshëm më të ulët krahasuar me popullsinë e vendit.

Gjatë dekadave të fundit po shtohen shkaqet jonatyrore në sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e popullsisë rome, sidomos asaj në moshë të re. Ndër këto shkaqe mund të përmendim aksidentet automobilistike, traumat e ndryshme si pasojë e përhapjes së kriminalitetit, përdorimi i tepruar i pijeve alkoolike dhe i duhanit, shkalla e lartë e punësimit të fëmijëve në kushtet e mungesës së sigurisë

dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, uria dhe kequshqyerja, përdorimi i ushqimeve me origjinë industriale ose të dyshimtë, emigrimi masiv, përhapja e sëmundjeve seksualisht të trashëgueshme, rritja e konsumimit të drogës etj.

Sëmundshmëria e romëve është një pasqyrë e sëmundshmërisë së popullsisë së vendit, por me një incidencë më të madhe të shumicës së sëmundjeve. Anketa e realizuar me familjet rome tregoi se 17 për qind e tyre vlerësojnë se nuk gëzojnë shëndet të mirë. Rreth 11 për qind pohojnë se kanë vuajtur nga sëmundje të rënda, ndërsa rreth 15 për qind vuajnë nga sëmundje kronike. Sipas të anketuarve, sëmundjet më të përhapura kronike janë ato kardiovaskulare, të shoqëruara nga ato reumatizmale, të diabetit, neurologjike dhe psikiatrike, të veshkave, të stomakut dhe ato të organeve të frymëmarrjes. Konsumi i tepruar i alkoolit dhe duhanit është një faktor tjetër që ndikon në sëmundjet kronike, por pasojat e tyre mbi shëndetin janë të vështira për t'u vlerësuar. Midis romëve vërehen edhe raste të tuberkulozit, sifilizit, hepatitit B dhe HIV/AIDS (Hafizi at al, 2007) me një incidencë më të lartë krahasuar me popullsinë e vendit. Ndërsa, midis fëmijëve romë (nga 0 në 18 vjeç) sëmundjet më të përhapura janë ato të organeve të frymëmarrjes, infektive dhe mendore.

Tabela 4: Sëmundjet më të përhapura ndër romët

Nr.	Sëmundjet	Romët
1	Tensioni i gjakut	16.9
2	Zemra	15.7
3	Reumatizma	8.7
4	Diabeti	6.8
5	Sëmundje mendore	6.1
6	Veshkat	4.9
7	Stomaku	3.2
8	Astma	3.9
9	Rrufa/Gripi	2.3

Burimi: Pyetësorët socialë ekonomikë për familjet rome dhe egjiptiane, 2011

Ndërkaq, të dhënat e anketës tregojnë se 4.1 për qind e familjeve rome kanë anëtarë të familjeve me aftësi të kufizuara. Nga këta, rreth 1/4 janë fëmijë, të cilët përfaqësojnë rreth 3.2 për qind të fëmijëve romë.

Shënim përfundimtar

Në Shqipëri ka ende një konfuzion në lidhje me statistikën e popullsisë romë. Burime të ndryshme ofrojnë të dhëna të ndryshme dhe kjo shtrun nevojën e unifikimit të tyre si edhe saktësimin e të dhënave numerike mbi romët e Shqipërisë. Romët, edhe pse një komunitet i vogël, janë një popullsi diverse dhe ky diversitet ndikon në mobilitetin, profesionet, veprimtaritë punuese, marrëdhëniet me komunitetet e tjera, tiparet e zhvillimit njerëzor dhe me cilësinë e tyre të jetës. Komuniteti rom është dukshëm më i ri në moshë sesa popullsia e përgjithshme e Shqipërisë. Moshë e re, niveli i ulët arsimor, shëndeti problematik dhe varfëria e lartë shtrojnë nevojën e hartimit të politikave të zhvillimit, specifike për këtë komunitet. Rreth 12 për qind e forcave të punës (grup-moshat që në vitin 2011 ishin 8-14 vjeç) që do të dalin në treg gjatë periudhës 2015-2018 do të jenë të paarsimuar (rreth 40 për qind e tyre analfabetë) dhe rrjedhimisht të pakualifikuar. Ndërkaq, hendeku arsimor me popullsinë në shumicë do të vazhdojë të rritet. Kjo, nga njëra anë, do të prodhojë papunësi (duke rritur papunësinë e lartë ekzistuese), të ardhura të ulëta nga sektori informal, pasiguri ekonomike e stres emocional për të ardhmen, si dhe nuk do t'i lejojë romët të dalin nga cikli i varfërisë. Ndërsa nga ana tjetër, do të përbëjë një barrë për buxhetin e shtetit dhe sistemin e mirëqenies. Këto kontradikta mund të zgjidhen nëpërmjet arsimimit dhe kualifikimit të rinjve romë. Treguesit e gjendjes shëndetësore të romëve janë më të përkeqësuar sesa treguesit e shëndetit të popullsisë së Shqipërisë dhe këta tregues vijnë duke u përkeqësuar. Kjo tendencë shtrun nevojën e intensifikimit të politikave e programeve parandaluese në shërbim të komunitetit rom. Disa programe të sistemit të mbrojtjes shoqërore, si "Ndihma Ekonomike" etj., duhet të mbajnë parasysh jo vetëm nevojat e popullsisë në tërësi, por edhe specifikat e varfërisë dhe zhvillimit të ulët njerëzor të popullsisë romë.

Bibliografia

- Auzias, C. (1998) *Les Poetes de Grand Chemin. Voyages avec les Roms des Balkans*, Editions Michalon, Paris.
- Barjaba, K. (2013) *Kurthet e papunësisë*, Tiranë: UET Press.
- Barjaba, K. (2012) *Elita demografike në tranzicionin demografik*, Tiranë: Toena,
- Barjaba, K. (1995) Recent Implications of Inter-Ethnic Relations in Albania, *Anthropological Journal on European Cultures*, Vol. 4, Number 1.
- Berxoli, A. (2005) *Minorities in Albania*, Tirana.
- Braham, M. (1993) *The untouchables: a survey of Roma people of central dhe Eastern Europe*. Geneva: UNHCR.
- Courthiade, M. & Duka J. (2002) *A Social and historical profile of the Roms in Albania*.

- De Soto H., Gëdeshi, I. (2002) Dimensions of Romani Poverty in Albania, Roma Rights. *Quarterly Journal of the European Roma Rights Center*, Number 1. Budapest: Hungary.
- De Soto, H., Beddies, S., Gedeshi I. (2005) *Roma and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion*, The World Bank, Washington D.C.,
- ECRI (2002) (European Commission Against Racism and Intolerance) EU Support for Roma Communities in Central and Eastern Europe, *Enlargement Briefing*, Brussels.
- Gëdeshi, I., Jorgoni, E. (2012) *Mapping Roma Children in Albania*, UNICEF.
- Gëdeshi, I., Miluka, J. (2012) *Needs Assessment Study on Roma and Egyptians Communities in Albania*, UNDP.
- Gëdeshi, I. & Miluka, J. (2012) *Migrimi i romëve. A mund të maksimizojmë përfitimet e tij?* Fondacioni Soros.
- Gëdeshi, I. (2013) *Punësimi i romëve*, në librin "Dekada e romëve dhe situata e romëve në Shqipëri - 2012", Fondacioni Soros, Tiranë.
- Hafizi, H. & Bardhi, D. & Dilko E. & Tafaj, S. & Aliko, A. (2007) Epidemiologjia e tuberkulozit në Shqipëri për vitin 2007, *Revista Mjekësore*, 3.
- Hasluck, M. (1938) The Gypsies of Albania, *Journal of the Gypsy Lore Society*, 17 (2): 49-61.
- Government of Albania (2003) *National Strategy for improving Roma living conditions*.
- INSTAT (2012) *Shqipëria. Rezultatet Paraprake të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011*, Dhjetor.
- INSTAT (2012) *Censuri i popullsisë dhe banesave*, Rezultatet kryesore, Tiranë .
- INSTAT (2013) *Albania. Population and Housing Census 2011*, Main Results.
- Ivanov, A. & Kling, J. & Kagin, J. (2012) Integrated household surveys among Roma populations: one possible approach to sampling used in the UNDP-World Bank-EC Regional Roma Survey 2011, *Roma Inclusion Working Paper*, Bratislava: UNDP, 2012.
- Liegeois, J-P (2009) *Roms et Tsiganes*, La Decouverte, Paris.
- Liegeois, J-P (1983) *Tsiganes*, La Decouverte, Paris.
- Koinova, M. (2000) *Minorities in Southeast Europe: Roma of Albania*, Center for Documentation and Information on Minorities in Europe - Southeast Europe (CEDIME).
- Kolsti, J. (1991) *Albanian Gypsies: The Silent Survivors*, in Crowe and Kolsti eds., *The Gypsies in Eastern Europe*, Armonk, New York: Sharpe.
- Mann, S. E. (1933) Albanian Romani, *Journal of the Gypsy Lore Society*, Vol. XII, No. 1.
- Marushiakova, E., Popov V. (2001) Gypsies in the Ottoman Empire. *Centre de recherches tsiganes*, University of Hertfordshire Press.
- Matras, Y., (2004) Romacilikanes - The Romani dialect of Parakalamos, *Romani*

Studies 5, Vol. 14, No. 1.

Milaj, J. (1943) *Raca shqiptare*, Tiranë.

Ringold, D. & Orenstein A. M. & Wilkens E. (2003) Roma in an Expanding Europe: Breaking the Poverty Cycle, *A World Bank Study*, Washington D.C.,.

Silverman, C. (1995) Prosecution and Politicization: Roma (Gypsies) of Eastern Europe, *Cultural Survival* 19 (2).

Sokoli, L. (2014) Some Critical Themes Regarding the International Migration of Albanians After 1990s, *Mediterranean Journal of Social Science*, Vol. 5, nr. 1, January.

Taho, A. (1943) Magjypët e Shkodrës, *Revista Leka*, N. 7.

UNICEF (2012) Mapping Roma Children in Albania, Tirana.

Ligji i hekurt i oligarkisë. Vështrim mbi demokracinë e brendshme të partive shqiptare.

Ina K. ZHUPA¹

Abstrakt. Ky punim vjen si një vështrim kritik mbi demokracinë e brendshme të partive politike shqiptare në këto 20 vjet, duke tentuar të japë kontribut se cilët janë treguesit matës për demokracinë e brendshme, pse është e domosdoshme dhe çfarë tregon mbi partitë dhe shtetin pasja apo mospasja e demokracisë së brendshme partiake. Studiohen statutet e partive kryesore deri sot në skenën shqiptare duke nxjerr në pah të gjitha modalitetet që ato përcaktojnë mbi demokracinë e brendshme. Ajo që vihet re është që “de juro” këto parti janë demokratike. Ndërsa nga ana tjetër është parë praktika e derisotme e trajtimit të mendimit ndryshe, përjashtimet dhe krijimi i partive të reja nga fraksione dhe “de facto” na rezulton se nuk janë demokratike. Për këtë arsye sugjerohen disa zgjidhje afatgjata që mund të çojnë në zbatimin de facto të demokracisë së brendshme partiake në Shqipëri.

Fjalët kyçe: Demokraci, zgjedhje të brendshme, fraksion, mendim ndryshe, 1 anëtar-1 votë, parti politike.

¹ Lektore & Doktorante në Universitetin Europian të Tiranës

Hyrje

Shfaqja e partive politike bëri të mundur kalimin nga kontrolli oligarkik-borgjez të pushtetit te demokracia konstitucionaliste moderne. Me të drejtë thuhet se demokracia aktuale është demokracia e partive dhe shpikja më e madhe në fushën e organizimit politik (Zampetti, 1973:19). Pa ekzistencën e partive nuk mund të ketë demokraci autentike që domethënë demokraci pluraliste. Pa disa parti politike të qëndrueshme, duke marrë për bazë mbështetjen e tyre sociale dhe një organizim me kohezion dhe me disiplinë brendshme, është e vështirë që të ketë vlera të vërteta një sistem demokratik. Në këtë kuptim, për shembull, sipas Kelsen-it demokracia është thelbësisht çështje procedurale (Kelsen, 1988: 210), dhe kjo shënjon atë që demokracia nuk është e konceptueshme pa ekzistencën e partive politike dhe kjo sipas fjalëve “demokracia moderne mbështetet mbi partitë politike, rëndësia e të cilave rritet me forcimin progresiv të principeve demokratike” (Kelsen, 1992: 35-36).

Bile edhe sistemet me qeverisje autokratike, ashtu siç edhe ne për 50 vjet në komunizëm, organizimi partiak (thënë më saktë monopartiak) luan një rol vendimtar. Ashtu siç thoshte Laski, në këto vende zgjedhjet janë si garat me kuaj ku merr pjesë vetëm një kalë. Pavarësisht kësaj, partia përbën qendrën e pushtetit politik brenda shtetit. Është e qartë pra që partitë politike bashkëpunojnë në formimin dhe shprehjen e vullnetit politik dhe drejtimin e shtetit.

Për këtë janë përcaktuar si “organizime qytetarësh që me ndihmën e organizatës së tyre aspirojnë të ndikojnë në një drejtim të caktuar mbi formimin e vullnetit të shtetit” (Friederich, 1975: 357- 358). Për sa më sipër deduktohet që partitë kanë një bazë bashkëpunimi, pra janë më të ndërtuara nga qytetarë që janë duke ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese për t’u organizuar lirisht. Normalisht janë edhe mbartëse të një ideologjie të caktuar, ose të paktën një bashkim idesh dhe idealesh që lidhen me aspekte të ndryshme të jetës politike, sociale dhe ekonomike.

Partitë politike kërkojnë të forcohen në radhë të parë për të pasur më shumë votues/zgjedhës, në mënyrë që të kenë më shumë mundësi për të ndikuar, qeverisur apo drejtuar aktivitetin e shtetit. Le të kujtojmë që Heller me të drejtë thoshte: “Çdo pushtet politik, nga natyra e vet dhe prirja e tij ekzistenciale aspiron të shndërrohet në pushtet shtetëror” (Heller, 1955: 499). Pikërisht ky fakt na bën ne studiuesve edhe më të interesuar mbi jetën partiake sepse ajo në çdo moment mund të shndërrohet si model për jetën shtetërore të vendit, pas fitimit të zgjedhjeve nga partia. Gjithashtu demokracia e brendshme në një optikë tjetër mund të shikohet si mënyra e vetme për të parë tendencën demokratike ose jo që mund të ketë partia pas marrjes së pushtetit dhe qeverisjes së vendit.

Kuptime dhe konceptime mbi demokracinë e brendshme partiake

Kur vjen puna për të folur dhe për të trajtuar demokracinë e brendshme, vështirësitë e para lidhen me përkufizimin e saj. Nuk ka deri më sot një mënyrë për ta përcaktuar dhe çdo herë varet nga qasja me të cilin pozicionohet studiuesi apo edhe politikani. Demokracia e brendshme në një parti supozon adoptimin e parimeve të sistemit politik demokratik brenda këtij organizmi. Nga një perspektive pluraliste kjo do të thotë që të përfshihet brenda partive kriteri i konkurrueshmërisë, adoptimi i vlerave demokratike si liria e shprehjes, liria e zgjedhjes për anëtarët e vet dhe përdorimi i mekanizmave të ndershëm dhe të hapur në procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrjen e anëtarëve, ndjekës dhe vullnetarëve të partisë, si dhe ekzistenca e disa kushteve që lejojnë ushtrimin efektiv të pushtetit politik.

Mirëpo cilat mund të jenë disa nga treguesit që mund t’i përdorim në një gjykim mbi demokracinë e brendshme partiak? Gjëja e duhur do të ishte adaptimi i atyre treguesve, që i përdorimin edhe për të gjykuar mbi demokracinë e një vendi, por duke i përshtatur në një sfond brendapartiak. Siç, për shembull, mund të jenë: Garantimi i barazisë mes anëtarëve dhe mbrojtja e të drejtave themelore për ushtrimin e lirisë së shprehjes; mekanizmat përzgjedhës të kandidatëve që marrin pjesë në zgjedhje (të jashtme dhe të brendshme) të jenë konkurruese; pjesëmarrja e anëtarëve në organet e qeverisjes, pa asnjë lloj diskriminimi për grupet e ndryshme që përfaqësohen brenda organizatës; ndikimi aktiv i grupeve të ndryshme në diskutimin dhe formimin e propozimeve programatike dhe përpunimin e propozimeve partiake dhe vendimeve të përbashkëta që merren; respektimi i parimit të shumicës; që bën që vendimet të merren si rezultat i bashkimit të shumicës së vullneteve individuale dhe të respektohet dhe të garantohet mendimi i pakicës; kontrolli efektiv i anëtarëve mbi drejtuesit e tyre nëpërmjet një procesi “ndëshkimi” ose “shpërblimi” për vendimet e marra.

Rëndësia e demokracisë së brendshme partiake

“Nevoja për demokraci të brendshme, përbën themelin e një partie solide, konkurruese, demokratike dhe moderne. Përmes demokracisë së brendshme partia krijon struktura efektive, ngjall besim tek elektorati dhe bën më të preکشëm premtimin për shndërrimin e demokracisë dhe vlerave të saj në parim udhëheqës edhe gjatë qeverisjes në pushtet. Mungesa e demokracisë jep rezultate negative në prezantimin e partisë në elektorat, largon qytetarët e pavendosur, rrit burokracinë dhe familjaritetin, vë në dyshim aftësinë qeverisëse dhe ul nivelin e debatit politik” (Krasniqi, 2008: 105). Shumë e rëndësishme është të kuptojmë që partitë janë replika të shtetit, dhe në një mënyrë ato përfaqësojnë mënyrën sesi do të ndërtohet qeverisja kur ato të jenë në pushtet.

Nuk mund të mohojmë që demokracia në përgjithësi dhe partitë politike sot janë në një krizë legjitimiteti për shkak të tërheqjes që kanë bërë qytetarët nga votimet dhe nga pjesëmarrja nëpër aktivitete partiake dhe politike. Pikërisht lidhur me këtë ka mundësi që dalja nga kriza e legjitimitetit, që sot ka prekur partitë politike, të varet nga një pjesë e mirë nga ajo që na paralajmëron edhe Manuel Aragon mbi aftësinë e këtyre partive për të pasur një demokraci të brendshme të arsyeshme (Aragon, 1999: 139-142).

Po ashtu demokracia e brendshme është e rëndësishme brenda partisë sepse çdo patologji e partive ndikon në funksionimin e organeve të pushtetit. Për këtë arsyeje, nëpër rregulloret e partive duhet të jenë të gatshëm që jo vetëm të ndërfaqen, por dhe të zbatojmë norma që garantojnë demokracinë e brendshme. Guillermo O'Donnell shkruan "deficitin më i rrezikshëm i ligjshmërisë gjendet në ekzistencën e pushteteve faktike, që qëndrojnë mbi ligjin, dhe që duhen patjetër të futen brenda ligjit" (Valades, 1998: 65).

Organizimi i brendshëm i partive sipas bazave ligjore dhe statutore

Gjykimin mbi partitë politike shqiptare duhet vetvetiu ta nisim nga pjesa formale dhe nga ajo që parashikohet nëpër gjithë pjesën dokumentare të shtetit shqiptar dhe më pas të vetë partive. Për sa i përket pjesës shtetërore, dokumenti më i rëndësishëm juridik për shtetin është kushtetuta ku në nenin 9 të saj, pika 1 përcaktohet: "Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike" (Kushtetuta e Shqipërisë, neni 9).

Kjo është e vetmja pikë në kushtetutë ku citohet organizimi i partive politike dhe cilësohet si domosdoshmëri të jetë i përputhur me parimet demokratike. Por çfarë duhet të kuptojmë ne me organizimi demokratik kjo është lënë e papërcaktuar, dhe në vullnetin e partive politike për të vendosur mekanizmat e duhur që çojnë në plotësimin e këtij kriteri. Por diçka në lidhje me atë çfarë kuptohet me parimet demokratike brenda partisë e gjejmë te ligji mbi partitë politike.

Pikërisht dokumenti tjetër që marrim në shqyrtim është ligji "Mbi partitë politike" i cili në nenin 7 të tij përmend në pikën (a) që ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur: organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtari për të zgjedhur e për t'u zgjedhur (Ligji 8580, neni 7). Kjo do të thotë, që ekziston një kuadër legal, që sanksionon nevojën për demokraci të brendshme brenda partive politike. Fakti që nuk mund të regjistrohesh si parti nëse nuk ke demokraci të brendshme është një tjetër tregues që më bind se demokracia e brendshme është e nevojshme edhe për shtetin dhe për shoqërinë sepse ndryshe nuk do të përmendej.

Partitë politike zotërojnë, në ndryshim nga organizimet pararendëse të tyre, një organizim juridik të cilin e emërtojnë përgjithësisht statut. Ky i fundit saktëson parimet e mëdha që strukturojnë jetën e partisë, orientimin e saj ideologjik, objektivat që ajo do të ndjekë. Por statuti përkufizon sidomos, në terma abstraktë, funksionet e drejtimit dhe përcakton rregullat sipas së cilave do të funksionojë zgjedhja ose zëvendësimi i drejtuesve. Pikërisht statuti i partive do të jetë dokumenti tjetër që ne duhet të shqyrtojmë se çfarë përcakton mbi demokracinë e brendshme dhe sa nga kriteret e sipërpërmendura gjenden në reflektuara në statutet përkatëse.

Partia Demokratike e Shqipërisë

Aktualisht partia kryesore në pushtet sanksionon në statut demokracinë e brendshme si bazë të funksionimit të saj dhe zbatimin e saj e shpreh edhe me zgjedhjen e kandidaturave elektorale. Në nenin 8 përcaktohet "Funksionimi i PD bazohet në demokracinë e brendshme, e shprehur përmes votës së anëtarëve të saj... Demokracia zbatohet edhe në nxjerrjen e kandidaturave elektorale të partisë" (Statuti i PD). Gjithashtu në nenin 14 përcaktohet barazia mes anëtarë të saj për të marrë pjesë në zgjedhje dhe veprimtarisë e partisë si edhe të shpreh lirisht aty mendimin e tij, si edhe për të propozuar të gjitha organet legjislative e ekzekutive që përfaqësojnë partinë.

Në nenin 34 të statutit, pika 1, sanksionohet që: "kandidaturat për zgjedhjet në pushtetin lokal dhe Kuvendin e Shqipërisë konsultohen nga gjithë anëtarësia e PD-së". Në nenin 58 garantohet shprehja e lirë për çdo anëtar të partisë: "Çdokush nga anëtarët ka të drejtë të shprehë lirshëm mendimin e tij në strukturat dhe organet e PDSH-së. Kufizimi në kohë dhe në numër i diskutimeve në një mbledhje është i mundshëm kur nuk është diskriminues dhe kur këtë e kërkon shumica e anëtarëve me të drejtë vote. Në çdo rast duhet respektuar dhe garantuar shprehja e mendimit ndryshe. Për këtë, kur diskutohen çështje, për të cilat ka mendime "pro" dhe "kundra", të garantohet shprehja e mendimit të pakicës". Ndërsa në nenin 60 përcaktohet shumica e kërkuar për vendimarrje brenda partisë: "Vendimet quhen të miratuara nëse votat "pro" përbëjnë mbi 50% të votave të vlefshme të pjesëmarrësve në votim, me përjashtim të rasteve kur në Statut parashikohet ndryshe. Kur votat janë të barabarta propozimi i votuar konsiderohet i refuzuar. Abstenimet merren në konsideratë për llogaritjen e korumit. Për ndryshime statutore nevojitet shumica absolute e anëtarëve me të drejtë vote. Për miratimin e vendimit për shpërndarjen ose bashkimin e PDSH me një parti tjetër, duhet një shumicë prej ¾". Këto janë nenet kryesore që flasin dhe kanë lidhje me konceptin e demokracisë së brendshme në statutin e Partisë Demokratike. Në vija të përgjithshme, mund të përcaktohet në përputhje me parimet e demokracisë së brendshme sepse sanksionon vendimet që merren me shumicë votash. Me poshtë do ta krahasojmë këtë gjendje me atë të Partisë Socialiste.

Partia Socialiste e Shqipërisë

Që në nenin e parë të statutit sqarohen disa koncepte bazë organizative që lidhen me demokracinë e brendshme. Aty përcaktohet që: “Demokracia e brendshme në parti është kusht politik, organizativ dhe moral i ekzistencës dhe i zhvillimit të saj. Personaliteti dhe dinjiteti i anëtarit të partisë është i pacenueshëm. Organet drejtuese të partisë përfaqësojnë dhe shërbejnë vullnetin e anëtarëve dhe përkrahësve të saj. Anëtari i partisë shpreh vullnetin drejtpërdrejt ose me delegim. Delegatët zgjedhës në të gjitha nivelet e zgjedhjeve, si rregull, kanë mandat me kohëzgjatje të njëjtë me të zgjedhurit e tyre. PSSH garanton shanse të barabarta në përfaqësim midis grave dhe burrave. Disiplina në Parti bazohet në konvergencën e mendimeve për alternativën e zhvillimit të individit e të shoqërisë dhe në njohjen e dobisë së bashkërendimit të veprimeve. Organet drejtuese qendrore tërheqin dhe parashtrajnë mendimin e organeve drejtuese vendore (Statuti i PSSH-së).

Ndërsa në nenin 2 gjejmë mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes së tij si dhe lirinë e zgjedhjes, duke u përcaktuar në pikën 1 dhe 2 që: “Partia garanton dhe mbron për të gjithë anëtarët e saj lirinë e shprehjes së mendimeve, të pikëpamjeve dhe platformave që synojnë zbatimin dhe përmirësimin e Programit dhe të Statutit. Liria e zgjedhjes dhe votimi i fshehtë janë individuale dhe të garantuara”. Gjithashtu në nenin 4, pika 1, thuhet që: “Veprimtaria e organeve drejtuese të Partisë është e hapur për anëtarët e saj. Dokumentet që pasqyrojnë këtë veprimtari dhe vendimet që merren u bëhen të njohura anëtarëve të partisë nëpërmjet strukturave organizative ose shtypit dhe mjeteve të tjera të Partisë për informimin publik”.

Në partinë Socialiste sanksionohet sipas nenit 8 të Statutit, pika 1, ku “Anëtarët e PSSH-së janë të barabartë në raport me Partinë, pavarësisht nga funksionet që kanë brenda saj dhe gjendjes ekonomike e pozicionit shoqëror jashtë saj”. Ndërsa neni 41 qartëson se: “Votimi për zgjedhjen midis kandidatëve për anëtarë forumesh drejtuese të partisë është i fshehtë dhe presupozon: të paktën më shumë se një kandidat mbi numrin e vendeve...”. Po ashtu në statutin e Partisë Socialiste vëmë re përcaktimin dhe saktësimin e parimeve që lidhen me demokracinë e brendshme.

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim

Kjo parti është krijuar nga shkëputja e një bërthame përfaqësuesit të lartë të Partisë Socialiste pas një konflikti të hapur për mospërputhje qëndrimesh dhe interesash të kryetarit aktual të LSI-së, Ilir Meta me ish- kryetarin e atëhershëm, Fatos Nano. Megjithatë këtu mbetemi ende në gjykimin vetëm të bazës statutoare të partisë. Në pikën 6 të Statutit të LSI-së për parimet kryesore përcaktohet: “një anëtar një votë dhe organizimi vertikal nga baza në qendër; b. liria e shprehjes

e çdo anëtari për çdo problem që ka të bëjë me performancën e LSI-së, dhe të zgjedhurve të saj, dokumentet dhe zbatimin e tyre, si dhe çështje të tjera me interes; c. pacenueshmëria e personalitetit dhe e dinjitetit të anëtarit nga çdo anëtar, funksionar i zgjedhur ose i emëruar, forum apo vendim i cilido forumi të LSI – së; d. demokracia e brendshme dhe njohja e garantimi i përfaqësimit në forumet e LSI – së i fraksioneve; e. kolegjaliteti dhe transparenca në vendimmarrje dhe në drejtimin e çdo strukture të LSI – së; f. shtrirja e përfaqësimit dhe vlerësimi i gjithsecilit në bazë të kontributeve”(Statuti i LSI-së).

Po ashtu në detyrat e anëtarit pika 7.7 (g) shprehet vullneti për lirinë e shprehjes brenda partisë dhe për marrjen e vendimeve me shumicë: “anëtari i LSI-së ka për detyrë të pranojë vendimet e shumicës e të respektojë mendimin ndryshe”. Ndërsa pika 7.8 (d&e) ku flitet për të drejtat e anëtarit të LSI-së specifikohet që ai ka të drejtë: “të propozojë dhe të propozohet si kandidat i LSI-së për zgjedhjet e pushtetit vendor, ato të përgjithshme si dhe në të gjithë organizmat ku kërkohet përfaqësimi i LSI – së; të jetë i barabartë me të gjithë anëtarët e tjerë të LSI – së, pavarësisht nga funksionet që ai mbulon në LSI apo gjetkë, gjendja ekonomike, përkatësia shoqërore”.

Një pjesë interesante që lidhet me atë çka ne kemi parashtruar si demokraci të brendshme është ajo ku në statutin e kësaj partie përcaktohet mënyrat e marrjes së vendimeve, pika 12: “Në forumet e LSI – së vendimet merren vetëm pas debatit dhe këmbimit të lirë të mendimeve; Vendimet në forumet e LSI – së merren me konsensus dhe në mungesë të konsensusit me votim të hapur; vendimet që kanë të bëjnë me individët, me normat e Statutit dhe të Programit, apo kur kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të forumit të LS. – së, që merr vendimin, bëhen gjithnjë nëpërmjet një procesi të votimit të fshehtë; vendimi i miratuar nga shumica e pjesëmarrësve në votim është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga të gjithë ata të cilëve ky vendim iu drejtohet; vendimet e forumeve publikohen në organet e shtypit të LSI – së apo në buletinet e saj periodike informative”. Ndërsa në pikën 13.4 jepet mundësia edhe për ankimimin e këtyre vendimeve: “Të drejtën e ankimimit të vendimeve të marra nga forumet e LSI – së e kanë të gjithë anëtarët apo forumet e saj. Në Këshillin Ankimor nuk mund të ankimohen vetëm vendimet e Konventës Kombëtare”. E veçanta e statutit të kësaj partie është që paraqet një pikë të veçantë për mundësinë dhe lejimin e fraksioneve të brendshme të partisë pikërisht pika 14.1 shpreh: “LSI njeh dhe garanton përfaqësimin e fraksioneve në forumet e saj”.

Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut

Është marrë në shqyrtim për faktin se përbën një shembull të veçantë në spektrin politik shqiptar, për shkak të profilit të saj në mbrojtje të minoriteteve dhe të drejtave të njeriut dhe pse e lidhur më shumë me atë grek. Në statutin e saj fillohet

me të drejtat e anëtarit të PBDNJ-së, të drejtat të tilla që mund të cilësohen në linjë të njëjtë me nevojën dhe zbatimin e demokracisë së brendshme. Në nenin 12 përcaktohet që anëtari i partisë ka të drejtë: “të marrë pjesë në përpunimin e politikës, të qëndrimeve e vendimeve të Partisë në të gjitha nivelet, përmes diskutimit të debatit demokratik si dhe të shprehë lirisht pikëpamjet e tij për tërë veprimtarinë partiake; të ketë pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit, të zgjedhë dhe të zgjidhet në të gjitha forumet drejtuese të Partisë në të gjitha nivelet; të caktohet kandidaturë e Partisë në të gjitha zgjedhjet elektorale të përgjithshme apo vendore; të miratojë apo kritikojë lirisht funksionimin ose mosfunksionimin që konstaton në veprimtarinë e organeve në të gjitha nivelet drejtuese; të marrë pjesë në mbledhjet e Partisë të çdo niveli ku shqyrtohen probleme që kanë të bëjnë me vetë atë” (Statuti i PBDNJ).

Ndërsa në nenin 13 përcaktohet barazia mes anëtarëve të partisë: “Anëtarët e Partisë janë të barabartë në raport me Partinë, pavarësisht nga funksionet që mbajnë brenda saj, gjendjes ekonomike dhe pozicionit shoqëror jashtë saj”. Në nenin 83 përcaktohet mundësia për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet e partisë: “Zgjedhja e organeve drejtuese të Partisë në çdo nivel bëhet me votim të fshehtë dhe me kandidatura konkurruese. Çdo anëtar i PBDNJ-së ka të drejtë të shprehë mendimin e tij për çdo kandidaturë të propozuar si dhe të propozojë kandidatin e tij. Çdo kandidat i propozuar nga anëtarët ose nga organet e Partisë ka të drejtë ta refuzojë këtë kandidaturë”. Duke konfirmuar në nenin 85 që: “Vendimet e Partisë në të gjitha nivelet e organeve drejtuese merren përmes debatit të lirë demokratik dhe paraqitjes në të të alternativave të ndryshme. Vendimet merren me shumicë votash, ku vendimi i shumicës është i detyrueshëm për zbatim”. Dhe së fundmi në nenin 87 legalizohet mundësia për ekzistencën e mendimit ndryshe dhe rrymave alternative brenda partisë, por edhe duke qartësuar se: “...kur nuk arrihet konsensusi në marrjen e vendimeve, rryma që ndodhet në minorancë i nënshtrohet mendimit të shumicës, duke ruajtur të drejtën e paraqitjes sërish për diskutim të alternativës së vet”.

Demokracia e brendshme në praktikë. Modeli i partive shqiptare

Sapo shqyrtuam statutet e katër partive që i zgjodhëm si përfaqësuese të partive shqiptare, duke kombinuar veçantinë e tyre për sistemin dhe peshën e tyre elektorale dhe politike për vendin. Askush nga ne nuk mund ta mohojë që janë statute me norma demokratike, që e vlerësojnë dhe e parashikojnë demokracinë e brendshme si parim funksionues të partive. Megjithatë për të gjithë ata që e njohin sado pak realitetin partiak shqiptar, lindin menjëherë në mendje paralelizma mes asaj që shkruhet atje dhe asaj që ka ndodhur dhe ndodh përditë në jetën e brendshme partiake.

Le ta nisim me jetën e brendshme në Partinë Demokratike: Në vitin 1992 pas humbjes së PD-së në zgjedhje, zëra themelues të PD-së, filluan kritikën ndaj Berishës për mënyrën sesi po e ndante ai pushtetin. Mes tyre shquante Arben Imami, Preç Zogaj, Gramoz Pashko, Perikli Teta dhe figura të tjera të partisë. Ata botuan një dokument, ku kërkonin një analizë të përgjegjësive brenda PD-së, por si përgjigje morën një Konferencë të jashtëzakonshme në muajin shtator, që i përjashtoi ata nga Partia Demokratike. Ky përjashtim i parë çoi në krijimin e partisë Aleanca Demokratike, që u pozicionua si opozitare me PD-në.

Në vitet 1993-1994, brenda PD-së po formoheshin fraksione paksa më radikale nga e djathta, që përfaqësoheshin nga Petrit Kalakula, që drejtonte degën e Tiranës dhe Abdi Baleta, një deputet me qëndrime nacionaliste të qarta, të cilët po paraqisnin një frymën kritike ndaj Berishës për mbrojtjen që ky i bënte figurës së Fan Nolit. Kalakula dhe Baleta u përjashtuan nga PD-ja, dhe krijuan Partinë e Djathtë Demokratike dhe më pas partinë Rimëkëmbja Kombëtare. Pas humbjes së referendumit të Kushtetutës, në nëntor të vitit 1994, Eduard Selami, kryetar i PD-së, nisi një tur kritikash në të gjithë vendin duke kërkuar të bashkohej posti i kryeministrit, që mbante Aleksandër Meksi, me atë të kryetarit të PD-së dhe të kërkonte forma të tjera të rimirimit të Kushtetutës. Pas kësaj ai u përjashtua nga PD, në një Kuvend të saj në pranverë të vitit 1995.

Në vitin 1996 filloi të shfaqej pavarësia e një grupi deputetësh në 3 çaste të rëndësishme: lidhur me përbërjen e re të qeverisë Meksi; lidhur me refuzimin fillestar për të shkarkuar kryetarin e gjykatës së kasacionit si dhe lidhur me çështjen e “drurit të arrës” ku ishin për ndjekje penale dy deputetë të PD-së, Genc Ruli dhe Rexhep Uka (Fuga, 2008, fq. 269-270). Në janar të vitit 1997 u dhanë shenjat e para të krizës dhe u shfaqën po ashtu zërat e parë kritikë brenda PD-së. Kur kriza shpërtheu në të gjithë elementët e saj në muajin shkurt dhe mars, 14 ministra dhe ish-ministra të tij, mes të cilëve Genc Ruli, Dashamir Shehi, Dylber Vrioni, Bashkim Kopliku etj., dhanë dorëheqjen duke u distancuar nga politika e PD-së.

Ndërsa në vitin 1999 do të ndodhte çarja tjetër e PD-së, me daljen kundër politikës së atëhershme dhe vetë liderit Berisha si: Genc Pollo, Tritan Shehu, Ferdinand Xhaferaj, Nard Ndoka dhe Leonard Demi, të cilët formuan Partinë Demokratike të Reformuar. Në vitin 2006 Ngjela shprehu hapur kundërshtitë e tij ndaj linjës së liderit Berisha, në një debat me të, të cilin edhe e regjistroi duke e nxjerrë në media. Pas këtij veprimi ai u pezullua nga partia dhe nga posti si sekretar i marrëdhënieve publike dhe nga komisioni parlamentar si përfaqësues i PD-së dhe nga grupi parlamentar. Në vitin 2009 Ngjela krijoi Partinë për Ligj dhe Drejtësi.

Shembujt e bashkëjetesës së mendimit ndryshe dhe kundërshtive në Partinë Socialiste nisin me vitin 1998 sepse më parë ndoshta mospasja e pushtetit i kishte

ndaluar të kishin grupime dhe mendime ndryshe por, të kishin zëra tek- tek që nuk janë formalizuar ndonjëherë në lëvizje. Më 28 shtator 1998, kryetari Nano dha dorëheqjen nga postin i kryeministrit, dhe vendin e tij e zuri Pandeli Majko. Më 20 nëntor 1999 dha dorëheqjen edhe si kryetar i Partisë Socialiste. Nano deklaroi thirrjen e kongresit të jashtëzakonshëm brenda muajit mars, ndërkohë PS ishte e ndarë në dy pjesë, pro dhe kundër Nanos (Progni, 2009: 227) Më 17 maj Presidenti Mejdani firmosi shkarkimin e Petro Koçit si ministër i rendit dhe emërimin e Spartak Poçit. Propozimi vinte nga kryeministri Majko. Petro Koçi ishte pozicionuar te grupi i mbështetësve të Nanos në PS (Progni, 2009: 229). Zgjedhjet brenda partisë në kongres i fitoi Fatos Nano, ai ftoi për bashkëpunim edhe Ilir Metën që kishte qenë mbështetësi i Pandeli Majkos. Më 2 tetor Majko dha dorëheqjen dhe po në atë ditë KPD zgjodhi Ilir Metën për kryeministër.

Situata në PS ishte e mirë mes Metës kryeministër dhe Nanos kryetar partie deri në shtator 2001. Nano e akuzonte Metën se po përpiqeshin ta kthente partinë në parti-shtet, dhe qeverinë në “qeveri pa parti” (Progni, 2009, fq. 235). Beteja e akuzave ndërmjet grupeve në PS u ashpërsua shumë dhe kulmoi me KPD-në e famshme të dhjetor të vitit 2001, duke u pagëzuar me emrin “lëvizja për katarsis” (Progni, 2009: 235). Qeverisja e Metës u trondit fortë dhe u arrit një pamundësi zgjedhje emrash për ministrat e rinj, ngaqë mbështetësit e Nanos nuk shkonin në kuvend për të votuar. Në fund të janarit të vitit 2002 Meta dha dorëheqjen dhe KPD-ja e 6 shkurtit i dha votëbesimin Pandeli Majkos për të drejtuar qeverinë. Por në korrik u vendos nga KPD-ja bashkimi i postit të kryetarit të partisë me atë të kryeministrit. Kështu që Nano u bë kryeministër dhe Meta zëvendëzkryeministër dhe u duk sikur kjo ishte zgjidhja e konfliktit të brendshëm. Por kjo nuk do të ishte paqe e gjatë mes grupimeve në PS, kur në qershor të 2003-it Meta filloi kritikën për qeverinë Nano dhe bashkoi votat me Berishën që mos të arrihej të zgjidheshin tre ministrat e rinj. Në 12 dhjetor 2003 u mblodh Kongresi VI i PS-së ku u rizgjedh Nano kryetar dhe u mënjana totalisht Ilir Meta nga postet drejtuese. Më 6 shtator 2004 një grup anëtarësh dhe deputësh të PS-së, me në krye vetë Metën u ndanë përfundimisht nga Partia Socialiste, duke u bërë të parët në PS, që si pasojë e luftës së brendshme, krijonin një parti të re. Kjo parti e re ishte Lëvizja Socialiste për Integrim.

Në vitin 2005 me humbjen e zgjedhjeve në krye të Partisë Socialiste, mbas dorëheqjes së Nanos, erdhi Rama me votim të fshehtë nga Kongresi i partisë. Rama mënjanoi nga vendimmarrja dhe nga postet drejtuese ata që klasifikoheshin si nanoist, pjesën e deputetëve dhe të anëtarëve të PS-së që kundërshtonin politikën e tij. Në vitin 2007, gjashtë deputetë, pjesë e këtij grupi që konsiderohej si nanoist votuan për zgjedhjen e presidentit të republikës. Ata u përjashtuan nga Partia Socialiste. Në vitin 2008 një pjesë e deputetëve, që ishin përjashtuar de facto nga vendimmarrja e partisë dhe mendimi i tyre nuk vlente më, u bashkuan dhe krijuan

partinë e re: Partia Socialiste e Vërtetë 91 nën drejtimin e Petro Koçit, ku bënin pjesë Makhbule Çeço, Gjergj Koja, etj.

Ndërsa brenda partisë, sidomos mbas humbjes së zgjedhjeve të vitit 2009, zërat ndryshe si Kastriot Islami, Ben Blushi, Arben Malaj, Andis Harasani kanë krijuar atë që quhej Lëvizja e Mendimit Ndryshe. Në media shumë herë janë dëgjuar zëra për përjashtimin e tyre nga partia, mënjanimi i tyre ka qenë i plotë për sa i përket mundësisë së dëgjimit të zërit në lidhje me vendimet dhe me aksionet që ndërmer partia. Kjo gjë u bë realitet në dhjetor duke përdorur si justifikim mosprezencën në parlament të Kastriot Islamit. Ai u përjashtua nga partia e tij historike ku kishte pasur një peshë edhe një zë të rëndësishëm.

Nëse hedhim sytë tek Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, edhe pse me një histori 7- vjeçare si parti mund të gjejmë raste të mendimit ndryshe në të. Në vitin 2009 kur partia pranoi të merrte pjesë në koalicionin qeverisës, zëra në kundërshtim të kësaj dolën brenda partisë. Këta ishin figura si Pëllumb Xhufi, Ndre Legisi, Sabit Brokaj, Fatos Klosi, Mustafa Muçi që kishin pozita të rëndësishme atëherë dhe u larguan nga partia dhe filluan të dilnin përkrah Ramës dhe linjës së PS-së.

Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut në vitin 2004 u ndesh me kundërshtimet ndaj kryetarit, Dule, që vinin nga Ligoraq Karamelo dhe një grup që e mbështeste atë. Mospranimi i këtij mendimi dhe i reformave që ai kërkonte çoi në largimin e tij nga partia dhe në krijimin e një partie të re me emrin Lëvizja për të Drejtat e Njeriut. Më pas në vitin 2009 para zgjedhjeve PBDNJ shpalli ndarjen nga koalicioni qeverisës me PD-në për të dalë në koalicion me PS-në. Dolën zërat kundra si Kosta Barka dhe Thoma Mico, ky i fundit kërkoi edhe të kandidonte për kryetar partie. Por atij nuk iu lejua një gjë e tillë duke paraqitur argumentin se ata nuk përfaqësonin më PBDNJ-në, por Partinë Demokratike. Kjo solli shkëputjen e tyre nga partia.

Mesa duket qartë demokracia e brendshme të paktën për këto parti, që ne i morëm në konsideratë, është thjesht fasada e statutit sepse praktika na tregon vetëm përjashtime, mënjanim dhe largime nga partia kur anëtarë të caktuar dalin kundër liderit. Kjo në disa raste ka çuar në lindjen e partive të vogla politike si ndarja nga partia e madhe. Në partitë politike shqiptare gjithmonë demokracia e brendshme është mundur nga koncepti i disiplinës partiake. Ky i fundit ka shërbyer përherë si asi nën mëngë për të fuqizuar liderët e partisë dhe për t'i bërë ata të plotfuqishëm në vendimet që kanë vullnet të marrin dhe në mënjanim e kundërshtarëve të tyre politikë. Disiplina partiake vepron si kundërpeshë e demokracisë së brendshme dhe në luftën mes të dyjave fiton përherë e para duke bërë të mundur që pushtetin faktin dhe kontrollin ta mbajnë vetëm një grup i vogël njerëzish rreth kryetarit të partisë.

Në vitin 1911, Robert Michels në studimin e tij mbi partinë socialdemokrate

gjermane paralajmëroi në lidhje me një nga problemet qendrore me të cilin përballen partitë politike që ai e quajti “Ligji i hekurt i oligarkisë”. Në punimin e tij ai parashikonte që “një parti kurrë nuk do të jetë demokratike sepse brenda këtij organizimi është fara (geni) i oligarkisë” (Michel, University of Virginia Library Electronic Text Center). Ky përshkrim mbi partitë politike, i realizuar një shekull më parë, mund të merrej sot në përdorim dhe në konsideratë për të gjitha partitë politike shqiptare si tregues se drejtimi i tyre është më shumë oligarkik sesa demokratik.

Konstatimi i mësipërm, që tregon fare mirë mungesën totale të vëmendjes për zbatimin e demokracisë së brendshme nga partitë politike shqiptare, mund të hedhë dyshimin se ndoshta nuk shërben demokracia e brendshme. Ndoshta në të vërtetë për një parti ka më shumë rëndësi pushteti dhe forca e liderit sesa demokratizimi. Por ja që teoria dhe logjika demokratike nuk na e tregon një gjë të tillë.

Rekomandime dhe përfundime

Ashtu siç e përmendëm edhe më lart partitë politike ushtrojnë pushtet politik real gjë që u jep mundësinë edhe të cenojnë të drejtat themelore politiko-elektorale të qytetarëve- në mënyrë të veçantë të anëtarëve të tyre- me rrezikun që një dhunim i tillë mund të bëhet i pashmangshëm dhe i rrezikshëm nëse nuk luftohet në mënyrën e duhur. Për mendimin tim nuk ka asnjë justifikim për përjashtimin e veprimeve të brendshme partiake nga kontrolli juridik, si kushtetues ashtu edhe ligjor.

Nuk ka asgjë të keqe ose jashtë logjike nëse gjykatat shqiptare (qoftë ajo kushtetuese ose ajo e shkallës së lartë) të mund të verifikojnë kur ka kërkesë nga anëtarët e partisë nëse funksionimi i organeve të partisë është konform statutit që ata vetë kanë vendosur. Nëse organizatat, në këtë rast partitë, vendosin disa rregulla që më të rëndësishmet miratohen nga organet më të larta, detyrimi i parë që duhet të lindë është zbatueshmëria e tyre. Ashtu siç e pamë edhe lart problemi themelor me demokracinë e brendshme partiake nuk është mospasja e rregullave, që përcaktojnë demokracinë e brendshme, por moszbatimi i tyre nga organet apo personat që drejtojnë partinë. Pikërisht për këtë arsye mendoj se anëtari i interesuar, i cili mendon se i janë cenuar disa të drejta që përcaktohen në statut, duhet fillimisht t’i drejtohet organeve të brendshme të partisë për vënie në vend të së drejtës. Dhe nëse vendimi i tyre nuk i duket se është konform asaj që kanë rregullat e partisë atëherë ai të ketë mundësinë t’i drejtohet gjykatave dhe vendimi i tyre të bëhet i detyrueshëm për zbatim për partinë.

Dikush mund të mendojë se kjo është një ndërhyrje që i bëhet jetës së partive dhe një cenim i tyre nga pushteti gjyqësor. Ndërsa për mua është mëse normale që

të ketë një lloj mbrojtje anëtari i partisë nga cenimi që mund t’i bëjë partia e vetë. Për aq kohë që çdo qytetar është i mbrojtur nga cenimi që mund t’i ndodh nga familja e vet, nga njerëzit e punës, nga shteti, nga qytetarët e tjerë duke iu drejtuar gjykatave, atëherë pse duhet që të mos jetë i mbrojtur nga cenimi i partisë së tij pikërisht nëpërmjet gjykatave.

Së fundmi pas përmirësimit të zbatimit të statuteve duke vendosur edhe mekanizma të jashtëm kontrollues siç janë gjykatat, zgjidhje tjetër për të përmirësuar situatën demokratike është shtimi i mënyrave të ushtrimit të demokracisë së brendshme brenda partive. Aplikimi i parimit “Një anëtar-një votë” është një mundësi shumë e mirë për rritjen e demokracisë së brendshme. Partia Socialiste e futi këtë parim në zgjedhjen e veta, por nuk arriti në rezultatet e duhura sepse filloi sulmi brenda vetes për zgjedhje jo të drejta dhe të kontrolluara nga kryetari, megjithatë mund të konsiderohet si një hap përpara. “Elementi më reformues e demokratizues në jetën e një partie mbetet demokracia e tipit “Një anëtar-një votë” në kuptimin e vendimmarrjes që, jo vetëm zgjeron hapësirat e demokracisë, por dhe rrit përgjegjësinë dhe rolin e drejtpërdrejtë të anëtarit të partisë. Forma më e thjeshtë e zbatimit të këtij parimi është zgjedhja e kryetarit, që rezulton vendimtare për në procesin e reformimit partiak, sepse në Shqipëri nëpërmjet kryetarit perceptohet dhe fizionomia e partisë” (Mejdani, 2004: 46). Gjithashtu masivizimi i së drejtës për të votuar do të bëjë që shumica e anëtarëve të partisë të shohin me më shumë optimizëm të ardhmen e partisë së tyre, por edhe të kenë më besim në proceset zgjedhore në përgjithësi.

Së fundmi, mund të themi se demokratizimi më i mirë, që mund të ndodh së paku në partitë politike shqiptare, është ndryshimi i profilit të liderëve drejtues. Kjo do të thotë që normat në letër nuk janë të këqija dhe zbatimi i tyre do të çonte në një demokratizim të mjaftueshëm që nuk do të shtypej nga parimi i disiplinës partiake. Vullneti i liderëve ndryshohet nëse elektorati ndëshkon dhe mbështet partinë në zgjedhje edhe në varësi të masës së demokracisë së brendshme që tregon partia.

Bibliografia

- Zampetti (1973) *Dallo Stato Liberale allo Stato dei Partiti*, Milano.
Kelsen, H. (1988) *Los fundamentos de la democracia*, Madrid.
Kelsen, H. (1992) *Esencia y valor de la democracia*, Mexico.
Friederich, C. J. (1955) *Gobierno constitucional y democracia*, Madrid, 1975, Botimi i dytë.
Heller, H. *Teoria del Estado*, Mexico.
Ligji 8580, datë 17.02.2000, *Mbi partitë politike*.
Denquin, J.M. *Hyrje në shkencat politike*, Tiranë, UET-Press.

- Fuga, A. (2008) *Media, politika, shoqëria (1990–2000)*, Dudaj, Tiranë.
- Michel, R. *Political Parties; a Sociological Study of the Oligarchical Tendencies of Modern Democracy*, University of Virginia Library Electronic Text Center.
- Krasniqi, A. (2008) *Partitë politike dhe sistemet politike*, Ilar, Tiranë.
- Aragon, M. (1999) *Constitucion y control del poder. Introducción a una teoría constitucional del control*, Universidad Externado de Colombia, Bogota.
- Progni, L. (2009) *Trashëgimtarët, Partia Socialiste mes transformimeve dhe vazhdimësisë*, Ideart, Tiranë.
- Valades, D. (1998) *El control del poder*, UNAM, Meksikë.
- Mejdani, R. (2004) *Reformimi demokratik i partive politike shqiptare-domosdoshmëri e kohës*, Pegi, Tiranë.
- Statuti i Partisë Demokratike*
- Statuti i Partisë Socialiste*
- Statuti i Lëvizjes Socialiste për Integrim*
- Statuti i Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut*

Instrumentet e Diplomacisë parlamentare: Rasti i Italisë.

Ervis ILJAZAJ, PhD

Abstrakt. Gjatë viteve të fundit duhet marrë në konsideratë që, përkrah politikës së jashtme tradicionale të qeverive po manifestohet një aktivitet paralel i marrëdhënieve të jashtme të tipit të ndryshëm dhe të ri, kryesisht informal dhe i përhapur gjerësisht, që gjithmonë e më shumë lidhet drejtpërdrejt apo tërthorazi me organet parlamentare, nga të cilat lindin struktura dhe iniciativa me karakter tranzitor dhe episodik, por ndonjëherë edhe në forma të qëndrueshme bashkëpunimi. Në këtë kuadër vitet e fundit është duke u instaluar një “klime” e marrëdhënieve ndër-parlamentare e cila paraqet një formë të rëndësishme për zgjidhjen e konflikteve në momente të vështira midis shteteve të ndryshme. Këto lloj formash bashkëpunimi midis parlamenteve kombëtare njihen me emrin “diplomaci parlamentare”. Ky punim do t’i referohet si rast studimor instrumenteve të diplomacisë parlamentare italiane, specifikisht rolin të Komitetit për Diplomaci Parlamentare të krijuar në vitin 2001 në drejtim të bashkëpunimit midis Asambleve kombëtare për të marrë pjesë në procesin e qeverisjes ndërkombëtare. Analiza do të fokusohet gjithashtu edhe në instrumentet e diplomacisë parlamentare përtej rastit italian si, për shembull, dialogu parlamentarë Euro-Aziatik.

Përkufizimi i nocionit “diplomaci parlamentare”

Gjatë 20 viteve të fundit është vënë re një rritje e madhe e aktiviteteve të “jashtme” të Asambleve kombëtare, në kuptimin e një ndërhyrje institucionale të Parlamenteve në skenën ndërkombëtare. Një praktikë e tillë poliedrike i atribuohet “deficitit demokratik” ose e thënë ndryshe, mungesës së përfshirjes të parlamenteve kombëtare në proceset e vendimmarrjes qeverisëse me natyrë ndërkombëtare. Si pasojë ka detyruar instancat parlamentare të zgjerojnë sferën e tyre të influencës dhe aftësinë e tyre për të ndikuar në këto mekanizma. Kjo ka bërë të mundur domosdoshmërinë e lindjes së formave të ndryshme të aktiviteteve ndërkombëtare të parlamenteve, e cila quhet ndryshe me termin “diplomaci parlamentare” (Violante, L.: 2005).

“Diplomacia parlamentare” është një term i kohëve të fundit, me anë të të cilit kuptojmë një sërë iniciativash të rëndësishme ndërkombëtare që organet parlamentare ndërrmarin ose janë të përfshira. Praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare të parlamenteve nuk janë tërësisht të reja. Ato kanë ekzistuar që në shek. XIX, edhe pse vetëm me konotacion formal dhe protokollar. Nëse ekzaminohet procesi evolutiv i diplomacisë parlamentare duket qartë se gjendja e saj origjinale përfaqësohej nga forma bashkëpunimi ndërparlamentare midis dy asambleve. Kemi të bëjmë me një formë tradicionale shkëmbimi që, gjithsesi, ka ruajtur rëndësinë e saj edhe në fazën aktuale të diplomacisë parlamentare e cila është e orientuar kryesisht, siç do të kemi rastin ta shohim edhe në vazhdim të këtij artikulli, në skenarë multilateralë (Martinez, M. A.: 2007).

Megjithatë, termi “diplomaci parlamentare” mund të përdoret në mënyrë korrekte vetëm në një kuptim përshkrues, dhe jo në atë teknik. Duhet të kujtojmë që organet parlamentare nuk mund të ushtrojnë aktivitete diplomatike në kuptimin e ngushtë, duke shmangur si të drejtën ndërkombëtare, ashtu edhe rendin kushtetues kombëtar. Diplomacia dhe politika e jashtme në përgjithësi është prerogativë ekskluzive e qeverisë. Në këtë sens ajo që përcakton në mënyrë të qartë është e drejta ndërkombëtare në Konventën e Vjenës mbi të drejtën e traktateve në 23 maj, 1969 ku përcaktohet në mënyrë të veçantë principi se në marrëdhëniet ndërkombëtare konvencionale legjitimimi për të negociuar është kompetencë e qeverive legjitime dhe e përfaqësuesve rregullisht të akredituar prej tyre.

Së fundmi duhet të përjashtojmë nga diplomacia parlamentare aktivitete të parashikuara nga Kushtetuta apo nga Rregullorja parlamentare që bëjnë pjesë në funksionet tipike parlamentare si: ekzaminimi i projektligjeve për autorizimin dhe ratifikimin e akteve ndërkombëtare. Në këtë punim do të ofrohen disa elemente për të kuptuar institutet e “diplomacisë parlamentare” italiane, në disa raste duke iu referuar vetëm profilit institucional dhe organizativ duke lënë mënjanë për momentin diskutimin e thelluar mbi këtë argument.

Rast studimor: Komiteti për diplomacinë parlamentare i Dhomës së Deputetëve në Itali

Rasti i Italisë për sa i përket aplikimit të instrumenteve të diplomacisë parlamentare përbën një rast studimor tipik në analizën e funksionimit dhe zhvillimit të suksesshëm të marrëdhënieve ndërparlamentare. Parlamenti Italian gjatë viteve të fundit ka ditur t'i përshtatet në mënyrë relativisht efikase domosdoshmërisë së pjesëmarrjes të organeve përfaqësuese në politikën e jashtme. Me krijimin e disa organeve dhe me pjesëmarrjen aktive të tij, Parlamenti Italian ka treguar sesi diplomacia parlamentare mund të jetë një instrument i rëndësishëm në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare midis shteteve.

Duke filluar nga legjislatura XIII, në Dhomën e Deputetëve në Itali u formua Komiteti për diplomacinë parlamentare me funksionin e rakordimit, koordinimit dhe monitorimit të aktiviteteve ndërkombëtare të komisioneve parlamentare, të delegacioneve parlamentare në asambletë ndërkombëtare dhe në përgjithësi të organeve parlamentare që janë të përfshira në aktivitetet e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky Komitet drejtohet nga Kryetari i Dhomës së Deputetëve të Italisë dhe përbëhet nga parlamentarë me status të ndryshëm të cilët janë të përfshirë në mënyrë më të drejtpërdrejtë në aktivitetet ndërkombëtare. Roli kryesor i këtij Komiteti është përcaktimi i linjave direktive dhe programatike të aktiviteteve ndërkombëtare të Dhomës së Deputetëve.

Takimet ndërparlamentare

Në kuadër të aktiviteteve të jashtme të Parlamentit Italian regjistrohen shumë aktivitete me “projektim të jashtëm” të Kryetarit të Kuvendit, të komisioneve parlamentare të përhershme në institucionet parlamentare të huaja dhe anasjelltas, por edhe pjesëmarrje të deputetëve në konferencat ndërkombëtare të ndryshme.

Kryetarët e Dhomave të Parlamentit ndërmarrin vazhdimisht vizita protokollare me homologët e tyre të asambleve europiane dhe ndërkombëtare si edhe takime me kryetarët e shteteve dhe qeverive të huaja. Ndër takimet multilaterale autonome dhe që janë të lidhura me rrethin e organizmave ndërkombëtarë mund të përmendim si, për shembull, Këshillin e Europe INCE etj. Edhe në nivel komisionesh parlamentare shënohen misione të jashtme dhe takime. Në këto raste nëse iniciativa zhvillohet nga një delegacion, sigurohet një përfaqësim i grupeve politike të pranishme në Komision.

Të tilla iniciativa mund të jenë si formale ashtu dhe protokollare (takime korteze) ose me tema specifike në interes të komisionit. Në rastin e fundit mbas takimit i raportohet komisionit përkatës nga kryetari i delegacionit, në bazë të të cilit komisioni mund zhvillojë debate ose të aprovojë akte të orientimit politik

ndaj qeverisë. Në disa raste të tjera këto takime zhvillohen në mënyrë informale, pa publicitetin që karakterizon normalisht punimet parlamentare pa bërë asnjë procesverbal të parashikuar për punimet parlamentare.

Së fundmi Dhomat e Parlamentit Italian marrin pjesë, edhe në kuadër të projekteve të parashikuara nga organizmat ndërkombëtarë, në iniciativa të asistimit teknik ndaj parlamenteve të përfshira nga procese reformash komplekse institucionale. Në këto iniciativa zakonisht përfshihen përfaqësues të administratës parlamentare.

Vëzhguesit parlamentarë të nivelit të lartë dhe konferencat ndërkombëtare

Në takimet ndërkombëtare të nivelit të lartë, në të cilat marrin pjesë përfaqësues të qeverisë dhe të organeve ndërkombëtare në delegacionet nacionale italiane, shpesh janë të ftuar observatorë parlamentarë. Për shembull është bërë zakon që, me ftesë të Ministrit të Jashtëm Italian, marrin pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara delegacione të komisioneve përkatëse për çështjet e jashtme të të dyja Dhomave të Parlamentit, me detyrën për t'i referuar Komisionit për çështjet e diskutuara.

Në këto raste parlamentarë të pranishëm gjithsesi nuk mund të përfshihen në mënyrë aktive në diskutimet për përgatitjen e *dosierëve*, as të ngarkohen me përgjegjësi për çfarëdo aktiviteti që i përket delegacionit të Qeverisë. Ky princip ka një rëndësi të përgjithshme si pasojë e ndarjes së (e cila u përmend më lart) aksionit diplomatik zyrtar dhe aktivitetit të jashtëm parlamentar.

Në të njëjtën mënyrë konstatohet pjesëmarrja e parlamentarëve në takimet ndërkombëtare të organizuara nga OKB, si edhe në seksionet e Komisionit të OKB-së për të drejtat e njeriut me qendër në Gjenevë. Në këtë kuadër është e rëndësishme të kujtohet tentativa për të siguruar një dimension parlamentar në mbledhjet e ministrave të vendeve të G8-ës dhe Organizatës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Përpara pjesëmarrjes së observatorëve parlamentarë në evente të tilla mund të zhvillohen diskutime në komisionet kompetente me qeverinë, e cila informon për temat që do të jenë në qendër të axhendës ndërkombëtare. Organi parlamentar që merr komunikime të tilla mund të aprovojë eventalisht akte të orientimit politik ndaj qeverisë.

Megjithatë edhe pse në dhomat parlamentare mund të përcaktohen orientime ndaj qeverisë për sa i përket qëndrimeve që ajo do të mbajë gjatë traktativave ndërkombëtare, observatorët nuk kanë asnjë rol aktiv në implementimin e këtyre orientimeve politike. (Ciolo & Ciaurro: 2006) Në fakt, siç u përmend edhe më lart, vëzhguesit parlamentarë nuk mund të ndikojnë në përcaktimin e pozicionit që do të mbajë përfaqësia qeverisë në traktativat ndërkombëtare, e cila ka

dhe përgjegjësinë përkatëse. Por, mund të kërkojnë informacione mbi ecurinë e punimeve. Mbi bazën e informacioneve që mbledhin, observatorët parlamentarë i referojnë komisionit kompetent, duke provokuar eventalisht me aktet e duhura parlamentare një interpelancë me qeverinë, me qëllim verifikimin dhe respektimin e orientimeve politike dhe zhvillimin e vlerësimeve të duhura mbi rezultatet e arritura në negociatat ndërkombëtare dhe impenjimet e marra nga ana e ekzekutivit.

Konferencat ndërparlamentare tematike

Paralelisht me zhvillimin e takimeve ndërkombëtare ndërqeveritare, ose mbi tema të veçanta aktuale transnacionale, regjistrohen evente ndërparlamentare në të cilat kryetarët e Dhomave marrin pjesë personalisht ose dërgojnë, eventalisht me mirëkuptim, senatorë ose deputetë. Të tilla konferenca janë të shpeshta në të gjitha rajonet gjeografike botërore, duke vërtetuar se dialogu ndërparlamentar tashmë është një realitet në kuadër të globalizimit të marrëdhënieve sociale, ekonomike dhe kulturore.

Një përhapje e tillë e këtyre evenimenteve ndërparlamentare ka të bëjë edhe me faktin se takimet ndërqeveritare me interes botëror mbi tema si për shembull: (mbrojtja e mjedisit, zhvillimi i qëndrueshëm, liberalizimi i tregtisë ndërkombëtare, mbrojtja e të drejtave të njeriut, mbrojtja e grave dhe e minoreneve etj.) nuk janë publike për shkak të natyrës shumëpalëshe të negocimit. Në këtë rast, takimet e shumta paralele ndërparlamentare shërbejnë si kompensim për mungesën e transparencës dhe demokracisë që rrjedh nga karakteri i mbyllur dhe sekret i këtyre takimeve. Takimet ndërkombëtare ndërparlamentare, të quajtura “konferenca” ose “forum”, kanë sjellë me sukses strukturimin në forma të qëndrueshme të këtyre eventeve. (Martinez, M. A.: 2007)

Dimensionet parlamentare të krijuara me iniciativë ndërqeveritare

Ekzistojnë qendra të ndryshme në të cilat artikullohet dialogu parlamentar i qëndrueshëm paralelisht me implementimin e iniciativave ndërqeveritare të bashkëpunimit shumëpalësh në nivel rajonal.

Parteneriteti euro-mesdhetar dhe Asambleja parlamentare euromesdhetare. Në radhë të parë vihet re vazhdueshmëria e një sërë iniciativash ndërparlamentare me qëllim zhvillimin e dialogut midis civilitetëve të ndryshme, në kuadër të partneritetit euro-mesdhetar, iniciativë kjo e krijuar nga Bashkimi Europian dhe nga vendet e Mesdheut për të ndërtuar dhe për të forcuar një rrjet marrëdhëniesh dhe iniciativash politike dhe kulturore në kuadër të implementimit të procesit të Barcelonës.

Duke korresponduar me treguesit e dalë nga këshillat europiane të Lisbonës

(Qershor 1992), Korfuzit (Qershor 1994), dhe të propozimeve të Komisionit, Bashkimi Europian vendosi të ndërtonte një kontekst origjinal për marrëdhëniet e tij me vendet e Mesdheut. Ky projekt u realizua me rastin e Konferencës së Barcelonës (27-28 nëntor 1995), e cila bashkoi 15 ministra të jashtëm të vendeve anëtare të BE-së dhe 12- të vendeve të “treta të Mesdheut”.

Konferenca ka hedhur bazat për një proces me qëllim realizimin e një dialogu dhe kooperimi midis BE-së dhe vendet e treta të Mesdheut. Vendet pjesëmarrëse kanë aprovuar me unanimitet një Deklaratë dhe një program punimesh (Deklarata Euromesdhetare), e cila përcakton një kuadër shumëpalësh, i cili lidh aspektet ekonomike dhe të sigurisë me dimensionin social dhe kulturor. Pas krijimit të Partneritetit, përkrah dimensionit ndërqeveritar u zhvillua shumë shpejt një dimension parlamentar që kulmoi me realizimin e Asamblesë Parlamentare Euro-Mesdhetare.

Në këtë dimension janë zhvilluar edhe evente parlamentare specifike si, për shembull, Konferenca e Kryetarëve të parlamenteve euro-mesdhetar e mbledhur për herë të parë në Palma de Majorka në vitin 1999. “Dialogu parlamentar mbi civilitetet antike mesdhetare”, i cili ka filluar me iniciativë të Kryetarit të Dhomës të Deputetëve Italianë në bashkëpunim me atë grek, të Asamblesë së popullit egjiptian dhe Asamblesë konsultative të Republikës Islamike të Iranit, si instrument i kooperimit politik dhe kulturor për të arritur objektivin e mirëkuptimit midis popujve, duke u nisur nga trashëgimia historike e përbashkët mesdhetare, e paqes dhe tolerancës, por gjithmonë në respekt të specifikave kulturore.

Dimensioni parlamentar i Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore. Në kuadër të stabilitetit për Europën Juglindore është zhvilluar një dimension parlamentar i nisur në Zagreb (11-13 Shtator 2000) me drejtues Kryetarët e parlamenteve të shteteve dhe të asambleve të organizatave ndërkombëtare pjesëmarrëse në këtë Pakt (Parlamenti Europian, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, Asambleja Parlamentare e OSBE-së). Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore mund të konsiderohet tentativa e parë e komunitetit ndërkombëtar për të zëvendësuar ndërhyrjet në situatë krize në vendet e Europës Juglindore. Në bazë të Paktit janë në mënyrë të veçantë eksperiencat e NATO-s në zgjidhjen e krizave në Ballkan.

Ndër të tjera, një nga temat e bashkëpunimit të Paktit është implementimi i proceseve demokratike për të përmirësuar efçencën dhe transparencën në strukturat e qeverisë. Në këtë Pakt është e parashikuar një mbështetje në favor të vendeve të interesuara të rajonit: një nga prioritetet e Paktit është ajo e krijimit të një *netëork-u* midis parlamenteve të këtyre vendeve, duke parashikuar kurse formimesh për parlamentarët dhe funksionarët e parlamenteve dhe duke promovuar binjakëzime dhe okazione të tjera të kooperimit ndërparlamentar. Në këtë kontekst janë zhvilluar duke nisur nga viti 2001 disa konferenca parlamentare mbi tema si ndalimi i konflikteve në këtë rajon, siguria e Europës Juglindore, përforsimi i sigurisë dhe i

stabilitetit politik nëpërmjet kooperimit politik, perspektiva e aderimit të vendeve të interesuara në BE dhe lufta ndaj krimit të organizuar ndërkombëtar (Ciolo & CiaurroI:2006).

Bashkëpunimi parlamentar në kuadër të iniciativës së “katërshes lart dhe poshtë” dhe iniciativa e Europës Qendrore. Iniciativa e “katërshes lartë” lindi në nivel qeveritar në vitin 1996 për të ngritur një forum kooperimi midis Italisë, Sllovenisë, Hungarisë dhe Kroacisë me objektiv interesat e përbashkëta. Fusha e bashkëpunimit, fillimisht në sektorin e transportit, për realizimin e rrjetit të integruar të komunikimit midis vendeve (korridori 5), u zgjerua me vonë në fushën e kooperimit ekonomik, shkencor, kulturor, ushtarak dhe në luftën kundër krimit të organizuar. Qëllimi i iniciativës ishte ai i krijimit të një kooperimi të ngushtë në një zonë gjeografike të caktuar, i aftë të favorizojë kooperimin ekonomik, teknik dhe shkencor për realizimin e projekteve specifike në sektorin e transportit, në mbrojtjen e mjedisit, në turizëm dhe telekomunikacion. Dimensionin parlamentar i kësaj iniciative lindi në vitin 2000 dhe vazhdon takimet rregullisht edhe në ditët e sotme.

Një iniciativë e tillë, e ngjashme në nivel ndërqeveritar, u krijua midis Shqipërisë, Bullgarisë, Italisë dhe Maqedonisë me propozim të Italisë, në vitin 1997, për të zhvilluar një bashkëpunim po në sektorin e transportit ndërkombëtar (Korridori 8 i cili parashikon një rrjet transporti që lidh të katër këto vende.). Dimensionin parlamentar i këtij bashkëpunimi, që lindi mbas kësaj iniciative, u formua në vitin 1999 ku përfaqësues të komisioneve parlamentare të transportit përkatëse por edhe instanca të tjera parlamentare kanë zgjeruar bashkëpunimin ndër parlamentar në funksion të realizimit të këtij projekti.

Dimensioni parlamentar i iniciativës Adriatike-Jonike. Iniciativa Adriatike-Jonike lindi me Konferencën për zhvillimin dhe sigurinë e Adriatikut, e zhvilluar në Ancona në 20 maj të vitit 2000 midis Italisë, Shqipërisë, Bosnjës, Kroacisë, Greqisë dhe Sllovenisë. Në fund të Konferencës ministrat e jashtëm të vendeve pjesëmarrëse, nënshkruan, në prani të Komisionit Europian, një deklaratë në të cilën nënvizohet se përforsimi i kooperimit rajonal ndihmon në stabilitetin politik dhe ekonomik të zonës, duke krijuar kështu një bazë të fortë për procesin e integritetit europian (Sicari, S.:2004).

Dimensionin parlamentar nisi në prill të 2001-it në Kroaci, me një mbledhje të kryetarëve të parlamenteve të vendeve anëtare, e ndjekur nga mbledhjet në Athinë (maj 2002), Ravena (maj 2003), Slloveni (maj 2004) etj. I lidhur me këtë dimension parlamentar është edhe forumi i cili zhvillohet në Mal të Zi, me qëllim realizimin e një kooperimi në nivel komisionesh parlamentare, kompetente në fushat që janë objekt marrëveshjesh (politika e jashtme, mbrojtja, ekonomia, kultura dhe mjedisi).

Dialogu parlamentar euro-aziatik. Dialogu parlamentar euro-aziatik lindi si pasojë e marrëveshjes midis qeverive të vendeve anëtare të *Asia –Europë Meeting (ASEM)* në vitin 1996 midis vendeve të Bashkimit Europian dhe disa vendeve

aziatike. ASEM është forumi kryesor multilateral i marrëdhënieve euro-aziatike. Karakterizohet nga informaliteti, multidimensionaliteti (në dialogun brenda ASEM-it kërkohet shpeshherë një ekuilibër substancial midis dimensionit politik, ekonomik, kulturor dhe shkencor), barazia midis vendeve anëtare dhe kualifikimi i debateve. Në origjinë të ASEM-it është domosdoshmëria për të përforcuar bashkëpunimin midis dy rajoneve duke parë rritjen e rëndësisë së Azisë në arenën politike botërore dhe raporteve që ajo dhe Europa kanë me Shtetet e Bashkuara. ASEM u formua në Bangkok në mars të viti 1996. Me mbledhjen e parë të zhvilluar nën presidencën italiane u inaugurua i ashtuquajtur "Procesi ASEM", që konsiston në një seri takimesh midis të cilave ato midis kryetarëve të shteteve dhe të qeverive, mbledhje ministeriale vjetore, takime midis funksionarësh të lartë dhe iniciativa sektoriale.

Kanalet nëpërmjet të cilave zhvillohet dialogu parlamentar euro-aziatik janë: *Asia –Europe parliamentary intership (ASEP) dhe Asia –Europe Foundation (ASEF)*. ASEP ka objektiv forcimin e kontakteve të parlamenteve të vendeve anëtare, duke favorizuar shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave mbi temat e aktualitetit ndërkombëtar, dhe në një farë mënyre përbën dimensionin parlamentar të kësaj marrëveshjeje. Ndërsa ASEF është pjesë integruese e dimensionit ndërqeveritar dhe ka si qëllim shkëmbimin kulturor dhe intelektual midis Europës dhe Azisë, me iniciativa që përfshijnë mbi të gjithë parlamentarët e rinj.

Pjesëmarrja e strukturuar e parlamentarëve në organizmat europianë dhe ndërkombëtarë

Në këtë kuadër, është e rëndësishme të përmendim si shembull bashkëpunimin e kombinuar midis parlamenteve dhe qeverive (metoda konvencionale) në përkufizimin e teksteve themelore europiane, e ndjekur nga Konventa e ngarkuar për të përpunuar Kartën e të drejtave themelore dhe nga Konventa e cila kuroi shkrimin e propozimit fillestar të Traktatit, i cili adoptoi një Kushtetutë për Europën, e firmosur më vonë në Romë më 29 tetor 2004. Kushtetutë e cila nuk u aprovua asnjëherë nga shoqëritë europiane.

Në fushën e dialogu ndërparlamentar të Bashkimit Europian një konferencë tjetër e rëndësishme është edhe ajo e organizmave të specializuara në çështjet e BE-së (KOSAK) të parlamenteve kombëtarë të vendeve anëtare si dhe mbledhjet semestrale të komisioneve të specializuara në çështjet e komunitetit, të vendeve kandidatë dhe Parlamentit Europian, të organizuara mbi tema të veçanta. KOSAK është një organizëm i kooperimit ndërparlamentar, i formuar në kuadrin europian, i themeluar në Paris 16-17 nëntor 1989, rregullorja e të cilit mund të përdoret edhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare të specializuara që parlamenti i çdo vendi anëtar të BE-së mund të zhvillojë gjatë presidencës së Bashkimit Europian.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës. Asambleja Parlamentare, ku anëtarët janë të emëruar mbledhet në Strasburg katër herë në vit, gjatë seksioneve të ndryshme, ku marrin pjesë rregullisht delegacionet e përhershme të parlamenteve të vendeve që aderojnë në të. Në intervalet midis seksioneve vazhdimësia e punimeve kryhet nga Komisioni i përhershëm, që ka të njëjtat kompetenca me ato të Asamblesë. Kompetencat mbi punimet e Asamblesë janë të ndara midis 10 komisioneve në bazë të temave specifike. Në Asamblenë e Këshillit të Europës janë ndërtuar pesë grupe politike (socialistët, popullorët, demokratët europianë, liberaldemokratët si dhe e majta e bashkuar europiane), edhe pse disa parlamentarë nuk janë të regjistruar në asnjë grup. Asambleja mund të aprovojë rezoluta si: adresimin dhe stimulimin e Komitetit të Ministrave dhe t'i ofrojë orientime politike dhe juridike qeverive dhe parlamenteve të vendeve anëtare. Asambleja ka ndër të tjera kompetencën për të zgjedhur gjykatësit e Gjykatës Europiane për të drejta e njeriut.

Bashkimi Ndërparlamentar. Bashkimi Ndërparlamentar, i lindur në Paris në vitin 1889 me Konferencën ndërparlamentare, që bashkonte të deleguar nga nëntë vende midis të cilave edhe Italia, mbledh sot përfaqësi parlamentare të më shumë se një qind vendeve sovranë dhe është institucioni me antik ndërkombëtar parlamentar. Tradicionalisht BNP ka objektivin e promovimit të paqes, të zhvillimit dhe forcimit të institucioneve përfaqësuese, dhe kooperimit midis popujve nëpërmjet instrumentit parlamentar. Duke aspiruar të përfaqësojë një lloj OKB-je të parlamenteve, BNP bashkëpunon ngushtë me Asamblenë e Përgjithshme të saj si dhe me Sekretarin e Përgjithshëm. BNP ofron një qendër më të gjerë të bashkëpunimit ndërparlamentar me anë të Konferencës të Kryetarëve të Parlamenteve kombëtare, e mbajtur për herë të parë në 30 gusht 2001, në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. BNP gëzon statusin e observuesit në Kombet e Bashkuara.

Konkluzione: Impakti i diplomacisë parlamentare

Ndërkohë që diplomacia tradicionale është instrument i politikës së jashtme të Qeverive, diplomacia parlamentare krijon hapësira të reja për dialog, të hapura për kontributin e më shumë aktorëve politik, jo domosdoshmërisht qeveritare. Këto hapësira të reja dialogu që diplomacia parlamentare krijon karakterizohen nga një bashkëpunim ndër parlamentar i cili ka një limit dhe formalitet më të vogël të aksionit diplomatik. Kjo është vlera e shtuar kryesore e diplomacisë parlamentare: shumëfishimi i aktorëve politik të aftë të veprojnë në skenën ndërkombëtare dhe të mbajnë të hapur kanalet e diskutimit politik; të afrojnë kultura dhe sensibilitete të ndryshme; vendosjen përballë të sistemeve kushtetuese të ndryshme; kërkimin e terreneve të përbashkëta të bashkëpunimit dhe kuptimin e elementeve të ndryshëm dhe arsytet e tyre.

Fuqia për të ndërtuar mbi këtë bazë marrëdhënie, personale apo institucionale, bën të mundur bashkëpunimin në interes të progresit dhe dialogut. Edhe në këtë kuptim origjinaliteti dhe liria e diplomacisë përfaqësojnë një mundësi të mirë, mbi të gjitha në format e dialogut ndër parlamentar të cilat vendosin përballë Parlamentët me një traditë të konsoliduar me ato të demokracive të reja. Ndëer praktikat më të suksesshme mund të përmendim forumet e asambleve parlamentare rajonale, të cilat kanë arritur të japin rezultate konkrete edhe ku diplomacia tradicionale ka hasur vështirësi të medha. Mbi të gjitha në këto situata delikate instrumentat e diplomacisë parlamentare kanë pasur sukses. Instalimi i raporteve personale të parlamentarëve me përkatësi politike të ndryshme, me prejardhje fetare apo kombëtare të ndryshme, ka lehtësuar diskutimin e çështjeve që në forume të tjera ndërkombëtare dukeshin tabu.

Duke u nisur nga rezultatet që këto forma të reja bashkëpunimi kanë aritur, temat e trajtuara nga Parlamentët ndërkombëtarë janë zgjeruar edhe në fusha që më parë konsideroheshin si prerogative ekskluzive shtetërore. Mjafton të përmendim që asamble të tilla trajtojnë tema me impakt të lartë në komunitetin ndërkombëtar, mbi shtetet dhe popujt. Diplomazia parlamentare prej disa vitesh ka në axhendën e saj tema si: terrorizmi, imigracioni, asistencë për zhvillimin e zgjedhjeve, reformat kushtetuese; ekonomia, agrikultura, energjia, zhvillim të qëndrueshëm, të drejtat e njeriut, bashkëpunim në fushat e sigurisë, dialog midis kulturave dhe feve, ambjenti, etj.

Vullneti për të rritur nivelin e dialogut ndër parlamentar me qëllim përkrahjen e procesit të paqes, të zhvillimit dhe mirëkuptimit reciprok është kthyer "pothuajse" në një mision prioritar të komunitetit ndërkombëtar. Mund të shihet fare qartë sesi të gjitha institutet që u përmendën më lart në mënyrë të përmbledhur tregojnë potencialitetin e instrumenteve në dispozicion të parlamenteve në marrëdhëniet ndërkombëtare. Nëse organizohen si duhet, këta instrumenta mund të lejojnë efektivisht një rol domethënës ndërkombëtar të institucioneve parlamentare.

Por, duhet të mbahet gjithmonë parasysh fakti që, iniciativat ndërkombëtare parlamentare ose të disa organeve të tyre nuk mund të zhvillohen në mënyrë autonome nga konteksti i politikës së jashtme kombëtare. Politika e jashtme bëhet nga qeveria. Prandaj të gjitha iniciativat e jashtme të Parlamentit duhet të rakordohen me ato të qeverisë. Në disa raste mund të ndodhë që Parlamenti në bashkëpunim me qeverinë mund të ndërmarrë iniciativa të dobishme për vendin të cilat qeveria nuk mund t'i marrë për shkak të situatës momentale ndërkombëtare. Si përfundim, diplomacia parlamentare nuk duhet të jetë në përplasje me linjat e jashtme të qeverisë. Por, mund të ndihmojë Ekzekutivin në situata delikate diplomatike.

Në këtë kuadër "diplomacia parlamentare" mund të paraqesë efektivisht një lloj interesi në afirmimin e një "modeli italian" të pjesëmarrjes në sektorë specifikë

të marrëdhënieve ndërkombëtare, siç mund të jetë në veçanti sektori i kooperimit dhe i zhvillimit institucional të vendeve në zhvillim e sipër. Në këtë kuptim, mund të vlerësohen me një realizëm të drejtë iniciativat e shumta ndërkombëtare, të qëndrueshme ose okazionale, në të cilat marrin pjesë organet parlamentare, në kërkim të një përfshirje të tyre sa më efikase, mbi të gjitha, në ndihmën e vendeve me demokraci të reja.

Bibliografia

- Torre, A. (2000) *Il magistrato dell'assemblea, Saggio sui presidenti parlamentari*, Torino: Giappichelli.
- Martinez, A. M. (2007) *Le relazioni internazionali tra i parlamenti e la politica estera dei governi*, in "Storia d'Italia", Annali, n. 17, "Il Parlamento", Einaudi.
- Violante, L. (2004) Il ruolo della "diplomazia" parlamentare, *Politica internazionale*, Vol. 26.
- Sicari, S. (2000) *Parlamento* (organizzazione e funzionamento), Einaudi.
- Ciolo, V. & Ciarro, D. (2003) *Il diritto parlamentare nella teoria e nella pratica*, Giuffrè, 5^a edizione.

A e zvogëlon Traktati i Lisbonës rolin e Shtetit për një Politikë të Jashtme të përbashkët?

Dokt. Eglantina GOLEMI

Erjona CANAJ, PhD

Abstrakt. *Politika e Jashtme e Përbashkët e BE-së është, pa dyshim, kryefjala dhe njëkohësisht një nga sfidat e BE-së në ditët e sotme. Vendimet që merren apo ndryshimet që bëhen në këtë drejtim, kanë një impakt të drejtpërdrejtë në imazhin dhe rolin e BE-së si faktor ndërkombëtar. BE-ja vepron në katër fusha të politikës së jashtme: I) politika e përbashkët tregtare; II) politika e asociimit, partneritetit, bashkëpunimit dhe fqinjësisë; III) zhvillimi, bashkëpunimi teknik dhe ndihma humanitare si dhe IV) dimensionin i jashtëm i politikave të tjera të brendshme. Në këtë studim synohet të evidentohet nëse Traktati i Lisbonës ka ndikuar në uljen e rolit të shtetit për një politikë të jashtëm autonome, duke trajtuar si shembuj dy nga fushat kryesore të saj si politika e përbashkët tregtare dhe politika e zhvillimit, bashkëpunimit teknik dhe ndihmës humanitare. Nëse politika e përbashkët tregtare tashmë është kompetencë ekskluzive e Bashkimit Europian, politika për zhvillim, bashkëpunim teknik dhe ndihma humanitare janë kompetencë konkurruese midis Shteteve Anëtare dhe BE-së. Ekskluziviteti u përdor nga Traktati si mjet ligjor me anë të të cilit vërtetohet rënia e rolit të shtetit në një politikë të jashtme autonome, por dhe kompetencat e përbashkëta po sfidojnë hapur praktikën ligjore për nga funksionimi i tyre. Politika e Jashtme e Përbashkët sot përbën një sfidë të vërtetë të politikës botërore.*

Fjalët kyçe: *Politika e Jashtme e Përbashkët, ndihma humanitare, bashkëpunimi për zhvillim, ekskluzivitet në vendimmarrje, Traktati i Lisbonës*

¹ * Instituti i Studimeve Europiane, Tiranë

Hyrje

Politika e jashtme e BE-së konsiderohet, pa dyshim, sot një sukses i diplomacisë europiane, për nga multifunksionaliteti i procedurave vendimmarrëse, nga individualiteti ligjor ndërkombëtar që BE-ja gëzon sot, falë saj në politikat ndërkombëtare. Mund të themi pa frikë që, politika e jashtme e BE-së është një model konkurrues i politikave botërore, e cila ka kaluar një evolucion të gjatë, të vështirë por të suksesshëm, që e ka pozicionuar sot BE-në në aktor kyç në arenën ndërkombëtare. Ajo është mishërim i qartë i bashkëpunimit, duke na treguar se atje ku diplomacia flet dhe vepron, duke dhënë edhe nga vetja, arrihen vepra të një rëndësie thelbësore. Modeli politik që operon Europa sot në tregun e politikave ndërkombëtare, i cili ka rrëmbyer suksese diplomatik dhe pushtetë të shteteve më të mëdha europiane, ka hyrë në fuqi që në momentin e ratifikimit të Traktatit të Lisbonës. Traktati i Lisbonës që modifikoi Traktatet e Komuniteteve Europiane, u bë pre e kritikave që u ndanë në dy pjesë: a) integristët – që në njërin anë e kritikonin Traktatin e Lisbonës si shumë të gjerë për transferimin e sovranitetit kombëtar në drejtim të institucioneve të Bashkimit Evropian; b) federalistët – që kritikonin se dispozitat e Traktatit nuk shkonin aq sa duhej drejt sovranitetit kombëtar (Reka, B. & Höll, O. & Sela, Y., 2010:48) duke evidentuar nevojën e vendimmarrjes në nivel mbikombëtar dhe në fusha të tjera, përveç atyre që aktualisht janë. Gjatë një analize që do t'i bëjmë këtij Traktati, do të evidentojmë që PPJS-ja mbeti përsëri si shtyllë e dytë, por arriti disa stade, shkallë më të larta të zhvillimit, por kjo fushë e cila konsiderohet si e suksesshme, në të vërtetë nuk ka një kuadër të mirpërcaktuar të kompetencave. BE-ja konsiderohet si një sipërmarrje dhe histori suksesi për nga forma, vendimmarrja, stabiliteti i krijuar në rajon dhe për nga 'diplomacia e butë' që ajo përdor për të arritur qëllimet e saj. Kjo gjë evidentohet fare qartë me kalimin, madje dorëzimin në mënyrën më paqësore dhe vullnetar të pushtetit nga Shtetet Anëtare, të Bashkimi Evropian. Kjo nënkupton që traktati ka ndikuar në uljen e rolit të shtetit për një politikë të jashtme autonome.

Risite e Traktatit të Lisbonës

Një nga objektivat themelore të Traktatit të Lisbonës, pas mandatit të *Deklaratës Laeken*, ishte të forconte Bashkimin Evropian si një aktor global. Vlen të theksohet se ky traktat është një nga etapat e reja në procesin e krijimit të Unionit gjithnjë e më të ngushtë mes Shteteve Anëtare dhe një vazhdim i hapave të integritimit evropian, çka nënkupton që një pjesë e konsiderueshme e ndryshimeve që janë bërë në këtë traktat, kanë ulur rolin e shtetit për një politikë të jashtme autonome, duke nxjerrë si faktor në vendimmarrje gjithnjë e më shumë BE-në. Në mënyrë sipërfaqësore do të trajtojmë disa nga risitë e këtij traktati që kanë ndikuar në

uljen e rolit të shtetit në vendimmarrje, duke u ndalur më gjërësisht në fushën e kompetencave, si dëshmia e procesit të kalimit të kompetencave nga Shtetet Anëtare, të BE-ja.

Neni 47 i TFEU-së² i jep Bashkimit European personalitet juridik³. Homologjia e kësaj dispozite ka qenë neni 181 i KE-së, i cili ka qenë pjesë kryesore e argumentit të GJED-së mbi autonominë dhe superioritetin e sistemit ligjor të Komunitetit në vitet 1960⁴. GJED-ja në çështjen *ERTA* dalloi nocionin e kapacitetit nga autoriteti për të marrë pjesë në rrethana të caktuara në një marrëveshje ndërkombëtare. Sipas saj, kapacitet do të thotë që BE-ja ka mundësinë të veprojë, ndërsa autoriteti ligjor duhet të gjendet në kompetencë specifike të dhënë nga një dispozitë e traktatit⁵, pra, në ato kompetenca që i janë të dhënë BE-së nga traktati, roli i shtetit në vendimmarrje është i ulët. Duket se në nenin 47 nuk përmendet personaliteti ndërkombëtar. Sipas të drejtës ndërkombëtare, si organizatë, personaliteti juridik ndërkombëtar i të cilës njihet, BE gëzon të drejtën për t'u përfaqësuar, të drejtën për të përfunduar traktate dhe të marrë përgjegjësi ligjore, duke i dhënë mundësinë asaj që të përfaqësohet denjësisht si një aktor global me vendimmarrje autonome.

Traktati i Lisbonës ka qenë subjekt dhe i ndryshimeve të shumta institucionale. Ndryshimet institucionale tregojnë pushtetin relativ brenda dhe jashtë Bashkimit European, që ushtrohen nga aktorët kryesorë, Këshilli, Këshilli European, Komisioni, Parlamenti European. Ndryshimet institucionale kanë ndikuar gjithashtu edhe mbi forcën e BE-së në lidhje me Shtetet Anëtare.

A) Ndryshimi i numrit të Komisionerëve⁶, i cili redukton pushtetin e një shteti edhe pse minimalisht, në procesin vendimmarrës në momentin në të cilin nuk do të ketë përfaqësues aty.

² Neni 47 i TFEU-së përcakton se "Bashkimi ka personalitet juridik."

³ Kjo dispozitë i dha fund debatit, që ishte zhvilluar që nga miratimi i Traktatit të Matrihtit, rreth faktit nëse Bashkimi European, ndryshe nga Komuniteti European, do të gëzonte individualitet ligjor ndërkombëtar.

⁴ Çështja gjyqësore *Costa me ENEL* [1964] 585.

⁵ Deklarata Nr.24, që i shtohet Traktatit të Lisbonës dhe ku thuhet 'fakti që BE ka personalitet juridik, në asnjë mënyrë nuk e autorizon Bashkimin të nxjerr ligje apo të veprojë jashtë kompetencave që i janë dhënë nga Traktatet'

⁶ Neni 17/4 i TFEU-së shprehet "Komisioni i emëruar nga data e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës deri më 31 tetor 2014, përbëhet nga një shtetas i secilit Shtet Anëtar" Neni 17/5 i TFEU-së " Duke filluar nga data 1 nëntor 2014, Komisioni do të përbëhet nga një numër anëtarësh, duke përfshirë Presidentin e tij dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, që përkon me dy të tretat e numrit të Shteteve Anëtare, nëse Këshilli European, me unanimitet, nuk vendos ta ndryshojë këtë numër"

B) Ndryshimi i mënyrës së votimit në Këshill⁷ është një tipar tjetër i rëndësishëm i këtij organi qendror. Vlen të përmendet fakti që puna e tij që prej themelimit të Komunitetit European për Ekonominë është kristalizuar në mënyrë të vazhdueshme. Pra, fushat e veçanta politike, që mbulonin këshilla të ndryshëm të pjesëshëm, kanë krjuar gjithmonë e më shumë një ekzistencë të tyre të mirëpërcaktuar dhe të pavarur, dhe kjo, para së gjithash, për dy arsye: Së pari, në nivelin e Shteteve Anëtare ka gjithnjë e më pak koordinim dhe po kështu gjithnjë e më pak një pozicion gjerman, italian apo britanik. Ky është ndër të tjera një tregues domethënës i faktit, se sa shumë politika e shteteve të veçanta anëtare përkundrejt BE e ka humbur karakterin e vet si autonome. Së dyti, me kalimin në shumicën e kualifikuar është bërë gjithnjë e më pak e domosdoshme gjetja e dakordeve të mëdha, përfshirës të disa fushave politike, të tipit *package deals*. Një pasojë shumë e rëndësishme e këtij zhvillimi është që në plan të parë të dalin elemente specifike të fushave politike dhe jo ai i Shtetit Anëtar. Kjo do të thotë që, linja e ndarjes shkon tanimë përmes fushave të veçanta dhe gjithnjë e më pak mes Shteteve Anëtare.

C) Krijimi i Presidentit të Këshillit European, me një mandat dy vjet e gjysmë, i cili siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit për çështje që kanë të bëjnë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe, krijimi i organit të Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Jashtme dhe atë të Sigurisë si figura të diplomacisë europiane janë, pa dyshim, tregues të qartë të rritjes së rolit të përfaqësimit të BE-së në arenën ndërkombëtare.

D) Traktati i Lisbonës është i pari traktat që e kornizon në mënyrë të qartë ndarjen e kompetencave mes BE-së dhe vendeve anëtare. Për herë të parë në historinë e BE-së ka një listë të saktë me ndarjen e kompetencave. Para Traktatit të Lisbonës nuk kishte një ndarje të qartë të kompetencave dhe shpeshherë kjo mungesë shërbente si fushë beteje mes BE-së dhe Shteteve Anëtare, nëse kompetencat në një fushë të caktuar ishin të veçanta apo të përbashkëta.

Kategorizimi i kompetencave nga Traktati i Lisbonës është i një rëndësie fundamentale sepse përcakton ndikimin e tyre dhe ndarjen e pushtetit midis BE-së dhe Shteteve Anëtare (Craig, P., 2001). Pasi është vendosur ekzistenca e kompetencave të Bashkimit European çështja tjetër e rëndësishme është nëse ajo është një kompetencë ekskluzive apo është e përbashkët me Shtetet Anëtare sepse, parimi i përgjithshëm është dhe ka qënë gjithmonë se BE-ja ka vetëm kompetenca që i akordohen nga traktatet. Traktati i Lisbonës në neni 2 të TFBE-së bën një

⁷ Neni 16/4 i TBE-së thotë: "Duke filluar nga data 1 nëntor 2014, shumica e cilësuar është të paktën 55% e anëtarëve të Këshillit, me përbërjen e të paktën pesëmbëdhjetë prej tyre dhe me përfaqësimin e Shteteve Anëtare

që përbëjnë të paktën 65% të popullsisë së Bashkimit. Pakica bllokuese duhet të përfshijë të paktën katër anëtarë të Këshillit, dhe nëse nuk arrihet kjo atëherë konsiderohet se është arritur shumica e cilësuar."

kategorizim të plotë të kompetencave në:

- kompetenca ekskluzive të BE-së⁸,
- kompetenca të përbashkëta mes BE-së dhe Shteteve Anëtare⁹,
- kompetenca për të ndërmarrë vetëm veprime mbështetëse, koordinuese ose suplementare¹⁰,
- kompetenca të ndara midis Bashkimit dhe Shteteve Anëtare.

Do e trajtojmë më poshtë dhe më të detajuar këtë ndarje, por në fokus të studimit do të jenë vetëm dy kategoritë e para, duke analizuar nga një fushë për secilën nga kategoritë. Neni 3 i TFBE-së përcakton kategorinë e kompetencave ekskluzive¹¹. Ekskluzivitet do të thotë që kompetenca është transferuar plotësisht nga Shtetet Anëtare tek Bashkimi European dhe se nuk ekziston asnjë kompetencë konkurruese e shteteve anëtare (O'Keeffe, D.), pra Shtetet Anëtare nuk kanë kompetenca legjislativ autonome dhe nuk mund të nxjerrin ligje, me përjashtim të rasteve kur autorizohen nga Bashkimi, ashtu si dhe për zbatimin e akteve të Bashkimit.

Përcaktimi i ekskluzivitetit është i rëndësishëm për shkak të problemeve të shumta me caktimin e vijave ndarëse, edhe vetë brenda kompetencave ekskluzive midis kategorive të ndryshme. Do të përpiqemi të konkretizojmë domosdoshmërinë e përcaktimit të ekskluzivitetit, dhe si rrjedhojë uljen e rolit të

⁸ Neni 2/1 i TFBE-së "Kur Traktatet i japin Bashkimit kompetencë ekskluzive në një fushë të caktuar, vetëm Bashkimi mund të miratojë legjislacion dhe akte me fuqi ligjore detyruese, ndërsa Shtetet Anëtare mund ta bëjnë një gjë të tillë vetëm nëse këtë të drejtë ia jep Bashkimi ose për zbatimin e akteve të Bashkimit".

⁹ Neni 2/2 i TFBE-së "Kur Traktatet i japin Bashkimit një kompetencë të përbashkët me Shtetet Anëtare në një fushë të caktuar, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare mund të miratojnë legjislacion dhe akte me fuqi ligjore detyruese. Shtetet Anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në masën dhe për aq sa Bashkimi nuk ka ushtruar kompetencën e tij. Shtetet Anëtare e ushtrojnë gjithashtu kompetencën e tyre për aq sa dhe kur Bashkimi ka vendosur të pushojë së ushtruar kompetencën e tij."

¹⁰ Neni 2/5 i TFBE-së "Në disa fusha të caktuara dhe sipas kushteve të përcaktuara në Traktatet, Bashkimi ka kompetencën për të kryer veprime për të mbështetur, bashkërenduar ose plotësuar veprimet e Shteteve Anëtare, pa e kapërcyer përmes tyre kompetencën e Shteteve Anëtare, në këto fusha."

¹¹ Neni 2/1 i TFBE-së: Bashkimi ka kompetencë ekskluzive në fushat e mëposhtme:

- (a) bashkimi doganor;
- (b) vendosja e rregullave të konkurrencës, të nevojshme për funksionimin e tregut të brendshëm;
- (c) politika monetare për Shtetet Anëtare, monedha e të cilave është Euro;
- (d) ruajtja e burimeve biologjike detare në kuadër të politikës së përbashkët për peshkimin;
- (e) Politika e përbashkët tregtare.

shtetit në vendimmarrjen e BE-së. Neni 3/2 i TFBE-së¹² ka preokupuar shumë praktikën ligjore në tërësi dhe është dashur të kalojë një rrugëtim të gjatë dhe të superojë konflikte të ndryshme që të marrë formën që ai disponon aktualisht. Para Lisbonës GJED-ja e pati njohur prej kohësh kompetencën e Komunitetit për të përfunduar një marrëveshje ndërkombëtare, kur kjo ishte e domosdoshme për të zbatuar kompetencat e tij të brendshme, edhe kur nuk kishte kompetenca të jashtme të shprehura. Çështja, nëse kjo kompetencë e jashtme, e nënkuptuar, ishte ekskluzive, u trajtua si e dallueshme nga ekzistenca e një kompetence të tillë. Kompetencat e jashtme, të nënkuptuara, mund të jenë ekskluzive ose të përbashkëta¹³, por kriteri i ndarjes nuk ishte plotësisht i qartë (Cremona, 2000:03) dhe formulimet e GJED-së, se në cilat raste mund të shfaqej ekskluziviteti, kishin një rreze të gjerë veprimi. Kështu, në çështjen gjyqësore *ERTA*, GJED-ja u shpreh se kur Komuniteti vepronte për të zbatuar një politikë të përbashkët në përputhje me Traktatin, Shtetet Anëtare nuk kishin më të drejtë për të ndërmarre veprimtari të jashtme që mund të prekin rregullat e vendosura ose të deformonin kuadrin e tyre¹⁴. Ky qëndrim u modifikua në çështjen *Kramer*¹⁵ ku GJED-ja u shpreh se KE-ja mund të kishte kompetenca të jashtme, të nënkuptuara, edhe sikur të mos kishte marrë masa të brendshme për të vënë në zbatim politikat përkatëse, por deri në atë shkallë sa KE-ja të ushtronte kompetencat e saj të brendshme dhe Shteteve Anëtare t'u mbetej kompetenca për të vepruar, me kusht që veprimet e tyre të ishin në përputhje me objektivat e Komunitetit. Kuadri i ekskluzivitetit u vu në dyshim në çështjen *Inland Waterways*¹⁶, ku GJED-ja u shpreh se KE-ja mund të kishte kompetenca të jashtme ekskluzive, edhe sikur mos të ushtronte kompetencat e saj të brendshme, në qoftë se veprimtaria e shteteve anëtare mund të vinte në rrezik objektivat që kërkonte të arrinte Komuniteti. Më vonë GJED-ja u tërhoq nga interpretimi tejet i gjerë i ekskluzivitetit, i përdorur në çështjen *Inland Waterways*, me *Opinionin 1/94* mbi Marrëveshjen e OBT-së¹⁷. Ajo u shpreh se kompetencat e jashtme, ekskluzive, ishin në përgjithësi të varura nga ushtrimi

¹² Bashkimi ka gjithashtu kompetencë ekskluzive për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare, kur lidhja e saj parashikohet në një akt legjislativ të Bashkimit ose nevojitet për t'i dhënë mundësi Bashkimit të ushtrojë kompetencën e tij të brendshme, ose për aq sa lidhja e saj mund të prekë normat e brendshme, ose mund ta ndryshojë objektin e tyre.

¹³ Opinion 1/03 Competence of the Community to conclude the New Lugano Convention on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgements in civil and commercial matters [2006], I-1145, [114].

¹⁴ Çështja gjyqësore 22/70 *Komisioni v. Këshillin 22/70*.

¹⁵ Çështja gjyqësore 3.4 dhe 6/76 *Kramer*.

¹⁶ Opinioni 1/76 *Inland Waterways*.

¹⁷ Opinioni 1/94 Competence of the Community to Conclude International Agreement Concerning Service and the Protection of Intellectual Property, WTO [1994] I-5267.

aktual i kompetencave të brendshme dhe jo thjesht nga ekzistenca e tyre. Duhet ta pranojmë që tre interpretime të ndryshme në lidhje me ekskluzivitetin e jashtëm të kompetencave të BE-së përbënin një rrezik real dhe tepër serioz për vendimmarrjen e saj në fushën e jashtme, pasi shkaktojnë konfuzion dhe pasiguri brenda Unionit, duke përllogaritur dhe kostot e larta shkatërruese që do të përbënin për imazhin e saj në opinionin e politikës botërore. Kështu BE-ja krijonte një imazh të dyzuar dhe të pa pushtetshëm, dhe kjo në një moment që BE-ja po kërkonte të fitonte pikë dhe kredibilitet në tabelën botërore të politikës, ishte penalizuese. Traktati i Lisbonës i dha një dimension tjetër kësaj dispozite duke specifikuar tri situata, në të cilën BE-ja ka kompetenca të jashtme ekskluzive.

E para është kur përfundimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare parashikohet nga një akt legjislativ i Bashkimit Europian. Në nenin 3/2 të TFBE-së nuk thuhet që Bashkimi Europian do të ketë kompetenca të jashtme, ekskluzive, kur në një akt legjislativ të Bashkimit thuhet një gjë e tillë, gjithashtu as nuk përmendet që BE-ja do të ketë kompetenca të tilla, të jashtme, ekskluzive vetëm në fushat në të cilat ai ka kompetenca ekskluzive të brendshme. Në dispozitë përcaktohet se kur përfundimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare parashikohet në një akt legjislativ, Bashkimi Europian do të ketë kompetenca të jashtme ekskluzive dhe Shtetet Anëtare parandalohen nga përfundimi i një marrëveshjeje të tillë, në mënyrë individuale.

E dyta është kur BE-ja ka kompetenca të jashtme, ekskluzive, për të përfunduar marrëveshjeje ndërkombëtare, kur kjo gjë është e nevojshme për t'i dhënë mundësi Bashkimit të ushtrojë kompetencat e brendshme, i pavarur nga lloji i kompetencave të brendshme që kishte BE-ja. Kjo kupton që kompetencat e jashtme, ekskluzive, për të përfunduar një marrëveshjeje ndërkombëtare i takojnë Bashkimit, kur kjo është e nevojshme për të ushtruar kompetencat e brendshme, madje dhe kur kompetencat e brendshme janë të përbashkëta.

E treta është se BE-ja do të ketë kompetenca të jashtme, derisa përfundimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare 'të mos prekë rregullat e përgjithshme apo të ndryshojë kuadrin e tyre'. Cremona ka argumentuar bindshëm se neni 3/2 'bashkon dy çështje të veçanta të ekzistencës së kompetencave të jashtme, të nënkuptuara dhe ekskluzivitetit të atyre kompetencave (Cremona, 03), sipas tij kombinimi i këtij neni në nenin 216 të TFBE-së¹⁸ do të thotë se kompetencat e përbashkëta, të nënkuptuara, mund të zhdruken.

¹⁸ Neni 216 I TFBE-së "1.-Bashkimi mund të lidhë një marrëveshjeje me një ose më shumë vende të treta apo organizata ndërkombëtare kur këtë e parashikojnë Traktatet ose kur lidhja e një marrëveshjeje është e nevojshme për të arritur, brenda kuadrit të politikave të Bashkimit, një prej objektiveve të përmendur në Traktatet, ose parashikohet në një akt me fuqi detyruese ligjore të Bashkimit apo ka të ngjarë të prekë rregullat e përbashkëta ose ta ndryshojë fushën e veprimtari të tyre.

² Marrëveshjet e lidhura nga Bashkimi kanë fuqi ligjore detyruese për institucionet e Bashkimit dhe Shtetet Anëtare"

Para Traktatit të Lisbonës, shumë kompetenca të jashtme ishin ekskluzive të Shteteve Anëtare, por miratimi i këtij Traktati bëri të mundur zgjerimin e kuadrit të kompetencave të jashtme, të përbashkëta, të Bashkimit European më Shtetet Anëtare. Kompetencat e përbashkëta përfshihen në nenin 4 të TFBE-së, lista e përcaktuar në këtë nen përbëhet, në pjesën më të madhe nga kompetenca, të cilat në krye të herës kanë qënë ekskluziviteti i Shteteve Anëtare, por që falë procesit të Lisbonës, BE-ja ka marrë një pjesë të konsiderueshme të “fuqisë” së tyre.

Politika e Përbashkët Tregtare (PPT)

Bashkimi European është fuqia më e madhe tregtare e botës, ky tashmë është një fakt dhe një realitet të cilin e ndiejmë në çdo trasaksion tregatar që do të na duhet të realizojmë. Madhështia e BE-së, në kuptimin ekonomik, tregtar e financiar pas zgjerimeve dhe zhvillimeve të tjera të përshkruara më sipër, e bën atë lojtarin udhëheqës botëror, tregtarin më të madh dhe vendi i valutës së dytë në botë. Partneri më i madh tregtar i BE-së janë, pa dyshim, SHBA, marrëdhënie të cilat konsiderohen të suksesshme për nga mënyra e funksionimit dhe mbështetjes reciproke që këto fuqi i japin njëra-tjetrës. Fokusi ynë në lidhje me PPT-në do të jetë ulja e rolit të shtetit në vendimmarrje në këtë fushë, deri në kalimin si kompetencë ekskluzive të kësaj politike, Bashkimit European. Traktati i Lisbonës i bëri ndryshime të rëndësishme Politikës së Përbashkët Tregtare. Për shumë vite, kjo politikë ka qenë objekt regullimi i vendimeve të GJED-së, dhe ka marrë formë falë përdorimit të një miksi midis dialogueve, vendimeve të GJED-së dhe amendamenteve të traktatit. Centralizimi i kompetencave të PPT-së në duart BE-së duke e kthyer në një kompetencë ekskluzive ka kaluar në një rrugë të gjatë dhe Traktati i Lisbonës vë në dukje katër rezultate të rëndësishme në lidhje me këtë politikë. Së pari, PPT-ja tani e mbulon tregtinë në shërbime në tërësi, duke zgjeruar kuadrin e kompetencave të jashtme, ekskluzive, të BE-së në këtë fushë. Së dyti, e njëjta gjë vlen dhe për aspektet e tregtare të pronësisë intelektuale dhe investimeve të huaja të drejtpërdrejta¹⁹. Së treti, politika e transportit që është kompetencë e përbashkët mes BE-së dhe Shteteve Anëtare sipas nenit 4/2 i TFBE-së, mbetet jashtë kuadrit të PPT-së²⁰. Së katërti, Parlamentit European i është dhënë përfundimisht roli i plotë legjislativ i PPT-së. PPT-ja

¹⁹ Kalimi nga kompetencat e përbashkëta në kompetencat ekskluzive të BE-së në sferën e investimeve të huaja, të drejtpërdrejta ka mundësi të krijojë vështirësi, po të kemi parasysh rrjetin e madh të traktateve ekzistuese, dypalëshe të investimeve (BIT) midis shteteve dhe vendeve të treta.

²⁰ Neni 207/5 i TFBE-së ”Negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e transportit i nënshtrohen Titullit VI të Pjesës së Tretë dhe nenit 218”.

mbulon si masat njëpalëshe të Bashkimit European, për shembull, instrumentet e antidompingut, ashtu edhe masat konvencionale, që bisedohen me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, si marrëveshjet tregtare. GJED-ja, në një çështje të hershme, vendosi që funksionimi i duhur i bashkimit doganor justifikonte një interpretim të gjerë të kompetencave që jepte traktati në këtë fushë²¹. Lidhja midis PPT-së dhe projektit fillestar për krijimin e tregut të përbashkët të KE-së shpjegon shumë nga zhvillimet që ka pasur kjo fushë në drejtim të zgjerimit të kompetencave ekskluzive të Bashkimit European qysh në vitet e para (Cremona, 2000). Në Opinionin 1/75, duke iu referuar politikës së jashtme tregtare të një shteti (Koutrakos, P., 2004), GJED-ja e përcaktoi kadrin e PPT-së shumë gjërë, duke deklaruar se ajo ishte një fushë që zhvillohej në mënyrë progresive, nëpërmjet një kombinimi të masave të brendshme dhe të jashtme, pa ndonjë përparësi të ndonjë lloji ndaj tjetrit. Më tej, GJED-ja vendosi që kompetenca duhet të jetë ekskluzive (Eeckhout, P., 2004:15) ajo e bazoi argumentin e saj për ekskluzivitetin mbi dy faktorë kryesorë: a) rreziku që paraqisnin kompetencat konkurruese ndaj besimit reciprok brenda BE-së dhe të BE-së ndaj shteteve anëtare, dhe në këtë mënyrë edhe ndaj koherencës dhe efektivitetit për mbrojtjen e interesave tregëtare të Bashkimit European kundrejt shteteve joaëtare dhe b) rreziku i deformimit të konkurrencës brenda një tregu të vetëm që shkaktohej nga politikat e ndryshme të Shteteve Anëtare.

Edhe pse GJED-ja vendosi ekskluzivitetin të kompetencave të Bashkimit European në PPT, ajo la vend përsëri për interpretim, duke lënë njëfarë hapësire, gjatë së cilës shtetet anëtare nuk pengoheshin për të vepruar, me kushtin që veprimtaria e tyre të rregullohej nga e drejta e Bashkimit European. Në çështjen *Donckerwolcke*, GJED-ja vendosi që Shtetet Anëtare mund të devijonin nga normat e PPT-së, megjithëse vetëm me “autorizimin specifik” të Bashkimit European²². Ndërtimi dinamik i kuadrit të PPT-së nga GJED-ja ishte i rëndësishëm në vitet 1970, kur ekzistonte një tendencë drejt një qasjeje më rregullore dhe më pak liberalizuese në tregëtinë ndërkombëtare. Në *Opininin 1/78 (marrëveshja për kaucukun natyror)* GJED-ja theksoi objektivat kompleks të marrëveshjeve tregtare të këtij lloji dhe vendosi që BE-ja duhet të jetë në gjendje të shfrytëzojë “mjetet më të përpunuara për zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë ndërkombëtare”²³. Në këtë mënyrë, PPT-ja nuk mund të kufizohet vetëm në aspektet tradicionale të tregtisë së jashtme dhe traktati nuk ofronte një rregullim botëror të kësaj politike. Përfundimisht, GJED-ja vendosi që BE-ja kishte kompetenca ekskluzive në terma substancialë, për të marrë pjesë

²¹ Çështja gjyqësore 8/73 *Hauptzollamt Bermerhaven me Massey-Ferguson GmbH* [1973] ECR 897,[4]

²² Çështja gjyqësore 41/76 *Donckerwolcke* 32.

²³ Opinioni 1/78.

në marrëveshje, po roli i Shteteve Anëtare në financimin e marrëveshjes do të thoshte se kërkohej edhe përfshirja e tyre. Pas viteve 1986, tabloja e politikës tregtare ndërkombëtare ndryshoi falë bisedimeve tregtare të *Raundit të Uruguait*, i cili përfshinte trajtimin e tregtisë në shërbime. Meqenëse Komisioni mendonte se Komuniteti kishte kompetenca ekskluzive për të nënshkruar marrëveshjen përfundimtare të OBT-së, e cila ishte krijuar në vitin 1994, por shtetet anëtare nuk dëshironin t'ia dorëzonin kompetencat e tyre në këtë drejtim atëherë iu kërkuar GJED-së një opinion. Në *Opinionin 1/94* GJED-ja vendosi që të gjitha marrëveshjet e OBT-së mbi tregtinë e mallrave, futeshin brenda Politikës së Përbashkët Tregtare të Bashkimit Europian. Në lidhje me tregtinë e shërbimeve, përfundimi i gjykatës ishte se kompetenca mbi shërbimet *ndërkufitare* ishte ekskluzive, por Shtetet Anëtare vazhduan të mbanin kompetenca për mënyrën e furnizimit të tyre. Shërbimet e transportit nuk futeshin brenda PPT-së, por mbeteshin kompetenca të përbashkëta midis BE-së dhe Shteteve Anëtare. *Opinionin 1/94* ishte një ndër më të rëndësishmit, i cili shënoi dhe fundin e ekspansionit të kompetencave të BE-së, si edhe fundin e periudhës së aktivizimit gjyqësor në lidhje me kompetencat ekskluzive të Bashkimit Europian. Traktatet e Amsterdimit dhe të Nisës bënë ndryshime të tjera, duke zgjeruar edhe më tej hapësirën e PPT-së duke përfshirë dhe marrëveshjet në lidhje me pronësinë intelektuale dhe shërbimet. Traktati i Lisbonës bëri ndryshime të tjera, të rëndësishme në lidhje me PPT-në. Kompetencat e BE-së tani nuk varen më nga dallimi midis kategorive të ndryshme të tregtisë në shërbime, por PPT-ja e mbulon tregtinë në shërbime në tërësi. Krahas Këshillit, Parlamentit Europian i jepet përfundimisht pushtet i plotë legjislativ në fushën e PPT-së. Për përfundimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare tregtare është shumë e rëndësishme marrja e pëlqimit të Parlamentit Europian.

Politika e Zhvillimit, Bashkëpunimi Teknik dhe Ndihma Humanitare

Para miratimit të Traktatit të Mastroit, për këto tri fusha vendimmarrja ishte kompetencë e shteteve anëtare. Në çështjen *Parlamenti me Këshillin (Lome IV)*, Gjykata Europiane e Drejtësisë në interpretimin që i bëri çështjes në fjalë, përcaktoi se kompetencat në këto tri fusha nuk do t'i përkisnin më tërësisht vetëm shteteve anëtare, por do të ndaheshin me Bashkimin²⁴. Politika e Zhvillimit, Bashkëpunimi Teknik dhe Ndihma Humanitare trajtohet në TFBE-në përkatësisht në nenet 208-214 të këtij Traktati. Politika e Bashkimit për bashkëpunimin për zhvillim²⁵ ka si objektiv parësor uljen dhe, në periudhën

²⁴ Çështja Gjyqësore C-155/07 *Parlamenti Europian me Këshillin* [2008] I-8193.

²⁵ Neni 208/2 TFBE-së.

afatgjatë, zhdukjen e varfërisë. Bashkimi merr në konsideratë objektivat e bashkëpunimit për zhvillim në politikën që zbaton të cilat ka të ngjarë të prekin vendet në zhvillim. Ndihma Humanitare trajtohet në nenin 214 të TFBE-së²⁶.

Traktati i Lisbonës, në nenin 4/3 të TFBE-së²⁷, përcakton se Politika e Zhvillimit, Bashkëpunimi Teknik dhe Ndihma Humanitare është subjekt i një politike të përbashkët ku BE-ja ndërmerr veprime mbështetëse, koordinuse ose suplementare, e cila nuk i pengon shtetet anëtare që të ushtrojnë kompetencat e tyre. Karakteri bashkëpunues mes Bashkimit dhe Shteteve Anëtare në këto fusha del në pah në nenin 208/1 të TFBE-së, i cili thotë 'Politika e Bashkimit për bashkëpunimin për zhvillim dhe ajo e Shteteve Anëtare plotësojnë dhe përforcojnë njëra-tjetrën'. Pra, ajo çka më parë ka qenë kompetencë vetëm e shteteve anëtare, tashmë është ulur në nivele bashkëpunimi, kjo është një formë demonstrimi e uljes së rolit të shtetit në një politikë të jashtme autonome në fushat në fjalë. Duket sikur ka një konflikt midis nenit 4/3 të TFBE-së, i cili thotë shprehimisht që Shtetet Anëtare nuk pengohen në ushtrimin e kompetencave të tyre, çka do të thotë që paralelisht me BE-në, Shtetet Anëtare mund të lidhin marrëveshje në kuadër të këtyre politikave. Lufta në Libi na e vërtetoi edhe njëherë këtë fakt: BE-ja ka nxjerrë nëpërmjet transportit ajror e detar më shumë se 5.800 evropianë nga Libia në vend të sigurt. Por më shumë se gjysma e 28 shteteve anëtare të BE-së, në mënyrë individuale, ofruan anije, aeroplanë dhe ndihma për t'u mundësuar 20.000 punëtorëve emigrantë që të ktheheshin në vendlindjet e tyre. Vija ndarëse e përcaktimit të këtyre kompetencave është e hollë dhe delikate dhe shpesh ka pasur hapësira për keqinterpretime, ushtrimi i kompetencave të shteteve anëtare nuk duhet të bjerë në kundërshtim me politikën e Bashkimit, përkundrazi duhet ta përforcojë atë, dhe kjo pjesë e dispozitës i jep epërsi fushëveprimin të BE-së, kundrejt shteteve anëtare. Është për t'u përsëritur fakti që nga momenti që BE-ja ka marrë kompetenca në këto fusha, bota ka njohur një nivel tjetër zhvillimi, trajtimi dhe ndihme. Qëllimi kryesor i politikës së BE-së për zhvillim është që ta heq varfërinë njëherë e përgjithmonë. Më shumë se gjysma e parave që shpenzohen në ndihmë të vendeve të varfra në mbarë botën vijnë nga BE-ja, dhe nga shtetet e saj anëtare. Kjo e bën atë, donatorin më të madh humanitar në botë. BE-ja, është edhe mbështetësi më i madh i Kosovës sa i përket ndihmës teknike e financiare. Ndër

²⁶ Neni 214/1 i TFBE-së: Operacione të tilla kanë si qëllim dhënien e ndihmës ad hoc dhe mbështetjes, si dhe mbrojtjen e popullsisë të vendeve të treta që janë viktimë e fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, në mënyrë që të plotësohen nevojat humanitare që lindin në situata të tilla.

²⁷ Neni 4/3 i TFBE-së: Në fushat e bashkëpunimit për zhvillim dhe ndihmë humanitare, Bashkimi ka kompetencë të zhvillojë veprimtari dhe një politikë të përbashkët. Megjithatë, ushtrimi i kësaj kompetence nuk i pengon Shtetet Anëtare të ushtrojnë kompetencat e tyre.

vite, BE-ja ka financuar mijëra projekte zhvillimi në vendet në zhvillim. Shumë shpesh, pak para mund të jenë ndihmë e madhe. Politika e BE-së për zhvillimin synon edhe që t'u japë njerëzve të pafavorizuar kontroll mbi zhvillimin e tyre, që do të thotë se adresojnë burimin e dobësisë së tyre. Në aspektin e ndihmës humanitare vlen të përmendim ndihmën që BE-ja i ka ofruar vendeve si Iraku, Afganistani dhe pjesë të Afrikës. Vetëm në gjashtmuorin e parë të vitit 2013, BE-ja ka kontribuar me 150 milionë euro ndihma humanitare gjatë krizës.

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë

Me themelimin e Traktatit të Lisbonës, PPJS-ja mbeti përsëri si shtyllë e dytë, por arriti disa stadi, shkallë më të larta të zhvillimit duke filluar nga marrja e përgjegjësisë më të mëdha nga ana e BE-së, deri para Traktatit të Lisbonës. Rregullat në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë parashtrihen në Titullin V, të TBE-së. Vendimmarrja në këtë fushë vazhdon të jetë më tepër ndërqeveritare dhe më pak mbikombëtare, në krahasim me fushat e tjera të Bashkimit (Cremona, 2000). Neni 2/4 i TFBE-së²⁸ nuk specifikon se çfarë lloj kompetencash zbatohen në kuadrin e PPJS-së. Në pamje të parë kjo dispozitë për nga përmbajtja, duket shqetësuese, për arsye se krijon konfuzion dhe një sërë pikëpyetjesh në lidhje me funksionimin e saj. PPJS-ja nuk përmendet as te kompetencat ekskluzive të BE-së dhe nuk është subjekt as i listës së atyre fushave që janë subjekt i veprimit mbështetës, koordinues ose plotësues të Shteteve Anëtare. Kjo duket sikur kjo fushë lihet të nënkuptohet që ajo futet brenda kategorisë së munguar të kompetencave të përbashkëta të nenit 4 të TFBE-së²⁹, megjithëse nuk përmendet në listën jopërfundimtare. E vërteta është se PPJS-ja mund të mos futet siç duhet brenda kuadrit të kompetencave të përbashkëta, përderisa kjo tregon parandalimin e veprimit të Shteteve Anëtare, kur BE-ja ka ushtruar kompetencën e saj të fushës. Neni 24/3 i TFB-së e dëshmon këtë gjë, sipas tij “*Shtetet Anëtare e mbështetin aktivisht dhe pa rezervë politikën e jashtme dhe të sigurimit të Bashkimit, me frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjellë dhe e respektojnë veprimin e Bashkimit në këtë fushë. Ato nuk kryejnë asnjë veprim që bie ndesh me interesat e Bashkimit ose që ka të ngjarë ta ulë efektivitetin e tij si një forcë koberive në marrëdhëniet ndërkombëtare*”.

Kjo ide bie ndesh dhe me deklaratat që i bashkangjiten Traktatit të Lisbonës³⁰,

²⁸ Neni 2/4 i TFBE-së “ Bashkimi ka kompetencën, sipas dispozitave të Traktatit për Bashkimin Evropian, të caktojë një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, duke përfshirë edhe shprehjen progresive të një politike të përbashkët të mbrojtjes”.

²⁹ Neni 4/1 i TFBE-së ‘Bashkimi ka kompetencë të përbashkët me Shtetet Anëtare kur Traktatet i japin një kompetencë e cila nuk lidhet me fushat e përmendura në nenet 3 dhe 6’.

³⁰ Shih deklaratat 13 dhe 14 mbi politikën e përbashkët dhe të sigurisë.

sipas të cilave “*Dispozitat për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurimit, duke përfshirë ato në lidhje me Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurimit dhe Shërbimin për Veprim të Jashtëm, nuk prekin bazën ligjore, përgjegjësitë dhe kompetencat ekzistuese të asnjë Shteti Anëtar për të formuluar dhe zhvilluar politikën e tij të jashtme, shërbimin e tij diplomatik kombëtar, marrëdhëniet me vendet e treta dhe pjesëmarrjen në organizata ndërkombëtare, duke përfshirë anëtarësimin e Shtetit Anëtar në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*”³¹. Pra, duket sikur PPJS-ja është e dyzuar dhe pa një kornizë të qartë funksionimi dhe vendimmarrjeje, por Traktati është përpjekur ta strukturojë deri diku duke i dhënë jetë funksionimit të kësaj fushe. Ai krijoi imazhin e diplomacisë europiane që është njëkohësisht dhe risia më e madhe e Traktatit të Lisbonës, Përfaqësuesi i Lartë i Punëve të Jashtme dhe i Politikës së Sigurisë³². Traktati i Lisbonës përmirësoi koordinimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë duke bashkuar postin e deriatëhershëm të Komisionerit për Marrëdhënie me Jashtë dhe Përfaqësuesit të Lartë të Këshillit në një person të vetëm me dy poste që është Përfaqësuesi i Lartë dhe Zëvendës-presidenti i Komisionit. Mbajtësi i këtij posti quhet edhe si “nëna e organeve të marrëdhënieve të jashtme të BE-së”. Pavarsisht se BE-ja nuk ka një strategji të qartë dhe të plotë për PPJS-në, ai mund të pretendojë që të ushtrojë një lidhje në negociatat botërore ose rajonale, me kusht që të kapërcejë kontradiktat mes Shteteve Anëtare të tij dhe të flasë me një zë të vetëm. Për nga struktura dhe funksionimi, kjo politikë përbënë një histori suksesi të BE-së në politikat ndërkombëtare.

Konkluzione

Politika e Jashtme e Përbashkët e BE-së është, pa dyshim, kryefjala dhe njëkohësisht një nga sfidat e BE-së në ditët e sotme. Mund të themi pa frikë që, politika e jashtme e BE-së është një model konkurrues i politikave botërore, e cila ka kaluar një evolucion të gjatë, të vështirë por, pa dyshim, të suksesshëm, që e ka pozicionuar sot BE-në në aktor kyç në arenën ndërkombëtare. Politika e jashtme e BE-së është mëshirim i qartë i bashkëpunimit, duke na treguar se atje ku diplomacia flet dhe vepron, duke dhënë edhe nga vetja, arrihen vepra të një rëndësie fundamentale. Një nga objektivat themelore të Traktatit të Lisbonës, pas mandatit të *Deklaratës Laeken*, ishte të forconte Bashkimin Evropian si një aktor global. Vlen të theksohet se ky traktat është një nga etapat e reja në procesin e krijimit të Unionit gjithnjë e më të ngushtë mes Shteteve Anëtare dhe një vazhdim i hapave të integritimit evropian. Të gjitha risitë që solli ky traktat si, dhënia e personalitetit juridik, ndryshimet institucionale për nga forma

³¹ Deklarata 14 mbi politikën e përbashkët dhe të sigurisë.

³² Neni 18 pika 2 dhe 3 i TBE-së. Ministër i Jashtëm sipas Traktatit të braktisur kushtetues.

e vendimmarrjes apo struktura e tyre, krijimi i organeve me “ ekskluzivitet përfaqësimi” në politikën ndërkombëtare, janë dëshmi e uljes së rolit të shtetit për një politik të jashtme autonome. Traktati i Lisbonës është i pari traktat që i kornizon në mënyrë të qartë ndarjen e kompetencave mes BE-së dhe vendeve anëtare.

Kategorizimi i kompetencave nga Traktati i Lisbonës është i një rëndësie fundamentale, sepse përcakton ndikimin e tyre dhe ndarjen e pushtetit midis BE-së dhe Shteteve Anëtare. Më sipër trajtuam kompetencat ekskluzive dhe të përbashkëta, duke analizuar dhe nga një fushë për secilën nga këto kategori, përkatësisht PPT dhe politikën e zhvillimit, bashkëpunimi teknik dhe ndihma humanitare. PPT-ja si politikë ekskluzive e BE-së ka kaluar një tranzicion të gjatë të mbushur nga praktikat e GJED-së, por të suksesshëm. Politika e zhvillimit, bashkëpunimit teknik dhe ndihma humanitare klasifikohet në listën e kompetencave të përbashkëta të BE-së, duke lejuar Shtetet Anëtare, të ruajnë kompetencat e tyre të jashtme, por dhe duke i penguar që të ndërmarrin politika të jashtme që bien ndesh me BE-në, në këtë fushë. Kalimi i kompetencave nga Shtetet Anëtare të BE-ja është bërë për shkak të rrezikut që paraqisnin kompetencat konkurruese ndaj besimit reciprok brënda BE-së dhe të BE-së ndaj shteteve anëtare, dhe në këtë mënyrë edhe ndaj koherencës dhe efektivitetit për mbrojtjen e interesave të Bashkimit Evropian kundrejt shteteve joaëtare. Me themelimin e Traktatit të Lisbonës, PPJS-ja mbeti përsëri si shtyllë e dytë, por arriti disa stade, shkallë më të larta të zhvillimit duke filluar që BE-ja të marrë përgjegjësi më të mëdha se sa deri para Traktatit të Lisbonës. Vendimmarrja në këtë fushë vazhdon të jetë më tepër ndërqeveritare dhe më pak mbikombëtare, në krahasim me fushat e tjera të Bashkimit. Perderisa Traktati nuk specifikon se çfarë lloj kompetencash zbatohen në kuadrin e PPJS-së, kjo politikë sot, për nga forma e funksionimit, përbën një sfidë të vërtetë të politikës botërore.

Bibliografia

- Barone. A. (2004). *Le Politiche dell'Unione Europea*, Padova
- Bindi, F. (2010). *Politikat e jashtme të Bashkimit Evropian*. Virginia: THE BROOKINGS INSTITUTION.
- Buonanno, L. & Nugent, N. (2013). *Politikat dhe proceset e politikave të Bashkimit Evropian*. Prishtinë: UNIVERSUM PRESS.
- Canaj, E. & Bana, S. (2010). *E Drejta e Bashkimit Evropian-i azhurnuar me Traktatin e Lisbonës*. Tiranë: ARBËRIA 07.
- Canaj, E. & Bana, S. (2011). *E Drejta e Bashkimit Evropian*. Tiranë: ARBËRIA 07.
- Conforti. B. (2010), *Diritto istituzionale*, Editoriale Scientifica

- Craig, P. & De Burca, G. (2013). *E drejta e Bashkimit Evropian*. Tiranë: AIIS.
- D'Arcy, F. (2007). *Politikat e Bashkimit Evropian*. Tiranë: PAPIRUS.
- Daci, A. (2011). *Europa në mardhëniet ndërkombëtare*. Tiranë: JULVIN II.
- De Baere. G. (2008), *Constitutional Principles of EU Relations*. Oxford
- Nugent, N. (2012) *Qeverisja dhe politika e Bashkimit Evropian*
- Jacque, J. (2010). *E drejta institucionale e Bashkimit Evropian*. Tiranë: PAPIRUS.
- Paul, J. (2008). *Politika e jashtme e BE-së pas Lisbonës*. Minhen: CAP.
- Reka, B. & Höll, O. & Sela, Y. (2010). *Institucionet dhe Politika e Unionit Evropian*. Tetovë: ARBËRIA DESIGN.
- Smith, S. & Hadfield, A. & Dunne, T. (2012). *Politika e Jashtme*. Tiranë: AIIS.

Amerikanizimi i fushatës elektorale në Shqipëri

Rrezart LAHI¹

Abstrakt. *Një debat që përsëritet prej vitesh në Shqipëri gjatë periudhave zgjedhore ka të bëjë me “amerikanizimin” e fushatave elektorale. Spotet elektorale po fokusohen tek individët duke lene ne hije identitetin e partive politike. Ky studim analizon rolin e teknikave të marketingut politik gjatë zgjedhjeve të 2013-es. Te dhenat tregojne qarte per tendenca te qarta personalizimi, qendërzim te medias, reklamat negative fokusohen kryesisht në sulmin ndaj individit dhe jo tek debatet ceshtje te caktuara. Spotet synojnë të bëjnë të kënaqur votues që përfaqësojnë një grupe të ngushta interesi, karakteristike tipike e “shkencezimit” apo “amerikanizimit” të fushatave elektorale.*

Fjalë kyçe: *Komunikim politik, fushate elektorale, zgjedhje Shqiperi, spote elektorale*

¹ * Pedagog në Departamentin e Shkencave Politike pranë Universitetit të Tiranës. Ai ka studiuar për Komunikim Politik në Universitetin e Amsterdamsit dhe Gazetari pranë Universitetit të Tiranës.

Hyrje

Një debat që përsëritet prej vitesh në Shqipëri gjatë periudhave zgjedhore ka të bëjë me “Amerikanizimin” e fushatave elektorale. Personalizimi i reklamave politike duke u fokusuar më shumë tek individet sesa tek partitë, shpesh mund të konsiderohet si efekt i “Amerikanizimit”. Kjo gjë evidentohet jo vetëm tek ato sisteme politike që janë të bazuara tek individ (tipi i zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës) por edhe në fushata elektorale ku fitorja vjen nga votat për partinë. Për pasojë nuk është surprizë që përqendrimi tek imazhi është bërë temë qëndrore e shumë studimeve të komunikimit politik. Fushatat elektorale në vende demokratike po ngjajnë gjithnjë e më tepër pavarësisht ndryshimeve që ndajnë shtetet në vlera, histori dhe perceptim të demokracisë (Doolan, 2009).

Por a është “Amerikanizimi” thjeshtë personalizim i fushatave elektorale dhe a ka ndryshim mes kaheve politike në përdorimin e këtij fenomeni? A mund të testohen shkencërisht teknikat elektorale amerikane dhe a sjell një frymë personalizimi, modernizimi i politikës, shoqërisë dhe media? Per t’i dhënë përgjigje të gjitha këtyre dilemave të shekullit të ri teknologjik ne do të identifikojmë teknikat elektorale të “Amerikanizimit” dhe të ndërtojmë një proces metodologjik për matjen e tij në kontestin shqiptar përmes spoteve elektorale.

Studimi do të analizoje spotet elektorale të fushatave elektorale të vitit 2013 në Shqipëri. Përmes një studimi sasior ne kemi si qëllim të zbulojmë përdorimin e reklamave negative dhe nëse sulmi bëhet individual apo mbi idete, prezencën e liderit në raport me partinë që përfaqëson dhe sa përshtatej strategjia e reklamave elektorale me temat e sondazheve parazgjedhore.

Përgjatë këtij artikulli do kuptojmë që se teknikat e “Amerikanizimit” nuk janë me thjeshtë metoda të importuara nga SHBA por “modernizim” i fushatave elektorale që vijnë si ndryshim i brendshëm dhe i vazhdueshëm i medias, teknologjisë dhe shoqërisë në vetvete. Është me rëndësi të kuptohet se autori nuk kërkon të vijëzohet përfundime në debatin rreth “Amerikanizimit” por të sjellë një tjetër kontribut mbi këtë çështje duke analizuar fushatën elektorale në Shqipëri nën këtë prespektive. Matja e “Amerikanizimit” është një sfidë e vështirë por përsëritja e disa studimeve mbi këto baza kanë ndërtuar një model akademik që i shërben studiuesve dhe eksperteve të fushatave elektorale.

Baza teorike

Ndër studimet më të rëndësishme lidhur me “Amerikanizimin” e fushatave është ai i Fritz Plasser (2002) ku pas intervistave me 502 këshilltarë politikë del në përfundim se 84 përqind e tyre rrefyesh se vitet e fundit teknikat elektorale kanë ndryshuar rrenjësisht. Duke qënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës

janë identifikuar si vendi i origjinës së pjesës më të madhe të këtyre teknikave elektorale, ky fenomen gjeti vend në gjuhën akademike me termin “Amerikanizim” (Norris, 2004). Më tej Sëanson dhe Mancini (2004) gëjojnë se ky term më tepër duhet të jetë si hipotezë dhe pikë reference sesa si përfundim, duke patur parasysh vështirësinë për të përcaktuar kufijtë e këtij fenomeni.

Pedagogu i Universitetit të Innsbruck-ut, Plasser (2002) argumenton se këto teknika janë të orientuara drejt marketingut politik, pra testim i tregut dhe përshtatje e strategjisë në varesi se çfarë kërkon audienca. Ai shprehet se “Amerikanizimi” shihet si sinonim i modernizimit dhe profesionalizmit. Ky proces transformon formacionet politike, mediat dhe vetë elektoratin (Plasser, 2002). Edhe autorë të tjerë të rëndësishëm të fushës si Blumler et al (1996) apo Scammell (1998) i konsiderojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës si një model që ndiqet në formën e teknikave elektorale.

Gjithsesi, “Amerikanizimi” elektoral përmes teknikave të marketingut nuk është kudo i njëjtë. Plasser (2002) bën një dallim rrënjësor mes modelit të “shopping-ut” dhe atij të “përshtatjes”. I pari ka të bëjë me importimin e teknikave të kombinuara me kontekstin lokal ku zhvillohet fushata elektorale. Ky model është edhe më i përshtatshëm për rastin e Shqipërisë ku përshtatja tranzicionin nga fushatat amatore tek ato me profesionale. Nga ana tjetër, modeli “i përshtatjes” lidhet me tendencat e ekspertëve ndërkombëtarë për të vënë në jetë strategji tipike amerikane. Akademikët argumentojnë se zbatimi i këtyre teknikave bëhet duke injoruar edhe programet ideologjike (Plasser, 2002). Gjithçka në këto aksioma të gatshme fillon me përqendrimin deri në fiksime tek imazhi i kandidatit, marketingun për target-grupet, zhvillimin strategjik të produktit (në këtë rast politikani-lider) dhe reklamimin negativ (Plasser, 2002).

Fuqizimi i figurave politike individuale përtej autoritetit të partive politike përbën një aspekt të rëndësishëm të politikës së mediatizuar. Modernizimi dhe i ashtuquajturit amerikanizim i procesit politik, sidomos në periudhat zgjedhesh elektorale vlerësohet si një trend i ri komunikimi politik. Për shumë studiues, ky zgjerim shpjegohet me fuqizimin gjithnjë e më rritje të sistemeve mediatike. Praktika të tilla, si përzgjedhja e kandidatëve për shkak të imazhit tërheqës që ata projektojnë në TV ose mbështetja tek ekspertët e marrëdhënieve me publikun që këshillojnë kandidatët në lidhje me strategjitë mediatike, janë prezente në shumë vende.

Sipas ekspertëve të komunikimit politik (Blumer dhe Kavanagh, 1999 ; Scammell, 1995) amerikanizimi i procesit politik, sidomos në periudha zgjedhesh elektorale shihet si një trend i ri komunikimi politik edhe për vendet ish – komuniste. Në këtë valë të re komunikimi, personalizimi shndërrohet në një tipar themelor të media – politikës bashkohore dhe pamja vizuale e liderve politik përbën një aspekt të rëndësishëm të saj. Nga ana tjetër, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron media vetë politikanët bëjnë përpjekje maksimale për të tërhequr emocionet e

publikut. Për këtë arsye Axford dhe Huggins (2001) venë theksin tek rëndësia e përllogaritjes së emocioneve që frymëzojnë jetën politike. Përmes projekteve emocionale, politikanët organizojnë emocionet që duan të përfaqësojnë.

Mediatizimi i politikës

Sikurse shpjegon Eric Louë, mediatizimi i politikës i cili është përhapur pothuajse në të gjitha vendet demokratike, i referohet ndërfutjes së mediave në domenin politik. Kjo dukuri ka prekur edhe Shqipërinë. Natyra e fushatës elektorale në skenën tonë politike nuk është gjë tjetër veçse produkt i ndikimeve të kompanive të marketingut që projektojnë tipin e fushatës. Numri në rritje e kompanive apo ekspertëve të huaj dhe vendas që kontrahohen për organizimin e fushatës elektorale nga partitë të ndryshme shqiptare e fakton më së mirë këtë gjë. Në thelb të këtij transformimi, qëndrojnë proceset e ndërlydhura të rënies së rëndësisë së strukturave të partive politike, si institucione përfaqësimi, karriere dhe politik-bërjeje, si dhe forcimi i rolit dhe ndikimit politik të mediave dhe bizneseve të caktuara që i mbështesin ato.

Blendi Kajsiu në 2009 argumentonte se nevoja për të joshur masën e elektoratit që nuk përfshihej përmes militantizmit solli si domosdoshmëri ndërveprimin me mediat. Nga ky buron sipas Kajsiut (2009) edhe roli në rritje i medias në politikë. Nderveprimi tashmë kaq aktiv i medias në politikë, ka zbehur rolin e strukturave partiake. Karriera brenda njesive të partisë shpesh është zëvendësuar me karrierën mediatike. Përgjatë fushatave politike ka më pak trokitje në derë dhe me shumë filmime të gatshme.

Nga Amerikanizim në modernizim

“Amerikanizimi” u pa si një thjeshtëzim i tepërt për të argumentuar ndryshimet e përgjithshme në fushatat elektorale pasi duheshin patur parasysh edhe natyra e sistemit elektoral, rregullat lokale për konkurrencën elektorale apo edhe sistemin kombëtar mediatik (Doolan, 2009). Për këtë arsye u propozua termi “modernizim” i fushatave elektorale që sipas Sëanson dhe Mancini (1996) është më i përgjithshëm. Këta dy autorë sugjerojnë se teoria e modernizimit lidhet me ndryshimet strukturore në nivel makro (media, teknologjia dhe struktura shoqërore) që sjellin një tjetër model sjelljeje në nivel mikro (gazetare, kandidatë dhe parti politike).

David Kavanagh (1995) shpjegon se këto ndryshime strukturore përçojnë një stil tjetër në strategjitë tradicionale të komunikimit politik. Për më tepër, akademike të spoteve politike theksojnë faktin se “Amerikanizimi” ka ndryshuar në “Modernizim” që nënkupton profesionalizimin e fushatave si pasojë e ndryshimeve në politikë, media dhe shoqëri dhe jo si një kopjim i thjeshtë i teknikave elektorale amerikane

(Holtz - Bacha, (2004). Sëanson dhe Mancini (1996), argumentuan se globalizimi i medias nuk ka të bëjë vetëm me shpërndarjen ndërkombëtare të tyre por edhe përthithjen dhe zhdukjen e diferencave të komunikimit masiv në vende të ndryshme.

Pra debati mbi zhvillimin e komunikimit politik ndahet në konceptin e parë mbi importimin e teknikave amerikane dhe në konceptin e dytë mbi zhvillimin në kulturën politike, mediat dhe shoqëritë e këtyre vendeve.

Karakteristikat kryesore

Milly Doolan (2009) ka përmbledhur karakteristikat e “Amerikanizimit” të fushatave që kanë të bëjnë me: personalizimin, qëndrueshmërinë e medias, profesionalizimin, marketingun politik dhe politikën që përmbledhin gjithçka. Një ndër veçoritë e kesaj teknike lidhet me rrëshqitjen nga pikepamjet ideologjike në një rrugë më pragmatiste rreth strategjive elektorale (Swanson & Mancini, 1996). Në këtë mënyrë përfshihen interesat dhe kërkesat e grupeve të ndryshme të interesit ku madje përmbledhen alternativa kontradiktore ideologjike, duke nxitur konsensusin në ditët elektorale (Swanson & Mancini, 1996). Konkretisht gjatë fushatës elektorale të 2013, Partia Socialiste si parti e majtë doli në mbështetje të ish-të persektuarve të komunizmit apo ish-pronarve; grupe interesi dhe është tipikisht të djathta

Nisur nga logjika e *homo economicus* ku oferta më e leverdishme është më e preferuara i detyron partitë politike, të majtë dhe të djathtë, të fokusohen në çështje të përbashkëta. Bazuar thellësisht mbi marketingun politik një pjesë e madhe e partive nisur nga logjika e maksimizimit të elektoratit fokusohen tek çështje të ngjashme që e shqetëson këtë të fundit si: punesimi, cmimet apo pagat. Duke u larguar nga identiteti partiak dhe duke u bërë më gjithëpërfshirës, pavaresisht filozofive politike, sjell edhe uljen e rëndësisë së partive duke rritur rolin e liderit dhe imazhit të tij (Doolan, 2009). Personalizimi i politikës, është një ndër veçoritë kryesore të këtij fenomeni, ku zgjedhja e votës lidhet ngushtë me marrëdhënien e votuesit me kandidatin (Swanson & Mancini, 1996).

Nga ana tjetër, partitë politike, në mënyrë që të tërheqin vëmendjen e medias, duhet të prodhojnë lidere karizmatikë. Duke qënë në qendër të medias (media centricity) këta lidere mund shkëmbejnë pushtetin dhe influencën me partinë që përfaqësojnë, një nevojë e ndërsjelltë për të fituar vëmendjen e medias (Doolan, 2009). Kalimi nga perplasjet elektorale të tribunave dekada me parë në kryesisht spektakle mediatike me regji të mirefillte nevojën për ekspertë të medias për menaxhimin e fushatës elektorale, gjë që nxiti “shkencëzimin e politikës” (scientificization) (Swanson & Mancini, 1996). Kjo lidhet me ndërtimin e strategjive dhe mesazheve politike duke e bërë fushatën edhe më profesionale.

Ndërtimi i strategjisë shpesh vjen pasi ka hyrë në lojë marketingu politik i cili mat kërkesat, nevojat dhe pritshmëritë e publikut, duke identifikuar votuesit e

targetuar, dhe duke përdorur burimet e fushatës për ti bindur ata (Scammell, 1998). Ashtu siç ndodh në marketingun e biznesit, votuesit shihen si klientë që duhen kenaqur në mënyrë që të blejnë produktin tënd. Marketingu politik solli rritjen e sondazheve apo fokus-grupeve në mënyrë që kandidatët të gjenin pozicionimin e tyre mes votueseve potenciale dhe kundërshtarëve politikë (Scammell, 1998).

Për ta konkretizuar këtë element teorik, ky studim do të analizojë edhe përshtatshmërinë e sondazheve para-elektorale me strategjinë e komunikimit përmes spoteve elektorale. IPR Marketing beri ndër sondazhet e vetme para se të fillonte fushata dhe solli në vëmendje kërkesat e publikut që qëndruan të njëjta edhe në sondazhet pasuese. Nder problemet kryesore që votuesit ngrenin ishin punësimi, rritja e pagave dhe cmimet e larta. Duke marrë vetëm këto dy elementë studimi do të krahasojë përmbajtjen e spoteve të fushatës se 2013 ne duam të kuptojmë nëse metodat e “modernizimit” të fushatave elektorale kanë prekur edhe zgjedhjet në Shqipëri. Mbështetur tek qasjet teorike të përmendura mbi përshtatjen e shpejtë të vendeve në zhvillim me teknikën e “shopping” studimi sjell mbi hipotezat se:

H1. Fushata elektorale në Shqipëri i është përshtatur teknikave të “Amerikanizimit”.

Ha. Spotet elektorale fokusohen më tepër tek lideri sesa partia.

Hb. Spotet nxjerrin në pah cilësi të liderit.

Hc. Fushata mbështet çështje të parashikuara në sondazhet parazgjedhore.

Hd. Partite politike mbështesin çështje përtej filozofise të tyre politike.

He. Spotet negative janë të fokusuar më shumë tek kundërshtari politik sesa tek partia e tij.

Metodologjia

Ky studim analizon mënyrën sesi janë ndërtuar reklamat elektorale të dy partive kryesore në Shqipëri, Partisë Demokratike dhe asaj Socialiste. Kodi i pyetjeve është marrë i gatshëm nga një studim i mëparshëm i vetë autorit mbi karakteristikat e spoteve elektorale. Pyetsori për nxjerrjen e të dhenave në SPSS, ka të bëjë me kohën e qëndrimit të liderit përkatës në ekran gjatë një reklame politike, sa herë është përmendur emri i tij, sa herë është përmendur emri i partisë që ai përfaqëson, sa herë është shfaqur logo e partisë, si janë reklamat negative apo pozitive dhe nëse sulmi ndaj kundërshtarit politik është personal apo lidhet me idetë që ai prezanton.

Përzgjedhja

Ky studim do të analizojë fushatën elektorale në Shqipëri për shkak të njohurisë së mirë të autorit të vendit, gjuhës dhe eksperiencës në hartimin e spoteve elektorale. Janë përzgjedhur spotet e dy partive për tu analizuar, Partisë Demokratike dhe

Partisë Socialiste. Kjo për shkak se këto janë dy partitë më të medha politike për nga numri I deputeteve dhe vototave gjatë dy dekadave të fundit. Një tjetër shkak që u zgjodhën është se këto dy parti zëjnë hapësirën kryesore të reklamave politike gjatë fushatave elektorale.

Në këtë investigim janë përfshirë të gjitha reklamat e publikuara në mediat kombetare dhe në faqet e tyre zyrtare në rrjetin social “Facebook” dhe “You Tube” të lidhura me faqet online ëëë.pd.al dhe ëëë.ps.al. Në total partia demokratike ka publikuar 20 reklama elektorale ndërsa partia socialiste 16 të tilla. Si kriter për përzgjedhjen e spoteve ishte që të ishin publikuar gjatë 30 ditëve të fushatës elektorale dhe të kishin një gjatësi jo më shumë se 3 minuta.

Studimi

Ha. Spotet elektorale fokusohen më tepër tek lideri sesa partia

Rezultat tregojnë se kemi një fokusim të lartë dhe domethënës tek lideri ndërkohë që partitë lihen më në hije. Me e dukshme kjo është tek partia socialiste e cila në të paktën 50 përqind të reklamave flitet për liderin duke anashkaluar partinë. Për më tepër tek të gjithë reklamat e PS shfaqet jo më shumë se një sekondë ndryshe nga lideri që përveç përmendjes së emrit shfaqet vetë fizikisht. Edhe pse në nivele më të moderuara kryetari i partisë demokratike përmendet I pari dhe më shumë se partia që përfaqëson. Emri i kreut të PD-së, Berisha është prezent në 40 përqind të spoteve. Gjithsesi spotet të djathtës lenë një kohë me të gjatë të logos së partisë në rreth 1.5 sekonda.

Hb. Spotet nxjerrin në pah cilësi të liderit

Vetëm një në pesë spote vlerëson edhe aftësitë e liderit. Strategjet elektorale të PS-së kanë zgjedhur të përmendin cilësitë e liderit Rama në 25 përqind të reklamave ndërsa Berisha në 15 përqind. Gjithsesi liderët përmenden më shpesh duke dhënë argumentin se janë zgjidhja e vetme me e mirë krahasuar me kundërshtarin.

Hc. Fushata mbështet çështje të parashikuara në sondazhet parazgjedhore

Gjatë analizës së spoteve shihet qartë që kërkesat e publikut dhe reklamat politike shkojnë në një kah. 66% përqind e spoteve flasin për punësimin, pagat dhe cmimet, çështje të cilat janë edhe në krye të kërkesave të votuesve. Në disa spote nuk flitet për këto çështje pasi janë spote negative që sulmojnë kundërshtarin politik.

Qartësisht pothuajse e gjithë strategjia elektorale ngjan e vendosur mbi kërkesat e publikut dhe ka një përshtatshmëri të lartë dhe domethënëse. Vetëm pak spote të PD-së flasin për internetin apo barazine gjinore, apo arritje në infrastrukturë, shkaqe që nuk ishin në krye të listës të shqetësimeve të votuesve.

Hd. Partite politike mbështesin çështje përtej filozofise të tyre politike

Edhe pse gjatë fushatës elektorale të majtët përkrahën edhe ish-të përndjekurit politik të komunizimit apo ish-pronarët spotet elektorale nuk tregojnë asnjë mbështetje të çështjeve përtej filozofisë politike. Përkundrazi kjo ishte një ndër fushata e para politike kur ndasitë politike prodhuan edhe program konkrete siç ishte debate mbi taksën e sheshtë të demokrateve dhe taksën progresive që mbështesnin socialistët.

He. Spotet negative janë të fokusuara më shumë tek kundërshtari politik sesa tek partia e tij

Çdo fushatë elektorale ka një element shumë të rendësishëm siç përballja mediatike me kundërshtarin. Në Shqipëri vihet re një nivel domethënës i reklamave negative. Partitë politike kanë zgjedhur të sulmojnë kundërshtarin personalisht dhe jo për idetë e tij. Pra një ndër pesë spote të demokrateve ka të bejë me Edi Ramën dhe jo me programin politik të partisë socialiste. Ndërsa socialistet reklamën negative e kanë mbizotëruese. Një në dy reklama PS sulmon Berishën për paaftësinë e tij për të qeverisur (56%). Edhe socialistët nuk sulmojnë partinë demokratike por thjeshtë liderin e saj duke personalizuar akuzat me Berishën.

Përfundime

Ky studim ekzaminoi “modernizimin” apo Amerikanizimin e fushatës elektorale në Shqipëri. Rezultatet treguan flasin qartë për një fushatë me personalizim të skajshëm, qendërim te medias, profesionalizem dhe marketing politik. Siç thamë më lart një element i “modernizimit” është dhe përfshirja e “politikave që përmbledhin gjithçka. Strategët e fushatës së PD-së kishin krijuar nga një spot kushtuar temave të ndryshme si turizmit, zhvillimit rural, shkollat, interneti, bujqësia ndërsa PS ishte mbështetur tek individët ku i kishte kushtuar reklama të rinjeve, pensionisteve, mesuesve, sportistëve apo fermerëve.

Rezultatet treguan se komunikimi politik është direkt mes liderit dhe publikut duke anashkaluar rolin e partisë. Në mënyrë më të moderuar paraqiteshin cilësitë e liderit ndërsa reklamën negative sulmonin personalisht kundërshtarin dhe jo idetë e tij politike. Elementi i vënë re më qartë gjatë këtij studimi ishte përshtatshmëria e temave të reklamave politike dhe tre problemeve kryesore të evidentuara nga sondazhet parazgjedhore. Gjithësesi temat e trajtuara ishin brenda filozofise së tyre politike.

Lideri i PS, Rama, është shfaqur më shumë në spotet elektorale sesa Berisha ndërsa PD ka mbështetur fushatën më shumë mbi arritjet dhe ka parashtruar idene e vazhdimësisë. Ashtu si në shumë fushata të tilla me teknikat e “Amerikanizimit” opozita sfiduese tenton të mbushë votuesit me shprese për një fillim të ri në rimekembjen e vendit, ndërsa pozita thekson arritjet dhe nxit vazhdimësinë

e projekteve. Në të dyja partitë politike këshillimi ndërkombëtar ka qënë nga kompani të mirënjohura për fushatat e tyre nën stilin “amerikan”.

Në përfundim, teknikat e “modernizimit”, “shkencëzimit” apo “amerikanizimit” të fushatës janë evidente në pjesën më të madhe të komunikimit. Ky studim mbështet aspektet teorike të trajtuara më sipër për të gjithë taktikat elektorale për një fushatë të mediatizuar, të matur përmes teknikave të marketingut politik dhe rritjes së kultit të individit duke lënë më në hije bashkëpunëtorët e liderve politikë.

Bibliografia

- Axford, B. & Huggins, R (2001). *New Media and Politics*, London: Sage.
- Blumler, J. G., Kavanagh, D. and Nossiter, T. C. (1996). “Modern Communications versus Traditional Politics in Britain: Unstable Marriage of Convenience.” In *Politics, Media, and Modern Democracy. An International Study of Innovations in Electoral Campaigning and Their Consequences*, ed. David L. Swanson and Paolo Mancini. Westport, Conn.: Praeger.
- Blummer, J. G., & Gurevitch, M. (1995). *The Crisis of Public Communication*. New York: Routledge.
- Doolan, M. A. (2009). Exploring the ‘Americanization’ of political campaigns, *Media@ LSE, London School of Economics and Political Science*.
- Holtz - Bacha, C. (2004). Political Campaign Communication: Conditional Convergence of Modern Media Elections. In Esser, F. and Pfetsch, B. (Eds.) *Comparing Political Communication*. (pp. 213 - 230) Cambridge: Cambridge University Press.
- Kajsiu, B. (2009). Amerikanizimi i politikës ose rreziku i politikës mediatike, Tirane; *Polis*.
- Louw, E. (2005). *The Media and Political Process*, London; Sage.
- Norris, P. (2004). *Political Communications and Democratic Politics*. In Plasser, F. (2002). “American Campaign Techniques Worldwide”, *Safundi*, 3: 1, 1 — 20
- Scammell, M (1995). “Great Britain; Politics and Government; 1979-1997; Campaign management; Electioneering; Elections”. New York: Macmillan.
- Scammell, M. (1998). “The Wisdom of the War Room: U.S. Campaigning and Americanization.” *Media, Culture, and Society* 20, no. 3, 251-75.
- Swanson, D. and Mancini, P. (1996). Patterns of Modern Electoral Campaigning and Their Consequences . In Swanson, D. and Mancini, P. (Eds.). *Politics, Media, and Modern Democracy* (pp. 247- 276). London: Praeger.
- Swanson, D. (2004). Transnational Trends in Political Communication: Conventional Vieës and New Realities. In Esser, F. and Pfetsch, B. (Eds.) *Comparing Political Communication*. (pp. 45 -64). Cambridge: Cambridge University Press.

Transformimet gjuhësore morfologjike dhe sintaksore, një domosdoshmëri në komunikimin mes dy identiteteve të ndryshëm

Holta HEBA

Abstrakt. Argumenti thelbësor i këtij punimi identifikohet me faktin se, përkthyesi i gjendur përballë një mosidentiteti material gjuhësor dhe kulturor arrin ta përcjellë mesazhin me kuptim vetëm nëpërmjet transformimeve gjuhësore dhe kulturore si dhe dualitetit besnikëri/liri. Këto të fundit bëhen të domosdoshme dhe shmangin papërkthyeshmërinë e mesazhit. Qëllimi kryesor i këtij studimi është analiza e detajuar e shembujve që nxirren nga krabasimi dhe vërejtja e disa koncepteve të përkthyer në disa fabula nga gjuha frënge në gjuhën shqipe, të cilët transformohen nga ana morfologjike dhe sintaksore. Punimi kërkon t'i përgjigjet pyetjes se "A ndikon transformimi gjuhësor në përcjelljen e saktë të mesazhit gjatë përkthimit?" Në këtë punim do të vërtetohet se sa ruhet kuptimi i mesazhit nga transformimet gjuhësore që ndodhin nga kalimi i një gjuhe-burim tek një gjuhë-shenjë.

Hyrje

Transformimet gjuhësore që analizohen në këtë krahasim tekstesh janë: transformimi morfologjik dhe sintaksor. Komunikimi ndërmjet dy vendeve që nuk flasin të njëjtën gjuhë arrihet vetëm atëherë kur kuptimi i gjuhës-burim gjen vend edhe në gjuhën-shenjë. Përkthyesi nuk mund të përkthejë fjalë për fjalë, si pasojë në disa raste ai është i detyruar të transformojë në gjuhësi dhe kulturë. Transformimet në strukturën gjuhësore mund të shkelen deri në atë masë që e lejojnë rregullat e gjuhës.

Çështja kryesore që lidhet me komunikimin është përcjellja e saktë e mesazhit me kuptimin e duhur. Një fjalë, shprehje, apo fjali nuk do të kishte kuptim nëse nuk do të strukturohej sipas sistemit të brendshëm të gjuhës dhe nuk do të ishte semantikisht e saktë. *“Të përkthesh do të thotë të kuptosh sistemin e brendshëm të një gjuhe dhe strukturën e një teksti të caktuar në atë gjuhë dhe të ndërtohet një sistem të dyfishtë tekstori”* (Eco, 2006: 17).

Sistemi i dyfishtë tekstori i krijuar nga përkthyesi duhet të shkaktojë pasojë të ngjashme tek marrësi i gjuhës shenjë si në planin semantik e sintaksor ashtu edhe në atë stilistikor. Mesazhi i gjuhës burim duhet të jetë i pandryshueshëm kur arrin në gjuhën shenjë. Ajo që të bie më shumë në sy gjatë krahasimit të teksteve është se përkthyesi V. Kokona, gjatë përkthimit të fabulave ka përdorur një përkthim të lirë artistik. Ai bën interpretimin e tij personal të kuptimit të tekstit origjinal dhe i lejon vetes disa manipulime fantaziste. Si gjithë përkthyesit që kërkojnë të ruajnë kuptimin e një mesazhi edhe Kokona duket se interesohet më shumë për përshtypjen e publikut se sa për besnikërinë ndaj tekstit fillestar. Në përkthimin e një fabule interpretimi personal nuk është i ndaluar, sikurse mund të ndodhë te librat e shenjës. E rëndësishme është që të respektohet ajo që ka dashur të thotë autori i gjuhës-burim, si dhe kontratat gjuhësore të po kësaj gjuhe. Gjuha që përdoret në fabulë është një gjuhë poetike. *Për të kuptuar gjuhën poetike duhen vlerësuar 4 aspekte: forma metrike dhe ritmi, figurat retorike të kuptimit, strukturat sintaksore dhe lidhjet morfo-sintaksore* (Varfi, 1999:156).

Në përputhje me teorinë interpretative të kuptimit shihet përçimi i mesazhit nga frengjishtja në shqip, nëpërmjet transformimeve që realizohen gjatë përkthimit. Përkthyesi është i vetëdijshëm se, për të siguruar kuptimin e fjalëve duhet gjetur ekuivalenca\korrespondenca e duhur, në mënyrë që mesazhi i gjuhës-burim të korrespondojë me mesazhin e gjuhës-shenjë.

Në analizën e studimit do të vërtetohet se si shkaktohen transformimet në gjuhësi kur kalohet nga njëra gjuhë te tjetra. Analiza bëhet për të vëzhguar qëllimin e këtyre transformimeve, të cilat lidhen drejtpërdrejt me kuptimin e mesazhit.

Transformimet morfologjike

“Morfologjia është formimi i fjalëve dhe formave të ndryshme që pësojnë këto fjalë në fjalë” (Robert, 1970:114). Morfologjia e fjalëve është një aspekt shumë i rëndësishëm për formimin e fjalive, të cilat na lejojnë të shprehemi. Si degë e gjuhësisë, ajo merret me studimin që marrin fjalët e lakueshme (emri) dhe fjalët e zgjedhueshme (folja). Fjala duhet të jetë e formuar mirë morfologjikisht, në mënyrë që të plotësojë parametrat gjuhësorë të duhur, duke dhënë kështu një fjalë të saktë dhe të kuptueshme. Në përkthimin e fabulave vihen re shumë transformime morfologjike, të cilat ndodhin si pasojë e përshtatjes së fjalës në fjalë dhe në rimën e fabulës.

1. Për shembull: folja në kohën e kryer të përbërë “ayant chanté” (vargu 1, faqe 13) në gjuhën shqipe është shqipëruar “si këndo” (lidhës + folje në të shkuarën e thjeshtë). Përkthyesi është i detyruar që të bëjë transformime morfologjike në mënyrë që të formojë fjalë dhe mesazhe të sakta sipas parametrave të gjuhës shenjë.

2. Transformim morfologjik: nga emër në trajtën e shquar në emër + përemër dëftor. Fjala “Le loup” (vargu 3, faqe 15) në frengjisht shfaqet si emër në trajtën e shquar, por përkthyesi nuk e përkthen si emër në trajtën e shquar, por i shton fjalës në trajtën e pashquar përemrin dëftor “ky”.

3. E njëjta gjë vihet re edhe te përkthimi i fjalës “l’éléphant” (vargu 16, faqe 18), që në shqip përkthehet me përemër dëftor (ky) + emrin (elefant), ky elefant. Transformim morfologjik: (nga numri shumë në numrin njëjës).

4. Në fabulën “Ujku dhe qeni” (faqe 28), në vargun 27-të rrethanori i vendit “au fond des forêts” përkthehet në shqip “në pyll thellë”. Në gjuhën frënge rrethanori i vendit është në numrin shumë, kurse në gjuhën shqipe ka kaluar në numrin njëjës.

5. “À l’empire des morts” është një sintagmë, që gjendet në vargun e fundit të fabulës “Vdekja dhe druvari”. Fjala “des morts”, është në numrin shumë në gjuhën-burim, por kur kalon në gjuhën shenjë, ajo kthehet në njëjës: “në mbretërinë “e vdekjes”.

Arsyet e transformimeve morfologjike gjatë kalimit nga njëra gjuhë tek tjetra janë të shumta, por ajo më kryesorja lidhet direkt me ardhjen e konceptit me kuptim. Përshtatja e fjalës, togfjalëshit apo vetë konceptit me parametrat e gjuhës dhe kulturës pritëse është tepër e domosdoshme nëse duam të ruajmë kuptimin e vetë konceptit. Ngjyrimet stilistike në gjininë e fabulës janë një nga arsyet pse përkthimi i saj është tepër i lirë. Ruajtja e rimës përgjatë gjithë fabulës kërkon nga përkthyesi që fjalët të transformohen edhe morfologjikisht. Bagazhi konjitiv i secilit nga përkthyesit i ndihmon ato të luajnë me fjalët në fabulë, por sigurisht duke ruajtur kuptimin dhe duke bërë përpjekjet maksimale që një kod lingistik i gjuhës dhe kulturës burim të vijë sa më i perceptueshëm dhe i saktë në gjuhën dhe kulturën shenjë.

Shembuj të tillë mund të gjejmë pa fund në këtë krahasim tekstesh. Vlen për

t'u theksuar fakti se, gjatë krahasimit të fabulave shfaqen shumë transformime morfologjike, por në një farë mënyre, ato bëhen gati të domosdoshëm dhe të dobishëm në përcimin e mesazhit. Kuptimi nuk çenohet në rastet kur përkthyesi luan me formën e fjalëve. Pak rëndësi ka nëse emri në gjuhën-burim kthehet në folje në gjuhën-shenjë. E rëndësishme është të ruhet kuptimi brenda gjithë parametrave gjuhësorë të gjuhës-shenjë. Mesazhi në gjuhën-shenjë ka ardhur me kuptim dhe është bërë një zgjedhje e lirë e formës së fjalës dhe kjo është arritur me anë të këtij lloji transformimi gjuhësor. Popuj të ndryshëm nga njëri-tjetri kanë identitetet gjuhësor të ndryshëm.

Transformimet morfologjike nuk çenojnë përcimin e mesazhit me kuptim. Përkundrazi ndihmojnë në përcjelljen e saktë të tij kur flitet për dy gjuhë dhe dy kultura me identitete të ndryshëm.

Transformimet sintaksore

Sintaksa është pjesë përbërëse e gramatikës dhe merret me studimin e funksioneve të fjalës. Morfologjia trajton formën e fjalës, kurse sintaksa studion funksionin e saj. *Sintaksa merret me bashkimin e fjalëve në togje dhe togjeve në fjali* (Demiraj, 1995:31). Është një aspekt i rëndësishëm kryesor, sepse nëpërmjet sintaksës bëhet i mundur ndërtimi i fjalive në një gjuhë. Sigurisht që çdo gjuhë ka rregullat e saj sintaksore. Sintaksa në fabul është e një lloji të veçantë, ndryshe quhet: Sintaksa poetike, e cila është = një ndërtim i posaçëm i fjalisë, e cila shërben për t'i dhënë fuqi dhe gjallëri shprehjes.

Është e ditur se shumë fjali të një gjuhe shprehen në forma të ndryshme në një gjuhë tjetër. Ajo që është e rëndësishme për këtë studim lidhet me kuptimin e mesazhit të shprehur. Në krahasimin e teksteve është e qartë se ndërtimi i fjalisë në gjuhën-burim ndryshon nga ndërtimi i fjalisë në gjuhën-shenjë. Kuptimi është thelbësor për transferimin e mesazhit nga një gjuhë në tjetrën dhe duhet të mbetet i pandryshuar, kurse ngjyrimet sintaksore dhe stilistikore të secilit nga ndërtimet e dy gjuhëve mund të jenë të ndryshëm.

Shembull: 1. Në fabulën "Vdekja dhe druvari", vargu "À charger ces bois; tu ne tarderas guere" (vargu 16, faqe30) është shqipëruar me një transformim sintaksor të dukshëm. Përkthimi fjalë për fjalë i këtij vargu është: "Të ngarkosh këtë barrë; nuk do të vonosh". Në këtë mënyrë nuk realizohet kuptimi i saktë i vargut. Në tekstin shqip ky varg është transformuar nga ana sintaksore dhe është krijuar fjalia: "barrën për ta ngarkuar, se s'mund i gjori plak" (Kokona, vargu 16, faqe 31). Gjithashtu në këtë version shqip është shtuar dhe lidhëza "se", e cila ndihmon në realizimin e fjalisë fthilluese. "Të më ndich të ngarkoj drutë" (Çajupi, vargu 10, faqe 30). Në versionin frengjisht, vargu fillon me folje që pasohet me përcaktorin, kurse në versionin shqip të Kokonës, vargu fillon me emër në rasën kallëzore. Në

versionin e Çajupit vargu fillon me folje dhe është shkruar në një të vetëm me ndihmën e dy kallëzuesëve të njëpasnjëshëm

2. "La cigale, ayant chanté tout l'été" (vargu 1, faqe 12) është një fjali dëftore në versionin frengjisht, që gjendet te fabula "Gjinkalla dhe milingona". Në versionin shqip të Kokonës ky varg shqipërohet në një fjali fthilluese. Folja në kohën e kryer të përbërë, kthehet në kohën e kryer të thjeshtë dhe fjalia fillon me lidhëzën "si", e cila para foljes këndoi realizon fjalinë fthilluese. "Si këndoi gjinkallë e marrë, gjithë beharë". Në këtë varg është shtuar edhe mbiemri "e marrë", po kjo gjë është realizuar për efekt të ruajtjes së rimës. Me interes për momentin është transformimi sintaksor i vargut. Në versionin e Çajupit vihet re përdorimi i formës përcjellore të foljes " Gjithë beharë e shkoi duke kënduar" (vargu 2/3, faqe 5).

3. "Cette félicité par un lievre troubleé, Fit qu'au seigneur du bourg notre home se plagnait" (vargu 11, 12, faqe 58). Vargjet e mësipërme gjenden te fabula "Kopshtari dhe senjori i tij". Në krahasimin e këtyre dy vargjeve me gjuhën-shenjë, vihet re se në gjuhën-shenjë fjalia kthehet në fjali të nënrenditur shkakore: "meqë një lepur lumturinë ia prishte fort këtij të shkretit vendos e shkon për t'u ankuar te senjori i qytetit". Rendi i fjalëve ka ndryshuar plotësisht nga ai i gjuhës-burim. Fjalia nuk fillon më me një emër të ndihmuar nga një përcaktor, por nga një lidhëz shkakore dhe vargu i dytë është tërësisht në një rend tjetër, ku folja nuk qëndron në fund të fjalisë, por në fillim të vargut të dytë. Në përkthimin e Çajupit këto vargje janë thjeshtëzuar vetëm në një varg të vetëm "ngrihet në mëngjes, te pashai vete qahet" (vargu 11/12, faqe 117). Në rikrijimin e idesë, Çajupi është disi më larg fjalëve të përdorura gjatë përkthimit të fabulës.

4. "C'est sur nous qu'il fond sa cuisine" (vargu 14, faqe 86) është versioni frengjisht në fabulën: "Gjeli i vogël, maçoku dhe koçomiu". Përkthimi fjalë për fjalë i këtij vargu është " Është mbi ne që ai bazon kuzhinën". Është më se e qartë se vargu i përkthyer në këtë mënyrë nuk sjell kuptim të saktë dhe fjalia nuk është e strukturuar mirë nga ana gramatikore, që të ndihmojë në nxjerrjen e kuptimit. Në versionin frengjisht ky varg gjendet i shqipëruar në këtë mënyrë: "na ka vënë në shënjestër". Në këtë rast, përveç transformimit sintaksor, gjendemi dhe përballë një transformimi leksikor. Kuptimi i vargut lidhet me faktin se maçja e ka miun si ushqim parësor, por ky fakt është shprehur në mënyra të ndryshme në të dy versionet. Edhe në një version të tretë të Çajupit, duket qartë se Maçja ushqehet me minj e është armik për këta të fundit. "Mach-ziu, bir ha mish nga miu" (vargu 1 faqe 169).

5. Po teke njëta fabul vargu i parafundit (faqe 87), që në versionin frengjisht është "Garde-toi, tant que vivras", shqipërohet: "Mos u gabo, gjersa të rrosh". Përkthimi i foljes "garde-toi" është: "ruaju", mirëpo përkthyesi ka zgjedhur të përdorë foljen "gabo", duke shtuar dhe pjesëzën e mohores "mos". Fjalia në frengjisht dëftore, kur kalon në gjuhën shqipe, kthehet në fjali mohore. Transformimi sintaksor

ka ndihmuar në përcjelljen e kuptimit. Këtë thënie në fund të fabulës, Çajupi e përkthen me një fjali të vetme që qëndron shumë pranë kuptimit parësor “fytyra nuk ka besë” (vargu 3, faqe 169).

Shembujt e mësipërm flasin qartë se sa i nevojshëm dhe i pashmangshëm është transformimi sintaksor në kalimin nga njëra gjuhë në tjetrën, sidomos kur flitet për gjininë e fabulës, e cila duke qenë një gjini letrare kërkon një liri në përkthim, për sa i përket sintaksës poetike. Sintaksa poetike është shumë e përdorur në këtë gjini dhe përkthimi fjalë për fjalë bëhet gati i pamundur, pasi rrezikohet rima e vargjeve të fabulës.

Transformimet gjuhësorë të trajtuar në këtë studim janë një tregues i qartë i një mosidentiteti gjuhësor. Dy kombe kanë kod gjuhësor të ndryshëm nga njëri-tjetri. Ata mund të kenë afinitete me njëri-tjetrin, por kodin material gjuhësor nuk mund ta kenë të përbashkët. Si pasojë, përkthyesi i gjendur përballë këtij mosidentiteti gjuhësor, arrin të përshtatë nëpërmjet transformimeve specifike gjuhësore gjithë mesazhin që duhet të përçohet nga gjuha-burim në gjuhën shenjë. Shembujt e mësipërm janë disa mënyra të këtij kalimi.

Përfundime

Ruajtja e kuptimit shkakton transformime gjuhësore, të cilat ndodh që bëhen të domosdoshme për një përçim sa më të drejtë të mesazhit. Thelbi i një komunikimi të realizuar mes dy, apo më shumë vendeve me gjuhë dhe kultura të ndryshme është përkthimi.

Një njeri që nuk e njeh gjuhën dhe kulturën e huaj, ka nevojë të mbështetet dhe të krijojë besim te përkthyesi, i cili përkthen, transformon, zhvesh dhe vesh me parametra gjuhësorë e kulturorë mesazhin, si dhe e përgatit atë për t’u perceptuar nga lexuesi i huaj. Të gjitha këto i bën vetëm për të ruajtur atë që zë dhe vendin parësor në komunikim ndërmjet kulturave, kuptimin.

Përkthimi mbetet ura lidhëse ndërmjet dy, apo më shumë vendeve që nuk flasin të njëjtën gjuhë dhe që kanë kultura, zakone dhe tradita të ndryshme. Mesazhi është element thelbësor i komunikimit. Një mesazh i përkthyer mirë, është komunikim i realizuar dhe produktiv. Produktiviteti lidhet me realizimin e përfundimit të kuptimit nga njëra gjuhë në tjetrën dhe nga njëra kulturë në tjetrën. Rrekja për të ruajtur kuptimin në një proces të tillë, siç është kalimi nga njëra gjuhë në tjetrën, shkakton transformime gjuhësore.

Në një proces përkthimi, aty ku ekziston kuptimi, ekziston edhe shkëmbimi i ideve, traditave, zakoneve dhe kulturave të vendeve të ndryshme: “I lindur nga marrëdhëniet shoqërore komunikimi formon, mban dhe transformon marrëdhënien” (Meunier & Peraya 2009 : 271). Në këtë rast përkthimi është ai që bën të mundur marrëdhënien midis Francës dhe Shqipërisë. Për të arritur cilësinë

e kuptimit, përkthyesi nuk i ka qëndruar besnik kodit material të gjuhës-burim, si pasojë ai e ka kaluar mesazhin në gjuhën-shenjë, duke e veshur atë me parametrat e kësaj gjuhe.

Bibliografia

- Kokona, V. (2005). *La Fonten, Fabula të zgjedhura*. Tiranë: Botimet Kokona.
Eco, U. (2006). *Të thuash gati të njëjtën gjë. Përvoja përkthimi*. Tiranë: Dituria.
Dibra, K. & Varfi, N (1999) *Gjuhësi teksti*. Tiranë: Botimet e Librit Universitar.
Demiraj, Sh. (1995). *Gramatika e Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH.
Robert, P. (1970). *Dictionnaire Petit Robert*. Paris: Societé du nouveau Littre.
Meunier, J. & Peraya, (2009) *Hyrje në teoritë e komunikimit*. Tiranë, QSSHE.

Roli i të tretit ndërmjetësues në zgjidhjen e konflikteve jashtëgjyqësore

Erjona CANAJ, Ph.D

MSc. Emiliano ALIU

Abstrakt: Zgjidhja gjyqësore, e cila konsiderohet si e vetmja formë e mundshme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në disa raste i ka lënë vendin disa rregullave të tjera ligjore për zgjidhjen e konflikteve. Një nga këto është dhe ndërmjetësimi, veprimtari jashtëgjyqësore në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjans (ndërmjetësit) për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin. Ndërmjetësimi ka qenë përherë i pranishëm në shoqërinë shqiptare si në të drejtën zakonore, fetare apo atë pozitive, ku gjejmë modele/shembuj të shumtë tradicionalë të zbatimit të metodave pajtuese e ndërmjetësuese. Alternativa e ndërmjetësimit paraqet interes edhe në ditët e sotme në konfliktet me natyrë familjare, civile, tregtare dhe penale. Një rol të veçantë në këtë institut ka edhe i tretë-ndërmjetësues, personi i zgjedhur me detyrën t’u ofrojë palëve një mekanizëm transparent, më të shpejtë e më pak të kushtueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tyre. Roli kryesor i të tretit të paanshëm është t’i nxisë palët të arrijnë në një diskutim konstruktiv mbi komponentët e ndryshëm të mosmarrëveshjes, duke krijuar kushte optimale për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit. Rezultatet në këto vitet e fundit, edhe pse nuk janë shumë të kënaqshme, tregojnë gjithsesi për një proces në rritje dhe për një konsolidim të mëtejshëm të këtij instituti. Qëllimi i këtij punimi është, në thelb, studimi i rolit dhe i funksionit të ndërmjetësuesit, evolucioni i kësaj figure në kohë në vendin tonë, si dhe trajtimi i ndërhyrjes së palës së tretë neutrale në zgjidhjen e konflikteve me metodat e reja dhe bashkëkohore. Nga ana tjetër, ky punim kërkon të sjellë në vëmendje një alternative të re dhe bashkëkohore punësimi, pasi në rolin e ndërmjetësit mund ta shohin veten edhe të rinjtë, që kanë kryer programe të studimeve të ciklit të parë, pasi të kenë mbushur moshën 25 vjeç, si mundësi të ushtrimit të një profesioni të lirë: ndërmjetës.

Fjalët kyçe: Ndërmjetësim, ndërmjetësues, zgjidhje konflikti, ligji i ri i ndërmjetësimit, ndërmjetësi familjar, civil, tregtar dhe penal.

Hyrje: Rëndësia e studimit të institutit të ndërmjetësimit dhe figurës së ndërmjetësit

Ritmi i shpejtë i ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike në vendin tonë, në këto vitet e fundit, është karakterizuar përgjithësisht nga rritja e numrit të konflikteve, të cilët janë një realitet pothuajse i përditshëm dhe ndërmjetësimi i tyre nuk është vetëm një sfidë gjyqësore, por edhe shoqërore. Në konfliktet me natyrë civile, familjare ose tregtare, zgjidhja gjyqësore, e cila konsiderohej si e vetmja formë e mundshme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, i ka lënë në disa raste vendin disa rregullave të tjera ligjore për zgjidhje. Nga ana tjetër, mosmarrëveshjet e shumta, që vihen re në jetën e përditshme, kanë kohë që i vënë institucionet e drejtësisë përballë shumë vështirësive. Si shkak i rritjes së numrit të çështjeve dhe pamundësisë së zgjidhjes në kohë të tyre, institucionet e drejtësisë dhe të shoqërisë civile janë vënë në lëvizje për të gjetur zgjidhje alternative. Një nga këto është dhe ndërmjetësimi, një veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjans, *ndërmjetësit*, për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin. Si zgjidhje jashtëgjyqësore e çështjeve, alternativa e ndërmjetësimit paraqet shumë interes jo vetëm në konfliktet me natyrë familjare dhe civile, por në këto vitet e fundit edhe në ato me natyrë tregtare. Ndërmjetësimi u ofron palëve një mekanizëm më të shpejtë, më pak të kushtueshëm dhe më transparent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tyre. Ndërmjetësimi ka qenë përherë i pranishëm në shoqërinë shqiptare si në të drejtën zakonore, fetare apo atë pozitive, ku gjejmë shembuj të shumtë tradicionalë të zbatimit të metodave pajtuese e ndërmjetësuese. Avantazhet që ofron kjo alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore, kalvari i gjatë i pritjeve nëpër dyert e gjykatave dhe zvarritjet e shumta të seancave gjyqësore, ka bërë që palët në konflikt t'i drejtohen sot institutit të ndërmjetësimit (Andoni, 2012). Alternativa e ndërmjetësimit paraqet interes në ditët e sotme në konfliktet me natyrë familjare, civile, tregtare dhe penale dhe pikërisht kjo është arsyeja që ky institut të studiohet, të silltet në vëmendjen e lexuesit si dhe të rivlerësohet me qëllim aplikimin e suksesshëm të tij.

Ndërmjetësimi si një mundësi bashkëkohore e zgjidhjes së konfliktit. Ligji i ri i ndërmjetësimit

Zgjidhja e çështjeve civile, tregtare, penale, familjare etj., me marrëveshje është e njohur në legjislationin vendas e atë ndërkombëtar në fuqi dhe njihet si zgjidhje jashtëgjyqësore (Keka, 2005). Nëpërmjet ndërmjetësimit palët kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes, por që nuk bie në kundërshtim me ligjin në fuqi. Po ashtu, procesi ndërmjetësues

u jep mundësinë palëve që të jenë vetë ata të cilët vendosin për kushtet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

Në historinë e vendit tonë ndërmjetësimi si mënyrë për zgjidhjen e konflikteve nuk është një institucion i ri. Ndërmjetësimi ka qenë përherë i pranishëm në shoqërinë shqiptare. Në të drejtën zakonore, fetare apo pozitive, gjejmë modele e shembuj të shumtë tradicionalë të zbatimit të metodave pajtuese e ndërmjetësuese. Në kontekstin shqiptar, instituti i ndërmjetësimit e gjen zanafillën tek e drejta zakonore shqiptare, e cila është pjesë e një sistemi juridik të pashkruar. Ky sistem i përcaktonte ndërmjetësit të drejta dhe detyrime të cilat janë të sanksionuara sipas kësaj së drejte. Në të drejtën zakonore ndërmjetësimin e gjejmë të sanksionuar në Kanunin e Lekë Dukagjinit, ku në paragrafin 668 dhe në paragrafin 682 ai trajtohet si alternativë e zgjidhjes së konflikteve. Kanuni konfliktet dhe problemet shoqërore i rregullonte me anë të figurave të tilla si pleqnia (*me karakter gjyqi*), dorëzanët e gjakut (*bestari*), pajtimi, ku si ndërmjetës ka qenë edhe ai që *“ka hypër me da fjalët e kqia”*, më pas prifti si ndërmjetësues në emër të *“Famullis a nëmër të flamurit”*. Mund të përmendim gjithashtu rolin e veçantë që kanë luajtur pleqtë dhe gjyqi i pleqve, por edhe kuvendi që gjykonte në raste të veçanta, të cilët përpara se të gjykonin çështjen e paraqitur bënë të gjitha përpjekjet për pajtim. Këtë rol të këtyre institucioneve zakonore e ka huazuar herë pas here edhe e drejta shtetërore deri në ditët tona. Gjykatat e fshatit dhe të lagjeve, të njohura edhe si gjykata shoqërore të krijuara qysh më vitin 1968, e madje të njohura si hallka përbërëse të sistemit gjyqësor, gjykonin çështje të një rëndësie të vogël, të cilët me të marrë kërkesën duhet të bënin të gjitha përpjekjet për pajtim të palëve në konflikt (Mandro, 2008). Në dhjetor të vitit 1995, me iniciativën e një grupi specialistësh të drejtësisë, sociologjisë dhe kulturës, për herë të parë në Shqipëri është ngritur dhe institucionalizuar *“Fondacioni i Pajtimeve të Mosmarrëveshjeve”*. Përpjekjet e këtij fondacioni si edhe klima e re legjislativë e pas viteve '90 në Shqipëri, kanë bërë që ndërmjetësimi si alternativë e zgjidhjes së konflikteve të jetë i përfshirë në kodet dhe në akte ligjore.

Eksperiencia e parë me një ligj të posaçëm të ndërmjetësimit përkon me Ligjin nr. 8465, datë 11.3.1999, *“Për ndërmjetësimin për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve”*, i cili, në fakt, nuk parashikonte ndërmjetësimin si alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare. Ky problem u zgjidh me Ligjin nr. 9090, datë 26.06.2003, *“Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”*, i cili shfuqizoi të mëparshmin dhe me të cilin është përfshirë ndërmjetësimi si alternativë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare. Por, ky ligj nuk zgjidhte të tërë hallkën e këtij institucioni dhe pikërisht mbi këtë bazë dhe në kuadër të planit kombëtar për zbatimin e MSA-së (2007 - 2012), më 24.2.2011, Ligji nr. 10835 *“Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”* e shfuqizoi këtë të fundit, pasi nuk ka qenë efektiv në përdorimin e tij shtatëvjeçar. Ligji në fuqi nr.10835 i vitit

2011 është pjesë përbërëse e reformave në kuadër të përafrimit të legjislacionit të Shqipërisë me atë të BE-së dhe erdhi edhe si pasojë e kërkesës së vazhdueshme të shoqërisë civile, por edhe të vetë ekspertëve të huaj që të rregullojë si duhet veprimtarinë e ndërmjetësimit. Ky ligj, i hartuar në përputhje me direktivën 2008/52/KE të BE-së dhe me Kodin Etik European të Ndërmjetësit, e sanksionon ndërmjetësimin si një veprimtari të pavarur jashtëgjyqësore, që ndërmerret vullnetarisht nga palët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre. Mosmarrëveshjet mes palëve, me natyrë tregtare dhe civile, me Ligjin aktual nr.10385, mund të zgjidhen pa shkuar në gjykatë. Në këtë ligj është parashikuar që një ndërmjetësues i licencuar mund të mbyllë pretendimet mes palëve në konflikt, si dhe të gjithë veprimtarinë e ndërmjetësimit dhe procedurat për kryerjen e procesit.

Qëllimi i ligjvënësimit në Ligjin nr.10385 për ndërmjetësimin, është që të shkarkojë gjykatat civile nga një mbingarkesë e çështjeve të këtij lloji me anë të procesit të ndërmjetësimit të detyruar duke siguruar zgjidhje të shpejtë, fleksibilitet të procedimit, konfidencialitet, kursim dhe transparencë të tarifave, stimulime fiskale, profesionalizëm dhe seriozitet të agjencive dhe të ndërmjetësve. Kjo ka vlerë të veçantë sidomos në mosmarrëveshjet me natyrë tregtare, ku kërkohet një zgjidhje e shpejtë, fleksibilitet në procedim, konfidencialitet dhe mbi të gjitha një klimë besimi dhe vazhdimësie të marrëdhënieve të palëve në proces.

Ndërmjetësimi ka qenë edhe përpara se ligji ta bënte të detyrueshme për rastet që përfshijnë çështje të caktuara, por në vendin tonë nuk ka pasur sukses të madh për shkak të një njohjeje të dobët të institutit nga ana e palëve ndërgjyqëse, dhe nga mungesa e besimit që i linte në dorë një pale tjetër zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ligjvënësi me reformën e ndërmjetësimit ka vendosur një palë të tretë, të paanshme dhe pa ndonjë fuqi vendimmarrëse dhe gjykuese, me detyrën që t'i vendosë palët përballë njëri-tjetrit dhe do të jenë vetë ata që do të gjejnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre (ndërmjetësimi lehtësues), ose të pranojnë propozimin e ndërmjetësit për një marrëveshje (ndërmjetësimi vlerësues): pa dyshim që njëra zgjidhje ose tjetra duhet të ketë pëlqimin e të dyja palëve që të jetë efektive dhe detyruese.

Roli, profili dhe metodologjia e ndërmjetësit shqiptar

Roli kryesor i të tretit të paanshëm është t'i nxisë palët të arrijnë në një diskutim konstruktiv mbi komponentët e ndryshëm të mosmarrëveshjes, duke krijuar kushte optimale për trajtimin e konfliktit nga një këndvështrim tjetër. Në qoftë se në përfundim të kësaj, palët arrijnë një marrëveshje, rezultati me siguri do të jetë ai më optimal, por në çdo rast, para se të marrin pjesë në proces, si ndërmjetësi ashtu edhe palët, duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për mundësinë që mund t'i japin fund edhe pa marrëveshje. Edhe pse shumë ndërmjetësime përfundojnë pa marrëveshje,

arrijnë të hapin dritare të reja nëpërmjet të cilave palët rinisin dialogun, kjo sepse ndërhyrja e palës së tretë neutrale favorizon një kuptim më të mirë të aspekteve të vërteta të mosmarrëveshjes. Përpjekja për ndërmjetësim përbën një angazhim të mënyrave dhe nuk mund të garantojë rezultate të veçanta, prandaj, parametrat e vlerësimit duhet të përqendrohen në mënyrën sesi është kryer procedura.

Ndërmjetësi nuk është një palë e tretë gjykuese; ai nuk ofron këshilla dhe teknika ligjore, e as nuk vendos mosmarrëveshje në bazë të meritave. Si rrjedhojë, ndërmjetësi nuk mund të garantojë arritjen e një marrëveshjeje. Ai ka një detyrim metodologjia edhe jo rezultati. Kjo do të thotë që ai ka një funksion udhëheqës në procedurë, duke identifikuar pikat që formojnë të ashtuquajturën “harta e konfliktit”, lehtëson komunikimin dhe negociimin mes palëve, aplikon teknikat e tij të procedurës së zgjidhjes, inkurajon pjesëmarrjen e palëve në mënyrë të drejtë dhe lejon që secili prej tyre të shprehet lirshëm, në mbrojtje të interesave të tyre, pa cenuar ato të të tjerëve. Gjithçka është e realizueshme, vetëm nëse krijohet një klimë respekti reciprok dhe një urë lidhjeje komunikimi efektiv ndërmjet palëve dhe mes tyre e ndërmjetësit. Angazhimi i ndërmjetësit konsiston në një ndërveprim të vazhdueshëm me palët, që nga momenti i parë i ndërhyrjes së tij e deri në përfundim të procedurës. Objektivi i tij kryesor është ajo që të ndihmojë palët për t'u përballur me konfliktin nga një perspektivë tjetër, përmes analizës së komponentëve të tij të ndryshëm.

Kushtet që duhet të plotësojë një person për të ushtruar profesionin si ndërmjetës janë parashikuar në Ligjin nr.10385. Ky ligj, si në parim ashtu edhe në përmbajtje, është në përputhje të plotë me legjislacionin European si dhe me Kodin Etik European të Ndërmjetësit. Me këtë ligj, shtetasi shqiptar ose i huaj, që dëshiron të ushtrojë profesionin e ndërmjetësit, duhet të përmbushë njëkohësisht disa kushte të sanksionuara shprehimisht në nenin 2 të ligjit në fjalë: të ketë kryer programe të studimeve të ciklit të parë; të ketë mbushur moshën 25 vjeç; të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të veprave penale; të ketë përfunduar programin e trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DKN), si dhe të jetë i licencuar dhe i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve. Aktualisht, janë mbi 70 ndërmjetësit e regjistruar në DNK. Ndryshe nga ligji i mëparshëm i viti 2003, ligji aktual parashikon gjithë procedurën për ngritjen e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve (KLN), mënyrën e marrjes së licencës, regjistrimin e personit që kryen një aktivitet të tillë, kushtet që duhet të plotësojë një person për të punuar ndërmjetës, rastet kur i hiqet licenca e personit që bën ndërmjetësimin si dhe ngritjen e DKN-së. Po ashtu, në ligjin e ri të 2011-ës ndërmjetësit që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të shpërblehen për punën si dhe për shpenzimet e kryera në procedurën e ndërmjetësimit, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim të nënshkruar me palët.

Teknikat, të cilave duhet t'i referohet ndërmjetësi, mund të grupohen në tri kategori: *Teknikat procedurale*, që kanë të bëjnë me çështje të tilla si, përcaktimi i agjendës për trajtimin e çështjeve, përcaktimi i mënyrës më të përshtatshme për ndërmjetësim, përcaktimi i kohës së seancave individuale dhe të përbashkëta. Ndërmjetësi duhet t'i shpjegojë palëve që nga momenti i parë se nuk do të marrë asnjë vendim në lidhje me mënyrën me të cilën do të zgjidhet mosmarrëveshja dhe se i takon atij të përcaktojë dhe të kujdeset për aspektet procedurale dhe rregullat. *Teknikat komunikuese* i përmbahen procedurave të hartuara për të mbajtur kanalet e komunikimit të hapura, duke i ndihmuar palët në sqarimin e çështjeve dhe t'i lejojë që të mund të dëgjojnë njëri-tjetrin për të kuptuar interesat e tyre, duke siguruar në të njëjtën kohë, një hapësirë në të cilën secili ka të drejtë të shpreh ndjenjat e tij, të gjenerojë empati dhe të krijojë klimën e besimit të nevojshëm për negociata bashkëpunuese. *Teknikat e konsiderueshme* kanë të bëjnë me qartësimin e çështjeve dhe të interesave të palëve mbi bazën e kriterëve objektive, për t'i ndihmuar në gjenerimin e alternativave të ndryshme, bazë mbi të cilën do të strukturohet marrëveshja. Për këtë motiv, kompetencat e kërkuara nga ndërmjetësi janë të përfaqësuar nga njohjet teorike dhe aftësitë ose kapaciteti (Bush & Folger, 1994).

Ndërmjetësi duhet t'i shpjegojë palëve që në fillim qëllimin e ndërmjetësimit në mënyrë të qartë, sepse në qoftë se nuk e bën, palët mund ta konsiderojnë se qëllimi i vetëm i ndërmjetësimit është ai që të arrijnë një marrëveshje, ndoshta edhe me frikën që mund t'i serviret një zgjidhje e padobishme për ta. Pasi nuk ekzistojnë dy ndërmjetësime të njëjta, ndërmjetësi duhet të jetë në gjendje që të përshtatë çdo herë skemën dhe procedurën pajtuese me veçantinë e mosmarrëveshjes dhe me llojin e konfliktit, duke planifikuar që nga fillimi dhe gjatë gjithë ecurisë së ndërmjetësimit veprimin më të përshtatshëm për menaxhimin e situatave konkrete. Përveç teknikave dhe metodave të përdorura, ndërmjetësimi sjell një mënyrë të ndryshme të të menduarit, një përjasje krijuese që lejon pjesëmarrjen aktive të palëve në bashkëndërtimin e zgjidhjes. Ky sistem i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sjell me vete një respekt të thellë për njerëzit, bazuar në etikën ndaj së cilës duhet të frymëzohen veprimet e ndërmjetësit dhe avokatëve që ndihmojnë palët (Acland Floyer, 1993).

Ndërmjetësit në ushtrimin e kësaj veprimtarie kanë të drejtë të shpërblehen për punën dhe për shpenzimet e kryera, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim të nënshkruar me palët, si dhe duhet të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin profesional. Personi i licencuar nuk ofron këshillim ligjor, dhe nuk ka përgjegjësi nëse ndërmjet palëve për zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim nuk arrihet marrëveshje, si dhe në ato raste kur arrijnë një marrëveshje ai nuk mban përgjegjësi për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje. Në mbyllje të procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi njofton gjykatën, prokurorinë ose arbitrazhin me qëllim fillimin e procedurave të pezulluara për efekt të ndërmjetësimit.

Llojet e ndërmjetësve sipas fushave të veprimit të tyre

Gama e çështjeve që mund të ndërmjetësohet është tejet e gjerë. Ndërmjetësimi, zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, familjare, të punës dhe ato penale. Në këto të fundit është fjala për çështjet që shqyrtohen nga gjykata, me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit. Alternativa e ndërmjetësimit paraqet shumë interes edhe në konfliktet civile dhe këto vitet e fundit është shtrirë edhe për çështjet tregtare. Për këtë Ligji i ri nr.10385, datë 24.2.2011, "*Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*" e parashikon ndërmjetësimin tregtar si një alternativë për zgjidhjen e konflikteve jo vetëm dhe thjesht të natyrës personale, por edhe pasurore dhe në ndryshim nga ligji i mëparshëm, ligji i ri i rendit edhe në fushën tregtare: në këtë mënyrë këto çështje nuk janë vetëm ekskluzivitet i arbitrazhit si alternativë jashtëgjyqësore. Palët në këtë proces vendosen në pozita të barabarta dhe procedura zhvillohet në mënyrë të tillë që të sigurojë trajtimin e njëjtë të tyre, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, si ato ligjore ashtu edhe ato njerëzore, sociale, psikologjike, etj., ndërkohë që tërësia e të dhënave dhe rrethanave, në lidhje me procedurat e ndërmjetësimit, është konfidenciale.

Ndërmjetësi familjar

Ndërmjetësimi familjar është një mënyrë zgjidhjeje e konflikteve familjare pa iu drejtuar gjykatës, si për shembull, një ndarje, ku gjatë procesit të ndërmjetësimit çiftet ndihmohen të shohin alternativa të ndryshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre. Gjithashtu, ndërmjetësimi familjar tashmë po përdoret për të zgjidhur dhe llojet e tjera të problemeve familjare, si: mosmarrëveshjet mes fëmijës dhe prindit, mosmarrëveshjet për kujdesin për të moshuarit apo të afërmit e sëmurë, kontaktet mes gjyshërve dhe nipërve dhe mungesa e strehimit e shkaktuar nga konfliktet familjare. Gjatë këtij procesi ndërmjetësimi, palët shpjegojnë shqetësimet dhe nevojat që kanë në prani të një mediatori familjar të kualifikuar, ku ndërmjetësi është i paanshëm dhe nuk mban anën e askujt, por i ndihmon palët, ndryshe nga një avokat i cili punon vetëm për njërin palë. Ndonjëherë ndërmjetësi dhe mund të sugjerojë një mënyrë për zgjidhjen e konfliktit, kjo gjithmonë për t'i ndihmuar palët të arrijnë një marrëveshje të pranueshme për të dyja, por kurrë nuk u dikton palëve se çfarë duhet të bëjnë. Të pranosh ndërmjetësim familjar do të thotë të lejosh, siç e kemi parë, transformimin e një situatë konfliktuale, emocionale dhe financiare, në një situatë bashkëpunimi të vërtetë, me të gjitha përfitimet pasuese.

Teknikat dhe mënyrat e ndërhyrjes së ndërmjetësve janë të ndryshme si dhe të përshtatura sipas ndjeshmërisë të secilit ndërmjetës dhe sipas nevojave të çështjes konkrete. Sesionet e ndërmjetësimit realizohen me praninë e të dyja palëve (p.sh. bashkëshortëve) në një hapësirë, ku edhe pse i nënshtrohen rregullave të caktuara,

rezulton të jetë vendi ku asnjë nuk duhet të ketë frikë dhe të ndihet i lirë për të shprehur jo vetëm mendimet, por edhe dëshirat që me ndihmën e ndërmjetësit propozohen në një mënyrë me të vërtetë të kuptueshme për njëri-tjetrin. Përmes pyetjeve të synuara ndërmjetësi mund të përqendrojë frikën dhe ankthet e bashkëshortëve, gatishmëritë e tyre për t'u ndihmuar, mbi të gjitha, për të komunikuar midis tyre; ku në vazhdim të fillojnë të angazhohen në përpjekjet e caktuara për të vlerësuar, madje edhe në anën praktike, vlefshmërinë e marrëveshjeve të pjesëshme, ku seance pas seance merren nga bashkëshortët. Në seancat e ndërmjetësimit janë palët ata që vendosin dhe jo ndërmjetësi. Këta të fundit, në fakt, kufizohen në krijimin e kushteve për të gjetur disa pika të përbashkëta. Përdorimi i mjeteve objektive, të tilla si, për shembull, i një table me fleta të lëvizshme, rezultojnë të dobishme për t'i dhënë një mundësi çifteve në vëzhgimin e situatës me sy tjetër, atë çfarë ndodh apo atë që duan, atë se çfarë kanë vendosur apo atë që kanë qenë, por mbi të gjitha, për të parë rezultatet që hap pas hapi arrijnë. Ndërmjetësimi jo domosdoshmërisht përjashton praninë e avokatëve gjatë ndërmjetësimit, përkundrazi, asistenca ligjore është e rekomanduar, pasi njerëzit gjejnë më shumë siguri duke u këshilluar në lidhje me marrëveshjet e arritura, siguri në mbrojtjen e të drejtave të tyre ose për paraqitjen e veprimit për ndarjen për miratimin e marrëveshjeve në fund të procesit.

Ndërmjetësi në fushën civile dhe tregtare

Ndërmjetësimi civil dhe tregtar është një proces privat dhe shmang përbashkjen me gjykatën, një proces ku palët në konflikt përpiqen të gjejnë një zgjidhje të kënaqshme ndaj nevojave dhe interesave të tyre, të ndihmuar nga një ndërmjetës, të paanshëm dhe të pranuar nga të gjitha palët, i cili synon pajtimin e palëve dhe pranimin e marrëveshjes pa penguar marrëdhëniet e tyre të ardhshme. Ky është një element i rëndësishëm dhe më se i përshtatshëm në marrëdhëniet tregtare, ku roli ekonomik luan një rol kyç. Ndërmjetësimi civil dhe tregtar është frymëzuar nga vendet anglo-saksone dhe, në veçanti, nga Shtetet e Bashkuara, ku kjo teknikë ka pasur sukses të konsiderueshëm dhe është integruar plotësisht në kontekstin tregtar të evoluar dhe që njihet me emrit *business oriented*– biznes i orientuar.

Ndërmjetësimi, përveç zgjidhjes konsensuale të konfliktit, i ndihmon palët të arrijnë zgjidhje funksionale, të cilat të jenë në të mirë të interesit të tyre të përbashkët, të redukojë konfliktualitetin, të përmirësojë komunikimin si dhe të nxisë ndarjen e drejtë dhe racionale të përgjegjësive aktuale dhe të perspektivës, me një rezultat të pranueshëm dhe të pëlqyeshëm nga palët në konflikt, pra, një rezultat *“fitore-fitore”* (Mandro, 2006).

Sot, është bërë e mundur që baza ligjore, e cila ka ekzistuar edhe më parë, të rishihet në përshtatje me kohën, me legjislacionin e BE-së dhe me praktikën ndërkombëtare, për të arritur që, ndërmjetësimi të zbatohet si zgjidhje alternative e

mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës tregtare, ashtu si civile, familjare, të punës edhe në fushën penale për çështje që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankim të të dëmtuarit dhe në ato raste kur vetë ligji e lejon një gjë të tillë. Me reformën e drejtësisë, legjislatori ka bërë disa raste të detyrueshme për ndërmjetësim, përpara ngritjeve të padive të zakonshme në gjykatë, duke mos i vendosur palët përballë një rezultati të pakënaqshëm dhe ku mund ta kontrollojnë këtë të fundit nëpërmjet përgatitjes profesionale të ndërmjetësve.

Neni 2 paragrafi 4 i ligjit aktual saktëson se: “Kur vihet në lëvizje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës apo familjare, *gjykata ose organi përkatës shtetëror*, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa e kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve: a) në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve; b) në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes; c) *me karakter pasuror me objekt padie deri në 500 mijë lekë, si dhe për paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit.*”

Ndërmjetësimi bazohet në parimin e barazisë së palëve, konfidencialitetit të të dhënave, si dhe në respektimin e fleksibilitetit e të transparencës së procedurave dhe të vullnetit të palëve në proces. Ai zbatohet në rastet kur kërkohet dhe pranohet nga palët, përpara ose pas lindjes së mosmarrëveshjes, kur çmohet nga gjykata, arbitrazhi ose nga organi kompetent shtetëror, pra, ndërmjetësimi është një proces vullnetar. Nëse një palë i kërkon tjetrës ndjekjen e procedurave të ndërmjetësimit dhe kjo e dyta nuk i përgjigjet brenda 30 ditëve ftesës së bërë, kjo mund të vlerësohet si mospranim për ndërmjetësim. Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme rruga gjyqësore, nuk mund t'i drejtohen ndërmjetësimit.

Në pajtim nuk ekzistojnë skema të bazuara në arsye ose në gabim, por kërkohet që nëpërmjet koncesioneve, të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme. Pra, ndërmjetësimi është një proces në të cilin një palë e tretë e paanshme ndihmon palët e një mosmarrëveshjeje të negociojnë lidhur me marrjen e një vendimi të tyre të përbashkët. Ndërmjetësi nuk ka pushtet detyrues, nuk ka të drejtë të urdhërojë ose të detyrojë palët të pranojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes; ai nuk vepron as si gjyqtar, as si avokat ose arbitër për secilën nga palët. Ndërmjetësi nuk ka autoritetin që t'u imponojë palëve një zgjidhje, aq më tepër që diskutimet janë të karakterit konfidencial e sidomos në sektorin tregtar. Kur një person zgjidhet si ndërmjetës nga palët në mosmarrëveshje, ai duhet të deklarojë të gjitha rrethanat që mund të shkaktojnë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij. Ndërmjetësi, nëpërmjet institutit të ndërmjetësimit, (Mandro, 2006) mundëson arritjen e një marrëveshje miqësore mes palëve në konflikt, në pajtim me kërkesat ligjore për paanshmëri, konfidencialitet dhe transparencë, sepse kjo zgjidhje përbën një mekanizëm më të shpejtë, më pak të kushtueshëm dhe më transparent: mosmarrëveshja zgjidhet

shumë më shpejt se çdo rrugë tjetër; është ekonomike; çështja mbahet nën kontroll; palët edukohen me situatën ligjore, praktike dhe reale; eksplorohe në mënyrë informale disa opsione zgjidhjeje; organizohen shumë negociata gjatë një procesi; mbrohet dhe ruhet vazhdimësia e marrëdhënies.

Ndërmjetësi në fushën penale

Në legjislacionin tonë penal ka disa vepra penale të cilat mund të zgjidhen jashtë procesit gjyqësor. Në praktikën gjyqësore është vërtetuar se shumica e këtyre çështjeve është zgjidhur me pajtim. Për rastet e fyerjes, shpifjes, dhunimit të banesës, dëmtimit të shëndetit, shumica e çështjeve pushohen për shkak të pajtimit të palëve në konflikt.

Neni 2 i Ligjit nr. 10385 për ndërmjetësimin parashikon përdorimin e ndërmjetësimit në çështje të caktuara penale, respektivisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale. Sidoqoftë, Kodi i Procedurës Penale nuk specifikon kushtet për transferimin e çështjeve penale për t'u trajtuar përmes modeleve të drejtësisë restauruese. Kështu, gjithnjë sipas Kodit, gjyqtari, prokurori, apo oficeri i policisë gjyqësore nuk mund të transferojë çështje për ndërmjetësim. Për më tepër, as në rastet e të miturve, Kodi nuk përmban dispozita që të mund të bëjnë të mundur devijimin e procedimit penal dhe përdorimin e drejtësisë restauruese në raste kur mund të jetë më e dobishme përdorimi i kësaj të fundit sesa ndalimi, hetimi, apo gjykimi i një të mituri. Devijimi rekomandohet dhe në shumë instrumente ndërkombëtare për të miturit, në të cilat vendi ynë është palë (Gjoka R., 2009).

Ndërmjetësimi në fushën e konflikteve penale është më i vështirë, sepse ato shkaktojnë një dhimbje të madhe te viktimat, por shpesh edhe te vetë i akuzuari, i cili mund të ndihet i penduar për sjelljen kriminale që ka kryer (Tutulani-Semini, M., 2006).

Një rol të rëndësishëm në zbatimin e ndërmjetësimit në konfliktet penale ka luajtur sistemi gjyqësor shqiptar. Legjislacioni në këtë fushë i njeh gjykatës të drejtën dhe detyrimin për të ndërmarrë veprime në zgjidhjen e çështjeve, që parashikohen nga ligji, përmes ndërmjetësimit dhe pajtimit. Prandaj, gjykata mund ta bëjë këtë për çështje penale të cilat nuk mund të procedohen nëse nuk ka një akuzë kundër autorit të veprës penale. Duke iu referuar nenit 59 të K.Pr.Penale, një kategori e çështjeve penale, të tilla si dëmtime të tjera me dashje; plagosje e rëndë nga pakujdesia; plagosje e lehtë nga pakujdesia; dhunimi i banesës, hyrja ose qëndrimi në banesën e tjetrit pa pëlqim të tij; fyerja; fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik; shpifja; ndërhyrja e padrejtë në jetën private; përhapja e sekreteve vetjake; mosdhënia e mjeteve për jetesë; marrja e padrejtë e fëmijës, botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet, riprodhimi pa të drejtë të veprës së tjetrit dhe shkelja e paprekshmërisë së banesës. Viktima ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë

për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

Sipas K.Pr.Penale, në rastet e përmendura më lart, gjykata fton viktimën dhe të akuzuarin dhe i propozon atyre që ta zgjidhin çështjen përmes ndërmjetësimit. Nëse viktimat pranon të tërheqë padinë dhe i akuzuari e pranon këtë, gjykata vendos mbylljen e çështjes dhe palët i adresohen ndërmjetësimit. Neni 284 i K.Pr.Penale përcakton edhe rastet e veprave penale për të cilat procedimet penale janë iniciuar nga zyra e prokurorisë ose policisë gjyqësore mbi ankimin e bërë nga i dëmtuari te prokurori ose në policinë gjyqësore, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, kërkon që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si veprë penale. Gjithashtu i njihet e drejta që viktimat mund të tërheqë ankesën në çdo fazë të procedurës penale. Raste të tilla janë: plagosje të lehta nga pakujdesia, vrasje nga pakujdesia, shpifjet dhe fyerjet për shkak të detyrës, etj.

Nuk duhet lënë këtu pa u përmendur ndërmjetësimi me subjekt viktimën/autorin e veprave penale për të miturit, ku qëllimi kryesor është zbatimi i metodave alternative të ndërmjetësimit në çështjet penale me të mitur, qoftë në rolin e viktimës apo të autorit të veprës penale dhe që ka për objekt kryesor sigurimin e ndërmjetësimit për të miturit duke shmangur procedimin penal dhe duke zgjidhur rastin sipas rregullave të ndërmjetësimit me mirëkuptim nga palët e përfshira (Gjoka R., 2009).

Pra, lidhur me fushat rreth mosmarrëveshjeve ku mund të ndërmjetësohej mund të thuhet se ato janë shumë dhe vetë neni 2 i ligjit për ndërmjetësimin përcakton përveçse parimet, ashtu edhe fushat ku mund të zbatohet ndërmjetësimi. Siç e përmendëm më sipër, ndërmjetësimi ka një fushë gjithëpërfshirëse për konfliktet me natyrë familjare, civile dhe tregtare, penale dhe jo vetëm, pasi gjen zbatim edhe në fushën pronësore, të punës dhe të çështjeve me natyrë pasurore. E thënë më thjesht, ndërmjetësimi është gjithëpërfshirës. Kjo do të thotë se palët janë të hapura ta përqafojnë alternativën ndërmjetësuese si rregull, në çdo rast. Themi si rregull, sepse këtu bëjnë përjashtim vetëm ato mosmarrëveshje, që janë detyrimisht kompetencë e një organi tjetër, siç është rasti i zgjidhjes së martesës, që mund të bëhet vetëm përmes gjykatës me vendimin e saj. Kjo, nuk do të thotë, që ndërmjetësimi nuk mund të zbatohet në fazën e zgjidhjes së martesës, për të provuar pajtimin e palëve dhe vazhdimin e martesës, duke u tërhequr nga zgjidhja e saj.

Përfundime

Zgjidhja gjyqësore, e cila konsiderohej si e vetmja formë e mundshme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, i ka lënë vendin rregullave të reja dhe bashkëkohore për zgjidhjen e konflikteve, të cilat janë gjithashtu ligjore. Në vendet më të zhvilluara, kjo ka ardhur si pasojë e dobësisë së shtetit në zbatimin e ligjit, rritjes së korrupsionit në organet e drejtësisë dhe nga humbja e besimit në to, aktet e vetëgjyqësisë, etj.

Në Shqipëri, konteksti aktual bën të nevojshëm zëvendësimin e ndërmjetësimit

gjyqësor me forma më të zbutura, komunitare dhe sociale, megjithëse sërish ligjore të ndërmjetësimit. Tradita e ndërmjetësimit ka mbetur aktuale deri në ditët e sotme për disa arsye: për shkak të mosbesimit përballë sistemit gjyqësor; pranisë së korrupsionit në gjykata; për shkak se paraqitja në gjykatë e një konflikti ka mundësi të nxisë urrejtje edhe më të mëdha mes palëve; shpesh vendimet e gjykatave në aspektin juridik edhe pse kanë dhënë vendimin sipas ligjit, kanë nxitur edhe më shumë konfliktin.

Ndërmjetësimi paraqet disa avantazhe në raport me procedurat e tjera, si një proces i shpejtë, konfidencial, avantazh për të mbajtur nën kontroll kostot dhe lëshimet reciproke, premisa që palët të vazhdojnë marrëdhëniet në të ardhmen, karakteri i detyrueshëm i aktmarrëveshjes. Palët konsiderohen dhe emërtohen “palë në proces” dhe jo me termat paditës, i paditur, keqberës, dëmtues, i pandehur, të cilat krijojnë gjendje të rëndë psikologjike për palët dhe përkatësi të fajit edhe pa ekzistuar ai. Praktika ka treguar se aplikimi i këtyre formave të zgjidhjes së çështjeve me marrëveshje ka përparësitë dhe mangësitë e saj. Ndër përparësitë që vlejné të përmenden janë reduktimi i shpenzimeve dhe kohës së nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe ekzistenca e një vullneti të lirë të palëve në konflikt, që vetë ata i zgjedhin mënyrat e zgjidhjes së kontekstit dhe luajnë rol aktiv në proces në mënyrë që ato vetë të mundohen të gjejné zgjidhjen më të mirë për ta. Pala e tretë vetëm i udhëzon palët drejt zgjidhjes, por nuk ua dikton atë. Qasja konsensuale vetëm se shton gjasat se palët do t’i ruajnë marrëdhëniet e tyre pasi ta gjejné zgjidhjen, qoftë personale, qoftë ekonomike dhe kjo nënkupton mirëkuptim (Keka, 2005).

Në këto vitet e fundit, edhe pse rezultatet nuk janë shumë të kënaqshme, ato tregojné për një proces në rritje dhe në konsolidim të këtij instituti. Për të ushtruar ndërmjetësimin nevojitet aftësim profesional dhe njohja e procedurës. Në rolin e ndërmjetësit mund ta shohin veten edhe të rinjtë, të cilët duhet të kenë kryer programe të studimeve të ciklit të parë dhe pasi të kenë mbushur moshën 25 vjeç, ta shohim këtë si një mundësi të ushtrimit të një profesionit të lirë: ndërmjetës.

Nga ana tjetër njohja dhe zbatimi në praktikë i ndërmjetësimit duhet të konsiderohet akoma më shumë nga njohësit e ligjit, nga gjyqtarët, avokatët, institucionet e ndryshme të arsimit, nga pedagogët, sociologët, psikologët e të gjithë ata persona që kanë interes ta ushtrojnë këtë veprimtari interesante.

Edhe pse ndërmjetësimi është një veprimtari e pavarur, që realizohet nga persona të licencuar dhe të regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë, që garantojnë zgjidhje të pranueshme për palët dhe që nuk bien në kundërshtim me ligjin ku një vëmendje e veçantë në realitet duhet t’i kushtohet vlerësimit nga ana e shoqërisë, rolit të ndërmjetësit dhe zbatimit në praktikë të këtij instituti në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare.

Bibliografia

- Ligji nr.10385, datë 24.2.2011, *Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve*.
Ligji nr.9090, datë 26.6.2003, *Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve*.
Ligji nr.8465, datë 11.3.1999, *Për Ndërmjetësimin për Zgjidhjen me Pajtim të Mosmarrëveshjeve*. Ligji nr.7572, datë 10.6.1992, *Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal*.
Ligji nr.4406, datë 24.6.1968, *Mbi Organizimin Gjyqësor të Republikës Popullore të Shqipërisë*.
Dekreti nr.4426, datë 23.9.1968, *Mbi Gjykatat e Fshatrave, të Qyteteve dhe të Lagjeve të Qyteteve*.
VKM nr.414, datë 8.6.2011, *Vendim për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve*.
VKM nr.418, datë 8.6.2011, *Vendim për Procedurën e Heqjes së Licencës së Ndërmjetësit*.
Codice Europeo di Condotta per Mediatori, 2004.
Acland, Floyer A. (1993), *Como utilizar la mediacion para resolver conflictos en las organizaciones*, Ed. Paidós, Barcelona.
ADR Center (2011), *Guida Alla Procedura Di Mediazione*, ADR Center member of JAMS INTERNATIONAL.
Besemer C. (2007), *Mediation, Vermittlung in Konflikten*, Baden.
Bush R. & Folger J. (1994), *The Promise of Mediation: Responding to Conflict through Empowerment and Recognition*, San Francisco, Jossey-Bass.
Community Mediation (1991), *A Handbook For Practitioners And Researchers*, Guilford Publications.
Corsi M., Sirignano C. (1999), *La mediazione Familiare. Problemi, prospettive, esperienze*, Milano. Vita e Pensiero.
Emmond P., Zaka T., Zaka, Kosta & Tashko (...) *Njohje me zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve*, RISTALINA-KH.
Fisher R., Ury W.; Patton B. (2004), *Das Harvard-Konzept, Der Klassiker der Verhandlungstechnik*, Frankfurt/Main.
Folberg J. & Taylor A. (1984). *Mediation - A Comprehensive Guide to Resolving Conflicts without Litigation*, San Francisco, Jossey-Bass Publishers.
Gjoka R. (2009), *Ndërmjetësimi midis viktimës-autorit të veprës penale, Manual për punonjësin e shërbimit të provës*, OSBE, Tiranë.
Haft F. (2000), *Verhandlung und Mediation, Die Alternative zum Rechtsstreit*, München.
Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë (2002). *Fjalor i shqipes së sotme*, ASHSH, Tiranë.
Keka D. (2005), *Zgjidhja e çështjeve me marrëveshje*, në “Tribuna Juridike”, nr.57.
Konferenca Vjetore (2008), *Zgjidhjet Alternative të Mosmarrëveshjeve*, RSHSL.
Mandro A. (2006), *Alternativat e Zgjidhjes Jashtëgjyqësive të Mosmarrëveshjeve*.

- Ndërmjetësimi dhe Avantazhet e Tij*, USAID.
Sharma Daniel H. (2009), *Handbuch Mediation*, München.
Tutulani-Semini M. (2006), *Korniza Ligjore e Procesit të Ndërmjetësimit: Aktmarrëveshja e Ndërmjetësimit*, USAID.
Voka J. (2004), Mundësitë e ndërmjetësimit gjyqësor, në “*Jeta Juridike*” nr.4. Tiranë.
WerdtJ.Duss-von (2005), *Geschichte und Menschenbilder der Mediation*, Stuttgart.
WerdtJ.Duss-von (2008), *Einführung in die Mediation*, Heidelberg.

Ndikimi i zhvillimit të mardhënieve ekonomiko–shoqërore tek veshjet qytetare

Alfred NINI

Abstrakt. Studimi ka si qëllim hulumtinin e zhvillimit ekonomiko – shoqëror që ka bërë të mundur dhe ka kushtëzuar zhvillimin e veshjes qytetare Shqiptare në fund të shekullit të XIX e në fillim të shekullit të XX-të. Duke klasifikuar veshjet si një pjesë e trashgimisë materiale kulturore bëhet gjithnjë dhe më e qartë ideja që ato nuk mund të shihen të shkëputura nga mjedisi shoqëror dhe ekonomik të cilin pasqyrojnë dhe në të cilin janë përdorur dhe përgatitur. Karakterizimi i mardhënieve ekonomiko shoqërore të kohës si veprimtari shoqërore, siç ishin zejtaria dhe produktet e tyre artizanale, formën e organizimit të mjeshtrave dhe punës së zejtarëve Shqiptarë gjatë kësaj periudhe. Ky studim që ka për objekt pasqyrimin e zhvillimit ekonomiko–shoqëror tek veshjet qytetare gjatë shekullit të XIX e fillim shekullit të XX, do të shihet nëpërmjet këtyre pikave që janë: Së pari veçoritë që pasqyrojnë veshja qytetare si kulturë materiale. Së dyti organizimi esnafor si pjesë e organizimit shoqëror të kësaj kohe. Së treti qendrat tregtare qytetare si qendra të zhvillimit të këtyre mardhënieve ekonomiko shoqërore dhe së fundmi konkluzioni.

Fjalët kyçe: Veçoritë e veshjes, Organizimi esnafor, Qendrat tregtare qytetare

Hyrje

Egziston një shprehje angleze që thotë njeriu bën veshjen dhe veshja bën njeriun, dhe me të vërtetë, kur shohim fotografitë e veshjeve të shekujve të mëparshëm, na lind dëshira për të mësuar më shumë rreth këtyre veshjeve dhe njerëzve që kanë jetuar gjatë kësaj kohe, dhe që kanë përdorur këto veshje. Veshjet si një nga elementet e rëndësishëm të mënyrës së jetesës, janë pasqyruese dhe reflektuese të zhvillimit të mardhënieve ekonomiko-shoqërore të kohës në të cilën janë prodhuar. Këtë e dallojmë në këndvështrimin estetik të pamjes së jashtëme që flet për shijet dhe aftësitë e mjeshtrave dekorator, po ashtu dhe për materialin me të cilin janë prodhuar nga artizanët dhe gratë shtëpiake, që kanë prodhuar një pjesë të konsiderueshme të veshjeve po dhe të pjesëve të veçanta të saj. Veshjet janë të klasifikuara si monumente të trashëgimisë materiale kulturore dhe bëhet gjithnjë e më qartë arsyeja që, ato nuk mund të shihen të shkëputura nga zhvillimi ekonomiko – shoqëror, të cilin e reflektojnë në mënyrë të natyrëshme. Në historikun e zhvillimit të veshjeve përherë kushtet ekonomiko – shoqërore kanë qenë një faktor që kanë luajtur një rol të rëndësishëm.

Më parë është marrë në studim zhvillimi ekonomik - shoqëror i qyteteve Shqiptare në kohë të ndryshme nga studiues të ndryshëm, por ky studim nuk ka për qëllim dhe si objekt studimi zhvillimin e mardhënieve ekonomiko – shoqërore në qytetet shqiptare. Por reflektimin prej veshjeve të zhvillimit ekonomiko – shoqëror dhe mjedisit në të cilin janë prodhuar dhe përdorur. Faktorët kushtëzues që kanë ndikur në zhvillimin e veshjes qytetare, dhe që të gjithë këta tregues janë të pasqyruar nëpërmjet veshjeve qytetare të kësaj periudhe, një studim i tillë nuk është bërë. Kjo është arsyeja që bëri marjen e iniciativës për të trajtuar këtë temë në lidhje me pasqyrimin e zhvillimit ekonomiko – shoqëror si mjedisi në lidhje me veshjen dhe konkretisht për veshjen qytetare. Kjo ide ka lindur gjatë temës së studimit për veshjet qytetare në fund të shekullit të XIX dhe fillim shekullit të XX. Gjatë gjithë periudhës studimore më ka rënë në sy një lidhje e ngushtë e veshjes me zhvillimin ekonomiko – shoqëror dhe veshja më ka rezultuar si një pasqyruese shumë e mire e zhvillimit të mardhënieve ekonomiko – shoqërore dhe e mjedisit në të cilin janë prodhuar dhe përdorur. Pra ky këndvështrim është arsyeja përse po e marr inisiativën për të zhvilluar këtë studim të reflektimit të mardhënieve ekonomiko-shoqërore nga veshjet qytetare të shekullit XIX dhe fillim shekullit të XX. Meqenëse veshja është një produkt shoqëror dhe e prodhuar për një funksion jetik, si e tillë ajo nuk mund të shihet jashtë zhvillimit të mjedisit shoqëror dhe kulturor.

Studimi ka si qëllim formën e pasqyrimin prej veshjeve qytetare, zhvillimin ekonomiko – shoqërore që ka bërë të mundur zhvillimin e veshjeve në qytetet Shqiptare. Nëpërmjet trajtimit të këtij studimi do të shihen karakteristikat e pasqyrimin të mardhënieve ekonomiko-shoqërore të kohës tek veshjet qytetare.

Mjedisi që mundësonte këtë veprimtari të prodhimit të këtyre veshjeve, siç ishin zejtaria dhe produktet e tyre artizanale si veprimtari shoqërore. Formën e organizimit të mjeshtrave dhe punës së zejtarëve, të sjellura nëpërmjet referimeve nga autorë Shqiptarë që kanë trajtuar artizanatin dhe zejet gjatë kësaj periudhe. Ky studim i pasqyrimin të organizimit ekonomiko-shoqëror nëpërmjet veshjeve qytetare, gjatë shekullit të XIX e fillim shekullit të XX do të shihet nëpërmjet këtyre çështjeve që janë: Së pari veçoritë që pasqyron veshja qytetare si kulturë materiale. Së dyti organizimi esnafor si pjesë e këtij organizimi shoqëror. Së treti, qytetet si qendra të mjedisit social – kulturor, si qendra të zhvillimit të këtyre mardhënieve ekonomiko shoqërore, dhe së fundmi konkluzioni.

Veçoritë pasqyruese të veshjes qytetare

Në të gjitha pjesët e saj si në aspektin funksional të saj, dhe materialin për dekorin që është përdorur, veshja qytetare gjatë fund shekullit të XIX dhe fillim shekullit të XX, kishte një natyrë lluksoze, dhe trasmetonte ndikimet e besimit të mbajtësit në pjesë të veçanta të dekorit të saj, tek motivet që përdorëshin për zbukurim. Motivët që përdorëshin për qëndisje si dhe objekte zbukurimi kryesisht të grate që ishin kryqet për kristjanet, dhe gjysmat e hënës për muhamedanet. Forma e veshjeve në të gjitha pjesët e saj ishte një produkt original i mjeshtrisë së artizanëve, dhe grave që i prodhonin nga ekonomitë e tyre shtëpiake. Këto motive që ishin të krijuara dhe të qëndisura prej mjeshtrave zejtarë, demonstroi një shije të lartë artistike të kushdo që i shihte. Këtë veçanti na e pohon Zija Shkodra sipas Lord Bajron për veshjen me fustanellë një veshje që është përdorur në të gjitha qytetet shqiptare deri në fillim të shekullit të XX, ai shkruan: “Imagjinata e artistit nuk mund të konceptoj kurrë ndonjë gjë më ideale, që është veshja shqiptare me ato mëngoret prej ari të prera të lëshuara në formë flatrash ëngjëllore dhe fluturonjëse, me fustanellën e bardhë si dëbora e mbërthyer në brez me qëllim që të nxjerrë në pah harkun e ijeve dhe që bien mbi gjunjët në mënyrë të ujdësuar në formë ujvare, me kalcat e punuara hollë – hollë nga duart e vajzave të reja dhe një mori të pa fund detajesh, që është vështirë të përshkruhen – ai që i jep burrit, nuk di se çfarë pamje prej ëndre dhe bote përallorë”.

Veshja me fustanellë dëshmon një fizionomi zejtare dhe pasqyron tërësinë e këtyre mardhënieve shoqërore, si në aspektin shpirtëror dhe në atë material. Ajo flet për një zhvillim të shijes estetike të mjeshtrave qëndistarë dekoratorë, të mjedisit ekonomiko-shoqëror të kësaj periudhe kohore. Kjo veshje qytetare është një vepër e këtij mjedisi shoqëror që gjatë kësaj kohe karakterizohet nga artizanati dhe mjeshteria, që spikaste në të gjitha produktet e prodhuara prej artizanëve, dhe grave shtëpiake që prodhonin pëlhurat dhe pjesë të veçanta të veshjes.

Me fuqizimin e shtresave shoqërore si aristokracia feudale dhe borgjezia

qytetare, rritën kërkesën për veshje më të kushtueshme për nga materiali dhe forma e dekorit. Kjo ishte një nxitje për zhvillim të veprimtarisë së tekstileve në lidhje me pëlhurat e kushtueshme dhe veprimtarinë e punës artistike të qëndstarëve, që qëndisnin zbukurimet e veshjeve me kërkesa më të mëdha me fije ari dhe argjendi. Këtë na e pohon shkrimi i Zija Shkodrës që thotë: “me pasurimin e disa shtresave shoqërore sidomos të aristokracisë feudale dhe të borgjezisë qytetare u rrit shumë kërkesa për artikuj të luksit. Ky fakt ndikoi drejtpërdrejt në lulëzimin e gjithanshëm të zejtarive atristike, si të atyre të punimit të kostumeve kombëtare, të argjendarisë, të zbukurimit në ar e argjend të armëve të gjata e të brezit, të punimit të enëve prej bakri e tunxhi, të punimit të gëzofëve, si dhe i shumë zejeve të tjera, të cilat tërhoqën deri vëmendjen e udhëtarëve të huaj. Një dëshmi tjetër e lulëzimit të forcave prodhuese në fushën e zejeve artistike është edhe kërkesa për ndërtim e shtëpive luksoze, që tërhoqi dhe aktivizoi një varg mjeshtërishë të zejeve artistike. Aneksë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, si ato të daltimit të gurit, gdhendjes së drurit, pikturave murale etj, të cilat u bënë një art i fuqishëm popullor në dorën e mjeshtërave dhe të artistëve shqiptarë. Këtë na e tregojnë edhe sot gjurmët e këtyre shtëpive të stilit të përzier oriental e vendës, me dhoma të shumta të ngarkuara me zbukurime mjaft të pasura, sidomos tavanet, trapezet dhe oxhakët”. Ashtu siç zhvillimi ekonomik – shoqëror ndikon në mënyrën e jetesës siç janë ushqimi, veshja dhe banesa, po ashtu dhe këta elementë tregues të jetesës e pasqyrojnë zhvillimin ekonomik – shoqëror. Ky ndikim i luksit ashtu siç u ndie te veshja u ndie dhe te banesa sidomos në fushën e zejeve artistike u rritën kërkesat për ndërtim e shtëpive luksoze, Veshja duke na trasmetuar jo vetëm modë në të gjithë paraqitjen e saj vizuale dhe funksionale, ajo reflekton mënyrën e jetesës së mbajtësit, dhe fizionominë shoqërore të formës së prodhimit, si për funksionalitetin dhe estetikën e saj. Kjo periudhë karakterizohej nga prodhimi zejtar dhe nëpërmjet zejtarisë prodhoheshin të gjitha pjesët e veshjes dhe të gjitha objektet e zbukurimit që përdorshin për dekor. Gjatë kësaj kohe në qytetet shqiptare lulëzuan si njësi të veçanta brenda kësaj zeje dege të prodhimit dhe zbukurimit të veshjes si; endjet e pëlhurave prej mëndafshi, mjeshtëria e qëndisjes me fije ari dhe argjendi, gajtanpunesit dhe qëndistarët me gajtane mëndafshi dhe pambuku. Në lidhje me fizionominë e veshjes që pasqyron jo vetëm zhvillimin ekonomik – shoqëror por dhe vlera shpirtërore që karakterizonin këtë kohë studiuesja Afërdita Onuzi pohon: “të tëra llojet e stolive vrullin më të madh të përdorimit dhe kulmin e rritjes së nivelit artistik të tyre e shënuan pikërisht në kohën kur këtë pikë zhvillimi e kishin shënuar edhe veshjet popullore. Siç dihet, kjo periudhë e artë u përjetua gjatë shekullit XIX, veçanërisht në gjysmën e dytë të tij. Përgjithësisht kjo ka qenë periudhë e suksesëshme për një varg mjeshtërishë që merreshin me prodhimet e objekteve të luksit, konkretisht ato që punonin pjesë veshjesh të qëndisura me fije metalike, që imitonin ngjyrën e arit e të argjendit,

ose ata që qëndisnin me gajtane mëndafshi e pambuku, endëset e pëlhurave prej mëndafshi, mjeshtër e gdhëndjeve në dru e për më tepër mjeshtër e punimit të objekteve prej argjendi, etj. mjeshtëri të tilla gjatë shek. XIX zhvilloheshin në disa qytete shqiptare si Prizren, Gjakovë, Shkodër, Elbasan, Berat, etj”. Mjeshtëritë e zejeve të punimit të materialeve të veshjes qytetare për prodhimin e pëlhurave dhe materialeve të zbukurimit, ishin element thelbësorë të mjedisit ekonomik – shoqëror të veshjeve të kësaj periudhe në studim.

Ky mjedis ekonomik – shoqëror si në aspektin e kulturës materiale dhe si kulturë shpirtërore dëshmon, për aftësitë dhe arrijtet teknike të mjeshtërave rrobaqepës si në prerje dhe në qepje të veshjeve. Duke qenë se veshja është përfituar nga një kulturë shpirtërore dhe materiale, ajo shpreh artin dhe punën në funksion të gjithë shoqërisë e gatëshme për të plotësuar kërkesat e saj jetike. Një veçori ekonomike e veshjeve qytetare të kësaj kohe ishte dhe kostua e saj e lartë, për shkak të përfitimit të saj kryesisht nga puna me dorë, dhe që për tu kompletuar si veshje me të gjitha pjesët e saj përfshi dhe zbukurimet dhe dekorin mernin pjesë shumë zeje, për këtë pohim që vjen nga Zija Shkodra sipas Bajronit që thotë: “Një veshje shqiptare që të jetë e mirë duhet të kushtojë rreth 2300 franga. Është e vërtetë që ka veshje dhe me 100 franga. Ky çmim kaq i lartë nuk duhet të çudisë fare në një vend kaq të varfër. Qëndisimat prej ari dhe argjendi, gjithnjë të domozdoshme për të ribërë një kostum, nuk duhet veçse të ndërrosh cohën, gjë që është jashtëzakonisht e thjeshtë. Shpesh në shqipëri këto qëndisima trasmetohen nga babai tek bijtë. Veshja femërore që mbahet më rrallë që kur mania e modave europiane ka hyrë në shqipëri, është shumë e hijshme, por ka të metën se mbulon linjat e ijeve dhe nuk nxjer në pah në mënyrë të mjaftueshme trupin e gruas, megjithëse në disa vise të shqipërisë, instikti i femrës i ka modifikuar këto të meta duke i dhënë veshjes një pamje më të lehtë dhe më të shpenguar”.

Ky pohim tregon për pasqyrimin e veshjeve të zhvillimit ekonomik – shoqëror. Veshja për nga materialet që prodhohet, është pjesë e kulturës materiale që përveç anës funksionale të përdorimit, ajo mbart dhe trasmeton dhe artin e zbukurimit nëpërmjet dekorit që krijon mjeshtri artizan, kështu që veshja është dhe një objekt që mbart dhe kulturë shpirtërore. Në lidhje me këtë për veshjen si pasqyruese e vlerave shpirtërore të saj, studiuesja Andromaqi Gjergji thotë: “veshja si nga roli i saj i dobishëm ashtu dhe nga funksioni shoqëror që kryen, përbën një nga elementet më të rëndësishëm të kulturës materiale. Por, e parë nga elementët e zbukurimit që ajo përmban, nga format artistike që merr, nga roli dekorativ që luan, ajo integrohet edhe në kulturën shpirtërore”.

Duke pasqyruar këto vlera shpirtërore dhe vlera materiale që shohim te veshja, ajo bëhet pjesë e një identiteti kulturor, i një mjedisi shoqëror si në aspektin artistik dhe teknik. Si objekt lëndor ajo përfshihet në kulturën materiale të zhvillimit ekonomik – shoqëror. Si e tillë ajo jep dhe dëshmi historike për njerëzit e kohës që janë dhe

përdoruesit e saj, duke na dëshmuar një pjesë të identitetit të vlerave të tyre kulturore, nëpërmjet veçorive teknike dhe artistike që trasmeton. Në kontekstin kulturor ajo bëhet në tërësinë e vetë, përfaqësuese e një qytetërimi të caktuar në një kohë të caktuar që na paraqitet nëpërmjet pasqyrit të kulturës materiale dhe shpirtërore që mbart, duke dëshmuar për mjedisin qytetar të kohës në të cilën ka jetuar. Kjo natyrë e veshjes si formë lëndore përcakton në mënyrë të dukëshme karakterizimin e unitetit të mardhënies ekonomiko – shoqërore, si në aspektin material dhe shpirtëror, dhe tregon qartë vazhdimësinë e influencës së brendëshme dhe të jashtëme të unitetit artistik dhe teknik. Kjo dukuri fleksibiliteti tek veshjet shfaqet tek moda që pasqyron, për shijen artistike dhe shkallën e arritjes së përpunimit të materialeve natyrore si një kulturë. Moda e veshjes është në vetvete një reflektim i një mënyre jetese të caktuar, dhe si e tillë veshja e pasqyron këtë më së miri.

Në lidhje me realitetin lëndor të veshjes, si një notë e gjallë në historinë e zhvillimit shoqëror për mënyrën e jetesës dhe zhvillimin ekonomik që pasqyron veshja A. Gjergji thotë: “në periudha të ndryshme të historisë së tij. Historia e veshjes pra, duhet parë si një realitet lëndor pa të cilin mënyra e jetesës do të mbetej e mangët dhe pa atë notë gjallërimi që moda e veshjeve i jep historisë së zhvillimit shoqëror të një vendi”.

Si përfundim mendoj se veshja qytetare si pasqyruese e unitetit të këtyre mardhënive ekonomiko – shoqërore përbëhet në të gjithë tërësinë e vetë nga disa veçori. Të cilat shprehen në cilësinë e përpunimit dhe punimit të materialit në formë të tillë që pasqyrojnë shije, modë, kulturë dhe identitet. Këta janë elementët që trasmetojnë një qytetërim të një kulture të caktuar dhe që përfaqësojnë një mënyrë jetese. Të gjitha këto veçori i gjejmë të përcaktuara mirë, dhe të pasqyruara tek veshja, në mënyrë shumë të dukëshme dhe të prekëshme.

Të gjithë këta elementë të mjedisit shoqëror, si forma, shija, moda, kultura, identiteti, janë veçori që i mbart veshja, dhe nëpërmjet tyre ajo dëshmon, jo vetëm si një element shumë i rëndësishëm i mënyrës së jetesës, por ajo si e tillë është një trashëgimi e gjallë dhe për historinë e zhvillimit të mënyrës se jetesës duke dëshmuar për kohën gjatë së cilës është prodhuar dhe përdorur.

Organizimi esnafor

Shoqëria Shqiptare gjatë kësaj periudhe në studim funksiononte mbi bazën e sistemit feudal, dhe është koha kur kjo periudhë tranzitive ecën drejt sistemit të mardhënive ekonomiko-shoqërore kapitaliste. Në fund të shekullit të XIX kemi dobësimin dhe çorëntimin e administrimit të teritoreve Shqiptare, për shkak të humbjes dhe dobësimin të kontrollit të qeverisë osmane në të gjithë veprimtarinë ekonomike dhe shoqërore. Nis rënia graduale e zejtarisë, një veprimtari ekonomike që drejtohej nga sistemi i esnafëve, një sistem i vjetër i mënyrës ekonomiko-

shoqërore të zejeve, dhe që po shkonte drejt konsolidimit të një organizimi ekonomiko-shoqëror më të avancuar, si në formën e organizimit shoqëror po ashtu dhe atë ekonomik. Ky mjedis shoqëror qytetar artizanësh kishte organizim e vet tregtar dhe ky organizim shoqëror quhej esnaf (korporatë). Ky tipar zhvillimi shoqëror kishte për bazë organizimin shoqëror esnafor-tregtar, dhe ishin këto mardhënie shoqërore organizimi, ku nëpërmjet këtij zinzhiri shoqëror krijohet dhe puna për plotëminin e kërkesave dhe nevojave jetësore për lëndë të parë, dhe për produktet siç ishin ushqimet, veshjet, pëlhurat, tekstilet, këpucët etj, të cilat ishin produktet e nevojshme për jetesën. Ky përshkrim është mjedisi për veshjet qytetare të kësaj periudhe dhe që ato e reflektojnë më së miri.

Zhvillimi ekonomik – shoqëror nuk është objekt i studimit të kësaj teme, por që të mësojmë më shumë për mjedisin shoqëror të kësaj kohe në lidhje me veshjen qytetare, le të flasim për mënyrën se si funksiononte ky organizim esnafor, dhe çfarë rëndësie kishte në jetën zejtare. Esnafi ndihmoi të gjithë mjeshtrart zejtare në bashkimin e tyre, si një forcë vepruese në zhvillimin ekonomik të qyteteve. Mjeshtrat e qyteteve si njerëzit që kishin në dorë jetën ekonomike të bashkëqytetarëve të tyre me vullnetin, me artin dhe punën e tyre për trasmetimin e shijes së kohës, dhe plotësimin të nevojave të popullsisë ishin të organizuar në formën e esnafit. Në sistemin e organizimit esnafor sistemi legjislativ ishte tepër i centralizuar dhe i mbyllur në lidhje me të drejtat e individit, kallfët dhe çirakët nuk kishin të drejtë të kërkonin ulje të orëve të punës apo ngritje të pagave për një jetë më të drejtë në raport me nevojat ata ishin të destinuar të qëndronin në atë punishte zejtare që kishin filluar punë që ditën e parë. Ky organizim ishte një veprimtari ekonomike që konsiderohej, si sistemi i esnafëve i cili trasmetonte mënyrën e qeverisjes së kontrolluar si në jetën shoqërore dhe ekonomike. Sistemi esnafor kujdesej dhe për qarkullimin e mallrave, në lëvizjen e popullsisë duke bërë veprime të qarta të një jete tepër të kontrolluar dhe të centralizuar. Studiuesi Shqiptar Abedin Çausi na jep një tablo të qartë dhe na vërteton në këtë studim për armëtarët në qytetin e Elbasanit, të cilët quheshin dyfekçinj, një fjalë e huazuar nga fjalori i gjuhës Turke gjatë përshkrimit bëhet e qartë kjo formë organizimi e zejeve në qytete ku thotë: “Këta dyfekçinj kanë pasun edhe esnafin e tyre të organizuem, që vazhdoi deri në çerekun e parë të shekullit tonë. Në shekullin e XIX- të dyfekçinjët ishin përqëndruar në dy zona të caktueme të tregut të Elbasanit.”. Nëpërmjet shkrimit na pohohet që çdo zej kishte një esnaf të vetin. Po ashtu Studiuesi Zija Shkodra na pohon dhe për zeje të tjera dhe shkruan: “si ajo e punimit të lëkurës, e pëlhurave prej pambuku, e leshit dhe e mëndafshit, dega e metaleve, etj.”

Ndërsa këto esnafe (korporata) kishin një organizatë që përfshinte të gjitha esnafet e çdo lloji zeje e cila caktonte dhe mbronte të drejtat e mjeshtrit, kallfës, dhe çirakut dhe njëkohësisht harmonizonte mardhëniet midis tyre brenda zejtit, por edhe me esnafët e zejeve (zanateve) të tjera. Esnafi përpiqesh të mos lejonte

kontradikta dhe nëse kishte ai ndërhynte, dhe në disa raste shumë ashpër këtë na e pohon një shkrim i Zija Shkodrës që thotë: “deri fyerjet më të vogla, si sharjet, kërcënimet etj, dënoheshin nga esnafi”.

Për të kuptuar domozdoshmërinë e esnafit qëndror, dhe nevojën e këtij organizimi ndërmjet zejeve për harmonizim e mardhënieve, jo vetëm brenda zejtarëve por dhe harmonizimin e mardhënieve me zejet e tjera që bashkëpunonin për produkte të veçanta zejtare. Le të shohim se çfarë shkruan Abedin Çausi për këtë zinxhir bashkëpunimi: “zeja e dyfekçinjve ka pasë lidhje të ngushta me atë të kujunxhinjve (argjendarëve) se këto i stolisnin armët me ornamente të punuara në argjend. Veç kësaj punojshin prej prinxhi ose prej argjendi vezmet e palcorët që ishin aksesore të armëve. Të njëjta lidhje dyfekçinjët kanë pasë edhe me saraçët, se këta përgatitshin rrypat e pushkëve, silahet e brezit, qeset e barutit dhe kollanat e fyshekëve”. Organizata e esnafit kishte dhe një kryesi, kryesia e esnafit përbëhej prej një kryetari dhe dy anëtarësh të cilët zgjidheshin në mbledhjen e mjeshtërave çdo katër vjetë. Në kryesi zgjidheshin mjeshtëra të kualifikuar që e njihnin mirë zejen, ata kishin dyqanet e tyre për çdo zeje (zanat) dhe punonin bashkë me kallfët (punëtor) dhe çirakët (nxënës) këta mjeshtër kishin të drejtën e dhënies së desturit (dëftesë e aftësisë për të ushtruar zanatin) ndryshimi i punëtorit nga nxënësi ishte se punëtori paguhej ndërsa nxënësi nuk paguhej, por paisej me dëshminë e zanatit që merte të drejtën e hapjes së dyqanit. Çdo ngjarje e tillë si dhënia e lejes së hapjes së dyqanit festohej, për këtë na pohon Zija Shkodra duke thënë: “çdo ngjarje e rëndësishme në jetën esnafore, si dhënia e testireve, teferiçet a festat e ndryshme, hapja e dyqaneve nga ustallarët e rinj etj, përdorej si shkak për të bërë gostira (ziafete), të cilat ndihmonin në afrimin, krijimin dhe mbajtjen përkohësisht të një atmosfere përzemërsie në mes anëtarëve. Edhe për rastin kur anëtari shkelte disiplinën dhe rregullat e brendshme, të ardhurat nga gjobat përdoreheshin shpesh herë për t’u bërë shokëve gostira të tilla”.

Këto organizata luanin një rol të rëndësishëm dhe në jetën politike dhe ushtarake, për këtë Zija Shkodra thotë: “si përfaqësuese të shtresave prodhuese qytetare, për shumë kohë ato luajtën një rol të dorës së parë në mbrojtje të interesave të ekonomisë qytetare, si dhe në ngjarjet politike të vendit, të lidhura ngushtë me këto interesa. Rritja dhe zhvillimi i mardhënieve monetare, të pasqyruara në një lëvizje të gjerë zejtarë-tregtarë, forcuan gjithnjë e më shumë pozitën dhe luftën esnafore si në drejtim të zotërimit të tregut të brendshëm ashtu edhe kundër arbitraritetit dhe lakmisë feudale të shfrenuar. Në këtë luftë të gjatë, të zhvilluar në disa etapa të caktuara, ato fituan, më në fund, prestigjin dhe autonominë e tyre vepruese. Kështu duke u shkëputur nga fuqia dhe sundimi i pronarëve feudal të tokës, duke pasur njëkohësisht mbështetjen e shtetit dhe të institucioneve fetare, këto ndihmuan me çdo mënyrë në organizimin e pavarur të jetës shoqërore dhe politike në qytet”. Ky rrjet organizimi ishte një element i rëndësishëm i formës së organizimit të mjedisit

ekonomiko-shoqëror gjatë kësaj periudhe, dhe kishte një rol të rëndësishëm në të gjithë zhvillimin e artizanatit dhe mjeshtërisë, që ishin baza e krijimit dhe prodhimit të veshjeve qytetare. Duke hedhur dritë mbi këtë formë organizimi të zejtarëve, ne mund të kuptojmë më mirë dhe mardhëniet ekonomiko-shoqërore, që ishin mjedisi në të cilin janë prodhuar dhe që kanë jetuar këto veshje qytetare.

Qytetet si qendra të mjedisit social – kulturor

Gjatë shekullit të XIX dhe fillim shekullit të XX qendrat qytetare Shqiptare janë në ndryshim për shkak të ndryshimit nga mardhënie shoqërore feudale në mardhënieve shoqërore kapitaliste. Kjo veprimtari shoqërore e re, ishte lindja e mardhënieve kapitaliste si në qarkullimin dhe prodhimin e mallrave në jetën ekonomike të popullsisë për një mardhënie tregtare të lire brenda vendit, dhe futja e qyteteve në ndikimin e tregut të fuqishëm dhe të madh Europian.

Studiuesi Zija Shkodra thotë: “nga mesi i shekullit të XIX në qytetet kryesore të vendit lindën manufakturat, më vonë edhe fabrikat e para kapitaliste së bashku me tregun nacional, faktor shumë i rëndësishëm ky i fundit pasi shënoi një hap të madh përpara në formimin e komunitetit ekonomik e shoqëror të vendit tonë”. Kjo formë e re e mënyrës së prodhimit që ishte me makineri, kursente forcën punëtore të prodhimit gjatë kohës së punës dhe riti papunësinë, për arsye se tregu i punës nuk kishte nevojë të larta për shkak të zëvendësimit të mënyrës së prodhimit, por dhe sepse popullsia punonjëse nuk ishte dhe e specializuar në teknikën e mënyrës së prodhimit për t’ju përgjigjur kësaj forme të re që po hynte.

Qytetet si qendra të mjedisit social – kulturor si vende të cilat zhvilloheshin dhe ndryshonin çdo ditë, kishin dhe qendrat e mëdha të zhvillimit të tregtisë që në gjuhën e përditëshme quheshin pazare, të cilat ishin dhe faktorë të jetës shoqërore që ndikonin në zhvillimin e mardhënieve ndërmjet njerëzve të atyre ditëve. Studiuesi Hasan Qatipi duke folur për tregtimin dhe prodhimin e drurit në tregun e qytetit të Grabovës ai na pohon për tregjet e qyteteve dhe vlerës së tyre për zhvillimin ekonomik – shoqëror të qyteteve për mjedisin e kësaj kohe dhe thotë: “veç gjërave të tjera që shiteshin e bliheshin atje bëhej dhe një tregti e dukëshme për prodhime druri, p.sh. atje shiteshin lëndë druri për ndërtim, dërrasa, kade, bucela, bluda, kupa, samarë etj., shumë prej këtyre artikujve grabovarët i punonin dhe i shisnin në vend, por disa prej tyre i shisnin në Berat, Voskopojë, Elbasan, Kavajë, Korçë, Lushnje, Fier etj. Kurse disa artikuj të tjerë që nuk kishin mundësi të transportoheshin si p.sh. magjet dhe hambarët i punonin në shtëpinë e konsumatorit”.

Zhvillimi dhe zgjerimi i degës së ndërtimit që çoi dhe në ndërtimin e ambjentëve të banimit dhe ambjentëve sociale studiuesi Hasan Qatipi duke folur për ndërtimin ai flet dhe për zhvillimin e sferës së ndërtimit: “Gjatë shekullit

të XIX – të kjo degë e ekonomisë në qytetin e Elbasanit kishte marrë një hov të dukshëm. Paria e qyteteve krahinave të Elbasanit dhe Peqinit bejlerët dhe agallarët, tregtarët e pasur, disa nga pjestarët dhe krerët e esnafëve të Elbasanit dhe Peqinit institucioneve fetare dhe zyrtare etj. bënë mjaft ndërtime si p.sh. në tregun e Elbasanit dhe Peqinit. Gjatë kësaj kohe u ndërtuan dhe u rindërtuan kisha, xhamia, shtëpia, dyqane, ura etj”. Zhvillimi ekonomik solli që të përvetësoheshin dhe të ushtroheshin aftësi teknike të reja apo të punonin si punëtorë me mëditje rreth shekullit të XIX filloi të dukej qartë ndryshimi në mënyrën se si prodhohej dhe shkëmbehej në degë të ndryshme të ekonomisë. Duke folur për zhvillimin e prodhimit dhe tregtimit të Hasan Qatipi na vërteton dhe krijimin e disa zanateve që ishin Brenda kësaj dege siç thotë: “Të gjitha këto ndërtime rritën kërkesat e tregut për artikuj të drurit..Janë bërë mjaft punime druri me daltë, atëhere kishte ende kërkesa për zbukurimin e pjesëve të drunjtta të ndërtesave si p.sh. të dehelizeve, perdeve, dollapëve, hyklykëve, parvasave, qemerëve, për dyert e odave dhe shtëpive të zjarit, për dyert e hajatit ose të buharëve, ikonostasëve, amvonave, proskinitarëve, fronave, të dhespotit në kasha, hydbeve, kapiteleve të ndryshme dhe objekteve të tjera druri që punoheshin me mjeshtëri të rrallë”. Këto zeje u zhvilluan si rezultat i prodhimit të vogël të mallrave në kooperim të thjeshtë në manifakturë kapitaliste. Zejtarët që ishin shtresa dominuese në jetën ekonomiko – shoqërore, si në plotësimin e nevojave materiale dhe shpirtërore me punën e tyre nuk prodhonin mallra në seri, por në copë dhe kujdeseshin që vlera e punës së tyre të udhëhiqej nga shija për të bukurën, dhe të konkuronte mjeshtëria artistike, që tashmë po përpiqeshin të përballonin konkurrencën e mallrave Europiane që po vërshonin në tregun e tyre me çmime më të leverdisëshme dhe me forma nga më të ndryshmet, si funksionale dhe estetike, si dhe prodhimeve të fabrikave të ngritura nga kapitalistët e parë shqiptarë të ndërmarjeve të pakta në qytete. Këto zhvillime të mjedisit qytetar sollën dhe ndryshime të mardhënieve shoqërore në jetën kulturore dhe artistike, që u pasqyruan dhe në modën e veshjes dhe në pjesët e kësaj veshje si rezultat i zhvillimit të mardhënieve ekonomike dhe shoqërore të këtyre qendrave qytetare. Në qendrat qytetare kishte dhe vende të posaçme ku tregtonin dhe gratë prodhimet e tyre pasi një pjesë e pëlhurave dhe veshjeve, përgatitej në shtëpi nëpërmjet ekonomisë shtëpiake.

Këtë treg e mbanin nevojat e popullsisë qytetare për shijen e veçantë të së bukurës dhe për mjeshtërinë artistike që e jepte vetëm puna e dorës. Faktorët që kanë nxitur në zhvillimin e mjedisit shoqëror dhe kulturor janë kërkesat e kohës, për një cilësi në paisje me plotësimin e domozdoshmërive materiale dhe shpirtërore, që janë plotësuar nga tregu i brendshëm i cili karakterizohej nga një zhvillim i gjerë ekonomiko - shoqëror. Me diferencimin e mëtejshëm të shtresave shoqërore në gjithë zhvillimet ekonomiko – shoqërore, disa zejtari në qytet u mbyllën si rezultat i mos pagesës së taksave, të pagave dhe si mos kërkesë e mallrave të tyre

që po konkurronin mallrat Europiane duke kaluar në punëtorë me mëditje, ose mërgonin në vendet më të zhvilluara si krahë pune i lirë.

Një pjesë e vogël e zejtarëve që mbijetuan arritën të pasurohen dhe ngritën radhët e borgjezisë që po bëhej fuqia dominuese dhe e jetës shpirtërore, kjo vazhdoi dhe gjatë shekullit të XX në popullsinë e qytetit. Gjatë fund shek. XIX dhe deri në fillim të shek. XX veprimtaria profesionale qytetare ishte e profilizuar dhe ushtrohej sipas grupeve të ndryshme shoqërore, dhe në vendin tonë arriti nivele zhvillimi po aq të larta sa të gjitha zhvillimet që kishte njohur rajoni deri atëherë në historinë e vetë. Zhvillimi i një numri të madh zejesh krijoi një shtresë shoqërore të gjerë zejtarësh, të cilët prodhonin për nevojat dhe kërkesat e tregut të brendshëm dhe të jashtëm. Duhet cilësuar që periudha në studim nuk është momenti më i mirë për shoqërinë zejtare por dhe gjatë shekullit XIX Shqipëria vazhdoi të ishte qendër e rëndësishme në ballkan dhe bënte tregti me Austrohungarinë – Italinë – Gjermaninë etj.

Qytetet Shqiptare e humbën funksionin dhe karakterin e qytetit mesjetar, filluan të bëhen qendra shumë të rëndësishme ekonomiko – shoqërore të prodhimit, të tregtimit në gjallërimin dhe pulsimin e gjithë jetës së vendit, po ashtu dhe në rritjen e tregut të brendshëm dhe mardhënieve të kapitalit të shkëmbimit të mallrave me tregun e jashtëm, të qenit Brenda hartës teritoriale madje dhe kufitare me vendet e shteteve të zhvilluara Europiane, u zhvillua transporti detar dhe kemi skelat e Vlorës të Durësit, Shën Gjinit, Shkodrës, Ulqinit. Në fillim të shekullit të XX qytetet shqiptare në lidhje me shijen dhe mënyrën e zhvillimit rruanin ende gjurmët e arkitekturës dhe urbanizimit të vjetër oriental ballkanas. Megjithatë qytetet shqiptare po zhvilloheshin dhe po fuqizoheshin, me gjithë pengesat dhe kushtet e vështira të sundimit otoman që mudohej të mbante sistemin e centralizuar të organizimit esnafor si drejtuese të jetës ekonomiko – shoqërore. Kjo u pasqyrua në çdo veprimtari ekonomiko – shoqërore në gjallërimin dhe zgjerimin e mardhënieve tregtare të çdo sferë, ndërmjet qyteteve kjo veprimtari ekonomike që po zgjerohej dhe që po çlirohej nga organizimi esnafor, çoi në rritjen e kapitalit të borgjezisë tregtare qytetare, e cila u bë një nga shtresat më të rëndësishme të zhvillimeve ekonomiko – shoqërore në qytetet shqiptare të kësaj kohe.

Përfundime

Si përfundim këto profesione që përfshinin prodhimin dhe zbukurimin e vesjeve të kësaj kohe përbënin një pjesë të zhvillimit ekonomiko shoqëror të qyteteve Shqiptare. Në këtë këndvështrim veshjet qytetare si pjesë e këtij identiteti ekonomiko shoqëror dhe si një element i rëndësishëm shprehin dhe pasqyrojnë mënyrën e jetesës dhe mjedisin social – kulturor të qyteteve Shqiptare gjatë shekullit të XIX dhe fillim shekullit të XX. Veshja është një dëshmi e gjallë e identitetit dhe frymës së shijes që mbart duke na pasqyruar jo vetëm vlerat ekonomiko – shoqërore, por

ajo ka pasqyruar dhe ndikimet e mënyrave të jetesës të kulturave dhe qytetërimeve, që janë ofruar në qytetet Shqiptare.

Në këtë tablo, në lidhje me veshjet si pasqyruese të mjedisit ekonomik – shoqëror dhe marrëdhënieve shoqërore të kësaj periudhe, është shumë e dukëshme fizionomia e tyre që karakterizohet nga marrëdhënie zeytaro-tregtare. Tek veshjet ne shohim si veçori artizanin & artizanatin, mjeshtrin & mjeshhtërinë, artin e shijet e tyre. Në prodhimin dhe tregtimin e veshjeve qytetare të shekullit të XIX dhe fillim shekullit të XX është e pasqyruar e gjithë forma e organizimit esnafor. Veshjet qytetare të kësaj periudhe na trasetojnë estetikisht formën e mjedisit të marrëdhënieve ekonomik-shoqërore, që na shfaqen edhe sot në shekullin XXI po kaq të bukura shpirtërisht dhe materialisht. Shih Fig. - “a,b,c,d,e,f,g,i,j,k”.

Veshjet qytetare, duke qenë një dëshmi e gjallë për kohën në të cilën janë prodhuar dhe janë përdorur, janë një pasuri me vlera të jashtëzakonshme në trashëgiminë materiale kulturore, të ciat trasetojnë një mjeshhtëri të lartë artistike dhe teknike. Në fushën e trashëgimisë materiale kulturore veshjet qytetare janë të një rëndësie të veçantë për nga vlerat që mbartin, pasi nëpërmjet pasqyrimit të tyre njohim historikun e zhvillimit të mënyrës së jetesës në qytetet shqiptare. Në përfundim është shumë kuptim plotë mesazhi për pasurinë e trashëgimisë kulturore, i studiuesve të njohur ndërkombëtarisht në fushën e trashëgimisë kulturore botërore, siç janë Bernard Feilden dhe Juka Jokilehto.

Në shkrimin prej tyre të udhëzuesi në lidhje me menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore, referuar kartës ndërkombëtare të Venecias 25 – 31 maj për monumentet dhe vlerat e tyre ata shprehin: “Të ngarkuara me një mesazh shpirtëror të së kaluarës, veprat monumentale të popujve janë në kohën tonë dëshmi e gjallë e traditave të tyre shekullore. Njerëzimi, që çdo ditë bëhet i përgjegjshëm për unitetin e vlerave njerëzore, i konsideron ato si pasuri të përbashkët dhe përball brezave të ardhshëm është bashkërisht përgjegjës për ruajtjen e tyre. Ai duhet që këtë pasuri të këtyre brezave t’ua transmetojë me të gjithë pasurinë dhe vërtetësinë e saj”.



Fig. a.



Fig. b.



Fig. c.



Fig. d.



Fig. e.



Fig. f.



Fig. g.



Fig. h.



Fig. i.

Bibliografia

- Çaushi, Abedin. Etnografia Shqiptare 1. Dyfekçinjte dhe armët në Elbasan në shekullin e XIX.
- Feilden, Bernard & Jokilehto, Jukka (2010) Udhëzues për menaxhimin e trashëgimisë kulturore. ICCROM, UNESCO, ICOMOS. *Cultural Heritage without Borders*.
- Gjergji, Andromaqi. Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri. Etnografia Shqiptare shek. VII. Akademia e shkencave RPSH (1976), Instituti i Historisë. Sektori i Etnografisë. Tiranë.
- Gjergji, Andromaqi (2006). *Arti i zbatuar popullor*. Tiranë.

- Onuzi, Afërdita & Gjergji, Andromaqi & Tirta, Mark & Dojaka, Selimi & Yllka. Shkurti & Spiro. Veshjet Popullore Shqiptare 1,2,3. Botim i *Institutit të Kulturës Popullore*. Departamenti Etnologjisë.
- Onuzi, Afërdita (2003). Larmia e stolive popullore të punuara nga mjeshtrat argjendarë Shkodranë. *Shkodra në shekuj*. Vëllimi II. Muzeu historik Shkodër.
- Qatipi, Hasan. *Etnografia Shqiptare 1: Prodhimi i drurit me anë të sharës së ujit në krabinat e Elbasanit nga shek. i XVIII deri në ditët tona*.
- Shkodra, Zija. Etnografia Shqiptare (shek. XV-XX). *Instituti i Historisë*.
- Shkodra, Zija. Qyteti Shqiptar gjatë rilindjes kombëtare. *Instituti i Historisë*.

Marrëdhëniet politike mes Shqipërisë dhe Kinës në vitet '70

Dokt. Alba KREKA

LEKTORE NË UNIVERSITETIN "FAN.S.NOLI", KORÇË

Abstrakt: *Një aleancë e pabarabartë është instrumenti më i mirë i një Fuqie të Madhe për të legjitimuar artin e qeverisjes, qëllimet e politikës së jashtme dhe objektivat e saj kundrejt një Fuqi të Vogël. Në marrëdhëniet bilaterale mes një Fuqie të Vogël dhe një Fuqie të Madhe, në shumicën e rasteve Fuqia e Vogël është konsideruar më tepër si satelit i Fuqisë së Madhe sesa një aleat i barabartë në këto marrëdhënie. Megjithatë një aleancë nuk duhet të zhvillohet domosdoshmërisht në kushte të barabarta për të dy vendet sepse interesat që i bashkojnë mund të mos jenë interesa të njëjta ekonomike dhe ushtarake por më shumë interesa politike. Ky ishte rasti i Kinës dhe i Shqipërisë, të cilat filluan një marrëdhënie të pabarabartë mes tyre. Kinës i interesonte një mbështetje politike në Europë për të propoganduar vijën e saj politike dhe për të sfiduar influencën sovjetike, e cila ishte dominuese brenda bllokut komunist.*

Bashkëpunimi ndërmjet RPSH dhe RPK u shtri në të gjitha fushat. Kina ishte një partner model për Shqipërinë, e cila e ndihmoi për të ecur para, ndërsa RPSH i shërbeu aleancës si zëdhënëse e interesave dhe qendrimeve kineze në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare deri në pranimin e Kinës si anëtare me të drejta të plota në OKB, në tetor të vitit 1971. Pas kësaj ngjarje, Kina filloi të ndiqte një politikë me "dyer të hapura", e cila në terminologjinë e kohës u cilësua si "diplomacia e ping-pongut". Në vitet '70 dhe më vonë Kina u shndërrua në një lojtar të fuqishëm global, i cili nuk mund të anashkalohej. Udhëheqja shqiptare duhet të rishikonte sërish pozicionin e saj në bllokun komunist. Ndryshimi i strategjisë në politikën e jashtme kineze, shkaktoi pakënaqësi ndaj liderit komunist shqiptar sepse në politikën e jashtme të Kinës tashmë kishin zënë vend interesat kombëtare, duke lënë në plan të dytë ideologjinë, e cila kishte shërbyer si gur themeli për aleancën Shqipëri – Kinë.

Fjalët kyçe: *Aleancë, pabarazi, politikë, OKB.*

Hyrje

Situata ndërkombëtare dhe ajo brenda bllokut komunist filloi të ndryshonte kur në krye të BRSS erdhi Nikita Hrushovi. E gjithë bota priste një ndryshim të politikës sovjetike, madje edhe një hapje më të madhe me Perëndimin. Qendrimi dhe kundërshtimi i E.Hoxhës kundrejt Kongresit të XX-të të Partisë Komuniste të BRSS dhe gjithë ndryshimeve që po ndodhnin në BS, ishte një luftë që ai po bënte për të siguruar mbijetesën e tij. Doktrina e bashkëkzistencës paqësore, pjesë e kursit të ri të Hrushovit nënkuptonte hapje me Perëndimin dhe rrjedhimisht edhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individit. Nqs ndodhte kjo në Shqipëri, atëherë hidhej poshtë një metodologji staliniste e cila ishte ndjekur për jo pak kohë. E. Hoxha kishte kuptuar se ekzistonte një tjetër vullnet i fuqishëm, Mao Ce Duni në Kinë, i cili nuk e kishte pranuar goditjen e “kultit të udhëheqësit” dhe nuk do të pranonte një rrugë liberale për drejtimin politik të vendit. Vitet '60 treguan se Shqipëria ndodhej në një udhëkryq sepse në rradhë të parë duhet të vërtetonte që vazhdonte të ishte pjesë e botës komuniste edhe pse ishte shkëputur nga BS dhe së dyti, një aleancë e mundshme me Kinën do ta ndihmonte atë politikisht dhe ekonomikisht. Ngërcin që kishte sjellë shkëputja e marrëdhënieve me BS dhe me vendet e tjera të Europës Lindore, udhëheqja shqiptare e kishte zëvendësuar me mbështetjen kineze.

Aleanca me Kinën i siguroi liderit komunist shqiptar një politikë autonome, pa çenuar pavarësinë e brendshme. Parimet që rregulluan marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kinës u përmendën në vitin 1964 në deklaratën e përbashkët kinezo-shqiptare, e nënshkruar me rastin e vizitës së parë të Cu En Lait në Tiranë. Në këtë deklaratë sanksionoheshin marrëdhëniet mes dy vendeve si marrëdhënie të një lloji të vecantë, të bazuara tek barazia, respekti reciprok, sovraniteti, pavarësia dhe mosndërrhyrja në punët e brendshme të secilit vend. Interesi për të konsoliduar aleancën ishte reciprok. Shqipërisë i duhej një mbrojtje e jashtme për t'u paraqitur e sigurt në arenën ndërkombëtare, në një kohë kur marrëdhëniet me dy fqinjët e saj, Greqinë dhe Jugosllavinë nuk ishin fort të qeta. Kjo paranojë e E. Hoxhës sa vinte dhe rritej dhe u bë një frikë reale kur BRSS rivendosi kontaktet me Beogradin. Çështja e “revizionizmit jugosllav” kishte një impakt të madh në udhëheqjen komuniste shqiptare. Rehabilitimi i Titos nënkuptonte edhe rehabilitimin e një sërë figurash të rëndësishme politike në të gjitha vendet komuniste, përfshirë edhe Shqipërinë. Në këto kushte, duke shfrytëzuar interesat e përbashkëta, si Shqipëria ashtu edhe Kina shfrytëzuan rrethanat ndërkombëtare por mbi të gjitha konfliktin sovjetik – kinez, i cili mund t'i sillte ndryshime bllokut komunist në përgjithësi. Kjo mund të konsiderohet si një mundësi për të treguar se “ndarja e bllokut sovjetik - kinez dhe sovjetik - shqiptar ishte për shkak të polemikës ndaj Jugosllavisë”. (Griffith, 1963, f.154) Një detente e vendosur nga BRSS me Jugosllavinë por edhe

me Perëndimin, u pa nga Hoxha si një kërcënim për regjimin e tij sepse mund të minonte logjikën e represionit të tij të brendshëm.

Që nga kjo kohë, tre vjet pas prishjes me BRSS, Shqipëria ndau të njëjtin qendrim me Kinën ndaj politikës së brendshme dhe të jashtme. Ndryshe nga BRSS dhe vendet e tjera të Europës Lindore, ajo refuzoi detantën me Perëndimin në favor të një beteje ideologjike, politike dhe ekonomike mes kampit socialist dhe Perëndimit. Në të njëjtën kohë Shqipëria doli kundër doktrinës së bashkëkzistencës paqësore duke e cilësuar si të rrezikshme dhe kundër revolucionare, nënvlerësoi rrezikun e një luftë atomike dhe mbi të gjitha ishte e bindur se qëndrimi i saj kundër kapitalizmit dhe imperializmit i rriste vlerat marksizëm – leninizmit dhe socializmit në gjithë botën. Në politikën e brendshme, Shqipëria ashtu si dhe Kina, përshendeti diktaturën e proletariatit si një institucion jetik dhe i pazëvendësueshëm i një vendi socialist; refuzoi liberalizimin ekonomik dhe kulturor në favor të një kontrolli të rreptë partiak dhe mbi të gjitha rriti vigjilencën ndaj depërtimit dhe përhapjes së ideologjisë së revizionizmit dhe borgjezisë. Me pak fjalë “Tirana dukej se ishte ngushtësisht e lidhur me versionin kinez të Stalinizmit. Marksizmi shqiptar ishte kinez në formën e tij por gjithsesi mbeti shqiptar në stil dhe përmbajtje”. (Prifti, 1999, fq.18)

Bashkëpunimi shqiptaro – kinez për çështje ndërkombëtare të kohës

Politika e brendshme dhe e jashtme e Shqipërisë ka qenë e influencuar nga perceptimet qeverisëse të elitës së saj dhe shteteve të tjera. Pikat e përbashkëta të Shqipërisë dhe Kinës përta i përket bashkëpunimit ekonomik, politik dhe ideologjik dolën në dukje edhe më shumë në kuadrin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Kina kishte vendosur prej një kohë të gjatë distancë me vendet kapitaliste në përgjithësi por sidomos me SHBA-në për çështjen e Vietnamit dhe Tajvanit dhe Moskën për krizën kubane në 1962. Duke e parë në këtë këndvështrim, politika që ndiqte Kina i përgjigjej më së miri politikës shqiptare të atyre viteve. PKK e shihte qeverinë shqiptare si “bastionin më të pastër në mbrojtje të doktrinës marksiste-leniniste”. (Biberaj, 1986, fq. 45)

Periodha midis viteve 1961- 1968 karakterizohet nga një bashkëpunim paralel mes Tiranës dhe Pekinit në politikën e brendshme por sidomos në atë të jashtme. Ndërmjet dy vendeve kishte nisur bashkëpunimi për çështje të botës komuniste si qendrimi ndaj lëvizjeve liberale, çaromatimi dhe lufta bërthamore, bashkëkzistenca paqësore, lufta e klasave dhe diktatura e proletariatit. Udhëheqja komuniste shqiptare gjeti një protektor të rëndësishëm tek RPK, e cila jo vetëm do ta mbronte Tiranën nga Beogradi në kohën e riafrimit mes Titos dhe Hrushovit por në të njëjtën kohë do të përballlej me Moskën pak a shumë në kushte “të barabarta”. Kjo nënkuptonte mbështetje ndaj Shqipërisë, të cilën e shihte si një mundësi

për t'u konfrontuar me Moskën që nga Europa. Megjithatë “do të ishte gabim të mendonim se Shqipëria në këtë kohë ishte thjesht një zëdhënëse e politikës kineze, pa asnjë iniciativë për veprime të pavarura apo pa asnjë ndikim në Pekin. Dukej se kishte një interes reciprok ndërmjet gjigandit të Lindjes dhe kombit të vogël shqiptar gjatë brigjeve të Adriatikut”. (Prifti, 1999, fq.29)

Në vitin 1966 në Kinë filloi Revolucioni Kulturor, i cili zgjati për 10 vjet dhe në thelb ishte një “luftë e brendshme për pushtet midis grupeve rivale në udhëheqjen e Partisë Komuniste Kineze”. (Gjecovi et al., Historia e Popullit Shqiptar IV, fq. 302). Revolucioni u përhap në të gjithë vendin madje filloi të aplikohet edhe në Shqipëri, sigurisht në përputhje me kushtet në të cilat ndodhej vendi në atë kohë. E. Hoxha implementoi ato reforma që “i leverdisnin atij politikisht për të çimentuar pushtetin e tij, madje pati raste kur kopjet shqiptare të këtyre lëvizjeve nuk ishin identike me ato kineze”. (Duka, 2007, fq.287) Në sfondin e Revolucionit Kulturor Kinez, PPSH mori disa masa si zhvillimi i luftës së klasave, revolucionarizimi i jetës politike brenda strukturave të Partisë, lufta kundër burrokracisë, emancipimi i gruas etj. Në kuadër të revolucionit në Shqipëri u pre rruga çdo lloj lëvizje reformiste, liberale apo kapitaliste. Këtë e vërteton edhe Liu Xen Hua, ambasadori kinez në Shqipëri gjatë bisedës së tij me E. Hoxhën ku mes të tjerave thekson se Revolucioni i madh Kulturor Kinez proletar pati një rëndësi të madhe sepse “u zbuluan shumë elementë të rrezikshëm reaksionarë, tradhëtarë dhe spiunë që kishin hyrë fshehur në rradhët e partisë”. (Arkivi Qendror Shtetëror [AQSH], Fondi [F] 14, Viti [V] 1971. Dosja [D] 1). Revolucioni Kulturor Kinez kishte instrumentat e tij për të vënë në jetë synimet dhe reformat e partisë. Ajo që ishte besuar prej shekujsh në Kinë, mbi mendimin e Konfucit u hodh poshtë, ashtu sic ndodhi edhe në fushën e muzikës, artit sepse u mohuan Bethoveni, Shekspiri, Einshteini etj. E gjithë kultura, shkenca dhe filozofia tashmë i referohej “Citateve të Maos”, një libër që “u bë Bibla e këtij revolucioni, u përkthye në të gjitha gjuhët dhe u shpërnda në të gjithë botën”. (Alia, 2010, fq.252) Në burimet e sotme që i referohen këtyre ngjarjeve të kohës theksohet se përqsja që u bë Revolucionit Kinez në Shqipëri, u bë për oportunitet politik, sepse realiteti i kohës fliste ndryshe. U përdoqën, torturuan dhe u ekzekutuan shumë njerëz të cilët cilësoheshin “revizionistë”, “borgjezë” dhe agjentë të njërit apo tjetrit shtet. Në kuadër të revolucionarizimit të jetës në Shqipëri u morrën masa kundër burrokratizimit në formën e nxitjes së kritikës ndaj veprimeve të gabuara të kuadrove të kohës. Gjithashtu u vendos “Likujdimi i ministrisë së drejtësisë dhe i institutit të avokaturës, me justifikimin se zbatimi i drejtësisë kryhet nga të gjitha institucionet shtetërore, ndërsa mbrojtjen e të akuzuarve e bën vetë shteti, i cili është shtet i punëtorëve dhe i fshatarëve”. (Alia, 2010, fq.256) Veprimi më radikal ishte shpallja e Shqipërisë si shteti i vetëm ateist në botë. Kjo masë ekstreme u justifikua me përpjekjet që u bënë për emancipimin e gruas, proces i cili pengohej nga zakonet e vjetra prapanike. Megjithatë spastrimi

i rradhëve të PKSHE nga elementë të tillë filloi që herët, me ardhjen e komunistëve në pushtet, me prishjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë, me BS dhe së fundi me Kinën. Sa herë që PPSH –së i duhej të ndryshonte kursin politik, spastronte strukturat shtetërore nga përkrahësit respektivë.

Një çështje tjetër që reflektoi bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe Kinës ishte mbështetja që u jepej partive marksiste – leniniste në kuadër të lëvizjes socialiste internacionaliste. Me ardhjen e Hrushovit në pushtet, me shpërthimin e konfliktit sovjetë – kinez dhe me prishjen e marrëdhënieve sovjetë – shqiptare, situata brenda bllokut komunist ndryshoi. Në këto kushte, PPSH dhe PKK tërhoqën rreth vetes ato parti komuniste që e kundërshtuan politikën e re të BS si partitë e Indonezisë, Malajzisë, Birmanisë, Koresë, Vietnamit, Kamboxhias, Laosit etj, të cilat nuk ishin dakord me ndryshimet që duhet të bënin si rezultat i reformave që diktoi Hrushovi. Për këtë arsye partitë m – l ishin të bindura se rruga që ato ndiqnin ishte ajo e drejta dhe rruga që ndiqte Hrushovi ishte e gabuar. Ndihma që u jepej partive m – l shihej si një detyrë internacionaliste dhe për më tepër ishte një instrument që i interesonte PPSH dhe PKK për të vërtetuar se vija dhe qendrimet e tyre ndaj Hrushovit, ishin korrekte dhe për këtë gëzonin simpati dhe mbështetje në botën komuniste: “më shumë se 90% e popullatës botërore e kishin vështrimin nga populli kinez, PKK dhe Mao Ce Duni, të cilët ishin një bastion i rëndësishëm i marksizëm – leninizmit”. (Peking Review 1966, Vol 9, No 19, Marrë nga <http://www.marxists.org/subject/china/peking-revieë/1966/PR1966-19.pdf>). Në përgjithësi grupet marksiste në shtetet europiane ishin të vogla dhe nuk kishin shumë ndikim në vendet e tyre. Një pjesë e tyre u shkrinë gjatë rrugës, ndërsa marksistët e vendeve të tjera jashtë Europës luajtën një rol të rëndësishëm në lëvizjen internacionaliste. Lëvizjet revolucionare të popujve të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine u mbështetën në emër të marksizëm – leninizmit për rivendosjen e diktaturës së proletarietit. Fondet që u shpërndareshin partive m-l janë diskutuar gjatë. Në kujtimet e tij R. Alia (2010) thekson “se u janë dhënë fonde disave, por këto kanë qënë relativisht fare të vogla. Asnjëherë nuk i kalonte 3-4 mijë dollarët”. (fq.241). Fondi në ndihmë të partive m-l sigurohej nga Kina për aq kohë sa RPSH kishte marrëdhënie të mira me të, ndërsa më vonë, financimin e bënte vetë Shqipëria. Një nga arsyet kryesore që nxiti RPK dhe RPSH për të qënë financuese të partive m-l në botë ishte fakti se të dy vendet kërkonin të kishin sa më shumë informacion dhe mbështetje të jashtme për të propoganduar se rruga e tyre ishte parimore dhe e drejtë.

Një tjetër ngjarje që testoi frymën e bashkëpunimit ishte edhe invazioni i vitit 1968 në Çekosllovakë sepse ky veprim u konsiderua arbitrar. Në shtypin e kohës të partive marksiste – leniniste shkruhej se një veprim i tillë nuk tregonte gjë tjetër vecse ndarjen e botës në zona të influencës mes BS dhe SHBA. Madje u arrit deri aty sa të bëhej një paralelizëm mes “imperializmit amerikan” dhe “revizionizmit

sovjetik”. Veprimet e sovjetikëve në emër të Traktatit të Varshavës ishin arbitrare duke patur parasysh qëllimin për të cilin u krijua ky Pakt. Shkelja e këtij Pakti coi në ndërhyrjen në Çekoslovakia dhe madje nxiti frikën e shteteve të tjera komuniste për ndonjë sulm të mundshëm. Këtë frikë pati edhe udhëheqja komuniste shqiptare, e cila si kundërpërgjigje denoncoi Traktatin e Varshavës dhe në këtë mënyrë “do çlirohej nga cdo obligim që rridhte si rezultat i të qenit pjesë e Paktit”. (Prifti, 1999, fq.10). Në këtë mënyrë as BS dhe asnjë shtet tjetër, anëtar i këtij Pakti nuk do ta përdorte Traktatin për të ndërhyrë në Shqipëri. Këtë e konfirmoi edhe kreu i ushtrisë kineze Huang Yung-Sheng gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 1968 ku theksoi se veprimi i Shqipërisë për të denoncuar Traktatin e Varshavës duhej përshëndetur “si një akt revolucionar sepse duke okupuar Çekoslllovakinë, BS synoi drejt Bullgarisë dhe më tej nëpërmjet daljes në Mesdhe mund të kërcënonte sigurinë e RPSH dhe shteteve të tjera ballkanike”. (Peking Review 1968, Vol 11, No 50. Marrë nga <http://www.marxists.org/subject/china/peking-review/1968/PR1968-50.pdf>). Moska mbajti një qëndrim të ashpër ndaj vendimit të RPSH për të denoncuar Traktatin e Varshavës. Në një emision radiofonik në BS, një komentator rus i adresoi RPSH disa pyetje retorike lidhur me ngjarjet e fundit të kohës. “A ka mundësi që Traktati i Varshavës ta ketë humbur rëndësinë në lidhje me sigurinë e Shqipërisë?...E ka harruar Tirana që Kongresi i ashtuquajtur i Epirotëve në Janinë ka deklaruar hapur se Greqia është në luftë me Shqipërinë dhe kjo mund të nënkuptojë që jugu i Shqipërisë të aneksohet nga Greqia?”. (Peking Review 1968, Vol 11, No 50. Marrë nga <http://www.marxists.org/subject/china/peking-review/1968/PR1968-50.pdf>). Të gjitha këto deklarata ishin një formë presioni nga ana e BS që Shqipëria të rishikonte edhe njëherë vendimin për të zhvilluar më tej aleancën me RPK. Por ky vendim tashmë ishte marrë dhe madje ishte i pandryshueshëm në kushtet në të cilat ndodhej Shqipëria. Mesazhet e udhëheqjes kineze në mbështetje të veprimeve shqiptare për dënimin e ndërhyrjes sovjetike në Çekoslovakia dhe për denoncimin e Traktatit të Varshavës, dëshmuar edhe njëherë bashkëpunimin dhe ndihmën kineze në kuadër të aleancës, edhe pse nuk ishte nënshkruar ende një traktat – marrëveshje për ndihmë të përbashkët mes dy vendeve.

Siguria europiane ishte një tjetër çështje me rëndësi në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare të kohës. Në kushtet e Luftës së Ftohtë, dy blloqet kryesore Lindje – Perëndim vazhdonin garën e armatimeve. Përpyekjet për të stabilizuar gjendjen u bënë të shpeshta dhe nëqoftëse arrihej fryma e bashkëpunimit, gjendja e krijuar mund të pësonte një evolucion të madh pozitiv. Ndërkohë që Lindja dhe Perëndimi intensifikonin përpjekjet për të realizuar një sigurim të përgjithshëm europian. RPK, RPSH dhe disa parti të tjera m-l i shihnin këto nisma “si një propogandë të madhe, sidomos nga ana e klikave revizioniste, për të vendosur një paqe fallco në Europë dhe kjo përbente rrezik për Kinën. Shqipëria duke qenë si një trup i vetëm

me RPK, nuk mund të jetë në favor të një marrëveshjeje o traktati që përgatitet në dëm të aleates sonë.” (AQSH, F 14, Viti 1972, D 2). Duke iu referuar gjykimit të RPSH dhe RPK, mundësia e arritjes së sigurimit europian ishte e vështirë për shkak të politikave hegjemoniste të shteteve, ekzistencës së dy blloqeve ushtarake si NATO dhe Traktati i Varshavës, ndërhyrjes në Çekosllvaki por gjithashtu edhe marrëdhëniet në ekonomi të cilat karakterizoheshin nga një bashkëpunim i pabarabartë mes vendeve. Gjithsesi kufizimi i armëve bërthamore dhe vendosja e një paqe ndërkombëtare ishin objektivat kryesore që shqetësonin botën. Sipas një gazete të kohës (Stone), pjesëmarrja e kinezëve nuk ishte e domosdoshme për të gjitha marrëveshjet e kontrollit të armëve. BS dhe Shtetet e Bashkuara nuk mund ta injoronin Kinën në lidhje me çarmatimin, edhe pse autorët sugjerorin se të dy superfuqive mund të arrinin në marrëveshjeje pavarësisht opionencës kineze. Udhëheqësit sovjetikë nga ana tjetër duhet të ishin të kujdesshëm sepse një pozitë kërcënuese mund të shtonte bashkëpunimin kino-amerikan. Niksoni ishte i mendimit se Amerika nuk mund të përjashtonte nga alternativat diplomatike të saj “një vend të përmasave të Kinës sepse në të kundërt do të thoshte që Amerika të vepronte në fushën ndërkombëtare me një dorë të lidhur nga pas”. (Kissinger, 1999, fq.721). Në vitet ’70, administratës së Niksonit po i bëhej presion nga Kongresi dhe media që t’i rikthehej bisedimeve me sovjetikët për kontrollin e armëve. Por gjithashtu një nga objektivat e Niksonit në këtë kohë ishte edhe një dialog i mundshëm mes SHBA dhe Pekinit. Niksoni mori ndoshta hapin më të guximshëm gjatë presidencës së tij, duke paralajmëruar se “BS se SHBA nuk do të qëndronin indiferente në rast se ai do të sulmonte Kinën”. (Kissinger, 1999, fq 723). Vënia në jetë e këtij qëllimi të diplomacisë amerikane nënkuptonte një ekuilibër global por edhe mbrojtje të interesave kombëtare amerikane.

Çështja e kufirit kino-rus u diskutua shumë dhe madje nxiti reagime të palës shqiptare në momentin kur kinezët menduan për një takim të mundshëm me Kosiginin. Çështjet e kufirit ishin shumë të ndjeshme aq sa sollën edhe reagimin e SHBA. Niksoni kërkonte të ulte tensionet me Kinën dhe mendoi se rruga më e mirë për ta bërë këtë, ishte mbështetja për një politikë të hapur ndaj saj, edhe pse në deklaratat zyrtare thuhej se SHBA nuk dëshironte të ndërhynte në marrëdhëniet sovjetiko – kineze. “Ne nuk do të bëjmë asgjë për të acaruar këtë konflikt – as për ta nxitur atë, ashtu si nuk do lejojmë as Kinën Komuniste dhe as BS të diktojnë politikat dhe qëndrimin tonë ndaj tyre...Ne do të na duhet të gjykojmë për Kinën, si dhe për BS, jo në bazë të retorikës, por të veprimeve të tyre”. (Kissinger, 1999, fq. 725). Për zgjidhjen e këtij konflikti u realizua një takim mes Kosiginin dhe përfaqësuesve kineze. Në fakt ky takim mendohej të zhvillohej në fshehtësi, ashtu sic deklaroi edhe Kan Shen në një bisedë me tij dhe Rita Markos në Pekin “lidhur me ardhjen e Kosiginin në Pekin, ne nuk do publikojmë gjë por sovjetikët mund të publikojnë” (AQSH. F 14, Viti 1969, D. 7). Këtë vizitë të Kosiginin në Pekin, PPSH

nuk e priti mirë, pavarësisht se udhëheqja kineze u mundua të jepte shpjegimet e saj. Në takimin e Cu En Lait me përfaqësuesit e ambasadës shqiptare në Pekin, u diskutua në lidhje me këtë ngjarje duke bërë edhe krahasime me vende të tjera. “Ne bëjmë bisedime me amerikanët për vite të tëra; Stalini bisedoi me Ribentropin, po ashtu edhe Molotovi”. (AQSH. F 14, V 1969, D.8) Në vitin 1969 marrëdhëniet sovjeto-kineze ishin acaruar dhe nuk mund të zgjidheshin nga takimet e palëve në kufi por vecse me një vizitë të nivelit të lartë shtetëror mes palëve. Me kërkesën e sovjetikëve dhe me miratimin e Maos, u caktua vizita shtetërore e Kosiginit në datën 11.09.1969 por nga pala kineze u theksua se “këtu nuk ka asgjë që të ketë të bëjë me punë partie, ne biseduam vetëm në rrugë shtetërore”. (AQSH. F14, V1969, D 8). Mesa duket kjo zbutje tensionesh mes Kinës dhe BS nënkuptonte ndjekjen e një politike më të hapur të Kinës, e cila pavarësisht nga deklaratat për shtyp kundër “revizionizmit sovjetik dhe imperializmit amerikan” kërkonte t’i jepte fund izolimit ndërkombëtar. Ky fakt bëhet më i besueshëm kur Cu En Lai pranon para përfaqësuesve shqiptare rëndësinë e kësaj vizite “sidomos tani që jemi në pargun e OKB”. (AQSH. F14, V1969, D 8)

Rivendosja e të drejtave legjitime të Kinës në OKB

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) u themelua pas Luftës së Dytë Botërore, në 1945 dhe kishte në përbërje të saj 51 shtete. Kina ishte një nga vendet anëtare, themeluese të OKB-së si dhe anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit. Konflikti për t’u përfaqësuar në OKB lindi pas revolucionit kinez të vitit 1949, kohë kur fitimtare doli PK e Kinës dhe Kina u shpall Republikë Popullore. PK e shpalli veten si të vetmen trashëgimtare duke kërkuar në të njëjtën kohë nxjerrjen jashtë OKB-së, përfaqësuesit e Republikës së Tajvanit me Chaing Kai Shi-në në krye. Çështja e rivendosjes së të drejtave të Kinës në OKB është shoqëruar me ulje – ngritje për shkak të interesave të shteteve të ndryshme dhe terrenit të krijuar nga vendet anëtare të OKB. Që nga sesioni i parë deri në v 1959, kërkesa për vënien në rendin e ditës të përfaqësimit të Kinës në OKB u bë nga India. Për sa kohë që Kina gëzonte marrëdhënie miqësore me BS “kërkesën e saj për t’u pranuar në OKB deri në vitin 1961, e prezantoi BS, i mbështetur edhe nga vendet e tjera komuniste” ndërsa me prishjen e marrëdhënieve dypalëshe BS - Kinë, që nga viti “1964 iniciativën e mori Kamboxhia, ndërsa Shqipëria së bashku me disa shtete të tjera nga Azia dhe Afrika u bënë bashkëautore me projekt - rezolutën e Kamboxhias”. (H. Kaba, 2007, fq.166). Përbalë rezolutës së BS qendronte ajo e SHBA, e cila interesohej më shumë për ecurinë e qendrimit të Kinës pas anëtarësimit në OKB.

Në vitet ’70, pala shqiptare e nxitur nga ajo kineze, u angazhua seriozisht që çështja të vendosej në rend të ditës gjatë diskutimeve në OKB. Qeverisë kineze i interesonte të kishte sa më shumë informacion mbi zhvillimet e OKB dhe sidomos

mbi qendrimet e delegacioneve të shteteve të tjera. Gjatë korrespondencave të kohës mes qeverisë kineze dhe asaj shqiptare, kësaj të fundit iu dhanë udhëzime për ta paraqitur çështjen dy muaj para hapjes së sezonit në mënyrë që “të mos u lihej kohë revizionistëve, sovjetikë e të tjerëve për të marrë iniciativën për një kërkesë të tillë”. (Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme [AMPJ], V 1965, D 147). Sa më shumë mbështetës të kishte RPK në OKB, aq më e lehtë do të ishte rruga drejt pranimi, pavarësisht se RPK e paraqiste (në bllokun komunist) “si një luftë diplomatike kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik dhe për këtë arsye duhet të bëjmë sa më shumë miq me vlerë dhe të sigurt në çështjen tonë”. (AQSH, F 14, V 1970, D 4) Në fakt Kina i frikësohej më tepër një ballafaqimi me sovjetikët sesa me amerikanët pasi konflikti sovjeto – kinez ishte përshkallëzuar akoma dhe më shumë sidomos për çështjen e kufirit kino – sovjetik. Në këto kushte Kinës i duhej të realizonte sa më shpejt qëllimin e saj për t’u bërë pjesë e OKB duke u mbështetur tek shtetet komuniste anëtare të kësaj organizate. Shqipëria dhe Kina e mbështetën njëra – tjetrën dhe qeveria e RPSH ishte një informator i vlefshëm brenda strukturave të OKB.

Si rezultat i insistimit të vazhdueshëm nga pala shqiptare, në 15 korrik 1971, pas konsultimeve me bashkëautorët, u paraqit kërkesa për vënien në rend të ditës të sesionit të 26 të çështjes “Rivendosja e të drejtave të ligjshme të RPK në OKB. Nga ana tjetër përfaqësuesit e SHBA (Xhorxh Bush) paraqiti një çështje mbi përfaqësimin e Dy Kinave në OKB”. (AQSH, F 14, V 1971, D 570). Deri në seancën e fundit të tetorit ende nuk mund të përcaktohej nëse do të aprovohej rezoluta shqiptare apo jo sepse influenca e rezolutës amerikane ishte ende e madhe. Në punimet e rradhës “u kalua në votimin e projekt-rezolutës amerikane të 2/3-ve, e cila u hodh poshtë me rezultatin 55 në favor, 59 kundër dhe 15 abstenime.” (AQSH, F 14, V 1971, D 570) Pas kësaj u kalua në votimin e rezolutës shqiptare për të cilën “votuan 76 delegacione, 35 votuan kundër dhe 17 abstenuan”. (AQSH, F 14, V 1971, D 570). Si rezultat i këtij votimi RPK rifitoi të drejtën për të qënë pjesë e OKB. Anëtarësimi i Kinës në OKB ishte një hap para sepse i dha mundësi shtetit kinez që të dilte nga izolimi ndërkombëtar. Për një kohë të gjatë rolin e zëdhënës në OKB por edhe në mbledhje të tjera ndërkombëtare e kishte bërë Shqipëria, ndërsa tani nuk ishte më e nevojshme; Kina do përballej vetë me realitetin ndërkombëtar. Rivendosja e të drejtave të saj në OKB ishte një fitore e cila u arrit nga kushtet e krijuara në atë kohë. Gjatë 10 viteve përpjekjet ishin të shumta por peshorja anoi nga Kina në kohën kur një pjesë e mirë e shteteve u renditën pro projekt - rezolutës shqiptare por mbi të gjitha në kohën kur ndryshoi qendrimi i RPK ndaj SHBA dhe anasjelltas. Vizita e Kissingerit në Kinë dhe caktimi i vizitës së ardhshme të Niksonit e zbutën politikën armiqësore që ishte ndjekur deri në atë kohë. SHBA kishte vendosur që të hynte vetë në kontakt me vendet komuniste, sidomos me Pekinin dhe ishte e bindur se do të arrinte të thyente

akullin e krijuar prej kohësh. Synimet e saj ishin strategjike dhe pragmatiste sepse në kohën e duhur ajo shfrytëzoi edhe mosmarrëveshjet mes BS – Kinës. Në vitin 1971 të gjitha vendet ishin ndërgjegjësuar se kishte ardhur koha që Kina të ishte pjesë e OKB dhe kjo u duk edhe nga votimi pro pranimit të Kinës në OKB nga Anglia, Franca, Italia, Holanda etj si dhe të gjitha vendet e bllokut komunist, duke përfshirë edhe BRSS dhe Jugosllavinë.

Duke parë zhvillimet e fundit dhe orientimin e RPK ndaj “hapjes me Perëndimin”, RPSH tashmë kishte filluar ta shihte në mënyrë të zbehtë rolin e OKB sepse në gjykimin e saj “nuk mund të shpresohet për asgjë të rëndësishme nga OKB por ajo mbetet një qendër ku jepen mundësi të gjera për ta shfrytëzuar për propogandimin e politikës së Partisë”. (AQSH, F 14, V 1971, D 570). Ndryshimi i politikës së jashtme kineze përcaktoi edhe politikën e brendshme sepse ideologjia që zinte vendin kryesor në këtë politikë po zëvendësohej nga interesat kombëtare. Që nga korriku i vitit 1971, kur Kina ftoi zyrtarisht presidentin amerikan të vizitonte Kinën dhe deri në dhjetor të vitit 1972, Kina arriti të vendoste marrëdhënie diplomatike me mbi 30 vende; në vitin 1972 me Japoninë dhe në vitin 1979 me SHBA. Politika e jashtme e Kinës tashmë kishte ndryshuar dhe ideologjia që kishte shërbyer si themeli bazë për aleancën Shqipëri – Kinë, tashmë nuk ishte më primare sepse Kina po tregojë gjithnjë e më tepër realiste. Në vitet ’70 dhe më vonë ajo u shndërrua në një lojtar të fuqishëm global, i cili nuk mund të anashkalohej.

Perfundime

Bashkëpunimi Kinë-Shqipëri mund të konsiderohet një aleancë e pabarabartë duke marrë parasysh rëndësinë dhe fuqinë reale të këtyre dy shteteve në arenën ndërkombëtare. Shqipëria deklaroi mbështetjen e saj në favor të Kinës në konfliktin sovjetik – kinez dhe si kundërpërgjigje Kina i ofroi mbështetje politike dhe ndihmë ekonomike. Vec të tjerash aleanca me Kinën i jepte Shqipërisë siguri sepse nuk cënohej integriteti territorial i saj. Kina kishte treguar se nuk pajtohej kurrsesi me “revizionizmin sovjetik dhe imperializmin amerikan” dhe kjo ishte një çështje që i bashkoi politikën e tyre për shumë kohë. Palës kineze i interesonte qendrimi që mbante qeveria shqiptare për çështje ndërkombëtare që lidheshin me pozitën kineze. Shqipëria do të shërbente si një vendndodhje e Kinës në Europën Lindore nga e cila Kina mund të lobonte idetë e saj ndaj BS. Përfitimi ishte i ndërsjelltë për të dy vendet sepse nga njëra anë Shqipëria përfitoi mbështetje por nga ana tjetër “mbështetja e Shqipërisë shërbeu si një legjitimizim i ideologjisë kineze”. (L. Miller 2000, Vol 1, Issue 2, Sapientia, Marrë nga http://www.abdn.ac.uk/pir/postgrad/vol1_issue2/issue2_article3.hti 2000, f.2).

Vitet ’70 ishin një periudhë e vështirë jo vetëm në arenën ndërkombëtare por

edhe për binomin RPK-RPSH. Udhëheqja shqiptare duhet të rishikonte sërish pozicionin e saj në bllokun komunist. Ndryshimi i strategjisë në politikën e jashtme kineze shkaktoi pakënaqësi ndaj liderit komunist shqiptar. Politika që filloi të ndiqte Kina dhe SHBA i përgjigjej një politike me “dyer të hapura”. Në verën e vitit 1969, Niksoni mori dy vendime të rëndësishme. Së pari të linte mënjane të gjitha çështjet që shërbenin si pengesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kino – amerikane dhe të fokusohesh në një dialog të gjerë. “Në rast se ne përcaktonim atë që mendonim – që BS dhe Kina kishin më shumë frikë nga njëri – tjetri, sesa nga SHBA – diplomacisë amerikane do t’i krijohej një mundësi e jashtëzakonshme”. (H. Kissinger, 1999, fq. 723). Sipas analizës së Niksonit dhe këshilltarëve të tij, për aq kohë sa Kina i trembej më shumë BS sesa SHBA, interesat e Kinës do ta detyronin atë të bashkëpunonte me SHBA. Meqënëse marrëdhëniet kino-amerikane u shfaqën sërish pas njëzet vjetësh, gjithçka ishte krejtësisht e re dhe mjaft e rëndësishme në atë që ndodhi më vonë. BS iu bë e qartë se SHBA nuk do të qendronte indiferente në rast të ndonjë sulmi të mundshëm ndaj Kinës. Pavarësia e Kinës konsiderohej nga diplomatët amerikanë si e domosdoshme për ekuilibrin global. Në dhjetor të vitit 1970 Mao i dha intervistë Edgar Snow-t, një gazetari amerikan por dashamirës i komunistëve kinezë, ku ftoi Niksonin të vizitonte Kinën, qoftë si turist, qoftë si President i SHBA-së. “Uashingtoni nuk mori vesh fare për ftesën, derisa çështja e vizitës së Niksonit ishte zgjidhur nëpërmjet kanaleve të tjera, shumë muaj më vonë”. (H. Kissinger, 1999, fq.726). Bisedimet kalonin në ulje – ngritje të shpeshta si rezultat i çështjeve të shumta politike që duhet të zgjidhnin të dy vendet. Edhe pse pala shqiptare fillimisht i shihte të largëta bisedimet me amerikanët, mosmarrëveshjet e para kino-shqiptare u përshkallëzuan me vizitën e Kissingerit, e cila përcaktoi edhe ardhjen e presidentit amerikan Nikson në Kinë, në shkurt të 1972. Ardhja e Kissingerit kishte dy qëllime, së pari të përgatiste kushtet për vizitën e presidentit amerikan dhe së dyti të nxiste bisedimet paraprake për të arritur në ato të nivelit të lartë. Ritmi i shpejtë i ngjarjeve tregoi se të dy palët kërkonin një bashkëpunim në bazë interesash të përshtatshme. Kjo ishte arsyeja përse, më vonë, një nga komentet e Maos për Niksonin ishte: “Çështja e vogël është Tajvani; çështja e madhe është bota”. (H. Kissinger, 1999, fq.727). Kinës i interesonte të dinte që SHBA nuk do të bashkëpunonte me BS, ndërsa SHBA i interesonte të dinte nëse Kina mund të bashkëpunonte me Amerikën për të penguar ofensivën gjeopolitike sovjetike. Qëllimet e secilës palë ishin në thelb konceptuale prandaj edhe faza e hershme e bisedimeve dypalëshe kineze dhe amerikane u përqëndrua në ndërthurjen e koncepteve dhe qendrimeve themelore. Në takimin e Niksonit me Maon, udhëheqësi kinez nuk humbi kohë për të siguruar presidentin amerikan se Kina nuk do të përdorte forcën kundër Tajvanit. Në këto kushte u nënshkrua Komunikata e Shangait, në shkurt 1972 sipas së cilës shtrohej një rrugë e re në marrëdhëniet kino – amerikane për vitet

në vazhdim. Më shumë se gjysma e Komunikatës fliste për kontradiktat mes dy palëve në ideologji, në marrëdhëniet ndërkombëtare, për Vietnamin, Tajvanin etj. “Brenda një viti e gjysëm, marrëdhëniet kino – amerikane kishin kaluar nga armiqësia e egër dhe izolimi, në aleancë de facto kundër kërcënimit predominues”. (H. Kissinger, 1999, fq.728)

E. Hoxha i trembej bisedimeve sekrete që mund të ishin bërë mes amerikanëve dhe kinezëve sepse nuk kishte informacion në lidhje me atë çfarë mund të ishte biseduar. “Diplomacinë e fshehtë ka filluar ta praktikojë me dashje edhe Kina socialiste. Asnjëri, qoftë mik, qoftë armik i Kinës, nuk di, nuk merr vesh ç’po ngjet në mes SHBA dhe Kinës. Miqtë e Kinës, sidomos, nuk dinë asgjë.” (E. Hoxha, 1979, fq. 24). Paranoja e E. Hoxhës u shtua edhe më tepër nga Teoria e “Tre botëve” e Maos, e cila nuk u pëlqye dhe udhëheqja kineze u akuzua se po ndiqte të njëjtën politikë si SHBA dhe BS, duke krijuar superfuqinë e tretë në botë, Kinën. PPSH e pa këtë politikë të re të Kinës si “kërcënim” për statusin e saj. Afrimi i RPK me SHBA pati dy anë të medaljes. Nga njëra anë Kina “adoptoi taktikën e mbështetjes në njërën superfuqi (SHBA) për të luftuar superfuqinë tjetër (BS)” (Xh. Gjecovi et al., Historia e Popullit Shqiptar IV, fq. 303) dhe nga ana tjetër, qeveria shqiptare e pa këtë afrim si një mesazh mënjanimi nga politika kineze. Këto iniciativa të politikës kineze shënuan një largim nga qendrimi prej një kohë të gjatë besnik i pozicionit të Tiranës me botën komuniste dhe “imperialiste” gjithashtu. Aktivitetet diplomatike të Pekinit që nga viti 1969 në raport me Moskën dhe Uashingtonin u interpretuan nga udhëheqja shqiptare si “një dëshirë për t’u marrë vesh me dy superfuqitë dhe për të përqafuar doktrinën e bashkekzistencës paqësore. Në fakt, rekrutimi i miqve politikë nga ana e Kinës mund të nënkuptonte se Pekini nuk do të kishte aq shumë nevojë për mbështetjen politike dhe ideologjike shqiptare në të ardhmen”. (P. Prifti, 1999, fq.50) Kjo u bë fakt me anëtarësimin e Kinës në OKB (edhe falë ndihmës së qeverisë shqiptare) në vitin 1971 sepse Kina kaloi nga një izolim i plotë drejt një ndërkombëtarizimi që do të sillte edhe ndryshimin e politikës së saj të jashtme. Nëqoftëse deri atëherë Shqipëria ishte konsideruar nga Kina, një aleat i rëndësishëm politik por më tepër ideologjik, tashmë ajo po rifitonte të drejtat e saj në arenën ndërkombëtare dhe ndihma e Shqipërisë nuk ishte aq e “vyer” sa më parë. Kina vendosi marrëdhënie diplomatike me një sërë shtetesh, mes të cilave Gjermania Perëndimore, Austria, Kanadaja, Italia etj. Krahas vendeve perëndimore, Kina mori masa për përmirësimin e marrëdhënieve edhe me Jugosllavinë. Në 9 qershor 1971, delegacioni jugosllav arriti në Pekin, me ftesën e qeverisë kineze. Gjatë bisedimeve delegacioni jugosllav deklaroi se “bashkëpunimi mes dy vendeve duhet të shtrihet në fushën politike, ekonomike, dhe kulturore. Periudha e mëparshme i ka lënë vendin një periudhë zgjerimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar”. (Peking Review 1971, Vol 14, No 25, Marrë nga <http://www.marxists.org/subject/china/peking-revieë/1971/PR1971-25.pdf>) Kjo

vizitë nxiti paranojën e E. Hoxhës për ndonjë bashkëpunim të mundshëm mes Kinës dhe Jugosllavisë në dëm të interesave shqiptare. Vizita e Titos në Pekin u prit me mjaft entuziazëm nga kinezët. Madje një radio italiane deklaronte se “nuk i është bërë kurrë një pritje e tillë ndonjë kryetari shteti.” (E. Hoxha, 1979, fq. 577)

Hapja e Kinës me Perëndimin dhe ideja e saj për një “Europë të Bashkuar” që do të balanconte influencën sovjetike dhe amerikane në kontinent” (P. Prifti, 1999, fq. 70), vdekja e Mao Ce Dunit, vizita e Niksonit në Kinë dhe rivendosja e marrëdhënieve Jugosllavi – Kinë ishin treguesit kryesore të ndryshimit të politikës kineze në arenën ndërkombëtare. Këtu qëndronte edhe sfida më e madhe për udhëheqjen shqiptare dhe vetë liderin komunist E. Hoxha. Ai duhet të zgjidhte një nga dy rrugët që i paraqiteshin; ose duhet të ndryshonte duke ndjekur ritmin politik të Kinës, ose duhet të vazhdonte politikën e ndjekur deri në atë kohë por tani edhe më agresive sepse i duhej të konsolidonte pozitën e tij në parti dhe popull. Nqs do të zgjidhte rrugën e parë kjo nënkuptonte likujdim të pushtetit të tij personal, largimin e tij nga udhëheqja dhe shembjen e kultit të udhëheqësit, të cilin e kishte ngritur me aq mund. Për këto arsye ai preferoi rrugën e dytë. Shkëputja e marrëdhënieve me Kinën u zyrtarizua në Kongresin e VII të Partisë, i cili konfirmoi edhe njëherë divergjencat mes dy vendeve dhe frymën konfliktuale të marrëdhënieve. Menjëherë pas shkëputjes nga Kina, Shqipëria ndoqi politikën e vetëizolimit duke u mënjeluar nga çdo ngjarje botërore. Shqipëria ishte vendi i vetëm në Europë që nuk e nënshkroi Kartën e Helsinkit të vitit 1975, e cila njihje të drejtat e njeriut dhe garantimin e tyre ndërkombëtar.

Bibliografia

Burime parësore

AQSH, F 14, V 1969, D 7,8.

AQSH, F 14, V 1970, D 1,4.

AQSH, F 14, V 1971, D 570

AQSH, F 14, V 1972, D 2

AMPJ, V 1965, D 147

Literaturë

Alia, R. (2010) Jeta ime, Kujtime, Tiranë: Botimet Toena.

Biberaj, E. (1986) Albania and China, A study of an Unequal Alliance, USA: Westview Press/ Boulder and London.

Duka, V. (2007) *Histori e Shqipërisë 1912 – 2000*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.

Griffith, W. (1963) Albania and the sino-soviet rift, Massachusetts, Cambridge: The M. I. T. Press.

- Hoxha, E (1979) Shënime për Kinën II (1973-1977), Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori".
- Kaba, H. (2007) Shqipëria në rrjedhën e luftës së ftohtë (studime dhe dokumente), Tiranë: BOTIMPEX.
- Kissinger, H. (1999) Diplomacia, Tiranë: Shtëpia Botuese LAERT.
- Prifti, P. (1999) Remote Albania, The politic of isolation, Tiranë: Onufri.
- Gjecovi, Xh. Milo, P. Meta, B. Sadikaj, D. Dyrmishi, D. Rama, F. Mato, J. Papagjoni, J. Kucuku, B. Lalaj, A. Abdyli, T. Limani, M. Verli, M. Vokri, A. Kosumi, H. Pushkolli, F. (2009). 'Historia e Popullit Shqiptar IV, Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990', Tiranë: Botimet TOENA.
- Artikuj të marrë nga revista online*
- Miller, L (2000) 'China's strategic retreat: An alternative explanation for the sino-soviet rift', *Sapientia*, Marrë nga http://www.abdn.ac.uk/pir/postgrad/vol1_issue2/issue2_article3.htm 2000, f.2, Last updated 03/05/2014
- Peking Review 1968, Vol 11, No 50. Marrë nga <http://www.marxists.org/subject/china/peking-review/1968/PR1968-50.pdf>
- Peking Review 1971, Vol 14, No 25. Marre nga <http://www.marxists.org/subject/china/peking-review/1971/PR1971-25.pdf>

Shoqëria Botërore: Kushtëzimi nëpërmjet "Qeverisjes së Mirë"

Dokt. Dorina NDOJ¹

Abstrakt. Punimi ka për qëllim të analizojë konceptin e "qeverisjes së mirë" nga perspektiva teorike e Shkollës Angleze, duke e inkuadruar atë në debatin ndërmjet shoqërisë ndërkombëtare dhe shoqërisë botërore. Argumenti qendror mbështetet në premisën se "qeverisja e mirë" kontribuon në materializimin e shoqërisë botërore. Qeverisja e mirë çon në tendencën e shteteve për t'u bërë të ngjashme së brendshmi, të kuptuar në idenë e normave dhe vlerave të përbashkëta që modelojnë shtetet deri në nivelin individual. Debati midis qasjes pluraliste dhe solidariste lidhur me shkallën e shtrirjes dhe zgjerimit të shoqërisë ndërkombëtare ofron terren për të diskutuar ndërlidhjen e konceptit të shoqërisë botërore me qeverisjen e mirë, kryesisht referuar çështjes së të drejtave të njeriut dhe homogjenitetit në strukturat e brendshme të shteteve.

Fjalët kyçe: "Qeverisje e Mirë", Shoqëria Ndërkombëtare, Shoqëria Botërore, Solidarist, Pluralist.

¹ * Doktorante & Lektore në Departamentin e Shkencave Sociale të Aplikuara, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Universiteti European i Tiranës.

Hyrje

Realiteti dhe praktika e marrëdhënieve ndërkombëtare tregon se pavarësisht se shtetet nuk janë të barabartë në çdo aspekt, presioni ndaj punëve të tyre të brendshme po formësohet gjithnjë në rritje nga forca përtej shteteve dhe autonomia e shteteve për të vendosur për punët e tyre të brendshme është zvogëluar shumë, veçanërisht brenda shteteve të dobëta. Megjithëse shumë nga problemet lindin brenda shteteve, zgjidhjet kryesisht imponohen nga forca të jashtme. Në mënyrë që ndërhyrjet të rezultojnë efektive, këto zgjidhje përcaktojnë standardet që duhet të karakterizojnë një strukturë qeverisëse dhe të sjellin ndryshimin e synuar. Qeverisja e mirë ka kontribuar në projektimin e një modeli të tillë ndaj vendeve në zhvillim nëpërmjet kërkesës për mirëqeverisje dhe reformim të brendshëm.

Ky punim ka për qëllim të analizojë konceptin e qeverisjes së mirë nga perspektiva teorike e Shkollës Angleze, duke e inkuadruar atë në debatin ndërmjet shoqërisë ndërkombëtare dhe shoqërisë botërore. Çështja e homogjenitetit në strukturat e brendshme të shteteve, si një nga synimet e qeverisjes së mirë, përbën një aspekt interesant për të eksploruar marrëdhënien ndërmjet shoqërisë së shteteve dhe shoqërisë botërore. Argumenti qendror mbështetet në premisën se “qeverisja e mirë” kontribuon në materializimin e shoqërisë botërore. Qeverisja e mirë çon në tendencën e shteteve për t’u bërë të ngjashme së brendshmi, të kuptuar në idenë e normave dhe vlerave të përbashkëta që modelojnë shtetet deri në nivel individual. Në mbështetje të argumentit kryesor punimi rreket të diskutojë implikimet që ka shkaktuar mirëqeverisja si një qasje ndaj zhvillimit dhe performancës së shtetit, e orientuar nga të drejtat e njeriut dhe praktika e ndërhyrjeve humanitare, në shtimin e debateve lidhur me shkallën e shtrirjes dhe zgjerimit të shoqërisë ndërkombëtare drejt një shoqërie botërore.

Diskutime rreth konceptit të “qeverisjes së mirë”

Koncepti i “qeverisjes së mirë” është futur në studimin dhe praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare nga ligjërimi i Bankës Botërore. Ai është bërë pjesë e axhendës së institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare për zhvillim, më shumë se dy dekada më parë, kur u prezantua nga një studim i Bankës Botërore në vitin 1989 në vendet afrikane, i cili fokusohet në rolin e shtetit në proceset e zhvillimit ekonomik. Në vitet 1980 zhvillimi dhe performanca ekonomike e këtyre vendeve ishte përkeqësuar pavarësisht implementimit të programeve të ndihmës të Bankës Botërore. Fillimisht ky koncept u përdor për të përshkruar nevojën për reforma institucionale dhe një sektor publik më eficient duke qenë se programet ndërkombëtare nuk kishin sjellë rezultatet e pritshme në këto shtete. Kështu

“qeverisja e mirë nënkuptonte një shërbim publik eficient, një sistem gjyqësor të besueshëm, si dhe llogaridhënie ndaj publikut në administrimin e shtetit (Banka Botërore, 1989: xii).

Koncepti është përpunuar dhe ripërkufizuar që nga ajo kohë. Megjithatë ende nuk ka një përkufizim të vetëm dhe shterues të tij. Fleksibiliteti i madh në përdorimin e tij në varësi të kontekstit dhe qëllimit kanë bërë që “qeverisja e mirë” të përfshijë shumëçka që nga sektori publik eficient, sundimi i ligjit, pjesëmarrja efektive, transparenca dhe përgjegjshmëria e institucioneve e proceseve publike deri tek ushtrimi dhe respektimi i plotë i të drejtave të njeriut. Megjithatë, ekziston një shkallë e konsiderueshme konsensusi që qeverisja e mirë ka të bëjë me proceset dhe rezultatet politike dhe institucionale që mendohet se janë të nevojshme për të arritur qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Koncepti i qeverisjes së mirë është ripërkufizuar gjithashtu edhe nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut (2000), i cili në rezolutën e tij 2000/64 identifikon disa tipare kryesore: transparenca, përgjegjshmëria, llogaridhënia, pjesëmarrja dhe reagimi ndaj nevojave të njerëzve. Duke ndërlidhur qeverisjen e mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm njerëzor, kjo nënkupton një qasje ndaj zhvillimit orientuar nga të drejtat e njeriut.

“Qeverisja e mirë” lindi si koncept në një kohë të ndryshimeve të mëdha politike siç ishte fundi i viteve 1980. Këto ndryshime politike krijuan terrenin dhe nxitën diskutime rreth mënyrës sesi shteti duhet të strukturohet me qëllim zhvillimit. Ky kontekst i hap rrugë komunitetit ndërkombëtar, fillimisht nëpërmjet institucioneve ekonomike, në projektimin e një standardi ndaj vendeve në zhvillim nëpërmjet kërkesës për mirëqeverisje. Kjo përbente një ndryshim të madh në qasjen ndaj shteteve në zhvillim, tashmë jo vetëm në aspektin e politikave të tyre makro-ekonomike, por edhe në aspektin e performancës së tyre institucionale.

Shoqëria ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe qeverisja e mirë

Konteksti i fillim viteve 1990 ka vënë në diskutim sjelljen e shteteve dhe shkallën e përfshirjes së shoqërisë së shteteve në çështjet ndërkombëtare. Nga perspektiva e Shkollës Angleze politika ndërkombëtare shpjegohet në termat e një shoqërie shtetesh ose shoqërie ndërkombëtare, në formën e një marrëveshje ndër-subjektive që komunitetet e pavarura politike kanë krijuar për të ruajtur pavarësinë e tyre dhe pranuar kufizime në ushtrimin e forcës kundrejt njëri-tjetrit. H. Bull (2002) argumenton se pavarësisht karakterit anarkik të arenës ndërkombëtare, shtetet janë të angazhuar në kufizimin e konflikteve nëpërmjet rregullave dhe institucioneve të përbashkëta. Ai e përshkruan shoqërinë e shteteve si një grup shtetesh, të cilët të vetëdijshëm për disa interesa dhe vlera të përbashkëta formojnë një shoqëri në sensin që ato e lënë veten të udhëhiqen nga një tërësi rregullash në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin dhe të punojnë për institucionet e përbashkëta (Bull,

2002:25). Në të njëjtën kohë, shtetet bashkëpunojnë për ndërtimin e institucioneve të përbashkëta, të tilla si ligji ndërkombëtar dhe diplomacia, lufta, organizatat ndërkombëtare, roli i fuqive të mëdha, balanca e fuqisë (Bull, 2002:71).

Ngjarjet pas Luftës së Ftohtë kanë vënë në pikëpyetje dhe kanë ngjallur debat përsa i përket gamës së interesave, vlerave dhe institucioneve të shoqërisë ndërkombëtare. Në këtë periudhë ndërhyrjet, kryesisht për qëllime humanitare, u bënë pjesë e diskursit dhe axhendës ndërkombëtare. Në fillim të viteve 1990 shoqëria e shteteve i është drejtuar aplikimit të forcës në një numër rastesh për të ndaluar dhunimet sistematike, flagrante, gjërisht të përhapura të të drejtave të njeriut nëpërmjet të ashtuquajturave ndërhyrje humanitare. Praktika e këtyre ndërhyrjeve ka artikulluar nevojën në rritje për të mbrojtur të drejtat e njeriut. Ky zhvillim rrjedhimisht ka nxitur rishikimin dhe vlerësimin e shkallës së solidaritetit që duhet të ekzistojë në shoqërinë e shteteve për sa i përket qëllimeve të saj. Pyetjes se deri në çfarë shkalle shoqëria ndërkombëtare mund të përmirësojë performancën e saj në përmbushjen e kërkesave dhe shqetësimeve ndërkombëtare në rritje, mund t'i përgjigjemi duke analizuar qasjen e re ndaj individit si aktor në politikën ndërkombëtare, konkretisht lidhur me ligjërimin për respektimin e të drejtave të njeriut. Këtë dinamikë fillimisht mund ta gurmojmë në standardin që synonte të implementonte koncepti i qeverisjes së mirë në vendet në zhvillim, ku ndryshimet institucionale ndër të tjera duhet të krijonin terrenin për respektim e të drejtave të njeriut.

Në kushtet kur debati për të drejtat e njeriut gjithnjë e më shumë ka evidentuar nevojën për trajtimin e politikës ndërkombëtare jo vetëm me anë të qasjeve shtet-centrike, por në marrjen në konsideratë edhe të aktorëve dhe normave të reja, Shkolla Angleze e Mendimit na ndihmon në inkuadrimin e një problematike të tillë në debatin midis qasjeve pluraliste dhe solidariste ndaj shoqërisë ndërkombëtare. Në këndvështrimin pluralist, veprimtaria e shoqërisë ndërkombëtare fokusohet në një numër minimal çështjesh, të cilat realizojnë aspektin funksional të kësaj shoqërie shtetesh. Bëhet fjalë për respektimin e parimit të sovranitetit dhe mosndërhyrjes, të cilat njëkohësisht bëjnë të mundur ekzistencën e rregullit ndërkombëtar. Kjo bën që qëllimi i shoqërisë ndërkombëtare të jetë shumë minimal dhe i kufizuar në shqetësimet e përbashkëta rreth shkallës së rregullit ndërkombëtar të nevojshëm për bashkëekzistencën në anarki (Jackson 2000; Mayall 2000). Qasja pluraliste mbështet ruajtjen dhe kultivimin e diferencave, dallimeve politike dhe kulturore, si trashëgimi të historisë njerëzore (Buzan, 2001:478). Sipas Mayall pluralizmi është "pikëpamja që shtetet, ashtu si individët, mund të kenë dhe kanë interesa dhe vlera të ndryshme, dhe rrjedhimisht shoqëria ndërkombëtare është e kufizuar në krijimin e një kornize që do t'i lejojë ata të bashkëjetojnë në harmoni [...] për pluralistët, një nga karakteristikat që dallon shoqërinë ndërkombëtare nga çdo lloj tjetër organizimi social është e karakterit procedural dhe për pasojë jo e zhvilluar (Mayall, 2000:14).

Në këndvështrimin solidarist, në kontrast me të parët, shoqëria e shteteve duhet të bëjë më tepër për të promovuar të drejtat e njeriut dhe angazhimin në këto çështje kur është e nevojshme. Në perspektivën solidariste angazhimi i shoqërisë ndërkombëtare duhet shtrirë në një numër më të gjërë normash, rregullash dhe institucioneve, të cilat përveç se bëjnë të mundur rregullin ndërkombëtar kanë në fokus të tyre angazhimin për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut. Qasja solidariste supozon që potencialisht qëllimi i shoqërisë ndërkombëtare ka shtrirje të gjërë, mundësisht në përfaqimin e normave të përbashkëta në aspekte të tilla si kufizimi i përdorimit të forcës dhe pranimi i "standarteve të civilizimit" në lidhje me marrëdhënien ndërmjet shteteve dhe qytetarëve (Buzan, 2001:478). Në këtë këndvështrim, sovraniteti mund të përqafojë shumë shkallë të konvergencës politike sipas një modeli apo standardi të "imponuar" së jashtmi. Ata pak a shumë justifikojnë "cënimin" e të drejtës së shteteve për pavarësi politike dhe mosndërhyrje në punët e tyre të brendshme, si psh. në rastet kur këto shtete dështojnë në përmbushjen e përgjegjësisive të tyre në ruajtjen dhe respektimin e jeteve njerëzore brenda tyre.

Diskutimi i mësipërm rreth veprimtarisë së shoqërisë ndërkombëtare është me vlerë prësa i përket ofrimit të një këndvështrimi të ri në shpjegimin dhe të kuptuarin e konceptit të qeverisjes së mirë. Qeverisja e mirë, ashtu si praktika e ndërhyrjeve humanitare, projektin rezultate të caktuara në dimensionin e brendshëm të shteteve sipas një modeli të caktuar. Në këtë nivel analize shtetet nuk konsiderohen më si "kuti të zeza", për të cilat mjafton respektimi i sovranitetit në raport me njëra tjetrën. Dakordësia ndërmjet shteteve [shoqërisë ndërkombëtare] në kushtëzimin e vendeve në zhvillim për përfaqimin dhe brendësimin e një modeli të caktuar zhvillimi politik-ekonomik, pashmangshmërisht ka patur implikime për shoqërinë ndërkombëtare. Duke inkuadruar konceptin i "qeverisjes së mirë" në debatin midis pluralistëve dhe solidaristëve lidhur me shkallën e shtrirjes dhe zgjerimit të shoqërisë ndërkombëtare gjejmë terren për të diskutuar konceptin e shoqërisë botërore, një koncept shumë i kontestuar në brendësi të Shkollës Angleze të Mendimit. Qeverisja e mirë çon në tendencën e shteteve për t'u bërë të ngjashme së brendshmi, duke i dhënë jetë në një farë mënyre ideve të Kantit dhe duke hapur debatin që shoqëria botërore kushtëzon organizimin e brendshëm politik të shteteve (një pikë e rëndësishme që do të trajtohet në vazhdim të këtij punimi). "Me shoqëri botërore kuptojmë jo vetëm shkallën e ndërveprimeve që lidhin të gjitha pjesët e komunitetit njerëzor me njëri tjetrin, por një sens të interesave dhe vlerave të përbashkëta, në bazë të të cilave ndërtohen rregullat dhe institucionet. Në këtë kuptim, shoqëria botërore përbën totalin e ndërveprimeve sociale globale (Bull 1977: 279). B. Buzan (2001:477) sugjeron se menjëherë sapo pranohet idea e shoqërisë, duhet të mendojmë jo vetëm për shoqërinë ndërkombëtare ndërmjet shteteve, por gjithashtu edhe për shoqërinë botërore të kuptuar në idenë e normave dhe vlerave të përbashkëta në nivel individual.

Shoqëria Botërore: Kushtëzimi nëpërmjet “Qeverisjes së Mirë”

Gjithnjë e më shumë debatohet që po zhvendosemi drejt një bote post-sovrane, në të cilën legjitimiteti dhe autoriteti nuk shtrihet më në territorialitetin e shteteve (Thomas, 2004:04). Dhe pyetja që shtrihet në mënyrë të vazhdueshme është se nëse ndarja e popujve të botës në shtete sovraane është akoma një fakt dominant i jetës ndërkombëtare (Singer, 2002:05). Pavarësisht ndryshimeve që kanë shtrirë fuqinë përtej shtetit, sovraniteti vazhdon të mbetet një parim themelor dhe shumë me vlerë për shumicën e shteteve (Hoffman, 1997:111). Kjo sepse ai i njeh shtetet si të barabartë në vlerën dhe dinjitetin e tyre në mbrojtjen e identiteteve të tyre unike, të lirisë së tyre kombëtare, si dhe pohon të drejtën e tyre për të formësuar dhe përcaktuar fatin e tyre. Në një botë ku ka pabarazi të mëdha ndërmjet shteteve si në fuqi ashtu edhe në burime, shumë shtete, sidomos ato të dobëtat, vlerësojnë faktin që sipas ligjit ndërkombëtar të gjitha shtetet shihen si sovraane të barabartë. Sovraniteti i shtetit dhe parimi i mosndërhyrjes në çështjet e brendshme të shteteve ofrojnë pak nga mekanizmat mbrojtës me anë të cilit shtetet mund të ruajnë fuqinë dhe autonominë e tyre. Në nivelin e moralit praktik, shoqëria ndërkombëtare nënkupton që ne duhet të mbyllim sytë ndaj vlerave të politikës së brendshme të njëri tjetrit kur nuk biem dakord me to (Jackson, 2000:182).

Megjithatë, realiteti tregon se pavarësisht se shtetet nuk janë të barabartë në çdo aspekt, punët e tyre të brendshme po formësohen gjithnjë në rritje nga forca përtej shteteve dhe autonomia e shteteve për të vendosur për punët e tyre të brendshme është zvogëluar shumë, veçanërisht brenda shteteve të dobëta (Thomas, 2004:04). Shumë nga këto problematika lindin brenda shteteve dhe megjithëse zgjidhja mund të imponohet nga forca të jashtme, zgjidhjet duhet të implementohen brenda shteteve. Tashmë, zgjidhjet imponojnë përcaktimin më parë të standardeve që duhet të karakterizojnë një strukturë qeverisëse. Referuar standardeve të tilla, bëhet e nevojshme të hetohet nëse shoqëria e shteteve është një mënyrë e përshtatshme për të organizuar politikisht botën, si dhe çfarë lloj institucionesh është e mundur dhe e dëshirueshme të zhvillohen brenda kuadrit të shoqërisë së shteteve për të përmirësuar performancën e saj në përmbushjen e këtyre standardeve (Suganami, 2010:24). Në adresimin e problemeve me të cilat po përballen shtetet shihet si zgjidhje shtrirja e një shkallë të gjërë solidariteti ndërmjet shteteve. Në këtë kontekst, ky solidaritet nënkupton praninë dhe promovimin e një kulture të përbashkët ndërmjet shteteve në ballafaqimin e nevojave deri në nivelin e individit, që do të çonte drejt një homogjeniteti në strukturat e brendshme të tyre.

Çështja e homogjenitetit në strukturat e brendshme të shteteve është një ndër aspektet për të eksploruar marrëdhënien ndërmjet shoqërisë së shteteve dhe shoqërisë botërore, si dhe kontributit dhe domethënies së “qeverisjes së mirë” në këtë raport. Në diskutimin rreth shoqërisë ndërkombëtare, Wight (1977:33) shprehet se

“ne duhet të supozojmë që sistemi i shteteve nuk mund të krijohet pa një shkallë uniteti kulturor ndërmjet anëtarëve të tij”. Megjithëse Wight nuk e përmend literalisht termin e shoqërisë botërore, ai përcakton qartë se uniteti kulturor është diçka e dallueshme nga shoqëria ndërkombëtare. Duhet thënë se përdorimi nga Wight i termit “kulturë e përbashkët” është i paqartë nëse ai ka në mendje kulturën në sensin historik apo nëse e lidh me rregulla të përbashkëta që formojnë një shoqëri kontraktuale. Por, përpara se të zhvendosemi në shpjegimin e kuptimit të kulturës së përbashkët në kontekstin e shoqërisë botërore, do t’i rikthehemi përsëri konceptit të sovranitetit, por tashmë në një tjetër këndvështrim, pasi homogjeniteti në vetvete bie në kundërshtim me logjikën e parimit të sovranitetit.

Marrëdhënia ndërmjet konceptit të sovranitetit dhe ndërhyrjes ka evoluar së fundmi në politikën ndërkombëtare. Sipas Xavier Mathieu (2011) këto dy koncepte dikur të konsideruara antagonistë mund të shihen të ndërlidhura: ndërhyrja mund të “forcojë” sovranitetin në shtetin ku ndërhyhet, ose madje mund të “ndërtojë” sovranitetin e një shteti të dobët apo të dështuar. Para dy dekadash ky pohim mund të konsiderohej tërësisht inkoherent, por me zhvillimet e fundit në politikën ndërkombëtare, në disa raste mund të gjendet i justifikuar. Revolucioni në politikën ndërkombëtare është i lidhur me evolucionin e parimit të sovranitetit, por si mund të ndodhë një evolucion i tillë pa qënë në kontradiktë me parimin në fjalë? Kjo pyetje kërkon të kuptuarin thellë të sovranitetit dhe evolucionit të kuptimit të tij në kohë.

Në ditët e sotme, sovraniteti është subjekt i ripërkufizimeve të vazhdueshme. Për Thomson (1995:228), në çdo periudhë të caktuar historike ka ekzistuar një standard ose normë për sovranitetin. Kështu sovraniteti është “vazhdimisht në ndërtim” (Eillen, 2011:18). Për më tepër, shkollarët, në përgjithësi, bien dakord që sovraniteti mbetet i njëjtë në disa aspekte, por ndryshon në disa të tjera (Jackson, 2007:23). Sovraniteti në formën e tij tradicionale është i ndërlidhur me pavarësi të plotë, e cila shpjegon pse sovraniteti dhe ndërhyrja janë konsideruar kontradiktore në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky konceptim është tipik për një vizion pluralist të shoqërisë ndërkombëtare. Ndërmjet shkollarëve të MN-ve, ky konceptualizim i sovranitetit është vënë në pikëpyetje që kur ka filluar të mos i korrespondojë realitetit empirik të marrëdhënieve ndërkombëtare. Mënyra për ta bërë konceptin e sovranitetit “sa më të matshëm” është ta lidhim atë me konceptin e “jetës së mirë” të popullsisë. Kjo hap rrugën në mënyrë të dukshme për një ndryshim radikal siç është ndërlidhja e qeverisjes së mirë me sovranitetin. Në ditët e sotme “jeta e mirë” përshkruhet nën formën e qeverisjes së mirë. Për pasojë, me qeverisjen e mirë si një manifestim empirik i sovranitetit, ky koncept bëhet empirikisht i observueshëm dhe operacional (Mathieu, 2011). Gjithashtu,

sovrانيتeti dhe shteti janë të lidhur me krijimin e një rregulli të brendshëm, i cili kontribuon në organizimin i jetës politike (Ashley, 1988:238), i cili krijon kushtet për “jetën e mirë” ose e thënë ndryshe standardet e jetesës të konsideruara të dëshirueshme, të realizueshme dhe të mbrojtura (Gong, 1984). Në këtë vazhde diskutimi në mënyrë të vetëdijshme lind pyetja se çfarë nënkupton termi “jeta e mirë”? Nuk ka dyshim se përkufizimi i saj është i varur nga zhvillimet historike dhe kulturore. Për modelin klasik të sovranitetit, “jeta e mirë” shihej e lidhur më pavarësinë, pasi kjo e fundit konsiderohej si kusht për realizimin e “jetës së mirë” brenda shtetit. Reus-Smit (2001:519-538) shpjegon se e drejta e vetëvendosjes dhe pavarësisë legjitimohej nga premisa për të përmirësuar jetën e brendshme dhe për rrjedhojë të drejtat e njeriut. Megjithatë, gjatë periudhës pluraliste të shoqërisë ndërkombëtare, karakteristikat e “jetës së mirë” nuk përcaktohen qartë. Në nivelin e moralit praktik, shoqëria e shteteve nënkupton që ne duhet të mbyllim sytë ndaj vlerave të politikës së brendshme të njëri tjetrit kur nuk biem dakord më to (Jackson, 2000:182). Përkundrazi, në shoqërinë ndërkombëtare të ditëve të sotme, e cila është duke u bërë gjithnjë e më shumë solidariste, version bashkëkohor i “jetës së mirë” gjendet në emrin e qeverisjes së mirë. Termi i qeverisjes së mirë mbetet i vështirë për t’u përkufizuar saktësisht apo njëherë e përgjithmonë. Megjithatë, ajo i referohet elementëve publikë të nevojshëm për mirëqënien (Eiess, 2000:802). Sipas përkufizimit të Bankës Botërore, idea e qeverisjes së mirë nënkupton aftësinë, kapacitetin dhe vullnetin e gatishmërinë e autoriteteve politike për të qeverisur në mënyrë efektive për interesin e përgjithshëm (Santiso, 2001). Për shkak të natyrës normative, termi “qeverisje e mirë” është e ndryshueshme në kuptimin e saj dhe nuk ka standarte objektive për përcaktimin e saj (Nanda, 2006:269). Pavarësisht përdorimit të saj të gjërë, idea e qeverisjes së mirë është e përcaktuar në disa mënyra. Fillimisht, ajo lindi si një ide që të siguronte një efektivitet më të madh të ndihmës së dhënë në vendet në zhvillim (Nanda, 2006:300). Ndërsa, në një kuptim më të gjërë përfshiu të gjitha aspektet e jetës sociale: mbrojtjen universale të të drejtave të njeriut; ligjet jo-diskriminuese; proceset të paanshme gjyqësore, agjensitë transparente publike; llogaridhënie për vendimet e zyrtarëve publikë; dhe një pjesëmarrje kuptimplotë të qytetarëve në diskutimin e politika publike (Weiss, 2000:801). Në përkufizimin e kuptimit të “qeverisjes së mirë” dhe në çfarë e legjitimon atë është e dukshme që shumica e shkollarëve të MN reflektojnë qëndrimet dhe vlerat e tyre perëndimore. Në një botim të vitit 2003, Bain identifikon krijimin e nocionit të legjitimitetit ndërkombëtar të shprehur në termat e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe ekonomisë së tregut të lirë (Bain, 2003:155). Këto tre element përfaqësojnë thelbin e asaj çka shoqëria ndërkombëtare shikon si realizimi i “jetës së mirë”. Në këtë kontekst, nuk mund të flasim më për një shoqëri ndërkombëtare pluraliste, por më saktë për zhvendosjen e kësaj të fundit në drejtim të shoqërisë solidariste botërore. Një ide e tillë nxit nevojën për

elementë të solidarizmit për të mbështetur shoqërinë ndërkombëtare dhe nevojën për një strukturë të rregullit politik për të stabilizuar më shumë vizione liberale (Buzan, 2004).

Shoqëria botërore, përveç të tjerash, konsiston në angazhimin e saj normativ deri në nivel individual, e cila është e demonstruar qartësisht në nocionin e “qeverisjes së mirë” apo jetës së mirë”. Në qoftë se do të përpiqemi t’i japim një përkufizim asaj çfarë kuptojmë me shoqëri botërore, do të kishte të bënte më një konstrukt social më të gjërë normash, rregullash dhe institucioneve ndërmjet shteteve, që e kapërcejnë qëllimin e bashkëekzistencës me rregull, për t’u angazhuar në respektimin dhe implementimin e normave që kushtëzojnë një qeverisje të mirë brenda shteteve, me qëllimin parësor respektimin e të drejtave të njeriut dhe krijimit të mundësisve të barabarta ndërmjet njerëzve.

Pyetja që ngrihet është “a përbën “qeverisja e mirë” kulturën e përbashkët?” Donnelly argumenton që të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht janë shndërruar në një “standart të ri civilizimi ndërkombëtar” (Donnelly, 1998:1-24). Hobson dhe Boëden (2008; 2009) mund të themi se i bëjnë të barazvlefshme me njëra tjetrën konceptet e “jetës së mirë” dhe “standartit të civilizimit apo kulturës së përbashkët”, ku të dyja i referohen parimeve të demokracisë, tregut të lirë dhe të drejtave të njeriut”. Këto tre elementë ofrojnë një përafrim të asaj çfarë kuptohet si qeverisje e mirë në ditët e sotme, e cila brenda konceptit të shoqërisë botërore nënkupton kulturën e përbashkët. *Së pari*, qeverisja e mirë nënkupton ekzistencën e regjimit demokratik liberal, duke besuar se demokracia është forma më e përshtatshme e organizimit politik. Sipas Santiso-s, qeverisja e mirë kërkon një organ ekzekutiv efficient, një organ legjislativ funksional dhe një sistem gjyqësor të pavarur, si dhe balancën e pushteteve, të gjithë elementë konstituiv të një regjimi demokratik (Santiso, 2001:16). Si rrjedhojë ka një mbivendosje midis demokracisë dhe qeverisjes së mirë që kur sistemi demokratik është mënyra e vetme për të siguruar qeverisje të mirë (Santiso, 2001:16). Po ashtu, Hameiri (2010:194) thekson se shqetësimi ndërkombëtar për forcimin e demokracive liberale është shndërruar në një shqetësim për të promovuar qeverisjen e mirë. Gjithashtu, sistemi demokratik shihet si një mekanizëm për të legjitimuar vlera të tjera shumë të rëndësishme për drejtësinë sociale (Held, 2004). McGree (2004:1-17) dhe të tjerë autorë (Held 2004; Archibugi, 2004) kanë përdorur termin e demokracisë sociale kozmopolite, si një mënyrë për të ndërmarrë hapa drejt një drejtësie kozmopolite, e cila në disa situata ekstreme pranon ndërhyrjet mbrojtëse apo korigjuese në punët e brendshme të shteteve në mënyrë për të avancuar drejtësinë ose të ndrequr padrejtësitë. *Së dyti*, ekonomia e tregut të lirë, që në kuadër të idesë së shoqërisë botërore krijon terren për aktorët transnacional, konsiderohet si pjesë e legjitimitetit ndërkombëtar. Në kuadër të standardit kulturor zhvillimi i këtij aspekti përbën standardin ekonomik të një shoqërie botërore potenciale. Dhe *së treti*, respekti për të drejtat e njeriut

përbën një komponent të rëndësishëm të qeverisjes së mirë dhe një legjitimiteti të ri ndërkombëtar. Tashmë, të drejtat e njeriut janë pjesë e konceptit se çfarë është legjitime dhe jo legjitime në veprimet e një shteti (Reus-Smit, 2001:520). Ish Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan i referohet garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut si një qëllim thelbësor për një qeverisje të mirë (UN, 2012). Shkollarët bashkëkohorë e konsiderojnë sovranitetin si një kusht për krijimin e rregullit, qëllimi i të cilit është garantimi i jetës së mirë. Në këtë kuptim sovraniteti është i lidhur me një model të organizimit politik.

Çështja e modelit të organizimit politik dhe homogjenitetit të brendshëm të shteteve hap debatin mbi natyrën e sistemit ndërkombëtar. A do të vazhdojë të jetë anarkik në kushtet e mbivendosjes ndaj shoqërisë së shteteve të një shoqërie botërore në zhvillim e sipër? Në terma strukturalë, sistemi modern politik i shoqërisë ndërkombëtare është anarkik, ku sovraniteti i shteteve është themeli i marrëdhënieve shoqërore ndërmjet tyre, ndërsa, struktura politike e një shoqërie botërore potenciale është e paqartë (Buzan, 1993:327-352). Sipas Buzan-it, kjo strukturë mund të jetë hierarkike, psh qeveria botërore; mund të vazhdojë të jetë anarkike; ose mund të jetë anarkike në nivel individual, si një shoqëri pa shtet që eleminon sektorin politik (Buzan, 1993:339). Në mendimin tim, kjo e fundit përbën një alternativë që nuk është as e dëshirueshme dhe as e këshillueshme në kohet e shteteve moderne. Ndërtimi i shteteve moderne bëri të mundur kapërcimin e gjendjes anarkike në shoqëritë brenda shteteve nëpërmjet kontratës sociale. Përgjatë punimit, idea e shoqërisë botërore nuk është konceptuar dhe as dëshiruar të konsiderohet si mungesa e shteteve në politikën ndërkombëtare. Por, siç thotë edhe Vincent, pse ekzistojnë shtetet në qoftë së në fund të fundit nuk i shërbejnë nevojave të qytetarëve të tyre. Prandaj, kundërshtimi që i bëhet shoqërisë ndërkombëtare si e qendëruar tek shteti, të paktën në këtë punim, nuk ka për qëllim anashkalimin apo zhdukjen e shteteve. Përkundrazi, lind nevoja që shtetet duhet të zgjerojnë marrëveshjen ndërmjet tyre në drejtim edhe të mbarëvajtjes së rregullit dhe drejtësisë së tyre të brendshme. Qeverisja e mirë mund të shërbejë si standardi për të materializuar një marrëveshje të tillë. Ndoshta, kjo do të ndikojë në sistemin anarkik ndërkombëtar në përpjekjen për ta bërë disi hierarkik në qoftë së flasim për një shoqëri botërore në terma globale.

Mendime përmblylëse

Koncepti i "qeverisjes së mirë" rreket të investigojë performancën e shtetit, duke kontribuar kështu në diskutimet lidhur me shkallën e shtrirjes dhe zgjerimit të veprimtarisë së shoqërisë ndërkombëtare. Në këndvështrimin pluralist, veprimtaria e shoqërisë ndërkombëtare fokusohet në një numër minimal çështjesh, të cilat realizojnë aspektin funksional të kësaj shoqërie shtetesh. Bëhet fjalë për respektimin

e parimit të sovranitetit dhe mosndërhyrjes, të cilat bëjnë të mundur ekzistencën e rregullit ndërkombëtar. Mirëpo praktika e marrëdhënieve shpeshherë e ka sfiduar këtë konceptim shumë të ngushtë të marrëveshjes midis shteteve. Pyetjes se deri në çfarë shkalle shoqëria ndërkombëtare mund të përmirësojë performancën e saj në përmbushjen e kërkesave dhe shqetësimeve ndërkombëtare në rritje, ku punim u përpoq t'i përgjigjej duke analizuar konceptin e "qeverisjes së mirë" në brendësi të debatit pluralist-solidarist të Shkollës Angleze.

Punimi mbështet argumentin se "qeverisja e mirë" kontribuon në materializimin e shoqërisë botërore, që nënkupton një konstrukt social më të gjërë normash, rregullash dhe institucionesh ndërmjet shteteve, që e kapërcejnë qëllimin e bashkëekzistencës me rregull [shoqëria ndërkombëtare], për t'u angazhuar në respektimin dhe implementimin e normave që kushtëzojnë një qeverisje të mirë brenda shteteve, me qëllimin parësor respektimin e të drejtave të njeriut dhe krijimit të mundësisve të barabarta ndërmjet njerëzve.

Bibliografia

- Archibugi, Daniele (2008) *"The Global Commonwealth of Citizens. Toward Cosmopolitan Democracy"*, Princeton: Princeton University Press.
- Annan, Kofi (2002) "Democracy as an International Issue", *Global Governance* 8, No. 2.
- Archibugi, D & Held, D (2011) "Cosmopolitan Democracy: Paths and Agents", Panel Cosmopolitan Global Governance and the Role of the State: Canada.
- Ashley, R. N. (1988) "Untying the Sovereign State: A Double Reading of the Anarchy Problematique". *Millennium: Journal of International Studies*, 17(2).
- Banka Botërore <http://www.worldbank.org/>
- Buzan, Barry (2004) *"From International to World Society? English School Theory and the Social Structure of Globalisation"*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Buzan, Barry (2001) "The English School: An Underexploited Resource in IR", *Review of International Studies*, Vol. 27, No. 3.
- Buzan, Barry (1993) "From International System to International Society: Structural Realism and Regime Theory Meet the English School", *International Organization*, Vol. 47, No. 3.
- Bowden, B. (2009) *"The Empire of Civilization: The Evolution of an Imperial Idea"*, Chicago and London: The University of Chicago Press.
- Bull, Hedley (1984) *"Interventions in World Politics"*, Oxford: Clarendon Press.
- Bull, Hedley (2002) *"The Anarchical Society: A Study of Order in World Politics"*, Palgrave.
- Bain, W (2003) *"Between Anarchy and Society: Trusteeship and the Obligations of*

- Power*”, Oxford: Oxford University Press.
- Donnelly, Jack (1998) “Human Right: A Neë Standard of Civilization?” *International Affairs*, Vol. 74. No.1.
- Hobson, C. (2008) “Democracy as Civilisation”. *Global Society*, 22(1).
- Held, David (2010) “*Cosmopolitanism. Ideals and Realities*”, Cambridge: Polity Press.
- Held, David (1995) “*Democracy and the Global Order: From the Modern State to Cosmopolitan Governance*”, Cambridge: Polity, 1995.
- Held, D. & McGrew, A. (2002) “*Globalisation/ Anti-Globalisation*”, Cambridge: Polity Press.
- Hoffman, John (1997) “Blind Alleys. Can We Define Sovereignty?” *Politics*, Vol. 17, No. 1.
- Hameiri, S. (2010) “*Regulating Statehood. State Building and the Transformation of the Global Order*”, Basingstoke: Palgrave Macmillan.
- Jackson, Robert H. (2000) “*The Global Covenant: Human Conduct in World of States*”, Oxford University Press.
- McGrew, Anthony (2004) “Cosmopolitanism and Global Justice”, *The International Studies Association of Ritsumeikan University* Vol.3.
- Mayall, James (2000) “Democracy in International Society”, *International Affairs*, 76, No.1.
- Nanda, V. P. (2006) “The “Good Governance” Concept Revisited. *Annals of the American Academy of Political and Social Science*, 603.
- Reus-Smit, C. (2001) “Human Rights and the Social Construction of Sovereignty”. *Review of International Studies*, 27(4).
- Santiso, C. (2001) “Good Governance and Aid Effectiveness: The World Bank and Conditionality”, *The Georgetown Public Policy Review*, 7(1).
- Suganami, Hidemi (2010) “The English School in a Nutshell”, *Ritsumeikan Annual Review of International Studies*, Vol.9.
- Thomas, Holli (2004) “Cosmopolitan Sovereignty”, *Australasian Political Studies Association Conference*.
- Thomson, J. E. (1995) “State Sovereignty in International Relations: Bridging the Gap between Theory and Empirical Research”. *International Studies Quarterly*, 39(2).
- United Nations <http://www.un.org/en/>
- World Bank (1989) *Sub-Saharan Africa: From Crisis to Sustainable Development*. Washington, DC: World Bank.
- Wilén, N. (2011) “*Justifying Interventions: (De) Stabilizing Sovereignty. The Cases of Liberia and Burundi*”, Brussels: Universite Libre de Bruxelles.
- Weiss, T. G. (2000) “Governance, Good Governance and Global Governance: Conceptual and Actual Challenges”. *Third World Quarterly*, 21(5).

Abstracts

Alfred Nini

The impact of the development of economic and social relations to urban Dress

The study aims to show how economic and social development has made it possible and has limited the development of the Albanian civil dress in the late nineteenth century and early XX . Being classified as a part of the cultural heritage materials the idea becomes more and more clear that they cannot be seen separate from the social and economic environment in which they are used and prepared. Characterization of social - economic relations of the time as social activities such as crafts and their products , the organization of Albanian master craftsmen during this period , and the study of socio-economic organization during the early nineteenth century to the twentieth century will be seen through these points: First features that reflect urban attire as material culture. Secondly esnaf organization as part of this social organization . Thirdly shopping centers as proof of the economic development of these social relations and finally the conclusion.

Keywords: The dress features. Craftsman organization. Citizens shopping centers.

Ervis Iljazaj

Instruments of Parliamentary Diplomacy: The case of Italy

Lately, we have seen that alongside traditional foreign policy lead by governments there is also a new, informal kind of foreign relations, that is widespread and it involves directly or indirectly parliamentary structures. In some cases, these inter-parliamentary activities create short-term and transitory initiatives, but,

in other cases, they bring to life stable and permanent forms of collaboration. In this context, in the last years, it has been created an “environment” of inter-parliamentary relations that represents a valuable tool for solving issues among countries, even in hard moments. These collaboration practices between national parliaments are known as “parliamentary diplomacy”. This analysis will look at “parliamentary diplomacy”, focusing on Italy as its case study: created in 2001 to direct the collaboration among National Assemblies in order to participate in international governance. This study will analyze the instruments of “parliamentary diplomacy” by also looking at other cases, such as the inter-parliamentary dialog between European and Asian nations.

Marcela Mele & Erion Cuku

Good Governance: Representative Image for the Albanian Civil Society

Accompanied by a general movement in the industrial world, government has been the main focus in the development debate in the early '90s, not only about the need to restructure the organization of global governance, but also about restructuring of the state and state-society relations within these countries as a basic condition for sustainable development.

In this article appears transformation of some political scientists think about the way state and government, the role of civil society and especially the importance of governance ‘good’ for sustainable development. The concept of ‘good governance’, designed by the Rio Declaration and the World Bank in 1992 and adapted under the neoliberal approach to development, through its strategic mechanisms, contributes to long-term commitment to policy coherence through an open, transparent, comprehensive stakeholder to bring sustainable development strategies closer to the community and civil society. In this context, it is proposed as a thematic content analysis methodology, how a ‘good governance’, reflects the sustainable development strategies. The study emphasizes that strategic mechanisms are needed to distribute best practices and strategies to bring sustainable development closer to the people, in the format that they use to understand and change their behavior in a more durable. This study paves the way for future studies in reflection of good governance in sustainable development strategies, based on different approaches and methodologies.

Key words: good governance, sustainable development strategy, civil society, thematic content analysis, Albania.

The role of the mediator as third part in resolving disputes out of court

Erjona Canaj, Emiljano Aliu

Judicial resolution, which was considered as the only possible form of dispute resolution, in some cases, has given way to some other legal rules for resolving conflicts. One of these is the mediation, an extra judicial activity where the parties try to find a resolution of a dispute through a neutral third person (the mediator) to find a mutually acceptable not contrary to the law. Mediation has always been present in the Albanian society as customary law, religious or positive one, where we find models / examples of many traditional enforcement methods of mediating. The alternative of the mediation still presents interest nowadays in family, civil, commercial and criminal conflicts.

A special role in this institute plays the third-mediator; the person elected has the obligation to provide to the parties a transparent mechanism, faster and less costly to resolve disputes between them. The main role of an impartial mediator is to encourage the parties to a constructive discussion on the various components of the dispute, creating optimal conditions for handling and resolving the conflict. The results in these years, although not very satisfactory, however, show an increasing process and a further consolidation of the Institute.

The aim of this paper is the study of the role, the function and the methodology of the mediator, the evolution of this institute in our country, as well as the treatment of the third neutral party in resolving conflicts with new and modern methods.

On the other hand, this paper seeks to bring attention to a new and modern alternative of employment, because in the role of intermediaries may find themselves even young people who have completed programs of the first cycle, after having reached the age of 25 years, as an opportunity to exercise a free profession: mediator.

Keywords: *mediation, mediator, conflicts resolution, the new mediation law, the family, civil, penal and commercial mediator.*

The iron rule of oligarchy: An exploration into 'de facto' internal democracy of Albanian political parties

Ina Zhupa

This paper comes as a critical review on the internal democracy of the Albanian political parties in these 20 years. Trying to contribute to: what are the indicators for measuring internal democracy, why is it necessary and what shows about the state and the parties having or not, internal party democracy. Studied the statutes of the main parties to the Albanian scene today reveals all the modalities that they modify the internal democracy. What I noticed is that “de jure” these parties are democratic. On the other hand we see the practice of treating them thought otherwise, the exemptions and creation of new parties from factions and it results that “de facto” this parties are not democratic. For this reason, I suggest certain long-term solutions that can lead to de facto implementation of internal party democracy in Albania.

Key words: democracy, internal elections, faction, thought otherwise, one member-one vote, political parties.

Sino-Albanian political relations during the 70s

Alba Kreka

An unequal alliance is the best instrument of a great power to legitimize the art of governance, foreign policy goals and objectives against a small power. In bilateral relations between a Small Power and a Big Power, in most cases the Small Power has been seen more as a satellite than an equal ally. However an alliance may not necessarily form under the same conditions for both countries because that unite interests may not be the same economic and military but rather political interests. This was the case of China and Albania, which began an unequal relationship between them. China was interested in its political propaganda line and to challenge Soviet influence in Europe, which was dominant within the communist bloc.

Cooperation between PRA and CRP was extended to all areas. China was a model partner for Albania, which helped to move forward, while Albania played the role of the spokesperson of Chinese interests and attitudes in international organizations and in UN until the acceptance of China as a full rights member in

October 1971. After this China began to pursue an “open doors” policy which was described as “Ping-Pong diplomacy” in the terminology of that time. In the ‘70s and later, China became a powerful global player, which cannot be easily overruled. Albanian leadership had to reconsider its position inside the communist bloc because the new strategy of China’s foreign policy caused resentment towards the Albanian communist leader. At this time China began to pay more importance to national interests, leaving in the background Marxist-Leninist ideology, which had served as an important groundwork of sino-Albanian alliance.

Keywords: Alliance, inequality, policy, UN.

Dorina Ndoj

World Society: Conditionality through “Good Governance”

This paper aims to examine the concept of “good governance” within the theoretical perspective of the English School, focusing especially in the debate surrounding international and world society concepts. The paper argues that a premise of “good governance” contributes to the materialization of the world society. Good governance tends to lead states in making them internally similar, referring the shared norms and values that shape them even in individual level. The debate on the degree of extension and expansion of international society between pluralism and solidarism approach provides ground to discuss the link of world society and good governance concepts. It is mainly focused on the issues concerning human rights and homogeneity of the international structures of states.

Keywords: Good Governance, International Society, World Society, Pluralism, Solidarism

